

Nada Jovanova

KONTABILITETI
VITI I DYTË

2013

Autorë:

Nada Jovanova – SHMK “Jovçe Tesliçkov” – Veles

Recensues:

Mr. Borçe Trenovski – Universiteti “Kirili dhe Metodi” – Fakulteti Ekonomik – Shkup Jasmina

Gurçinovska – SHMEJQSH “Arseni Jovkov” – Shkup

Biljana Ninovska – SHMEJQSH “Vasil Antevski - Dren” Shkup

Përkthyes:

Besa Drndar

Redaktor i botimit në gjuhën shqipe:

Doc. dr. Seadin Xhaferi

Lektor i botimit në gjuhën shqipe:

Hamit Hajrullai

Rregullimi teknik:

Nikolla Ignov, inxhinier i diplomuar i makinerisë

Botues:

Ministria për Arsimit dhe Shkencë e Republikës së Maqedonisë

Shtypi:

Qendra grafike Shpk, Shkup

Tirazhi: 20

Me aktvendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë, nr. 22-4268/1, të datës 28.07.2010, aprovohet përdorimi i këtij teksti shkollor.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св.Климент Охридски”, Скопје

657(075.3)

ЈОВАНОВА, Нада

Сметководство : II година / Нада Јованова. - Скопје : Министерство за образование и наука на Република Македонија, 2010. - 227 стр. : илустр. ; 30 см

Појмовник: стр. 209-223

ISBN 978-608-226-041-9

COBISS.MK-ID 84259850

HYRJE

Suksesi ose mos suksesi i biznesit matet me para. Ndërsa vlera e parave është ajo që kontabiliteti e incizon. Kontabiliteti është gjuha e biznesit. Pavarësisht nëse jeni kyçur në biznes ose jo, mësimi i kontabilitetit do t'ju sjellë vetëm dobi. Menaxherët duhet patjetër të kenë njohuri të përkryer të transaksioneve financiare dhe të mënyrës në të cilën ato ndikojnë mbi rezultatet financiare. Të gjithë ato që janë të ndërlidhur me punën financiare të kompanisë si pronarë, investues, kreditorë, të punësuar apo qeveria dhe shërbimet shtetërore, duhet ta njohin kontabilitetin që të mund t'i matin performancat financiare të biznesit. Po ashtu, secili që do të gjendet në këtë rol, do të duhet që ta përvetësojë mirë kontabilitetin – mënyrën se si ripërtërihet, interpretohet dhe analizohet informata. Teksti shkollor *Kontabiliteti* është i dedikuar për nxënësit e vitit të dytë në shkollat e mesme të ekonomisë në R. e Maqedonisë të drejtimit ekonomik - juridik dhe tregtar, për nxënësit e shkollave të tjera të mesme, për studentët të cilët pas mbarimit të studimeve do të kërkojnë punësim, për ato të cilët kanë filluar me biznesin vetjak ose që duan të provojnë ta bëjnë këtë.

Ky tekst shkollor është shkruar sipas standardeve dhe trendëve të reja për përgatitjen e literaturës profesionale dhe mundëson mësim gradual nëpërmjet të menduarit, zbulimit, përfundimit dhe përgjithësimit, me ç'rast Ju duhet të merrni pjesëmarrje aktive dhe t'ju përcillni dhe përvetësoni me vëmendje përmbajtjet e reja.

Përmbajtjet në tekstin shkollor janë përpunuar në 10 tërësi tematike, të cilat janë në përputhje me programin mësimor për lëndën. Nëpërmjet tyre, Ju do të njohoheni me: *bazat e kontabilitetit; mjetet, obligimet dhe kapitalin; ngjarjet dhe llogaritë kontabiliste; librat kontabilistë; planin kontabilist; evidentimi i qarkullimit pagesor dhe kërkesave me para në dorë dhe pa para në dorë; evidentimi i materialeve dhe shpenzimeve; evidentimi i obligimeve dhe kapitalit (burimet e mjeteve), hyrjet dhe të dalat dhe kuptohet rezultati financiar.*

Ky tekst shkollor ka për qëllim që të Ju ndihmojë t'ju "lexoni" transaksionet financiare dhe nëse keni sukses në këtë, atëherë qëllimi është arritur. Sinqerisht, shpresoj se ky libër do ua bëjë të këndshëm çastet e leximit dhe të mësimi.

Veles

Autori

Tema 1:

BAZAT E KONTABILITETIT

PËRMBAJTJA E TEMËS:

- Kontabiliteti si burim i informatave dhe si formë e komunikimit
- Shfrytëzuesit e informatave kontabiliste
- Nocioni, domethënia dhe roli i kontabilitetit financiar
- Rregullativa profesionale në profesionin e kontabilistit
- Parimet dhe rregullat kontabiliste
- Kontabiliteti i dyfishtë

QËLLIMET E MËSIMIT:

Nxënësi:

- ta definojë kontabilitetin si burim të informatave
- t'i identifikojë shfrytëzuesit kryesorë të informatave kontabiliste,
- ta kuptojë rolin e kontabilitetit financiar,
- ta njohë rregullativën profesionale në kontabilitet,
- t'i sqarojë parimet e kontabilitetit,
- t'i kuptojë bazat e kontabilitetit të dyfishtë.

KONTABILITETI SI BURIM INFORMATAVE DHE SI FORMË E KOMUNIKIMIT

Kontabiliteti është procesi i identifikimit, matjes (vlerësimit) dhe këmbimit (komunikimit) të informatave ekonomike, i cili do të mundësojë marrje të vendimeve nga ana e shfrytëzuesve të informatave.

Kontabiliteti është burim i rëndësishëm i informatave. Informatat kontabiliste i siguron sistemi informativ kontabilist. Kontabiliteti është burim i rëndësishëm i informatave, ndërsa informatat financiare janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve nga ana e shfrytëzuesve të atyre informatave. Për këtë arsye, mësimi i kësaj disipline do të kërkojë të njoftohemi me format e ndryshme të organizatave dhe llojet e aktiviteteve që ato i kryejnë. Në këtë kontekst, do të njoftohemi me kontabilitetin si formë e komunikimit me ato të cilët në njëfarë mënyre kanë interes për punën financiare të kompanisë, si edhe me raportet kontabiliste financiare.

Shumica e njerëzve kanë paraprakisht parafytyrim ose ide rreth asaj se çka është kontabiliteti. Ato mendojnë se kontabiliteti është procedurë shumë e ndërlikuar e aktiviteteve të cilat i zbatojnë njerëzit të cilët janë *të mirë në matematikë*. Ky shënim për kontabilitetin është shumë i kufizuar (i ngushtë) dhe në fokus është vetëm shënimimi i ngjarjeve në kontabilitetin dhe mbajtje (ruajtje) e librave si aspekte të disiplinës. Në esencë, kontabiliteti është shumë më i gjerë nga ajo që është thënë paraprakisht. Specifike është ajo që kontabiliteti është *“proces i identifikimit, matjes (vlerësimit) dhe këmbimit (komunikimit) të informatave ekonomike, i cili do të mundësojë marrje të vendimeve nga ana e shfrytëzuesve të informatave”*.



Kontabiliteti është burim i rëndësishëm i informatave

Secili nga tre aktivitetet e cekura në këtë përkufizim: identifikimi, matja (vlerësimi) dhe këmbimi (komunikimi), kërkojnë njohuri përkatëse nga ana e profesionistit – kontabilistit të arsimuar (trajnuar). Kontabiliteti, në suazat e funksionimit të ndërmarrjeve, ka rol dhe rëndësi të veçantë. Kjo rrjedh nga fakti që kontabiliteti paraqet sistem të identifikimit, të matjes,

të analizimit dhe të dërgimit të informatave përkatëse të shfrytëzuesit e atyre informatave për marrjen e vendimeve afariste racionale dhe efikase. Kontabiliteti paraqet funksion të nevojshëm për çdo ndërmarrje bashkëkohore. Ai i përfshinë dhe i përpunon të gjitha informatat financiare të cilat rrjedhin nga zhvillimi i biznes – aktiviteteve. Njëkohësisht, kontabiliteti jep edhe prezantim analitik të këtyre informatave, të cilat janë të domosdoshme për marrjen e vendimeve afariste përkatëse nga ana e menaxhmentit në aspekt të efekteve nga shfrytëzimi i resurseve. Rëndësi jo më pak të vogël kanë edhe kontabiliteti shtetëror dhe kontabiliteti i organizatave jo fitimprurëse.

Realizimi i detyrave të ndërmarrjes në masë të madhe varet nga informatat kontabiliste. Këto informata u ndihmojnë menaxherëve në situatat dhe problemet më të ndryshme, të marrin vendime afariste racionale për zgjidhjen e suksesshme të problemeve dhe për arritjen e fitimit më të madh. Informatat kontabiliste i **siguron sistemi informativ kontabilist (SIS)**. Ky

Informatat kontabiliste i siguron sistemi informativ i kontabilitetit.

sistem, si nënsistem i sistemit informativ të ndërmarrjes ka rëndësi dhe rol të madh. Kontabiliteti, nëpërmjet planifikimit, kontrollit dhe analizës, si edhe me përpunimin kompjuterik, në kushte bashkëkohore të veprimit, shndërrohet në instrument shumë të rëndësishëm për menaxhimin efikas me ndërmarrjen.

Me rëndësi është të theksojmë se nuk mund të merret çfarëdo vendimi ekonomik pa informata përkatëse kontabiliste. Sipas kësaj, kontabiliteti është gjuha për aktivitetet ekonomike dhe çdo ndërmarrje dhe pa dallim në madhësinë dhe llojin e saj, mbështetet në kontabilitetin për shkak të vendim-marrjes afariste efikase.

Kontabiliteti është **veprimtari shërbyese**. Siç mund të vërehet, qëllimi i tij është të sigurojë informata financiare për marrjen e vendimeve. Kontabiliteti është **shkencë shoqërore**. Parimet kontabiliste janë shumë më të ndryshme nga rregullat që sundojnë në shkencat natyrore. Për shembull, sipas ligjeve të natyrës, nëse lëshon ndonjë send prej dore, ai më parë do të bjerë në tokë se sa të mbesë në ajër. Nuk ka rregulla që janë të krahasueshme me ato të kontabilitetit. Parimet që sundojnë në informimin kontabilist nuk udhëhiqen sipas ligjeve të natyrës, por zhvillohen si rezultat i kushteve të ndryshuara afariste. Për shembull, i atillë ka qenë rasti me marrjen e ndërtesës afariste me qira. Marrja me qira është zhvilluar si përgjigje në nevojën për pasjen e qasjes në mjetet me vlerë të konsiderueshme, si zyrat dhe ngjashëm, pa paguar shumë të madhe për blerjen e atij mjeti. Pasi marrja me qira është gjithnjë e më e popullarizuar, u lejua që nga ana e kontabilistëve të zhvillohen udhëzime prej të cilave disa edhe shumë të ndërlikuara, me qëllim që të ndiqen gjatë mbajtjes së kontabilitetit të marrjes me qira. Këto udhëzime, deri më tani, janë pjesë e parimeve të mbarë pranuar kontabiliste.

SHFRYTËZUESIT E INFORMATAVE TË KONTABILITETIT

Klasifikimi themelor i shfrytëzuesve të informatave kontabiliste para së gjithash është në:

- shfrytëzues të brendshëm dhe
- shfrytëzues të jashtëm

Shfrytëzues të brendshëm

Shfrytëzuesit e brendshëm para së gjithash janë menaxherët e kompanisë të cilët janë të përfshirë në biznesin e përditshëm. Shfrytëzuesit e brendshëm janë në pozitë të fitojnë informata financiare në mënyrën e cila më së shumti u konvenon nevojave të tyre. Për shembull, nëse menaxheri prodhues i firmës “Mareli” ka nevojë të dijë se sa kushton prodhimi i një njësie akul-

Shfrytëzuesit e brendshëm para së gjithash janë menaxherët e kompanisë të cilët janë të përfshirë në biznesin e përditshëm.

lore, kjo informatë ekziston në sistemin kontabilist dhe mund të publikohet. Nëse departamenti (seksioni) i supervizionit do që të zbulojë ose të lajmërojë nëse shpenzimet mujore (harxhimet) janë më të mëdha ose më të vogla nga shuma e planifikuar (buxhetore), raporti mund të jetë i bërë në atë mënyrë që të sigurojë përgjigje. Shfrytëzuesit e brendshëm Kontabiliteti menaxher ^{*1} është branshë informative (degë) e kontabilitetit e cila kujdeset që shfrytëzuesve kontabilistë të brendshëm (menaxhmentit) tu mundësojë informata që ta lehtësojë planifikimin dhe funksionin kontrollues.



Shfrytëzuesit e brendshëm të informatave kontabiliste.

Shfrytëzuesit e jashtëm të informatave kontabiliste nuk janë drejtpërdrejt të kyçur në operacionet e biznesit.

Shfrytëzuesit e jashtëm

Shfrytëzuesit e jashtëm janë ato të cilët nuk janë drejtpërdrejt të kyçur në operacionet e biznesit, por kanë nevoja për informata të cilat dallohen nga nevojat e shfrytëzuesve të brendshëm. Mundësia që shfrytëzuesit e jashtëm të fitojnë informata është më shumë e kufizuar. Ato nuk kanë kontakt të përditshëm me punën e biznesit dhe doemos duhet të mbështeten në informatat që ua prezanton menaxhmenti i kompanisë.

Shfrytëzues të caktuar të jashtëm, si për shembull, **Drejtoria e të Hyrave Publike**, kërkojnë që informata të prezantohet në mënyrë shumë specifike dhe të sigurohet me ligj, që të jenë të sigurt se do ta marrin. Aksionarët, pronarët e obligacioneve dhe kreditorët tjerë, për informatat e tyre, doemos duhet të mbështeten në raportet financiare të përpiluara nga kontabiliteti financiar, në përputhje me qëllimet e përgjithshme. **Kontabiliteti financiar** paraqet degë (branshë) të kontabilitetit e cila përpilon raporte financiare për dedikim të përgjithshëm që do t'i përdorin edhe menaxhmenti edhe personat e jashtëm.

Aksionarët dhe aksionarët potencial. Të dy grupet e shfrytëzuesve ekzistojnë dhe kanë nevojë për informata financiare që janë të ndërlidhura me biznesin. Nëse aktualisht posedon aksione në një kompani, ke nevojë për informata e cila do të ndihmojë në vendimin a të vazhdosh ta kesh aksionin



Shfrytëzuesit e jashtëm të informatave kontabiliste.

ose ta shesësh, ose po, nëse ke ndërmend të blesh aksion në kompani, ke nevojë për informata financiare e cila do të ndihmojë në zgjedhjen ndërmjet investimeve alternative konkurrense. Si janë performansat e paradokohshme të kompanive në tregun e aksioneve? Sa është përfitimi i tyre për vitin e kaluar të fundit? Si e krahasojnë ato përfitimin me atë të vitit paraprak? Sa ka paguar kompania për dividendë? Një burim për sigurimin e këtyre informatave janë kompanitë financiare.

¹ Ky kontabilitet mund të haset edhe me emrat: kontabilitet menaxhues, kontabilitet i menaxhmentit afarist, kontabiliteti menaxhues, kontabiliteti i brendshëm etj.

Shfrytëzuesit ekstern të informatave kontabiliste. Pronarët e obligacioneve, bankierët dhe kreditorët tjerë. Para se të blesh obligacione në një kompani (mbaje mend se ti i huazon para kompanisë), ti duhet të ndihesh i sigurt se kompania do të jetë e aftë të ta paguajë shumën që e ka borxh në ditën e arkëtimit, si edhe të paguajë kamatë. Raportet financiare mund të ndihmojnë të vendosësh a ta blesh obligacionin. Ngjashëm me këtë, para se të japë para hua, banka ka nevojë për informata të cilat do t'i ndihmojnë ta përcaktojë aftësinë e kompanisë për ta kthyer shumën e huas, si edhe kamatën. Në këtë mënyrë, tërësia e raporteve financiare është punë personale në propozimin për hua.

Agjencitë qeveritare. Agjenci të shumta qeveritare kanë nevojë për informata të specifikuar sipas ligjit. Për shembull, **Drejtoria e të Hyrave Publike** ka autorizim të grumbullojë tatime nga fitimi, edhe nga individë edhe nga firmat. Çdo vit kompania përgatit fletëparaqitje tatimore me qëllim që ta njoftojë Drejtorinë e të Hyrave Publike për shumën e përfitimit që e ka realizuar. Agjenci tjetër qeveritare është **Komisioni për Letra me Vlerë**. Kjo Agjenci rregullatore është e autorizuar t'i vendosë rregullat sipas të cilave përgatiten raportet financiare për korporatat të cilat ia shesin aksionet e veta publikut në bursat e organizuara të aksioneve. Ngjashëm me Drejtorinë e të Hyrave Publike edhe Komisioni për Letra me Vlerë ka autorizim që ta përcaktojë mënyrën në të cilën është prezantuar informata financiare në raport. Kompanitë të cilat punojnë në industrinë e specializuar, i parashirojnë raportet financiare te agjencitë tjera rregullatore. Në R. e Maqedonisë, këtë rol e kanë: Drejtoria e të Hyrave Publike, Komisioni për Letra me Vlerë, Regjistri Qendror dhe Oda Ekonomike e R. së Maqedonisë.

Shfrytëzuesit tjerë të jashtëm. Shumë individ dhe grupe të tjera mbështeten në informatat financiare që u janë dhënë nga bizneset. **Furnizuesi** i lëndëve të para duhet ta dijë aftësinë kreditore të kompanive para se ta shesë prodhimin në kredi, si pjesë e negociatave të tij për shpenzimet e zmadhuara për jetë, **sindikata** ka nevojë për informata për profitabilitetin e kompanisë. Me qëllim që ta promovojë industrinë e vet, **asociacioni tregtar** doemos duhet të grumbullojë informata financiare nga kompanitë e ndryshme në industri. Shfrytëzues tjerë të rëndësishëm janë **ndërmjetësuesit financiar**, siç që janë **brokerat aksionar dhe analistët financiar**. Atë shfrytëzojnë raporte financiare gjatë këshillimit të klientëve të tyre për vendimet investuese. Me qëllim që t'i realizojnë vendimet e veta, ato mbështeten në shtrirje të gjerë të informatave kontabiliste, që ua ka siguruar menaxhmenti.

NOCIONI, RËNDËSIA DHE ROLI I KONTABILITETIT KONTABILIST

Në praktikë, nocionet kontabilitet dhe mbajtja e kontabilitetit shpesh herë përdoren si sinonime, jo vetëm nga ana e njerëzve të rëndomtë por edhe nga persona të cilët kanë arsimim ekonomik dhe njohuri të shkencës ekonomike. Mirëpo, situata është ndryshe dhe këto nocione dallojnë shumë në domethënie dhe nuk duhet të njësohen, së paku jo nga personat e grupit të dytë të përmendur ku bëjnë pjesë teknikët ekonomik dhe ekonomistët e diplomuar në përgjithësi.

Mbajtja e **kontabilitetit** më së shpeshti definohet si sistem për evidentimin e mjeteve, burimeve të financimit (kapitali dhe obligimet), si edhe shpenzimet, të dalat dhe hyrjet, nëpërmjet ngjarjeve ekonomike të cilat e bëjnë transformimin e tyre në drejtim të rritjes ose zvogëlimit të tyre. Mbajtja e kontabilitetit është ajo pjesë e sistemit kontabilist në të cilin bëhet evidentimi dokumentar dhe formal në të cilin në mënyrë kronologjike dhe sistematike evidentohen ndryshimet afariste në ndërmarrje. Gjatë mbajtjes së kontabilitetit bëhet grumbullimi, evidentimi dhe sistematizimi i të dhënave dhe nga ai aspekt, është bazë e të dhënave në sistemin kontabilist dhe pjesa e tij më e rëndësishme, pasi pa të, pjesët tjera të sistemit kontabilist nuk do të mund të ekzistojnë.

Kontabiliteti zakonisht ndahet në:

- Kontabilitet menaxhues (administrativ),
- Kontabiliteti i shpenzimeve, dhe
- Kontabiliteti financiar.

Kontabiliteti zakonisht ndahet në:

- Kontabilitet menaxhues
- Kontabiliteti i shpenzimeve, dhe
- Kontabiliteti financiar.

Kontabiliteti menaxhues (administrativ) jep informata të nevojshme për ato të cilët e udhëheqin biznesin, gjegjësisht për nevojat interne. Menaxherët kanë nevojë për informata nëpërmjet të cilave do të vlerësojnë çfarë kanë bërë në periudhën kaluar dhe çka duhet të presin në të ardhmen. Profitabiliteti dhe likuiditeti i arritur do të jetë udhërrëfyes për marrjen e vendimeve për aktivitete financiare, investuese dhe operative. Ato duhet të marrin vendim për shembull, a të ndërtojnë fabrikë të re, sa të harxhojnë për kërkime dhe zhvillim, të blejnë ose të marrin me qira pajisje, ta prodhojnë ose ta blejnë pjesën përbërëse të prodhimit ose të shesin prodhim të caktuar. Kontabiliteti menaxhues është ai i cili i jep informatat e nevojshme për marrjen e këtyre vendimeve. Këto informata janë shumë më të hollësishme nga ato të cilat i jep kontabiliteti financiar.

Kontabiliteti i shpenzimeve është i njohur edhe si kontabiliteti i brendshëm ose i repartit. Ky kontabilitet, i dedikuar kryesisht për nevojat interne, e bën klasifikimin, grumbullimin dhe renditjen e shpenzimeve sipas bartësve. Mendohet për alokimin e shpenzimeve nëpër prodhues ose grupe të prodhimeve me qëllim që të përcaktohet profitabiliteti i çdo prodhimi ose grupit të prodhimeve. Kontabiliteti i shpenzimeve paraqet përpunim më të hollësishëm të kontabilitetit financiar, edhe atë në pjesën që ka të bëjë me rezultatet dhe suksesin sipas rezultateve.

Kontabiliteti financiar është sistem i evidentimit të mjeteve, burimeve (kapitali dhe obligimet), shpenzimeve, të dalave dhe të hyrave, nëpërmjet ngjarjeve afariste që e bëjnë transformimin e tyre, i evidenton në vlefshmëri dhe në këtë mënyrë grumbullon të dhëna, i sistematizon, i sintetizon dhe në formë të raporteve finale ua prezanton shfrytëzuesve të ndryshëm. Sipas kësaj, **detyra e kontabilitetit financiar është ta bëjë, përpilojë, bilancin e gjendjes, raportin për rrjedhën e parave** dhe t'i furnizojë pronarët me një këndvështrim të vërtetë dhe të ndershëm mbi ndërmarrjet dhe përskaj kësaj, t'i kënaq edhe kërkesat ligjore. Kontabiliteti financiar siguron informata për shfrytëzuesit e jashtëm. Nga e lartpërmendura, rrjedh se kontabiliteti financiar është obligim ligjor i minimum evidencës kontabiliste në ndërmarrjet, pavarësisht se për cilin shtet bëhet fjalë. E atillë është edhe gjendja me kontabilitetin financiar në Maqedoni, ai është kontabilitet financiar dhe paraqitet nga të gjitha ndërmarrjet në formën dhe mënyrën siç është përcaktuar në Ligjin për kontabilitetin.

Kontabiliteti financiar është sistem i evidentimit të mjeteve, burimeve, shpenzimeve, të dalave dhe të hyrjeve dhe në formë të raporteve finale ua prezanton shfrytëzuesve të ndryshëm.


Ndërmarrjet, jo vetëm që mundën por edhe duhet evidencën kontabiliste ta vendosin në rrafsh më të lartë nga ai i përcaktuar me ligj, në dy drejtime. Së pari, kontabilitetin financiar ta thellojnë, me ç'rast do t'i kenë parasysh nevojat e veta dhe së dyti, përveç kontabilitetit financiar, evidencën kontabiliste ta zgjerojnë me evidencën e shpenzimeve dhe punës së bërë, me evidencën materiale dhe ngjashëm, në përputhje me nevojat e tyre individuale.




Kontabiliteti financiar është pjesë e kontabilitetit

Kontabiliteti financiar është sistem i evidencës së mjeteve, burimeve, shpenzimeve, të dalave dhe të hyrave dhe në formë të raporteve përfundimtare ua prezanton shfrytëzuesve të ndryshëm.

Pasqyrimi skematik i vendit të kontabilitetit financiar në strukturën organizative të ndërmarrjes.



Fotografia 1



Fotografia 2

Kontabiliteti duhet të kuptohet si fushë më e gjerë e cila përveç mbajtjes së kontabilitetit përfshin edhe aktivitete tjera. Për kontabilitetin hasen më shumë interpretime dhe përkufizime por ne do të përcaktohem për atë sipas së cilit kontabiliteti shihet si sistem i shënimit, analizimit dhe sistematizimit të të dhënave mikroekonomike dhe përpilimit të informatave të cilat rrjedhin në atë mënyrë që motivon aksione të zakonshme të personat për të cilët janë të dedikuara ato informata. Nga ajo që u tha deri tani, rrjedh se edhe mbajtja e kontabilitetit edhe kontabiliteti financiar janë vetëm nënsisteme, pjesë të kontabilitetit. Por, për shkak të rrethanave historike, vëllimit dhe rëndësisë së këtyre pjesëve, vjen deri në njësimin e mbajtjes së kontabilitetit me kontabilitetin, edhe pse dallimet janë qartë të dukshme.

Kohëve të fundit, hasim në përpjekje që të zgjerohet përkufizimi për kontabilitetin dhe për aktivitetin e tij, me atë që shtohen edhe rolet e tij: kontrollues, menaxhues, parashikues dhe ngjashëm, që sipas mendimit tonë, kontabiliteti i ka pasur përherë. Njëkohësisht, duhet të kuptohet se ka evoluim të ndryshëm dhe këndvështrime të ndryshme prej vendi në vend, prej autori në autor. Mirëpo, ato dallime nuk janë atë mëdha që ta shtrembërojnë pasqyrën për kontabilitetin.

Rregullat juridike të kontabilitetit financiar. Kontabiliteti financiar, si pjesë e kontabilitetit, në masë të madhe i është dedikuar përpilimit të raporteve financiare të cilat para së gjithash, janë të dedikuara që të kënaqin një pluralizëm të interesave. Këto grupe interesash janë të ndara në eksterne edhe atë: investitorë, kreditorë, sindikatë, agjenci qeveritare dhe grupe

interne dhe individ të tjerë, siç janë: organet e menaxhimit dhe individë të ndryshëm, ushtrues të funksioneve të caktuara në ndërmarrje.

Në praktikën tonë, materia kontabiliste, edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, më 01.02.1945 u bë lëndë e rregullimit ligjor. Pas kësaj periudhe ekziston tendencë për rritjen e ndikimit ligjor mbi kontabilitetin, që arriti deri në kufirin kur në masë të madhe e frenon kreativitetin e kontabilistit si profesionist në kryerjen e funksionit të tij. Ai është shndërruar në statistikë mbajtës i rëndomtë, i cili i përmbush formularët në llogarinë përfundimtare sipas një rendi rreptë të përcaktuar. Për fat, gjendja e këtillë është vërejtur dhe në ndryshimet e fundit të rregullave në fushën e kontabilitetit, me ç'rast zvogëlohet fusha e ndikimit të ligjeve. Në fund, bazat dhe rregullorja e kontabilitetit financiar janë: shkenca (dituria profesionale), Ligji për kontabilitetin, urdhëresat për plan të kontos dhe përmbajtja e llogarive, standardet kontabiliste, parimet dhe principet kontabiliste, Kodi i etikës profesionale dhe praktika pozitive.

RREGULLATIVË PROFESIONALE NË PROFESIONIN KONTABILIST

Parashtrohet pyetja: kush i përcakton rregullat të cilat doemos duhet të respektohen gjatë përpilimit të bilancit të suksesit dhe bilancit të gjendjes? Ne e dimë se qeveria, nëpërmjet Drejtorisë së të Hyrave Publike dikton kërkesa gjatë përgatitjes së bazës për përlllogaritjen e tatimeve mbi fitimin ose për kthimin e tatimit më shumë të përlllogaritur. Si do që të jetë, as qeveria, as cilido grup në sektorin privat nuk është tërësisht përgjegjës për vendosjen (sjelljen) e standardeve ose parimeve të cilat doemos duhet të respektohen gjatë përpilimit të raporteve financiare. Në esencë, procesi është, angazhim i bashkuar (i përbashkët) i punës. Në këtë kuptim, do të japim një arsytim të shkurtër për grupet e përfaqësuara në SHBA, e të cilët janë liderë në botë, dhe të cilët kanë qenë të përfshirë në përgatitjen e parimeve kontabiliste të mbarë pranuar.

Rregullativa profesionale

Komisioni për Letra me Vlerë. Qeveria federale nëpërmjet Komisionit për Letra me Vlerë ka rol të rëndësishëm në përcaktimin e rregullave të cilat duhet të ndiqen gjatë përpilimit të raporteve financiare për kompanitë, letrat me vlerë të cilave janë shitur në publik. Komisioni për Letra me Vlerë, kërkon që kompanitë, të dorëzojnë raporte financiare vjetore dhe tremujore, si edhe lloje të tjera të raporteve që janë në bazë kohore. Edhe pse Komisioni ka autorizim që t'i vendosë parimet konta-



Puna në bursë

biliste, ato kanë shtrirje të gjerë e cila i mundëson profesionit kontabilist që të etablojë rregulla të veta. Komisioni, kohë pas kohe intervenon dhe dikton çështje të caktuara, kur beson se profesioni nuk është përgjigjur mjaft shpejtë ose nuk është sjellë në mënyrë korrekte.

Këshilli për standarde për kontabilitetin financiar. Këshilli për standarde për kontabilitetin financiar e ka autorizimin që ta vendosë kompletin (setin) e standardeve kontabiliste në SHBA. Edhe pse Këshilli pranon mjete nga burimet e ndryshme, ai ekziston si grup i pavarur me 7 anëtarë të punësuar në mënyrë të rregullt, të përkrahur nga ana e personelit të madh. Nëpër punën e Këshillit, prej formimit të tij deri tani kanë kaluar më shumë se 100 standarde financiare - kontabiliste. Këto standarde mundësojnë ballafaqim me çështje të ndryshme në raportet financiare, siç janë: kontabiliteti për qira (dhënie me qira) për letra me vlerë, nga planet financiare etj. Në shtojcë të kësaj, Këshilli ka përcaktuar 6 raporte të cilat kanë të bëjnë me konceptet e kontabilitetit financiar, të cilat shfrytëzohen si doracakë (udhëzues) të cilët i përdor Këshilli që t'i vendosë standardet kontabiliste. ,



letra me vlerë - aksioni

Instituti amerikan për kontabilistët e autorizuar publik. Instituti amerikan për kontabilistët e autorizuar ka rol aktiv në vendosjen e standardeve kontabiliste. Ai i vendos standardet revizore të cilat duhet t'i përdorin firmat publike kontabiliste në sigurimin e shërbimeve për klientët e tyre. Instituti amerikan për kontabilistët e autorizuar publik është organizatë profesionale e kontabilistëve të autorizuar publik. Emri **kontabilist i autorizuar publik** është emërtim profesional për kontabilistët të cilët kanë dhënë provim rigoroz dhe kanë përfituar përvojë të caktuar. Të gjithë anëtarët japin provim profesional mirë të përpiluar, të organizuar dhe specifik, ndërsa ato që do ta japin këtë provim, fitojnë certifikatë përkatëse dhe bëhen anëtarë të këtij asociacioni.

Standarde ndërkombëtare kontabiliste (SNK)

Raportet financiare përpilohen dhe prezantohen me qëllim që t'i kënaqin nevojat e shfrytëzuesve ekstern nga ana e numrit të madh të ndërmarrjeve anembanë botës. Ekzistojnë dallime ndërmjet vendeve të caktuara në drejtim të formës dhe përmbajtjes së raporteve financiare. Këto dallime vërehen në definimin e ndryshëm të elementeve të raporteve financiare, përdorimit të kriterëve të ndryshëm për pranimin e zërave në raportet financiare ose në dhënien e përparësisë në drejtim të shfrytëzimit të bazave të ndryshme të matjes.

Sipas kësaj, Komiteti për Standarde Ndërkombëtare Kontabiliste (KSNK) është i autorizuar t'i ngushtojë dallimet e këtylla ndërmjet harmonizimit, standardizimit dhe procedurave në lidhje me përpilimin dhe prezantimin e raporteve financiare.

Komiteti për Standardet Ndërkombëtare Kontabiliste është trup i pavarur në sektorin privat. Është formuar në vitin 1973, me qëllim që të mundësojë njësim të parimeve kontabiliste në drejtim të informimit financiar anembanë botës. Prej vitit 1083, Komiteti për Standarde Ndërkombëtar Kontabiliste, në punën e vet ka kyçur shumë organizata të tjera.

Këshilli i KNSK, ka lëshuar rreth 40 standarde ndërkombëtare kontabiliste, si edhe kornizë për përgatitjen dhe prezantimin e raporteve financiare.



Kontabiliteti bazohet mbi zbatimin e më shumë dispozitave ligjore.

Te ne, Ministria e Financave, në përputhje me rregulloren ligjore, u përcaktua që t'i pranohet SNK dhe KSNK të përcaktuar si standarde kontabiliste të cilat zbatohen në Maqedoni prej më 1 janar 1998. Sot, këto standarde riemërtohen në Standarde ndërkombëtare për informimin financiar.

Rregullimi profesional i sistemit kontabilist në Republikën e Maqedonisë.

Në Republikën e Maqedonisë nuk ka organizatë profesionale të kontabilistëve (në periudhën e kaluar më shumë se 40 vjet ka funksionuar Lidhja e Kontabilistëve, finansistëve dhe revizorëve, por për fat të keq, nuk ekziston më). Ekzistojnë më shumë asociacione nga sfera e profesionit kontabilist, megjithatë, të gjitha ato asociacionet janë në funksion të firmave konsultative të cilat i kanë formuar. Firmat konsultative të cilat veprojnë në territorin tonë bëjnë interpretim të rregullave të rregullativës kontabiliste. Që do të thotë se ato lëshojnë revista të shumta profesionale, doracakë, këshillime gjatë përpilimit të llogarive vjetore, përcaktim të amortizimit, revalorizim, organizim të seminareve dhe ngjashëm. Mirëpo, është për tu shënuar fakti se të gjitha shërbimet që i ofrojnë, i ofrojnë vetëm me një qëllim, dhe ky është realizimi i profitit, respektivisht, rritja e rezultatit financiar personal.

Të gjitha ingerencat e Asociacionit profesional kontabilist në R. e Maqedonisë i ndërmori Instituti i Revizorëve të Autorizuar (si shoqatë profesionale odash) dhe Këshilli për përparim dhe mbikëqyrje të revizionit.

Ligji i ri për shoqëritë tregtare, për dallim nga Ligji për shoqëri tregtare i cili me ndryshimet nga viti 2001, përmbante dispozita për kontabilist dhe revizor të autorizuar, me asnjë dispozitë nuk e trajton kontabilistin përgjegjës si person i ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit të tregtari, as që përmban dispozita të cilat i trajtojnë organizatat profesionale të kontabilistëve. Në Ligjin për shoqëritë tregtare, ekzistojnë vetëm dispozita që kanë të bëjnë me revizorin e autorizuar. Ligji për revizion, përveç tjerave, i përcakton kushtet për fitimin e titullit revizor i autorizuar, por jo edhe për titullin kontabilist i autorizuar.

Në përputhje me të lartpërmendurën, vetë tregtarët vendosin për atë se kush dhe çfarë personi do ta mbajë kontabilitetin e tyre.

Kur bëhet fjalë për organizatat profesionale kontabiliste në Republikën e Maqedonisë, për fat të kemund të konstatohet se nuk ekziston asnjë organizatë kontabiliste profesionale.

Në R. e Maqedonisë, ekziston asociacion profesional revizor, që është një hap para në Rregullimin profesional të profesionit revizor, por jo edhe të profesionit kontabilist. Respektivisht, kontabiliteti dhe revizioni, edhe pse janë ngushtë të ndërlidhur ndërmjet veti, ato nuk janë profesione dhe fusha shkencore identike. Kjo do të thotë se praktika kontabiliste në Republikën e Maqedonisë është tërësisht e rregulluar me legjislacionin i cili shtrihet në territorin tonë. Kontabiliteti si profesion dhe sistem tërësisht është në funksion të sistemit të tregut, bën nxitjen dhe përkrahjen e iniciativës private dhe rritjes së profitabilitetit të subjekteve ekonomike. Nevoja për ekzistimin e asociacionit profesional kontabilist në Maqedoni është e paevitueshme.

Siç ekzistojnë organizata profesionale në numrin më të madh të vendeve në botë, ashtu edhe te ne është e domosdoshme të ekzistojnë organizata profesionale të cilat do të angazhoheshin në sferën e kontabilitetit, si në plan shkencor ashtu edhe në atë teorik. Është e domosdoshme organizatë e cila do të vepronte si organizatë konsultative në koordinimin e hulumtimeve metodologjike dhe teorike, dhënien e mendimit në lidhje me punën kontabiliste, realizimi i studimeve, ofrimi i mjeteve ndihmëse të shumta, i doracakëve, angazhimi në fushën e edukimit të kuadrove, si edhe lëshimin e standardeve kontabiliste dhe revizore dhe ngjashëm. Përcjellja e kërkesave bashkëkohore e implikon nevojën për ekzistimin e institucioneve të cilat duhet të jenë në rrjedhë me ndryshimet të cilat janë krijuar në standardet ndërkombëtare kontabiliste, respektivisht përcjelljen e përmirësimeve të tyre, përparimet dhe ngjashëm. Kjo do të thotë se edhe rregullorja jonë duhet t'i ndjekë ndryshimet në standardet ndërkombëtare kontabiliste dhe shpejtë dhe në mënyrë efikase t'u përshtatet trendeve botërore. Në rast se nuk ndiqen trendet botërore bashkëkohore, praktika jonë kontabiliste do të vijë në shtatë kur do të ngecë në mënyrë të konsiderueshme pas praktikës bashkëkohore kontabiliste.

Profesioni kontabilist dhe etika profesionale

Kontabiliteti si profesion dhe sistem i cili në shtetet perëndimore evropiane ka traditë më të gjatë, është tërësisht në funksion të sistemit të tregut, nxitje dhe përkrahje të iniciativës private dhe rritje të profitabilitetit të subjekteve ekonomike.

Parë historikisht, kontabiliteti është profesion shumë i vjetër. Por bazi shkencor dhe ndryshimet më bashkëkohore janë të datës më të re. Gjegjësisht, në periudhën kur është paraqitur tregtia, ka lindur edhe nevoja për mbajtjen e librave afarist. Niveli i sotëm i zhvillimit të kontabilitetit është rezultat i përparimit të shpejtë tekniko – teknologjik në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Ai ka nevojë të ndryshohet, të përkryhet dhe të përshtatet që të jetë në funksion të nevojave dhe kërkesave bashkëkohore. Andaj bëhen përpjekje për edukimin e përhershëm të kontabilistëve dhe sjelljes së tyre

Kontabiliteti si profesion dhe sistem është tërësisht në funksion të sistemit të tregut, nxitje dhe përkrahje të iniciativës private dhe rritje të profitabilitetit të subjekteve ekonomike.

etike, si edhe ngritjes së kualitetit dhe renomesë së profesionit kontabilist



Kontabilisti duhet të jetë mjaft i informuar.

në nivel më të gjerë. Kontabilistët duhet ta kryejnë detyrën e tyre në mënyrë të ndërgjegjshme, objektive dhe të pavarur. Ato duhet të kujdesen për ripërtirjen e diturive, por edhe për fitimin e njohurive të reja. Kjo arrihet nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare të ndryshme, simpoziume dhe forma të ngjashme të cilat i organizojnë institucionet, organizatat dhe asociacionet kryesore. Karakteristikat e kontabilistit të mirë

janë: evidentues, i organizuar, i aftë për ndjekjen e instruksioneve, i aftë për zhvillimin e shprehive të mira për mbajtjen e evidencës, të dijë t'i shfrytëzojë të dhënat. Kontabilisti duhet të jetë mirë i informuar.

PARIMET DHE RREGULLAT KONTABILISTE

Mbajtja shumëvjeçare e kontabilitetit detyrimisht ka çuar deri në përkryerjen, në thjeshtëzimin dhe racionalizimin e tij. Zbatimi konsekuent i rregullave të vendosura garanton kryerje të suksesshme të detyrave kontabiliste. Si rregulla më të rëndësishme kontabiliste mund të veçohen:

1. Dokumentimi
2. Rregullsia
3. Pasqyrimi
4. Azhurnimi
5. Ndërlidhja
6. Tërësia
7. Unifikimi

1. Dokumentimi:

Një nga rregullat themelore dhe të mbarë pranuar të mbajtjes së evidencës kontabiliste është dokumentimi. Nuk mund të parafytyrohet dhe nuk lejohet çfarëdo evidentimi pa dokument. Evidentimi në bazë të dokumentit është rregull e mbarë pranuar, te ne dhe anembanë nëpër botë. Evidentimi pa dokument është njësoj si falsifikimi. Me dokument dëshmohet ekzistimi i një ngjarjeje kontabiliste ndërsa me të kontrollohet edhe korrektësia e evidentimit të tij.


Për shkak të dokumentit të formuar jo në kohë dhe të përpiluar në mënyrë të pasaktë, mund të merret vendim jo përkatës. Dokument jo në kohë për arkëtimin e ndonjë kërkesë, për shembull, mund të sjellë deri në parashtrimin e panevojshëm të padisë pranë gjykatës për arkëtim. Me këtë ndërmarrja ekspozohet në shpenzime të panevojshme gjyqësore dhe në humbje të kohës, njëkohësisht lë përshtypjen për kontabilitet jo të mbajtur mirë. Ose, formu-

Zbatimi konsekuent i rregullave dhe parimeve të ndërtuara kontabiliste garanton kryerje të suksesshme të detyrave kontabiliste.

lar kërkese për materiale i përmbushur gabimisht, për shembull, mund të sjellë deri në përfundim të gabueshëm për tepricë ose pakicë në magazinë. Zbatimi konsekuent i rregullave dhe parimeve të ndërtuara kontabiliste garanton kryerje të suksesshme të detyrave kontabiliste. Për shkak të rëndësisë të korrektësisë të dokumenteve, në çdo ndërmarrje më së shpeshti ekziston shërbimi për kontrollin e dokumenteve, para se ato të dorëzohen për evidentim në kontabilitet. Ky shërbim quhet likuidatorë dhe ka për detyrë që ta kontrollojë korrektësinë dhe rregullsinë e çdo dokumenti dhe korrektësinë e shumave në të.

2. Rregullsia:

Rregullsia do të thotë evidentim pedant, rregullsi dhe ruajtje e librave afarist (evidencave) Evidentimi në kontabilitetin bëhet me dorë ose me kompjuterë. Ngjarja veç më e evidentuar, nuk guxon të fshihet



Rregullat kontabiliste duhet të respektohen.

me përdorimin e mjeteve kimike dhe fizike. Nëse evidentohet me dorë, secili gabim paraprakisht i bërë nuk guxon të shkarravitet, por kjo duhet të bëhet me vija të hollë, ashtu që të mundet të lexohet shuma fillestare (e gabuar). Me rregullat - rregullsi, përveç tjerave, nënkuptohet shkrimi me tekst të lexueshëm dhe të kuptueshëm të kontabilitetit dhe të respektohet, kuptohet edhe shkruarja e lexueshme e shifrave, si dhe shlyerje e hapësirës të pa shfrytëzuar. Numri i madh i dokumenteve kontabiliste, llojet e ndryshme të evidencës, e me këtë edhe numri i madh i evidentimeve, detyrimisht imponojnë që rregullsia të ketë rëndësi të veçantë në mbajtjen e evidencës kontabiliste. Evidentimi i bazuar mbi dokumentimin e rregullt, do të thotë dispozicion me argumente për saktësinë e evidentimit dhe mundëson kontroll të evidentimeve të bëra.

3. Pasqyrimi:

Ky rregull duhet të sigurojë pranim të shpejtë, të lehtë, të saktë të informatave kontabiliste, si edhe gjendje në librat kontabiliste. Duke u nisur nga ky rregull, ndalohet kompensimi i hyrjeve me të dalat, shkurtesat me tepricat ose kompensimi i kërkesave me obligimet. Kjo do të thotë se gjatë evidentimit, duhet të zbatohet „bruto parimi i ashtuquajtur“. Ashtu për shembull një ndërmarrje njëkohësisht të paraqitet si blerës dhe si furnizues, nuk mund të kompensohen kërkesat me obligimet, por duhet të hapen dy llogari për të, një për kërkesën nga blerësit etj. etrën për obligimet ndaj furnizuesit.

4. Azhurnimi:

Me nocionin azhurnim nënkuptohet evidentimi me kohë i ndryshimeve afariste në të gjitha librat afariste. Dokumentet duhet të evidentohen menjëherë gjatë pranimin të tyre.

Mos evidentimi në kohë çon kah mos përpilimi në kohë i informatës për ndërmarrjen e masave për kryerjen e aktivitetit në ndërmarrjen. Për shembull, mos evidentimi i pagesës së furnizuesve në kohë, mund të sjellë deri në pagesën e panevojshme të dytë ose vonesa me regjistrimin dhe përgatitjen e listave për regjistrim, mund të tërheqë edhe vonesë në përpilimin e bilanceve dhe llogarisë përfundimtare.

Ndikim të madh mbi azhuritetin e kontabilitetit ka grumbullimi dhe dorëzimi jo në kohë i dokumentacionit. Dokumentacioni duhet të formohet menjëherë pas ngjarjes dhe të evidentohet menjëherë pas pranimit të tij në kontabilitet. Çfarëdo të jetë prolongimi i evidentimit, mund të shkaktojë vendime të gabueshme. Mos evidentimi në kohë i pagesës së ndonjë fature ndaj furnizuesve, për shembull, mund të sjellë deri në pagesën e panevojshme të dytë. Nuk duhet të harrohet se jo azhuriteti lë përshtypje negative te partnerët afarist dhe të dhënat që pranohen me vonesë më të madhe, shpesh herë humbin çfarëdo vlere praktike.

5. Ndërlidhja:

Ndërlidhja mundëson përcaktim të lehtë të lidhjes së ndërsjellë të evidentimit të llogarive dhe evidencave të caktuara (dokumenteve, urdhëresave për regjistrim, ditarit, librit kryesor dhe evidencës analitike). Vërejtja e lidhjes mundëson përcaktim të shpejtë dhe të lehtë prej ku është bartur evidentimi i caktuar dhe ku është bartur i njëjti pastaj. Ndërlidhja është shumë e rëndësishme për lehtësimin e kontrollit të evidentimeve, për harmonizimin e llojeve të caktuar të evidencave dhe gjithashtu edhe për korrigjimin e shpejtë të gabimeve kontabiliste.

6. Tërësia:

Tërësia si rregull kërkon që të evidentohen të gjitha ndryshimet afariste te mjetet, burimet, hyrjet dhe të dalat në periudhën e njëjtë për të cilën kanë të bëjnë ato ndryshime. Shembull: nëse një dokument për një shpenzim të krijuar për vitin rrjedhës, evidentohet në vitin e ardhshëm, atëherë do të paraqitet rezultat financiar i pasaktë në të dy periudhat.

7. Unifikimi:

Me unifikimin në kontabilitetin nënkuptohet mbajtja e unifikuar e librave kontabilist prej të gjithë subjekteve të cilët mbajnë kontabilitet. numri dhe emri i njëjtë i llogarive, mënyra e njëjtë e bilancit të mjeteve, burimeve, hyrjeve dhe të dalave, bilance të unifikuara dhe përlllogaritje tjera dhe ngjashëm.

KONTABILITETI I DYFISHTË

Kontabiliteti i dyfishtë paraqet mënyrë të kompletuar, gjithëpërfshirëse të përpunimit të të dhënave kontabiliste. Në kontabilitetin e dyfishtë, nuk mund të evidentohen ngjarje në bazë të ndonjë burimi subjektiv të evidencës së mjeteve dhe burimeve të mjeteve. Lëndë e evidencës në kontabilitetin e dyfishtë janë të gjitha mjetet, burimet, shpenzimet, të dalat, hyrjet dhe rezultati financiar.

Tërësia e kontabilitetit të dyfishtë rrjedh nga parimi i dyfishmërisë së evidentimit të ngjarjeve kontabiliste. Sipas këtij parimi, nisemi nga supozimi logjik se çdo ngjarje kontabiliste shkakton së paku dy ndryshime prej të

Sipas parimit të kontabilitetit të dyfishtë, çdo ngjarje kontabiliste shkakton së paku dy ndryshime prej të cilëve njëri ndryshim doemos duhet të jetë pozitiv ndërsa ndryshimi tjetër negativ.

cilave njëri doemos duhet të jetë pozitiv ndërsa tjetri negativ. Mandej shuma e shumave të ndryshimeve pozitive doemos duhet të jetë e njëjtë me shumën e shumave të ndryshimeve negative. Sipas kësaj, nuk mund të evidentojë ndryshim pozitiv e të mos ketë ndryshim negativ. Për shembull, rritja e një mjeti është ndryshim pozitiv ndërsa zvogëlimi i mjetit tjetër ose rritja e ndonjë obligimi është ndryshim negativ.

Dyfishimi në evidentimin e ngjarjeve kontabiliste çon kah ashtu quajtura kontrolli automatik i evidentimeve - te çdo ndryshim doemos duhet të ekzistojë barazi e shumës të të gjitha ngjarjeve pozitive me shumën e ndryshimeve negative.

Për shkak të përfshirjes së të gjitha ngjarjeve, kontabiliteti i dyfishtë mundëson që në çdo kohë në mënyrë kontabiliste të mund të përcaktohet rezultati financiar, të fitohen të dhëna për gjendjen e çdo mjeti dhe obligimi, si edhe për çdo shpenzim, të dalë dhe hyrje, si edhe për të gjitha mjetet dhe burimet së bashku, edhe atë pa bërë regjistrimin, por vetëm në bazë të evidencës kontabiliste.

Historia e vërtetë e kontabilitetit fillon me paraqitjen e kontabilitetit të dyfishtë. Libri i parë nga fusha e kontabilitetit, i emërtuar “Përmbledhje e aritmetikës, gjeometrisë, proporcioneve dhe raporteve” ka dalë prej shtypi në vitin 1494. Mirëpo, ekzistojnë prova të bindshme se kontabiliteti i dyfishtë është aplikuar në praktikë njëqind vite, por mundet edhe dyqind vite më parë. Autori i librit të parë për kontabilitetin është itali-ani Lluca Paçioli, i cili pohon se e ka përshkruar kontabilitetin që aso kohe është mbajtur në Venedik.



Ngjarja bën ndryshim pozitiv dhe negativ.

Për shkak të përparësive të shumëfishta në Ngjarja bën krahasim me kontabilitetet tjera, me kohë kontabiliteti i dyfishtë është ndryshim pozitiv i shndërruar në procedurë dhe metodologji e gjithë pranuar në dhe negativ përpunimin e të dhënave kontabiliste.

Përparësitë e kontabilitetit të dyfishtë janë në:

- logjikën në mënyrën e evidentimit,
- gjithpërfshirja e ngjarjeve kontabiliste, - përshtatjen në kushtet e ndryshme,
- mundësia që të fitohen të dhëna të ndryshme të mjeteve, të burimeve, për punën, për mbajtjen rrjedhëse dhe afatgjate të politikës afariste, etj.

Për shkak të përparësive që i ka, kontabiliteti i dyfishtë është një sistem i përkryer i evidencës, kontrollit dhe burimit të dhënave të shumta, të domosdoshme për funksionimin e ndërmarrjeve për çka në përgjithësi është pranuar çdo kund në botë.

NOCIONET KRYESORE

Kontabiliteti
Sistem informativ kontabilist
Shfrytëzues të informatave kontabiliste
Kontabiliteti financiar
Standarde Ndërkombëtare Kontabiliste
Kontabilist Revizor
Parimet kontabiliste
Kontabiliteti i dyfishtë

PYETJE:

1. Definoje kontabilitetin!
2. Cili është qëllimi i raporteve financiare?
3. Numëroi dhe sqaroi cilët janë shfrytëzuesit e informatave kontabiliste!
4. Cili është qëllimi i Komitetit për Standardet Ndërkombëtare Kontabiliste?
5. Prej kur zbatohen SNK?
6. A ka nevojë që në Republikën e Maqedonisë të ekzistojë organizatë profesionale e kontabilistëve?
7. Sqaroi parimet e kontabilitetit?
8. Kur hasen fillimet e para të shënimit të dyfishtë?
9. Sqaroi parimin e kontabilitetit të dyfishtë?

DETYRË:

Sqaroi ngjarjet kontabiliste në vijim me zbatimin e parimit të kontabilitetit të dyfishtë – shënimi i dyfishtë:

- Sipas faturës nr. 56, janë blerë materiale zyre për 2.000 den. me para të gatshme nga arka,
- Sipas ekstraktit nga banka, arkëtari ka paguar 20.000 den. në xhirollogari, prej parave në arkë,
- Sipas ekstrakti nr. 22, janë ngritur nga xhiro-llogaria 10.000 den. për nevojat e arkës.

Tema 2: MJETET, OBLIGIMET DHE KAPITALI

PËRMBAJTJA E TEMËS:

Mjetet
Mjete të përhershme
Mjetet jo materiale (investime)
Mjetet materiale
(investime)
Mjetet financiare afatgjate
(investime)
Mjetet rrjedhëse (qarkulluese)
Burimet e mjeteve kapitale
(kryesore)
Obligimet
Formula bazike
(fundamentale) kontabiliste
Bilanci i gjendjes
(nacioni, forma dhe përmbajtja)
Parimet e bilancit.

QËLLIMET E MËSIMIT:

Nxënësi t'i:

- definojë nocionet mjete, obligime dhe kapital,
- i klasifikon mjetet, obligimet dhe kapitalin,
- e sqaron rolin, formën dhe rëndësinë e bilancit të gjendjes,
- i identifikon parimet e bilancit,
- përpilon bilanc të gjendjes,
- i rendit pozitat e bilancit sipas rregullores ligjore

MJETET

Elementet themelore të tërë sistemit kontabilist janë vendosur në mbajtjen e evidencës për ndryshimet të cilat u kanë ndodhur mjeteve, obligimeve dhe kapitalit të pronarëve. Ndërmarrjet themelohen që të kryejnë veprimtari të caktuar. Kryerja e veprimtarisë paraqet përmbushje të qëllimeve dhe detyrave të parashtruara paraprakisht. Që të arrihen qëllimet, të realizohen detyrat, ndërmarrjet kanë në dispozicion mjete.

Mjetet janë bazë materiale e punës së ndërmarrjeve dhe kusht për mbijetesën e tyre. Pa mjete nuk mund të paramendohet kryerja e detyrave të shumta që paraqiten para ndërmarrjes. Shpeshherë theksohet se mjetet janë ato që janë qarkullimi i gjakut në organizmin e njeriut. Mjete janë të gjitha sendet e paraqitura në mënyrë vlere, të cilat i posedon një ndërmarrje. Për llojet e ndryshme të nevojave, ndërmarrjet kanë në dispozicion lloje të ndryshme të mjeteve. Mjetet në para për shembull u shërbejnë për furnizime të ndryshme, gjegjësisht për pagimin e obligimeve që rrjedhin nga furnizimet. Përveç për pagimin e obligimeve, paratë shfrytëzohen për pagimin e rrogave, tati-meve dhe të ngjashme. Gjithashtu, në zhvillimin e punës, përveç me mjete materiale dhe në para, ndërmarrjet kanë në dispozicion makina, objekte ndërtimore, instalime të ndryshme, ndërtesa si edhe lloje të tjera të mjeteve. Përgjithësia e mjeteve me të cilat disponojnë ndërmarrjet, duhet të përkohet në mënyrë kuantitative dhe kualitative me detyrat e tyre. Kur thuhet kuantitative, mendohet për vëllimin dhe kohëzgjatjen e detyrave dhe harmonizimi i mjeteve me to. Për detyra më të mëdha dhe për vëllim më të madh të detyrave, janë të domosdoshme më shumë mjete. Sa i takon përkimit kualitativ të mjeteve me detyrat, kjo do të thotë se llojet e mjeteve duhet të përkohet me veprimtarinë me të cilën merren ndërmarrjet. Kështu p.sh., ndërmarrjet e veprimtarisë prodhuese, kanë në dispozicion mjete të cilat sipas vëllimit dhe sipas llojit, dallojnë shumë nga mjetet në ndërmarrjet me veprimtari tregtare. Nëse bëhet fjalë për ndërmarrjet e veprimtarisë prodhimtare, lloji i mjeteve dallon në varësi nga ajo se a bëhet fjalë për ndërmarrje industriale, bujqësore, ndërtimore ose tjetër lloji i ndërmarrjes, Lloji dhe vëllimi i mjeteve dallon madje edhe në rastin kur bëhet fjalë për veprimtarinë e njëjtë. Pohohet, jo pa arsye se, çdo ndërmarrje ka specifikat e veta të cilat shkaktojnë nevoja për disponim me lloje të ndryshme të mjeteve.

Në kushtet e sotme, mjetet paraqesin nocion të ndërlikuar. Përkufizimi i llojeve të caktuara të mjeteve mund të bëhet në mënyra të ndryshme, duke u nisur nga kushtet dhe nevojat e dhëna. Ndarja themelore është në:

- I) Mjete të përhershme (themelore) dhe**
- II) Rrjedhëse (qarkulluese).**

Mjetet janë bazë materiale e punës së ndërmarrjeve dhe kusht për mbijetesën e tyre.



Mjetet me të cilat disponojnë ndërmarrjet duhet të përgjigjen në mënyrë kuantitative dhe kualitative në detyrat e tyre.

I) MJETET E PËRHERSHME

Mjetet e përhershme karakterizohen me **përdorim shumëvjeçar**. Përdorimi i tyre zgjat më shumë se një vjet. Makinat, ndërtesat, mjetet transportuese dhe ngjashëm, përdoren me dekada. Mirëpo, ka edhe mjete të përhershme jeta e përdorimit të cilëve zgjat më shumë se 50 vjet.

Karakteristika e dytë e mjeteve të përhershme është **shpenzimi gradual**, për shkak se nuk harxhohen me përdorimin e njëfishtë. Pas çdo procesi të kryer të punës, makinat për shembull, kthehen në gjendjen e tyre fillestare të gatshme për përdorimin e ri. Një makinë, mund të përdoret njëmijë herë vetëm gjatë një viti dhe me atë rast në tërësi ta mbajë formën e vet të dukjes, për dallim nga stofi i cili nuk mund të përdoret më tepër herë pasi të përdoret një herë për prodhimin e veshjes.

Karakteristika e tretë e mjeteve të përhershme është se ato sipas rregullit angazhojnë mjete të larta parash gjatë furnizimit të tyre (kanë vlerë individuale të lartë) Në krahasim me një metër stof p.sh., makina për të qepur ka vlerë pa krahasim më të lartë.

Në fund, mjetet e përhershme i nënshtrohen ashtuquajtur **vjetërsisë morale ose ekonomike**. Progresi teknik dhe teknologjik çon kah paraqitja e mjeteve të përhershme të reja, më produktive, më efikase, më të lira, me një fjalë më të përkryera, paraqitja e të cilave sjell deri në vjetërsinë e mjeteve të përhershme që gjinden në përdorim. Për shkak të vjetërsisë ekonomike, shpeshherë ndodh që mjetet e përhershme të zëvendësohen me të reja, para skadimit të afatit të tyre të dobishëm për përdorim.

Mjetet e përhershme grupohen në:

- a) Mjete jo materiale (investime)
- b) Mjete materiale (investime)
- c) Investime financiare afatgjate



Mjetet e përhershme shfrytëzohen në mënyrë afatgjate.

A) MJETET JOMATERIALE (INVESTIMET)

Mjetet jo materiale përbëhen nga të drejta, ose nga shpenzimet e bëra që duhet të përkufizohen në periudhë më të gjatë kohore, në më shumë vjet. Mjetet jo materiale nuk janë të materializuara, nuk janë fizikisht të pranishme, nuk janë të dukshme me sy dhe nuk mund të preken. Si të atilla konsiderohen:

- 1) Shpenzimet për kërkim dhe zhvillim
- 2) Investimet themeluese
- 3) Patentat
- 4) Licencat
- 5) Koncesionet
- 6) Gudvill etj.

Mjetet jo materiale nuk janë të materializuara, nuk janë fizikisht të pranishme, nuk janë të dukshme me sy dhe nuk mund të preken.

1. Shpenzimet për kërkime dhe zhvillim sot janë zëra shumë aktual në suazat e përpjekjeve të përgjithshme për përparimin e punës dhe zhvillimit të ndërmarrjes. Ato janë shprehje e kujdesit të ndërmarrjes për progresin personal efektet e të cilit priten në periudhë më të gjatë se një vjet. Pasi nuk ndodhin në mënyrë të barabartë, nuk janë të njëjta as në periudhat e caktuara, me kohë është ardhur në përfundim se ato duhet të shpërndahen në periudhë më të gjatë kohore, e jo ta pranojnë karakterin e shpenzimit në periudhën kur janë krijuar, dhe atëherë në tërësi ta ngarkojnë hyrjen e ndërmarrjes.

2. Investimet themeluese nuk paraqesin mjete të materializuara, por janë vetëm shpenzime për përpilimin e dokumentacionit për fitimin e mjeteve të përhershme para se ato të fillojmë të shfrytëzohen në mënyrë efikase. Me shpenzime të këtilla, nuk është e drejtë të ngarkohet prodhimtaria e re në fillimin, pasi që kjo do të ishte tepër shtrenjtë, andaj ato udhëhiqen si lloj i veçantë i mjeteve të përhershme - të cilat shlyhen gradualisht në një periudhë shumëvjeçare. Në suazat e këtyre "shpenzimeve" bëjnë pjesë edhe shpenzimet e bëra për themelimin e ndërmarrjes së re (shpenzimet për studime dhe kërkime, për përpunimin e dokumentacionit projektues, për përkryerjen e kuadrove, etj.).

3.4.5. Patentat, licencat dhe koncesionet kryesisht janë të drejta. **Patenta** paraqet zbulim të regjistruar të ndërmarrjes në Entin për patente. Të gjitha shpenzimet rreth fitimit të tij e paraqesin vlerën e tij furnizuese sipas së cilës mbahet si mjet i përhershëm në kontabilitet. **Licenca** paraqet të drejtë të blerë për shfrytëzimin e zbulimit të huaj (patentat), respektivisht lejes së fituar për prodhimin e ndonjë prodhimi. Dallimi ndërmjet patentës dhe licencës qëndron në atë që patenta paraqet të drejtë në prodhim ndërsa licenca paraqet të drejtë në prodhim dhe në teknologjinë e prodhimit, me këtë licenca në vete e përmban edhe patentën. **Koncesioni** paraqet autorizim të blerë për shfrytëzimin e të mirave publike dhe komunale, për eksploatimin e pasurisë xeherore dhe ngjashëm.



patentë

6. Goodwill (Gudvill) është vlerë e paguar ndaj pronarit paraprak të ndërmarrjes, biznesit, por vetëm për zërin e mirë, reputacionin, mendimin e mirë të klientët e lokalitetit të caktuar. Gudvilli është dallimi ndërmjet vlerës tregtare të paguar të firmës dhe vlerës së saj kontabiliste. Për shembull: vlera tregtare është 100.000 \$, ndërsa vlera kontabiliste është 80.000 \$, gudvilli është 20.000 \$. (100 000-80 000).

B) MJETE MATERIALE (INVESTIME)

Investimet materiale janë grupi më i rëndësishëm i mjeteve të përhershme. Ato janë mjete të cilat fizikisht janë të pranishme, mund t'i ndjejmë, mund t'i shohim me sy, gjegjësisht ato janë gjithë ajo që na rrethon. Çdonjëra nga këto grupet e mjeteve të përhershme për punë, ndahet në nëngrupe të veta sipas afërsisë.

Në këtë grup bëjnë pjesë:

1. Pasuritë natyrore dhe

2. mjetet për punë.

3. Mjete tjera materiale

1. Pasuritë natyrore janë

- *tokat dhe pyjet* (tokë ndërtimore dhe bujqësore, livadhe, kullota, etj.). Tokat me karakter ekonomik trajtohen si mjete të përhershme. Vlera e tyre përcaktohet sipas hyrjeve kadastrale. Për tokën nuk llogaritet amortizimi, sipas kësaj, nuk bëhet shlyerje kontabiliste.

2. Mjetet për punë shërbejnë për kryerjen e subjektit. Këtu bëjnë pjesë:

a) Mjetet për punë në përdorim:

- *Objektet ndërtimore* - objektet ndërtimore përbëhen nga objektet ndërtimore në industri, në bujqësi, elektro-ekonomi, ekonominë e ujërave, në komunikacion dhe ngjashëm, (ndërtesat udhëheqëse, ndërtesat administrative, dyqanet, ndërtesat e reparteve, garazhet, magazinat, tunelet, urat ...)

- *instalime dhe pajisje* (aparate dhe instalime, alete të mëdha, inventar reparti, inventar zyre dhe afarizmi, mobile, mjete transportuese, alete...)

- *mbëltime shumëvjeçare dhe kopeja kryesore* (pemishte, vreshta, plantacione, mbëltime shumëvjeçare, kopeja kryesore - gjedhë, dhi, derra, dele, shpendë, peshq, bletë...)

b) Mjetet për punë në përgatitje i përbëjnë mjetet që ende nuk janë në funksion, por janë të paraprirë të shndërrohen në mjete të përhershme në funksion. Ato mund të jenë në formë parash ose formë materiale Këto PSS mund të ndahen në grupet në vijim:

- *investime gjatë Objekteve ndërtimore*

- *investime gjatë pajisjes*

- *investime gjatë mbëltimeve shumëvjeçare*

- *investime të ndaluara*

c) Mjetet për punë jashtë përdorimit - janë PSS që më para kanë qenë në funksion, por në çastin e caktuar është ardhur në përfundim se është më mirë të mos përdoren. Mjetet e këtilla nuk janë në gjendje atë keqe që të nxirren jashtë përdorimit. Eventualisht, ato mund të kthehen më vonë në funksion, por për çastin konsiderohet se është më mirë të vihen jashtë përdorimit. Karakterin e PSS jashtë përdorimit mund ta marrë cilido lloj i PSS në funksion, përveç investimet themeluese. Shembull për këtë lloj janë makinat e vjetruara, makinat e amortizuara, mjetet në likuidim dhe ngjashëm.

3. Mjetet tjera materiale-në këtë grup bëjnë pjesë mjetet të cilat nuk harxhohen , por me kalimin e kohës fitojnë në vlerën e tyre. Ato janë: antikitetet, pjesë me vlerë artistike, përmendore, armë, stoli, libra, etj.

Investimet materiale janë grupi më i rëndësishëm i mjeteve të përhershme që mund të ndahen në mjete të përhershme, mjete për punë dhe mjete të tjera jo materiale.



C) MJETET FINANCIARE AFATGJATE (INVESTIMET)

Investimet financiare afatgjate i përfshijnë investimet në para dhe plasmanët afatgjatë afati ëpër kthim i të cilëve është më i gjatë se një vjet. Në këtë grup bëjnë pjesë: investimet në ndërmarrjet e ndërlidhura, investimet në aksione dhe në letra tjera me vlerë, mjete të investuara në bankat vendore dhe të huaja, kreditë e dhëna subjekteve të tjerë, depozitat dhe kaucionet e dhëna, investimet e obligueshme afatgjata etj.

1. Ushtrimi: Afër çdo investimi shëno se i cilit lloj është!

- patenta
- televizori
- karriget
- lopa
- ara
- vreshta
- pikturë artistike
- traktor
- shitore
- tokë me karakter ekonomik

2. Ushtrimi: Afër çdo investimi shëno se i cilit lloj është!

- investime themeluese
- ura
- investime në letra me vlerë
- PSS të amortizuara
- ndërtesë udhëheqëse
- patentë
- pyll gjetherënës
- traktor
- telefon
- bletë
- investime në rrjedhë
- pajisje
- biro zyre

Investimet financiare afatgjate i përfshijnë investimet në para dhe plasmanët afatgjatë afati ëpër kthim i të cilëve është më i gjatë se një vjet.

II) MJETET RRJEDHËSE (QARKULLUESE)

Investimet financiare afatgjate i përfshijnë investimet në para dhe plasmanet afatgjate afati për kthim i të cilëve është më i gjatë se një vit. Për dallim nga mjetet e përhershme, mjetet rrjedhëse (qarkulluese) janë ato që shkojnë rrotull, lëvizin, qarkullojnë dhe rrotullohen më shumë herë në procesin e punës dhe asnjëherë nuk kthehen në formën e tyre fillestare. Mjetet rrjedhëse nuk kanë karakter afatgjatë, pasi ato harxhohen njëfish. Stofi njëherë i përdorur për shembull, bëhet konfeksion dhe nuk mundet më

Mjetet rrjedhëse (qarkulluese) janë ato që shkojnë rrotull, lëvizin, qarkullojnë dhe rrotullohen më shumë herë gjatë procesit të punës dhe asnjëherë nuk kthehen në formën e tyre fillestare.

të përdoret si stof. Karakteristika e tyre kryesore është ndërrimi i shpeshtë i formës me ç'rast shndërrohen prej formës në para në formën materiale, dhe anasjelltas, sa më shpejt që mundet por, më së paku një herë në vit. Mjetet qarkulluese në bilancin e ndërmarrjeve përkufizohen në grupet në vijim:

- a) mjete parash,
- b) letra me vlerë,
- c) kërkesa afatshkurta nga puna,
- ç) investime financiare afatshkurta
- d) rezerva,
- dh) kërkesa dhe investime tjera afatshkurta



Mjetet e parave janë mjete rrjedhëse

a) mjete parash - mjetet e parave përkufizohen në: *mjete parash në xhirollogaritë dhe në llogaritë rrjedhëse, mjete parash të veçuara dhe akreditiv, Para të gatshme në arkë, deviza në llogarinë devizore dhe ngjashëm.*

b) letra me vlerë - në letra me vlerë bëjnë pjesë: *çeqet, kambialet obligime dhe letrat tjera me vlerë.*

c) kërkesa afatshkurta nga puna - kërkesat afatshkurta nga puna përbëhen nga *kërkesa të blerësve, kërkesa të subjekteve të ndërlidhur, kërkesa nga*

Mjetet e parave shteti, kërkesa nga të punësuarit, kërkesa nga avanset, depozitat, janë mjete rrjedhëse kaucionet dhe kërkesat e dhëna të tjera.

ç) investime financiare afatshkurta - investimet financiare afatshkurta janë investime deri në një vit dhe ato përbëhen nga: *investime në ndërmarrje të ndërlidhura, investime në bankat, kredi afatshkurta të dhëna, investime në letra me vlerë dhe investime afatshkurta të tjera.*

d) rezerva - rezervat si mjete rrjedhëse i përbëjnë: *rezervat e lëndëve të para dhe materialeve, rezervat e prodhimeve të gatshme, rezervat e mallrave tregtar, rezervat e gjysmë prodhimeve, rezervat e pjesëve rezerve, inventari i imët, ambalazhi dhe auto gomat etj.*

dh) kërkesa dhe investime tjera afatshkurta - në këtë kategori bëjnë pjesë mjetet rrjedhëse që nuk janë renditur në grupet paraprakisht të përmendura.

3. Ushtrimi: Bëje grupimin e mjeteve të përhershme dhe rrjedhëse në vijim:

- kërkesa nga të punësuarit për avance dhe për udhëtime zyrtare,
- licencë,
- kimikë,
- sfungjer,
- klasë,
- ndërtesë shkollore,
- lapsa,

- kërkesa nga blerësit,
- tokë me karakter ekonomik,
- salla shkollore në ndërtim,
- fletore,
- karrige,
- varëse,
- kazan avulli
- para në arkë

BURIMET E MJETEVE

Kapitali dhe obligimet në ndërmarrjen i paraqesin burimet e mjeteve dhe na e tregojnë prejardhjen e tyre. Me fjalë të tjera, kapitali dhe obligimet i paraqesin të drejtat pronësore mbi mjetet me të cilat disponon ndërmarrja.

A) KAPITALI (KRYESOR)

Nëse kapitali kuptohet si tërësi e pavarur, atëherë kapitali është ajo që ndërmarrja ua ka borxh pronarëve. Ai është dallimi ndërmjet vlerës së përgjithshme të mjeteve dhe vlerës së përgjithshme të obligimeve. Kapitali është burimi i mjeteve personale të ndërmarrjes.

$$\text{Kapitali} = \text{Mjete} - \text{Obligime}$$

Forma e investimeve të pronarëve varet edhe nga mënyra në të cilën është organizuar puna në ndërmarrjen. Nga aspekti i pronësisë, në kushte tregu të ekonomizimit, paraqiten tre forma kryesore të organizimit afarist.

- a) *Pronësi inokose ose individuale (kapitali i pronarit individual),*
- b) *Ortakëri ose partneritet (kapitali i pronarëve – investime të përhershme),*
- c) *Shoqëri aksionare - afariste (kapitali aksionar)*

a) Te pronësia **inokse** bëhet fjalë për pronësinë e ndërmarrjes nga ana e një personi fizik. Ai person është bartës i aktivitetit të ndërmarrjes dhe përfitimi nga puna i takon atij.



Burimi i mjeteve - kapitali

b) **Ortakëria ose partneriteti** është subjekt ekonomik i cili formohet me bashkimin vullnetar të investimeve të dy ose më shumë personave fizik. Ato janë pronarë të ndërmarrjes, bartës të aktiviteteve të ndërmarrjes, ato e ndajnë përfitimin e realizuar nga puna, por njëkohësisht kanë edhe përgjegjësi të pakufizuara për të gjitha.

Kapitali dhe obligimet në ndërmarrjen i paraqesin burimet e mjeteve.

Kapitali është borxhi i ndërmarrjes ndaj pronarëve

c) Forma dominuese e organizimit të punës në ndërmarrjen në ekonomitë e tregut paraqet **shoqëri aksionare**, të quajtur edhe shoqëri afariste ose korporatë. Të gjitha ndërmarrjet e mëdha janë të organizuara në formë të shoqërive aksionare. Kapitali vetjak i shoqërive aksionare është *kapitali aksionar*. Kapitali aksionar është kapitali i cili është siguruar me shitjen e aksioneve. Pronarët të cilët posedojnë aksione emërtohen aksionarë dhe janë pronarët e një pjese të shoqërisë dhe kanë të drejta të caktuara.

Kapitali i nominuar është në mënyrë të përhershme i lidhur me ndërmarrjen.


Kapitali për të cilin bëhej fjalë deri tani është kapital vetjak dhe është përhershëm i lidhur me ndërmarrjen. Ai është kapital i dominuar (kapital i përhershëm). Mirëpo, nevojat e përhershme për kapital mund të sigurohen me veçimin e përfitimit. Me veçimet e këtilla krijohen fonde vetjake të veçantë. Kapitali i këtyre fondeve është vetjak por nuk është i përhershëm, i vazhdueshëm dhe emërtohet kapital i jonominuar (i përfituar në plotësim, i paguar). Në kapital të jonominuar numërohen: *rezervat ligjore, rezervat statusore, rezervat e lira, rezervat e revalorizuara, përfitimi i pashpërndarë*.

Kapitali i jo nominuar është kapital i përfituar në plotësim, i paguar.

Sipas të lartpërmendurës, ekzistojnë dy burime kryesore të kapitalit: a) vetë investuesit, gjegjësisht shuma të cilën e kanë paguar pronarët e ndërmarrjes e njohur si kapitali i paguar, dhe b) përfitimi, i realizuar nga puna rentabile e ndërmarrjes, e njohur si përfitimi i mbajtur. Zvogëlimi i kamatës, gjegjësisht kapitalit vetjak mund të ndodhë me: a) tërheqjen e investimeve të pronarëve dhe b) humbjen në punën e ndërmarrjes. Sipas kësaj, ekzistojnë faktorë të cilët e zmadhojnë kryegjënë dhe faktorët të cilët e zvogëlojnë.

Kjo, në mënyrë vizuale është paraqitur në skemën në vijim:

1. Zmadhimi (burimet)



B) OBLIGIMET

Obligimet janë pjesë e burimeve të mjeteve të cilat ndërmarrja i përfiton nga transaksionet në lidhje me furnizimin e mjeteve, shfrytëzimin e shërbimeve ose përfitimin e dobive të tjera. Obligimet tregojnë se prej ku e kanë prejardhjen dhe prej ku financohen mjetet. Çdo ndërmarrje ka obligime. Në fakt, ndërmarrja edhe përpiket të blejë me pagesë të prolonguar, që gjithsesi është më mirë sesa blerja me para gatshme, në dorë.

Obligimet mund të jenë borxhe të bëra ndaj ndërmarrjeve të tjera, subjekteve, institucioneve financiare, shtetit, etj. që duhet të paguhen. Përveç nga blerja e mjeteve, ndërmarrja mund të fitojë obligime edhe në bazë të huazimit të parave nga bankat dhe institucionet tjera financiare. Obligimet në bazë të huazimit të larave nga bankat dhe institucionet tjera financiare janë të njohura si *obligime kreditore*. Për kompensimin e obligimeve të veta ndaj furnizuesve dhe kreditorëve, ndërmarrja mund të lëshojë letra me vlerë, çeqe, kambiale dhe ngjashëm. Obligimet e tilla njihen si *obligime në letra me vlerë*. Gjithashtu, obligimet mund të paraqiten edhe si *obligime ndaj pronarëve të kapitalit, obligime ndaj të punësuarve, obligime ndaj shtetit (për tatime dhe kontribute) dhe obligime t tjera*. Si lloj i veçantë i obligimeve paraqiten pagimet e prolonguara të harxhimeve dhe hyrjet e arkëtuara nga periudha e ardhshme, të njohura në praktikë si *përkufizime kohore pasive*.

Obligimet paraqiten si burime të huaja të mjeteve, ndërsa kapitali paraqitet si burim vetjak i mjeteve.

Të drejtë mbi mjeteve që realizohen kanë kreditorët, furnizuesit, dhe personat tjerë ndaj të cilëve ndërmarrja ka fituar obligime në njërin anë dhe pronarët e kapitalit në anën tjetër. Me ç'rast, të drejtat e kreditorëve, furnizuesve dhe personave të tjerë janë parësore. Kjo do të thotë, në rast të likuidimit të ndërmarrjes, obligimet ndaj kreditorëve dhe furnizuesve kanë prioritet për pagim nga masa e përhershme likuiduese para pronarëve të kapitalit. Bile edhe shuma e tërësishme e masës likuiduese mund tu paguhet kreditorëve ndërsa për pronarët e kapitalit të mos mbesë asgjë.

Nga këndvështrimi i kompensimit të obligimeve, të njëjtat mund t'i klasifikojmë në dy grupe:

- obligime afatgjate dhe
- obligime afatshkurta (rrjedhëse).

Obligimet afatgjate janë obligime të cilat arrijnë për pagesë për periudhë më të gjatë se një vit. Ato zakonisht shfrytëzohen për financimin e mjeteve afatgjate.

Obligimet janë pjesë e burimeve të mjeteve të cilat ndërmarrja i përfiton nga transaksionet në lidhje me furnizimin e mjeteve



Obligimet duhet të paguhen.

Obligimet janë pjesë e burimeve të mjeteve të cilat ndërmarrja i fiton nga transaksionet në lidhje me furnizimin e mjeteve. Ato janë, obligime për të cilat paguhen kamata dhe të cilat sigurojnë financim në bazë afatgjate dhe nuk arrijnë për pagesë brenda afatit prej dymbëdhjetë vjet.

Në procesin kontabilist, më së shpeshti paraqiten obligimet afatgjate në vijim: *obligime afatgjate ndaj subjekteve të ndërlidhura, obligime afatgjate në bazë të huave dhe kredive, obligime afatgjate për avance, depozita dhe kaucione, obligime afatgjate ndaj furnizuesve, obligime afatgjate në bazë të letrave me vlerë dhe obligime të tjera afatgjate.*

Përkundër obligimeve afatgjate, **obligimet afatshkurta** paraqiten në të gjitha ndërmarrjet. Këto obligime arrijnë dhe duhet të kompensohen brenda afatit njëvjetor, duke llogaritur prej ditës së krijimit. Këto obligime i përbëjnë: ***obligimet afatshkurta nga puna, obligimet financiare afatshkurta për obligime tjera afatshkurta.***

Obligimet afatshkurta nga puna, janë dukuri e përditshme në punën e subjekteve ekonomike. Të atilla për shembull janë *obligimet ndaj furnizuesve* të cilat fitohen gjatë furnizimit të materialeve ose mallrave. Është praktikë që obligimet gjatë furnizimit të mos paguhen menjëherë me para në dorë, por pas disa ditëve nëpërmjet bankës. Për kohën derisa të paguhen këto obligime, ato paraqesin burim afatshkurtër.

Në këtë grup të, obligimeve nga puna bëjnë pjesë edhe *obligimet për çeqet e lëshuara, obligimet për kambialet e lëshuara, obligimet për avanset e pranuar, depozitat dhe kaucionet, obligimet ndaj punëtorëve dhe obligimet tjera afatshkurta.*

Obligimet financiare afatshkurta janë *obligimet ndaj ndërmarrjeve të ndërlidhura, obligime për kreditë nga bankat dhe obligimet tjera financiare.*

Obligimet tjera afatshkurta i përbëjnë *obligimet për tatimet, kontributet dhe detyrimet tjera dhe obligimet tjera nga fitimi i ndërmarrjes.*


BARAZIMI BAZIK (FUNDAMENTAL) KONTABILIST

Paraprakisht, mjetet i definuam si bazë materiale (resurse ekonomike) me të cilat disponon një ndërmarrje (entiteti ekonomik), ndërsa obligimet i definuam si pjesë e burimeve prej ku i ka furnizuar ndërmarrja mjetet. Pjesën tjetër të burimeve të mjeteve e definuam si kapital pronësor.

Për shembull, pronarit të ndërmarrjes „List“, i nevojitet mjet transportues për kryerjen e furnizimeve. Vlera furnizuese e automjetit është 600.000 den. Ai planifikon që prej mjeteve të veta të investojë 450.000 den., ndërsa prej bankës të marrë kredi prej 150.000 den. E blen automjetin dhe tani e drejta e tij mbi automjetin është 450.000 den., ndërsa e drejta e bankës mbi automjetin është 150.000 den. Sipas kësaj, vlera e mjeteve është e njëjtë me të drejtën mbi ato mjete:

Mjete=Të drejta mbi ato mjete
(Assets=Equities)

Të huazuarat 150.000 den. nga banka për "List", paraqesin obligim pasi duhet t'ia kthejë bankës. Sipas kësaj, të drejtat e përgjithshme mbi mjetet (600.000 den.) i përbëjnë obligimet (150.000 den.) dhe të drejtat e pronarit (450.000 den.). Nga kjo del barazimi bazik (fundamental) kontabilist i cili e paraqet proporcionin ndërmjet mjeteve, obligimeve dhe kapitalit pronësor (kapitali i pronarit) dhe vijon:



Barazimi themelor kontabilist

Mjetet (M)=Obligimet (O)+Kapitali pronësor (K)

$$M=O+K$$

$$600.000=150.000+450.000$$

ose

$$\text{Assets (A)}=\text{Liabilities (L)}+\text{Owner's Equity (OE)}$$

Rregulli kryesor është se: Barazimi themelor kontabilist çdoherë duhet të jetë në balancë. Ana e majtë e barazimit e paraqet vlerën e mjeteve, ndërsa ana e djathtë tregon kush i ka siguruar fondet që të sigurohen ato mjete. Ose thënë me gjuhë kontabiliste, ana e djathtë e tregon vlerën e të drejtave mbi mjetet, përbërë nga vlera e obligimeve dhe vlera e kapitalit pronësor. Nga barazimi bazik kontabilist mund të fitohet shuma e obligimeve dhe kapitali, që paraqesin burime të mjeteve me të cilat disponon ndërmarrja.

$$M=O+K$$

Obligimet (O)= Mjetet (M) - Kapitali pronësor (K)

$$O=M-K$$

$$150.000=600.000-450.000$$

Kapitali pronësor (K)= Mjetet (M)-Obligimet (O)

$$K=M-O$$

$$450.000=600.000-150.000$$

Detyra 1. Numëroni mjetet dhe obligimet e juaja vetjake.

Detyra 2. Llogaritni sa është kapitali juaj personale

BILANCI I GJENDJES, NOCIONI, FORMA DHE PËRMBAJTJA

Për prejardhjen etimologjike të fjalës "bilancë" literatura dhe praktika kontabiliste-financiare me prejardhje vendore dhe të huaj ekzistojnë më shumë interpretime ndërmjet të cilave më së shpeshti përmendet pohimi se ky nocion paraqet një lloj tërësie të fjalëve "bi" (=2) dhe "lanx" (=peshore), me kuptim transferues, peshore me dy enë e ashtuquajtura "terezi" prej të cilës njëra pjesë e paraqet aktiven ndërsa pjesa tjetër pasiven e bilancit të gjendjes.



Mjete

obligime+kapital

Fotografia 3 - Peshore me dy tasa

Barazimi kontabilist është themeli i çdo sistemi kontabilist, së këndejmi rrjedh edhe themeli për punimin e bilancit të gjendjes:

Mjete=Obligime+Kapital vetjak

Ana e majtë e barazimit kontabilist i paraqet mjetet sipas vlerës. Është e logjikshme që këto mjete të vijnë prej diku. Me fjalë të tjera, cilat janë burimet këtyre mjeteve? Kush ka të drejtë për këto mjete? Përgjigjja në këtë pyetje është në anën e djathtë të barazimit kontabilist. Ana e djathtë na tregon se ca nga mjetet e kompanisë janë siguruar nga kreditorët. për to kemi obligime. Mjetet tjera janë siguruar nga pronarët e biznesit dhe paraqesin kapital vetjak.

Si rezultat i ndryshimeve që ndodhin në pronën gjatë punës për periudhën e kaluar kohore, në shoqëritë tregtare përpilohen dy lloje të bilanceve, edhe atë: bilanc i gjendjes dhe bilanc i suksesit.

Bilanci i gjendjes është raport financiar i cili për periudhë të caktuar kohore përmbledh mjete, obligime dhe kapital vetjak të kompanisë. Ai është pasqyrim i mjeteve dhe burimeve të mjeteve (kapitalit dhe obligimeve) të një ndërmarrjeje në ditë të caktuar. Bilanci i gjendjes mund të përpilohet për çdo ditë në vit, edhe pse ai më së shpeshti përpilohet ditën e parë të muajit, të tremujorit ose të vitit. Sipas rregullit, bilanci bëhet në fund të çdo periudhe përlllogaritëse me qëllim që të përkufizohen periudhat dhe të shihet efikasiteti nga puna e çdo periudhe përlllogaritëse. Ai jep pasqyrë statistikore për resurset ekonomike në ndërmarrjen në çastin e dhënë, gjegjësisht në çastin e bilancimit.

Bilanci i gjendjes është raport financiar i cili për periudhë të caktuar kohore grumbullon mjete, obligime dhe kapital vetjak të kompanisë.

Në çdo kohë, bilanci i gjendjes doemos duhet të jetë i balancuar. Kjo do të thotë se mjetet doemos duhet të jenë të barabarta me obligimet dhe me kapitalin vetjak. Barazimi matematikor i aktives dhe pasives së përgjithshme quhet **balanca bilancore**, dhe paraqet një nga karakteristikat kuantitative të bilancit. Edhe në bisedën e rëndomtë hasim në shprehjen "të balancohet", që do të thotë diçka të baraspeshohet. Balanca bilancore është një lloj i aksiomës kontabiliste, ndërsa mospërputhja eventuale e aktives me pasiven është shenjë se bilanci nuk është i saktë, pasi diku është bërë gabim kontabilist, për këtë shkak bilanci i atillë konsiderohet si i pasaktë.

Parë nga këndvështrimi formal bilanci i gjendjes mund të paraqitet në formë **të pasqyrimit dyanësh** dhe në **formë të raportit**. Kur bilanci përpilohet si pasqyrim dyanësh, atëherë ana e majtë e quajtur aktivë i përfshin mjetet ndërsa ana e djathtë e quajtur pasivë i përfshin obligimet dhe kapitalin. Për nevojat edukative, bilanci i gjendjes paraqitet në formë dyanëshe, prej të cilës e majta quhet aktivë ndërsa ana e djathtë quhet pasivë. Mirëpo në praktikë, bilanci i gjendjes përpilohet në formë të ashtuquajtura "raportuese". Në këtë formë në bilancin, renditja e paraqitjes së pozicioneve fillon me aktiven dhe vazhdon me pasiven. Bilanci i gjendjes i përpiluar në formë raportuese duhet të jetë në balanc bilancor, që do të thotë "Përgatitja e raporteve se shuma e mjeteve të përgjithshme duhet të jetë e barabartë me shumën e obligimeve plus kapitalin vetjak. E njëjta vlen edhe për bilancin e gjendjes të përpiluar në formë të pasqyrimit dyanësh. Ndryshe, me nocionin pozicion në bilancin ose "zëri bilancor" nënkuptohet grupacion i caktuar ose lloj i mjetit ose burimi.




Përpilimi i raporteve financiare

Pjesa e parë - aktiva i përmban mjetet të cilat janë aftësi aftësia potenciale, fuqia e ndërmarrjes. Me investimin e mjeteve në aktivitetet ekonomike, realizohen efekte ekonomike.

Pjesa e dytë - pasiva i përmban burimet e mjeteve që mund të jenë vetjake (kapitali) dhe të huaja (obligimet).

Aktiva	BILANCI I GJENDJES	Pasiva
	MJETE =	= KAPITAL + OBLIGIME

Fotografia 4. Bilanci i gjendjes, sipas mjeteve dhe burimeve të mjeteve



PARIMET E BILANCIMIT

Me nocionin bilancim nënkuptohet mënyra e përcaktimit, si edhe mënyra e paraqitjes së pozitive bilancore. Që të jetë gjendja bilancore më informative, shumë është me rëndësi se si janë grupuar zërat në aktiven dhe pasiven. Sipas kësaj, me kalimin e kohës janë krijuar më shumë parime për mënyrën e përcaktimit dhe renditjes së pozicioneve bilancore në bilancin. Kur bëhet fjalë për përshkrimet e bilancit, ato do të mund të kuptohen më mirë në rast se renditja gjegjësisht në bilancin paraprakisht ndahen në dy grupe:

1. Parimet në lidhje me mënyrën renditjes së pozicioneve të caktuara (*siguri, likuiditet, pronësi dhe dedikim*):
 - parimet të cilat përdoren për renditjen e mjeteve të përhershme (*parimi i sigurisë*)
 - parimet të cilat përdoren për renditjen e mjeteve rrjedhëse (*parimi i likuiditetit*) burimet e mjeteve sipas - parimet të cilat përdoren për renditjen e (*parimi i pronësisë dhe parimi i dedikimit*)

Parimet që kanë të bëjnë me mënyrën e radhitjes së pozicioneve bilancore.

2. Parimet që kanë të bëjnë me saktësinë, realitetin e prezantimit të të dhënave në bilancin e gjendjes dhe bilancin e suksesit

1. Mjetet e përherëshme në bilancin grupohen sipas **parimit të sigurisë**. Në bisedën e rëndomtë thuhet “i sigurt si patundshmëri”. Sipas këtij parimi, renditja e mjeteve të përherëshme në bilancin fillon me mjetet më të patundshme: tokat, pyjet, objektet ndërtimore, mandej vazhdon me më pak të tundshmet, si që janë pajisjet, kopeja kryesore, mjete tjera për punë etj.

Mjetet rrjedhëse në bilancin grupohen në **parimin e likuiditetit**. Ky parim do të thotë aftësi dhe shpejtësi që lloj i caktuar i mjeteve qarkulluese të shndërrohen, transformohen në para. Sipas kësaj, mjetet më likuide janë mjetet e parave. Njëkohësisht, ato janë edhe mjetet më mobile, për shkak se mund të shndërrohen në çfarëdo lloj tjetër të formave të mjeteve. Sa do të trajtohen si mjete të caktuara likuide varet nga rasti konkret. Kërkesat nga blerësit për të cilët me siguri nuk mund të arkëtohen dhe nuk trajtohen si mjete likuide, përkundër kërkesave, të cilat mundën menjëherë të arkëtohen dhe të cilat konsiderohen si mjete likuide. Sipas këtij parimi, te mjetet qarkulluese (rrjedhëse), fillimisht grupohen më likuidet, mandej mjetet më pak likuide, ashtu që likuiditeti vazhdimisht zvogëlohet. Së pari renditen mjetet më likuide: mjetet e parave në Xhironlogarinë, arkën; mandej më pak likuidet si që janë kërkesat, rezervat.



Respekti i parimeve e ndalon kaosin

Siç u tha, pasiven e bilancit e përbëjnë burimet e mjeteve, gjegjësisht kapitali dhe obligimet. Në pasive, burimet grupohen në bazë të **parimit të pronësisë**. Sipas këtij parimi, grupimi duhet të paraqesë të kujt janë ose prej ku kanë ardhur mjetet në aktivë. Pasi mjetet janë vetjake dhe të huaja, sipas këtij parimi fillimisht grupohen burimet e mjeteve vetjake mandej burimet e mjeteve të huaja. Aplikimi i **parimit të dedikimit**, do të thotë grupim të burimeve sipas asaj se për çka janë të dedikuara mjetet gjegjësisht për çka do të shfrytëzohen. Shembull, në rast se duhet që ndërmarrja të blejë automjet me marrjen e kredisë nga banka, paraqitet obligim afatgjatë për kreditit e pranuar për PSS.

2. Grupi tjetër i parimeve ka të bëjë me saktësinë dhe realitetin e të dhënave të prezantuara. Për bilancin posaçërisht është me rëndësi **balanci bilancor**, respektivisht, shuma e aktives doemos duhet të jetë e barabartë me shumën e pasives. Në rast se këto dy shuma nuk janë të njëjta, kjo do të thotë se ka gabim ose në aktiven ose në pasiven. Kjo është lehtë e kuptueshme nëse nuk humbet parasysh fakti se bilanci i paraqet mjetet nga dy qëndrime (aspekte). Në aktiven paraqiten mjetet sipas përbërjes së tyre, respektivisht a janë para, materiale, pajisje, alete. Nga ana tjetër, në pasiven mjetet e njëjta paraqiten sipas asaj se prej ku kanë ardhur dhe të kujt janë (vetjake ose të huaja). Sipas kësaj barazia e aktives dhe pasives rrjedh nga logjika se Respektimi i parimeve e parandalon kaosin 3 Parimet që kanë të bëjnë me saktësinë dhe realitetin e të dhënave të prezantuara Balanci bilancor i parandalon gabimet kontabiliste. nuk mund të ketë mjete dhe ato mos kenë ardhur prej

Parimet që kanë të bëjnë me saktësinë dhe realitetin e të dhënave të prezantuara.

diku, respektivisht ,të mos i takojnë askujt.

Në këtë grup bën pjesë edhe **parimi i përhershëmrisë** (kontinuitetit) i cili rrjedh nga përhershmeria e punës së ndërmarrjes. Kur themelohet një



Balanci bilancor i parandalon gabimet kontabiliste

ndërmarrje, konsiderohet se ajo do të ketë afat të pakufizuar të ekzistimit. **Parimi i konsekuencës** do të thotë se mënyrat dhe metodat e vlerësimit të mjeteve, obligimeve, të dalave dhe hyrjeve, gjegjësisht pozicionet në bilancin nuk do të ndryshohen prej viti në vit. **Parimi i kujdesit** do të thotë të grupohen me kujdes mjetet në aktiven dhe burimet në pasiven, që të mos lëshohet ndonjë pozitë bilancore që mund të sjellë deri në disbalancin bilancor. **Parimi i kushtëzimit** të hyrjeve dhe të dalave do të thotë se të gjitha të dalat dhe të gjitha hyrjet që janë krijuar në periudhën e caktuar përlllogaritëse, duhet të përfshihen në bilancin për atë periudhë. Rezultati financiar (fitimi ose humbja), duhet të

përcaktohet vetëm në bazë të kundërshtimit të hyrjeve përkatëse me të dalat përkatëse. Për shembull, hyrjeve nga shitja e prodhimeve të gatshme duhet tu kundërvihen vetëm shpenzimet që përmbahen në ato prodhime.

Ushtrim: Shembull për përpilimin e bilancit të gjendjes së

Shoqërisë tregtare "Intermarket" nga Velesi, në vitin afarist 2008, ka filluar të punojë me gjendjen e mjeteve në vijim dhe burimet në librin kryesor në bazë të së ciklës duhet të përpunojë bilanc fillestar të gjendjes:

-Objekte ndërtimore	5.500.000
-Instalime dhe pajisje	3.500.000
-Mbëltime shumëvjeçare	1.200.000
-Amortizimi i akumuluar i mjeteve materiale	4.200.000
-Shpenzime për kërkime dhe zhvillim	1.000.000
-Shpenzime themeluese	500.000
-Patentë, licenca dhe koncesione	300.000
-Xhirollogaria	3.700.000
-Mjete të veçuara parash dhe akreditiva	300.000
-Arka	8.000
-Çeqe	15.000
-Kambiale	2.000
-Letra të tjera me vlerë	700.000
-Kërkesa nga blerësit e tokës	1.300.000
-Kërkesa nga blerësit e huaj	20.000
-Shpenzime të varëshme të paguara për furnizim (ABP)	30.000
-Obligime për çeqet e lëshuara	150.000
-Obligime për kambialet e lëshuara	200.000
-Obligime ndaj furnizuesit në vendin	350.000
-Avance të pranuar 80.000-Obligime për TVSH	45.000
-Obligime afatgjate në bazë të huave dhe kredive	3.000.000
-Obligime afatgjate për avance, depozitë dhe kaucione	500.000
-Kapitali shtetëror-publik	2.200.000
-Rezerva ligjore 300.000-Kapital aksionar	13.310.000
-Prodhimet e rezervave	3.800.000
-Lëndë të para dhe materiale të rezervave	1.500.000
-Inventari i imët i rezervave	550.000
-Pjesë rezerve të rezervave	450.000
-Shpenzime përlllogaritëse për furnizim (PBR)	40.000

Bilanci fillestar i gjendjes së SHT „Intermarket” nga Velesi

aktivë

pasivë

N r.	li/ia	MJETET	Shuma		N r.	li/ia	BURIMET E MJETEV	Shuma	
			Veç e veç	Gjithsej				Veç e veç	Gjithsej
		I .Mjetet e përhershme					A) Kapital		
		A) Mjetet iomateriale					Kapital i përgjithshëm		
1	-	Shpenzime për kërkime dhe zhvillim	1.000.000		1	-	Kapital aksionar	13.310.000	
2	-	Shpenzime themeluese			2	-	Kapital shtetëror-publik	2.200.000	
3	-	Patente, licenca, konc.	500.000		3	-	Rezerva ligjore	300.000	
		Mjete të përgjithshme jo materiale	300.000	1.800.000					15.810.000
4	-	B) Mjetet materiale	5.500.000		5	-	Obligime në afat. në bazë të huave dhe kredive	3.000.000	
5	-	Objekte ndërtimore	3.500.000		6	-	Obligime afat. për avancë, depozita dhe kaucione	500.000	
6	-	Instalime dhe pajisje.	1.200.000		7	-	Obl. për çeqe të lëshuara	150.000	
7	-	Mbëltim shumëvjeçare			8	-	Obl. për kambiale të lëshuara	200.000	
		Amortizim i akumuluar i mjeteve materiale	10.200.000		9	-	Obligime sipas furn. në vend	350.000	
		Mjetet e përgjithshme materiale	4.200.000	6.000.000	10	-	Avancë të pranuar	80.000	
		II.Mjetet rrjedhëse			11	-	Obligime për TVSH	45.000	
8	-	Xhirollogaria	3.700.000		12	-	Obligime të llogaritura të varura për furnizime (PVR)	40.000	
9	-	Mjete parash të veçuara dhe akreditiva	300.000				Obligime të përgjithshme		4.365.000
10	-	Arka	8.000						
11	-	Çeqe	15.000						
12	-	Kambiale	2.000						
13	-	Letra tjera me vlerë Kërkesa nga blerësit në vend Kërkesa nga blerësit në vend të huaj	700.000						
14	-	Prodhime të rezervave	20.000						
15	-	Lëndë të para dhe mater. të rezerv Invent. i imët i rezer. Pjesë rezervë.	3.800.000						
16	-	Shpenzimet varëse të paguara për furnizimit (ABP)	1.500.000						
17	-		550.000						
18	-		450.000						
19	-		30.000						
20	-	Mjete të përgjithshme rrjedhëse		12.375.000					
21	-	Mjete të përgjithshme		20.175.000			Burime të përgjithshme të mjeteve		20.175.000

NOCIONET KRYESORE

Mjete Obligime Kapital Kryegjë
Bilanci i gjendjes
Barazimi bazik kontabilist
Aktivë
Pasivë
Balancimi bilancor Parimet e bilancimit

PYETJE:

1. Çka paraqesin mjetet?
2. Si klasifikohen mjetet?
3. Kush i paraqet burimet e mjeteve?
4. Si klasifikohet kapitali?
5. Si klasifikohen obligimet?
6. Sqaroje barazinë bazike kontabiliste!
7. Çka paraqet bilanci i gjendjes?
8. Shpjegoi pjesët e bilancit të gjendjes!
9. Çka paraqet bilanci bilancor?
10. Numëroi dhe shpjegoi parimet e bilancimit!

Mendoni për këtë:

1. Eleonora Gjurçinoska ka gjithsej mjete 45.000 den., obligimet e saj janë 6.500 den. Antonio Jovanov ka gjithsej 25.500 den, ndërsa kapitali i tij i përgjithshëm është 20.000 den. Cili nga këto të dy është në gjendje financiare më të mirë, gjegjësisht ka mundësi më të mirë t'i paguajë obligimet e krijuara (borxhet).
2. Shqyrtoni gjendjen e juaj financiare personale. Bëni listën e të gjitha mjeteve me të cilat dispononi, i keni si tuajat. Përcaktojeni vlerën e tyre veç e veç me anë të vlerësimit ose sipas vlerave të sakta. A keni ndonjë borxh (obligim) të shprehur në para? Cila është vlera Juaj neto ose kapitali? Përpiloni bilancin tuaj personal të gjendjes me datën e sotme!

USHTRIME PËR PËRPILIMIN E BILANCIT TË GJENDJES

1. Në bazë të gjendjeve fillestare në vijim të mjeteve dhe burimeve të mjeteve **BILANCI I GJENDJES** i korporatës “**Makpromet**” më 01.01.2009.

- Instalime dhe pajisje 3.500.000 den.
- Obligime për kredi afatgjate nga bankat 2.000.000 den.
- Sall e fabrikës 800.000 den
- Para të gatshme në arkë 25.000 den,
- Obligime ndaj furniz. të mjeteve qark.140.000 den,
- Obligime për kredi për mjete qark..90.000 den,
- Tokë 70.000 den
- Licenca 20.000 den
- Obligime ndaj furniz. të mjet. të përher.180.000 den,
- Kapitali vetjak?
- Rezervat e prodhimeve të gatshme 1.500.000 den,
- Mjete të investuara në bankë mbi 1 vit 230.000 den.
- Objekte tjera ndërtimore 120.000 den,
- Kredi afatgjate të dhëna 240.000 den,
- Rezerva e materialeve 400.000 den,
- Xhirollogaria 650.000 den,
- Kërkesa nga blerësit për mjete qarkull. 250.000 den,
- Inventari i imët 60.000 den,
- Shpenzime për kërkime dhe zhvillim 25.000 den,
- Magazinë 20.000 den,
- Rezerva statutore 30.000 den.
- Rezerva ligjore 10.000 den.
- Çeqe 18.000 den.
- Kërkesa nga të punësuarit 6.000 den.
- Pagimi i prolonguar i shpenzimeve 22.000 den.

2. Në bazë të gjendjeve fillestare në vijim të mjeteve dhe burimeve të mjeteve të përpilohet **BILANCI I GJENDJES** i kompanisë "TINEKS", më 01.01.2009

- Investime themeluese 15.000 den
- Toka 40.000 den,
- Obligime për kredi afatgjata nga bankat jashtë vendit për mjetet e përhershme 180.000 den,
- Gudvill 10.000 den
- Shpenzime për kërkime 20.000 den
- Para të gatshme në arkë 10.000 den,
- Llogaria devizore për valuta konvertuese 40.000 den.
- Obligime ndaj furniz. të mjeteve qarkull. 25.000 den,
- Obligime për kredi për mjete qarkull. 40.000 den,
- Makina 100.000 den,
- Rezerva të prodhimeve të gatshme 250.000 den
- Rezerva ligjore 15.000 den
- Objekte ndërtimore 110.000 den,
- Kredi afatgjata të dhëna 20.000 den,
- Rezerva e materialeve 60.000 den,
- Xhirollogaria 90.000 den,
- Kërkesa nga blerësit për mjete qarkulluese 35.000 den,
- Inventar i imët 10.000 den,
- Obligime afatgjata për avance të pranuar 120.000 den
- Rezerva e inventarit për zyra 24.000 den.
- Aparate dhe instalime 60.000 den.
- Kërkesa nga avancat e dhënë për mjete materiale 16.000 den.
- Obligime afatgjata në bazë të letrave me vlerë 34.000 den.
- Kapitali personal ?

3. Në bazë të gjendjeve fillestare në vijim të mjeteve dhe burimeve të mjeteve, të përpilohet **BILANCI I GJENDJES** i shoqërisë aksionare "Sllloboda", më 01.01. 2009

- Kapital aksionar,
- Xhirollogaria 550.000 den,
- Obligime afatgjata për kredi 100.000 den,
- Inventar i imët në rezervë 120.000 den,
- Obligime për kredi për mjete qarkull. 60.000 den,
- Obligime ndaj furnizueseve të mjeteve të përher. 39.000 den,
- Rezerva e prodhimeve të gatshme 250.000 den,
- Toka 120.000 den,
- Mjete të ndara të parave 8.000 den.
- Objekte tjera ndërtimore 20.000 den,
- Kredi të dhëna afatgjate 40.000 den,
- Para të gatshme në arkë 25.000 den,
- Obligime ndaj furniz. të mjeteve qarkull. 35.000 den.
- Shpenzime për kërkime dhe zhvillim 10.000 den
- Kambiale 13.000 den.
- Objekte ndërtimore 130.000 den.
- Kërkesa nga avancat e dhënë për mjete materiale 7.000 den
- Kërkesa nga blerësit 30.000 den.
- Kërkesa nga të punësuarit 4.000 den
- Obligime për tatimin e vlerës së shtuar 8.000 den.
- Obligime për rroga dhe kompensime të rrogave 150.000 den.
- Pagesa e prolonguar e shpenzimeve 12.000 den.

4. Shoqëria aksionare "Tehnoprom" nga Velesi më 31.12.2008 disponon me gjendjen në vijim të mjeteve, obligimeve dhe kapitalit në bazë të së cilave duhet të përpilojë **bilanc të gjendjes**:

- Para në xhirollogari 400.000 den.
- Rezerva ligjore 65.000 den
- Mjete parash të rezervave 65.000den
- Ndërtesa 2.000.000 den.
- Shitore 920.000 den.
- Obligime afatshkurta ndaj furnizuesve 250.000 den.
- Obligime afatgjata në bazë të kredive 250.000 den.
- Kërkesa nga avancat e dhënë për mjete materiale 550.000 den
- mjete mm 320.000 den.
- Mjete transportuese 600.000 den.
- Kompjuterë 80.000 den.
- Piktura artistike 75.000 den.
- Kredi të dhëna mbi 1 vit 90.000 den.
- Obligime afatshkurta për tatime 50.000 den.
- Kërkesa nga punëtorët për shkurtesa 15.000 den.
- Çeqe nga shitja nëpërmjet shitores 100.000 den.
- Lëndë të para dhe materiale në rezervë 185.000 den.
- Rezerva të mallrave 81.000 den.
- Kërkesa nga blerësit 150.000 den.
- Shpenzime themelimi 20.000 den.
- Rezerva revizore 300.000 den.
- Përfitimi i akumuluar 100.000 den.
- Përfitimi për vitin financiar 17.500 den.
- Amortizimi i akumuluar i objekteve ndërtimore 120.000 den
- Amortizimi i akumuluar i pajisjes 120.000 den.
- Kapitali aksionar?

Zgjidhja:

Aktivë e përgjithshme=Pasivë e përgjithshme=5.711.000 den.

Tema 3:

NGJARJE DHE LLOGARI KONTABILISTE

PËRMBAJTJA E TEMËS:

Nocioni ngjarje kontabiliste Grupet kryesore të formuara sipas ndikimit të tyre mbi bilancin e gjendjes Rritja e shumës së bilancit Zvogëlimi i shumës së bilancit Ndryshimet strukturore në aktiven Ndryshimet strukturore në pasiven Nocioni fatura Rregullat për regjistrimin e llogarive Katër grupe të ngjarjeve për regjistrim të mjeteve dhe burimeve Hapja e llogarive në bazë të bilancit të gjendjes Llojet e llogarive Llogari për mjetet dhe llogari për burimet Llogari aktive, pasive dhe aktive-pasive Llogari sintetike dhe analitike Llogari të tërësishme, të pa tërësishme dhe korrektuese Llogari të gjendjes, të suksesshme dhe të përziera Saldoja e llogarive Format e llogarive

QËLLIMET E MËSIMIT:


Nxënësi:

-ta definojë nocionin ngjarje kontabiliste,
-t'i klasifikojë grupet kryesore të ngjarjeve,
-ta sqarojë ndikimin e ngjarjeve mbi bilancin e gjendjes,
-ta kuptojë esencën e llogarive,
-t'i zbatojë rregullat për regjistrimin llogarive,
-t'i aplikojë grupet e ngjarjeve gjatë regjistrimit,
-ta analizojë ndikimin e transaksioneve mbi barazinë kontabiliste,
-të hapë llogari në bazë të bilancit të gjendjes,
-t'i klasifikojë llojet e llogarive,
-të përcaktojë saldo të llogarive,
-t'i dallojë format e llogarive.

NOCIONI NGJARJE KONTABILISTE

Puna e bizneseve përbëhet prej operacioneve të shumta, të cilat në fjalorin kontabilist quhen biznes aktivite afariste - **ngjarje afariste**. Veprimtaria e bizneseve prodhuese përbëhet nga aktivitetet afariste në vijim: aktivitete financiare, investuese dhe operative. Aktivitetet financiare përbëhen nga sigurimi i parave për fillimin e biznesit: nga mjetet vetjake, nga shitja e obligacioneve dhe aksioneve, sigurimi i parave nga kreditë afatgjata. Aktivitetet investuese përbëhen nga blerja e mjeteve për fillimin e biznesit me mjetet e siguruara me ç'rast krijohen obligime. Kur njëherë do të sigurohen financa dhe investime, biznesi është mi gatshëm të fillojë. Fillimi i biznesit përbëhet nga aktivitetet operative të shumta, prodhimi, shërbimet, shitja e prodhimeve dhe shërbimeve, lindja e shpenzimeve, pagesa e rrogave të punëtorëve, pagesa e obligimeve të furnizuesve, pagimi i tatimeve ndaj shtetit dhe ngjashëm. Të gjithë këto shembuj janë aktivitete operative të rëndësishme. Ngjarje afariste, sipas kësaj janë të gjitha ngjarjet që kanë të bëjnë me funksionimin e një biznesi.

Aktivitetet afariste përbëhen nga aktivitetet financiare, investuese dhe operative.



Ngjarjet afariste që mund të shprehen në para dhe që shkaktojnë ndryshime në madhësinë ose strukturën e mjeteve dhe burimeve të mjeteve, a për të cilat ekziston dokument janë ngjarje kontabiliste.

Ngjarjet kontabiliste zakonisht rrjedhin nga ngjarjet afariste. Mirëpo, të gjitha ngjarjet afariste nuk janë njëkohësisht edhe ngjarje kontabiliste. Vetëm ato ngjarje afariste që mund të shprehen në para dhe që shkaktojnë ndryshime në madhësinë dhe në strukturën e mjeteve dhe burimet e mjeteve e për të cilat ekziston dokument, janë ngjarje kontabiliste.

Ngjarja e cila nuk mund të shprehet në para (në vlerë) mund të jetë afariste, ekonomike, mirëpo nuk mund të jetë ngjarje kontabiliste. Ashu por shembull, leja ndërtimore e lëshuar për ndërtimin e objektit afarist është ngjarje afariste e rëndësishme për ndërmarrjen, mirëpo kjo nuk paraqet ngjarje kontabiliste për shkak se nuk mund të shprehet në para. I njëjtë është rasti me drejtorin e ri të ndërmarrjes, i cili mund të jetë ngjarje e rëndësishme afariste por jo edhe ngjarje kontabiliste. Ngjarja kontabiliste është megjithatë, pagimi i rrogave të punëtorëve, për shkak se shprehet në para dhe shkakton ndryshime në mjetet dhe obligimet. Gjegjësisht, me rastin e kësaj ngjarjeje, zvogëlohen mjete e parave në Xhirollogarinë dhe zvogëlohen obligimet ndaj punëtorëve. Ngjarje kontabiliste është edhe lëshimi i materialeve në prodhimtari për shkak se shkakton ndryshime në strukturën e mjeteve (zvogëlohen rezervat e materialeve, ndërsa rritet vlera e prodhimtarisë aktuale).

Ngjarjet kontabiliste, përveç tjerash, janë lëndë e **evidentimit**

Ngjarjet kontabiliste, përveç tjerash, janë lëndë e **evidentimit**. Që të mund të evidentohen (regjistrohen) ngjarjet kontabiliste, për to duhet të formohet dokument. Në rast se për një ngjarje kontabiliste nuk është formuar dokument, ai atëherë nuk mund të evidentohet. Pagimi i avancës për udhëtimin zyrtar, për shembull, është ngjarje kontabiliste. Ajo ngjarje shprehet në para dhe shkakton ndryshime në strukturën e mjeteve (mjetet e parave zvogëlohen ndërsa do të rriten shpenzimet për punën). Mirëpo, në rast se nuk formohet dokument për këtë pagesë, kjo ngjarje nuk mund të evidentohet.

Ngjarjet kontabiliste mund t'i klasifikojmë nga dy këndvështrime të ndryshme:

- 1) në ngjarje kontabiliste të thjeshta dhe të ndërlikuara, sipas asaj se në sa konto shkaktojnë ndryshime, dhe
- 2) në ngjarje kontabiliste eksterne dhe interne, sipas asaj se a krijohen nga transaksionet me rrethinën ose brenda në firmën.

Ngjarje e thjeshtë kontabiliste e cila shkakton ndryshime vetëm në kontot me të cilat përfshihen vetëm dy kategori kontabiliste prej të cilave njëra është pozitive (ka borxh), ndërsa tjetra negative (kërkon). Ngjarje e thjeshtë kontabiliste është për shembull tërheqja e parave nga banka (konto-Xhiro) për në arkë (konto-arkë). Ngjarje e ndërlikuar kontabiliste është ajo e cila shkakton ndryshime në më shumë se dy konto në të cilat regjistrohen ndryshimet e kategorive kontabiliste.

Ngjarje e ndërlikuar kontabiliste është për shembull ngjarja që ka të bëjë me renditjen e shpenzimeve, pagesën e rrogave etj.

Ngjarje kontabiliste eksterne janë ato të cilat rrjedhin nga interaksionet ndërmjet ndërmarrjes dhe rrethinës, si që janë transaksionet me ndërmarrjet tjera (shitja, furnizimi), me kreditorët, me shtetin dhe me partnerët tjerë me të cilët ndërmarrja korrespondon. Ngjarje kontabiliste interne janë ngjarjet të cilat ndodhin brenda në ndërmarrjen, si që janë shpenzimi i materialeve, përdorimi i prodhimeve vetjake për qëllime vetjake dhe ngj. Ekzistojnë një sërë ngjarjes kontabiliste të cilat kanë karakterin ekstern - intern. Ngjarje të atilla janë për shembull pagesa e rrogave, shpërndarja e përfitimit bruto dhe ngjashëm.

Në kontabilitetin hasim një grup të ngjarjeve i cili quhet "ngjarje pastër kontabiliste". Ashtu emërtohen për shkak se nuk krijohen nga ngjarjet shoqërore por është jashtëzakonisht e lidhur me funksionin evidentues të kontabilitetit. Të atilla janë ngjarjet që kanë të bëjnë me përmbyllen e llogarive, korrigjimin e gabimeve kontabiliste etj. Ngjarjet e këtilla nuk shkaktojnë ndryshime në madhësinë, as ndryshime në strukturën e mjeteve dhe burimeve të tyre. Këto ngjarje paraqesin përjashtim nga nocioni i përgjithshëm për ngjarjet kontabiliste.

GRUPET THEMELORE SIPAS NDIKIMIT TË TYRE MBI BILANCIN E GJENDJES

Me anë të ngjarjeve kontabiliste ose ndryshohet madhësia e mjeteve dhe burimeve, ose bëhet ndryshimi i formës së tyre, ose ndryshohet struktura e aktives dhe pasives. Ndryshimi i formës së mjeteve dhe burimeve (obligimet dhe kapitali) emërtohet edhe transformimi i mjeteve dhe burimeve. Si që u tha paraprakisht, ngjarjet kontabiliste mund të jenë interne dhe eksterne. Kur një ngjarje paraqitet si rezultat i transformimit të mjeteve në suazat e ndërmarrjes, atëherë themi se ajo është ngjarje e brendshme (interne) kontabiliste. Gjithashtu, ngjarje interne është edhe lëshimi i materialeve nga rezerva në prodhim. Nga ana tjetër, ngjarjet eksterne paraqiten gjatë raporteve me ndërmarrjet tjera. Ngjarje eksterne e atillë, për shembull, paraqet furnizimi i materialeve nga furnizuesit, marrja e kredisë nga banka, shitja e prodhimeve etj. Është e qartë se në dy shembujt e fundit, ndërmarrja hyn në raporte me persona të tjerë, së këndejmi edhe emërtimi ngjarje të jashtme (eksterne) kontabiliste.

Duke u nisur nga ndikimi i ngjarjeve interne dhe eksterne mbi bilancin e gjendjes, të gjitha ngjarjet kontabiliste mund të grupohen në katër grupet në vijim:

Katër grupet e ngjarjeve kontabiliste të cilat ndikojnë mbi shumën e bilancit.

1. Ngjarje kontabiliste të cilat e bëjnë zmadhimin e shumës së bilancit.
2. Ngjarje kontabiliste të cilat e bëjnë zvogëlimin e shumës së bilancit
3. Ngjarje kontabiliste të cilat bëjnë ndryshime strukturore të aktives.
4. Ngjarje kontabiliste të cilat bëjnë ndryshime strukturore të pasives.

1. RRITJA E SHUMËS SË BILANCIT

Në grupin e parë bëjnë pjesë të gjitha ngjarjet me ndikimin e të cilave vjen deri në zmadhimin shumës së aktives dhe pasives. Kuptohet se nuk mund të zmadhohet vetëm aktivja ose pasivja pasi që me atë rast do të çrregullohej bilanci bilancor, gjegjësisht mjetet nuk do të ishin të njëjta me obligimet dhe kapitalin. Por edhe ashtu sistemi i kontabilitetit bazohet mbi parimin sipas të cilit zmadhimi i shumës së aktives detyrimisht tërheq zmadhim të shumës së pasives dhe anasjelltas.

& Shembull: për formë të shkurtër të thjeshtëzuar të biznesit "Mile dhe Ace" për prodhimtarinë e lëngjeve:

- Xhirollogaria 50.000 den.
- Arka kryesore 10.000 den.
- Kërkesa nga blerësit 15.000 den.
- Rezerva të prodhimit 60.000 den.
- Kapitali i Miles dhe Aces?
- Kredi për mjet të përhershme 25.000 den.
- Kredi për mjete qarkulluese 20.000 den.
- Obligime ndaj furnizuesve për mjetet qarkull. 12.000 den.
- Obligime për tatime 5.000 den.

Në formë të thjeshtëzuar, bilanci i gjendjes sipas këtyre të dhënave të paraqitet si në mënyrën e vijim:

Bilanci i gjendjes nr.1 përpiluar më 31.12. 2008**Biznes "MILE DHE ACE"**

Aktive

Pasive

1.	Xhirollogaria	50 000		Kapitali i "M dhe A"	73 000
2.	Arka kryesore	10 000		Kredi për mjete të përherëshme	25 000
3.	Rezervat e prodhimit	60 000		Kredi për mjete qarkull.	20 000
4.	Kërkesa nga blerësit	15 000		Obligime ndaj furnizuesve	12 000
				Obligime për tatime	5 000
				Gjithsej	135 000
	Gjithsej	135 000			

Barazimi fillestar bazik kontabilist paraqet:

$$\text{MJETE} = \text{KAPITAL} + \text{OBLIGIME}$$

$$135\,000 = 73\,000 + 62\,000$$

Biznesi "MILE DHE ACE", më 31.12.2008 ka pasur gjithsej mjete 135.000 den., obligime 62.000 den. dhe kapital vetjak 73.000 den. me ç'rast mjetet janë të njëjta me kapitalin e pronarëve plus obligimet. Duke u nisur nga gjendja në bilancin e sipërm me nr.1., të supozojmë se ka ndodhur ngjarja kontabiliste në vijim:

1. Sipas fragmentit nga banka me nr. 121. më 05.01.2008, në Xhirollogarinë janë paguar 14.000 den., shumë e fituar si kredi për mjetet qarkulluese.

Për shkak të kësaj ngjarjeje vjen deri në rritjen e bilancit pasi edhe aktivja edhe pasivja janë rritur për 14.000 den. Në aktiven mjetet e parave në Xhirollogarinë rriten për 14.000 den., ndërsa në pasiven obligimet për kreditë për mjetet qarkulluese rriten për 14.000 den.

Në bilancin e gjendjes nr.1 është paraqitur gjendja para se të ndodhë ngjarja e përmendur gjegjësisht para se të fitohet kredia e përmendur për mjetet qarkulluese prej 14.000 den. Nëse do të merrej parasysh ndikimi i kësaj ngjarjeje do të fitohet bilanc i gjendjes me nr. 2 ku do të reflektohej ndryshimi i ngjarë në mënyrën si vijon:

Bilanci i gjendjes nr. 2 përpiluar më 05. 01. 2008**Biznes "MILE DHE ACE"****Aktive****Pasive**

1.	Xhirollogaria	64 000		Kapitali i "M dhe A"	73 000
2.	Arka kryesore	10 000		Kredi për mjete të përhershme	25 000
3.	Rezervat e prodhimit	60 000		Kredi për mjete qarkull.	34 000
4.	Kërkesa nga blerësit	15 000		Obligime ndaj furnizuesve	12 000
				Obligime për tatime	5 000
	Gjithsej	135 000		Gjithsej	149 000

Në grupin e parë të ngjarjeve ku bën pjesë edhe ngjarja e sipërme vjen deri në rritjen e shumës së bilancit. Në shembullin tonë erdhi deri në rritje për 14.000 den. për shkak të rritjes së njëkohshme të një mjeti dhe një obligimi (burimi).

$$\begin{array}{rclcl}
 \text{MJETE} & = & \text{KAPITAL} & + & \text{OBLIGIME} \\
 135\,000 & = & 73\,000 & + & 62\,000 \\
 + 14\,000 & = & \text{----} & & 14\,000 \\
 \hline
 149\,000 & = & 73\,000 & + & 76\,000
 \end{array}$$

Me kredinë e huazuar vlerat në barazimin themelor kontabilist u ndryshuan.

Pasi që kjo ngjarje ka ndikim mbi rritjen e mjeteve në aktiven dhe deri në rritjen e obligimit në pasiven, shuma e bilancit është rritur. Balanci bilancor nuk është çrregulluar, barazimi themelor kontabilist u ndryshua në vlerat: mjetet janë të barabarta me kapitalin dhe obligimet, por pas ngjarjes mjetet rriten për 14.000 gjithashtu edhe obligimet rriten për 14.000 ashtu që mjetet janë 149.000 ndërsa obligimet 76.000, kapitali i pronarëve nuk u ndryshua nën ndikimin e kësaj ngjarjeje.

Shuma e bilancit, megjithatë, mund të rritet edhe për shkak të ngjarjeve të tjera. Të atilla do të ishin për shembull, të paraqitet një mjet i ri në aktiven dhe të rritet një burim në pasiven; të paraqitet mjet i ri në aktiven dhe të paraqitet mjet i ri në pasiven...

2. ZVOGËLIMI I SHUMËS SË BILANCIT

Grupi i dytë i ngjarjeve çon kah zvogëlimi i shumës së bilancit të gjendjes. Ndryshimet paraqiten edhe në aktiven edhe në pasiven, por të tipit të atillë që vjen deri në zvogëlim në shumën e njëjtë edhe të shumës së aktives edhe të shumës së pasives. Në aktiven zvogëlohet një mjet ndërsa në pasiven zvogëlohet një obligim (një burim). Shemb. Duke e marrë parasysh gjendjen e bilancit nr. 2, supozojmë se ka ndodhur ngjarja kontabiliste (transaksioni) në vijim:

2. Sipas fragmentit të bankës nr. 4. më 25.01.2008 u është paguar furnizuesve 5.000 den.

Ndikimi i kësaj ngjarjeje e reflekton bilancin nr.3 që vijon:

Bilanci i gjendjes nr. 3 përpiluar më 25. 01. 2008

Biznes "MILE DHE ACE"

Aktive			Pasive		
1.	Xhirollogaria	59 000		Kapitali i "M dhe A"	73 000
2.	Arka kryesore	10 000		Kredi për mjete të përherëshme	25 000
3.	Rezervat e prodhimit	60 000		Kredi për mjete qarkull.	34 000
4.	Kërkesa nga blerësit	15 000		Obligime ndaj furnizuesve	7 000
				Obligime për tatime	5 000
	Gjithsej	144 000		Gjithsej	144 000

Në krahasim me bilancin nr 2., në bilancin e gjendjes nr.3. vjen deri në zvogëlimin e mjeteve të parave në Xhirollogarinë për 5.000 den., ndërsa për shumën e njëjtë janë zvogëluar obligimet ndaj furnizuesve, ashtu që vjen deri në zvogëlimin e shumës së bilancit. Shuma e bilancit mund të zvogëlohet edhe në rastin kur, për shembull vjen deri në shuarjen e një mjeti në aktiven dhe deri në zvogëlimin e një burimi në pasiven dhe anasjelltas.

MJETE	=	KAPITAL	+	OBLIGIME
149 000	=	73 000	+	76 000
- 5 000	=	----	+	5 000
<hr style="width: 100%;"/>		<hr style="width: 100%;"/>	-	<hr style="width: 100%;"/>
144 000	=	73 000	+	71 000

Mjetet zvogëlohen për 5.000 den. dhe janë 144.000 den, obligimet gjithashtu zvogëlohen për 5.000 den dhe janë 71.000 den, kapitali i pronarit mbetet i pandryshuar.

3. NDRYSHIMET STRUKTURE NË AKTIVEN (Një mjet zvogëlohet ndërsa mjete tjetër zmadhohet)

Transaksionet (ngjarjet) nga ky grup nuk e ndryshojnë shumën e bilancit të ngjarjeve. Nuk ndryshohen obligimet, nuk ndryshohet kapitali i pronarit – nuk ka ndryshime në anën e djathtë të barazimit kontabilist. Ndryshimet ndodhin në mjetet edhe atë për shumën e njëjtë për ndonjë mjet zvogëlohen ndërsa tjetri zmadhohet, së këndejmi shuma e mjeteve të përgjithshme mbetet e njëjtë, ndryshimet ndodhin vetëm në strukturën e tyre.

Shemb: Duke e marrë parasysh gjendjen në bilancin nr 3. supozojmë se ka ndodhur ngjarja kontabiliste në vijim (transaksion):

3. Pronarët kanë blerë pajisje më 10.02.2008 kur e kanë paguar Xhirollogarinë në shumën 10.000 den.

Bilanci i gjendjes nr. 4 i përpiluar më 10.02.2008.

Biznes “MILE DHE ACE”

Aktive			Pasive		
1.	Xhirollogaria	10 000		Kapitali i "M dhe A"	73 000
2.	Arka kryesore	49 000		Kredi për mjete të përhershme	25 000
3.	Rezervat e prodhimit	10 000		Kredi për mjete qarkull.	34 000
4.	Kërkesa nga blerësit	60 000		Obligime ndaj furnizuesve	7 000
		15 000		Obligime për tatime	5 000
		144 000		Gjithsej	144 000
	Gjithsej	144 000			

Në bilancin nr.4 është rritur një mjet (saktësisht është paraqitur mjet i ri) “Pajisje” në shumën prej 10 000 ден, ndërsa janë zvogëluar paratë në Xhirollogarinë për 10 000 den. Sipas kësaj, ndryshimi është vetëm në strukturën e mjeteve, shuma e tyre e përgjithshme mbetet e pandryshuar. Obligimet dhe kapitali i pronarëve nuk ndryshohen, sipas kësaj shuma e bilancit nuk ndryshohet.

MJETE	=	KAPITAL	+	OBLIGIME
144 000	=	73 000		71 000
+ 10 000				
- 10 000				
<u>= 144 000</u>	=	<u>73 000</u>	+	<u>71 000</u>

4. NDRYSHIME STRUKTURE NË PASIVËN (Një obligim zvogëlohet ndërsa obligimi tjetër zmadhohet)

Ngjarjet, transaksionet e këtij grupi shkaktajnë ndryshime në **strukturën e pasives** - obligimet dhe kapitali, shuma e saj nuk ndryshohet, mjetet mbesin të pandryshuara, së këndejmi shuma e bilancit nuk ndryshohet.

Shemb: Duke e marrë parasysh gjendjen në bilancin nr 4. supozojmë se ka ndodhur ngjarja kontabiliste në vijim (transaksioni) :

4.Për sigurimin e pagesës së obligimeve ndaj një furnizuesi më 16.02.2008 është lëshuar aksept i 3.000 den.

Ndikimi i kësaj ngjarjeje do të shprehet në strukturën e pasives në mënyrën në vijim:

Bilanci i gjendjes nr. 5 përpiluar më 16.02.2008

Aktive		Biznes "MILE DHE ACE"		Pasive	
1.	Xhirollogaria	10 000		Kapitali i "M dhe A"	73 000
2.	Arka kryesore	49 000		Kredi për mjete të përherëshme	25 000
3.	Rezervat e prodhimit	10 000		Kredi për mjete qarkull.	34 000
4.	Kërkesa nga blerësit	60 000		Obligime ndaj furnizuesve	4 000
		15 000		Obligime për tatime	5 000
				Obligime për kambialet e lëshuara (akcepte)	3 000
	Gjithsej	144 000		Gjithsej	144 000

Në krahasim me bilancin nr 4, në bilancin nr 5. mund të vërehet ndryshimi vetëm në pasiven. Respektivisht, është paraqitur një pozitë bilancore e re – akseptë, por njëkohësisht është zvogëluar pozitë tjetër bilancore në pasiven – obligime ndaj furnizuesit – për shumën e njëjtë 3.000 den., ashtu që sipas kësaj, shuma e bilancit nuk ndryshohet.

MJETE	=	KAPITAL	+	OBLIGIME
144 000	=	73 000	+	71 000
			-	3 000
			+	3 000
<hr/> 144 000	=	<hr/> 73 000	+	<hr/> 71 000

& USHTRIME “Frikom”, kompania për prodhimin e akullores më 30.06.2008 e ka gjendjen e mjeteve, kapitalit dhe obligimeve në vijim:

- Instalime dhe pajisje	220 000 den.
- Rezerva e prodhimeve	50 000 den.
- Xhirollogaria	90 000 den.
- Kërkesa nga blerësit	40 000 den.
- Kapitali i pronarit	190 000 den.
- Obligime ndaj furnizuesve	45 000 den.
- Kredi nga Stopanska banka	50 000 den.
- Obligime ndaj të punësuarve për rroga	15 000 den.

Më 01. 07.2008 kanë ndodhur ngjarjet kontabiliste në vijim:

- Pronari investon para të gatshme në biznesin 30 000 den
- I ka paguar rrogat e të punësuarve 15 000
- Pagan para të gatshme për pajisje 25 000
- Merr kredi nga Banka Komerciale 25 000

% Kërkohet: Të përpilohet bilanci i gjendjes më 30.06.2008. Ngjarjet paraprake të shprehen në bilancin e gjendjes më 01.07.2008.

Më 05. 07. 2008 kanë ndodhur ngjarjet në vijim:

- Shet pajisje të vjetër për para të gatshme 60 000 den.: **Zvogëlohet pajisja për 60.000 den, xhirollogaria zmadhohet për 60 000 den.**

% Kërkohet: Të vazhdosh!

- Ka blerë kamion të ri me të pritur nga furnizuesi 100 000? _____
- Tërheq (nxjerr) para të gatshme për nevoja personale 5 000? _____
- U ka shit prodhime me të pritur (konto e hapur) blerësve 25 000 den?__
- Ka kthyer kamatë nga kredia e Stopanska banka 10 000 den? _____
- Për sigurimin e obligimeve ndaj furnizuesit ka lëshuar akseptë kambiale 60 000? _____
- Ka blerë kompjuter në konto të hapur (t'i paguhet më vonë furnizuesit) 20 000? _____
- I ka paguar tatim shtetit 3000? _____
- Ka blerë materiale me para të gatshme 5000 den? _____

Përdorni secilin nga nocionet në vijim në fjali e cila ka lidhje me kontabilitetin

- | | |
|------------------------|-------------------------|
| - Ngjarje kontabiliste | - Pronari |
| - Balanci bilancor | - Aktive |
| - Pasive | - Obligime |
| - Pozita bilancore | - Ngjarjet kontabiliste |
| - Barazimi kontabilist | - Evidentimi |
| - Borxhet | - Kredi e pa paguar |

NJOHURI PËR LLOGARITË

Nga procedura e sqaruar në lidhje me ndikimin e ngjarjeve kontabiliste mbi bilancin e gjendjes mundet të vërehet se pas çdo ngjarjeje përpilohej lloj i veçantë i bilancit. Kuptohet se procedura e këtillë nuk mund të jetë praktike. Në fakt, në praktikë as që punohet në atë mënyrë. Nuk mund të bëhet bilanci pas çdo ngjarjeje, për faktin se ndërmarrjet në numër të madh evidentojnë në ditë më shumë se një mijë ngjarje kontabiliste. Kjo, do të thoshte se në ditë të bëhen nga disa mijë ngjarje. Jo vetëm për shkak të numrit të ngjarjeve por edhe për shkak të numrit të madh të pozitave bilancore që hasen në praktikën, përpilimi i bilancit pas çdo ngjarjeje bëhet e pa pararenduar. Nga ana tjetër, përpilimi i bilancit pas çdo ngjarjeje as që nevojitet.

Ndryshimet kontabiliste që paraqiten si rezultat i ngjarjeve kontabiliste evidentohen në **llogari**.

Me qëllim që të shihet gjendja veç e veç e mjeteve dhe burimeve të mjeteve, bilanci i gjendjes ndahet në llogari. Llogaritë pra, janë pjesë të bilancit të gjendjes ose të bilancit të ndryshimeve kontabiliste që paraqiten si rezultat i ngjarjeve kontabiliste evidentohen në llogari.

Ndryshimet kontabiliste që paraqiten si rezultat i ngjarjeve kontabiliste evidentohen në **llogari**.

Llogaritë janë formularë në të cilët evidentohen gjendja dhe ndryshimet e mjeteve dhe burimeve veç e veç, si edhe të hyrjeve dhe të dalave veç e veç/suksesit. Në to evidentohen gjendja dhe ndryshimet e mjeteve dhe burimeve si edhe të hyrjeve dhe të dalave. Për çdo lloj të veçantë të mjeteve ose burimeve hapet llogari e veçantë ashtu që mund të përcillet gjendja dhe ndryshimet e krijuara veç e veç. Llogaritë, pa dyshim, janë pjesë thelbësore e evidencës kontabiliste (së këndejmë emërtimi “kontabiliteti”). Për dallim nga bilanci i gjendjes, i cili e paraqet tërësinë e mjeteve dhe burimeve, tërësia e tyre ose për dallim nga bilanci i suksesit i cili e paraqet tërësinë e hyrjeve dhe të dalave, llogaritë e paraqesin gjendjen e tyre veç e veç dhe ndryshimet që kanë ndodhur në to.

Në literaturën bashkëkohore kontabiliste – financiare, dhe praktika me prejardhje vendore dhe e huaj për llogaritë e sipas disave kontot, ekzistojnë më shumë sqarime dhe përkufizime. Në pjesën më të madhe të punimeve nga kjo sferë. Llogaritë definohe si elemente kryesore konstitutive dhe pjesë thelbësore të dy tërësive kohezive: bilanci i gjendjes dhe bilanci i suksesit. Gjithashtu konsiderohet se llogaritë – kontot në formën e mjeteve vizuale paraqesin instrumente kryesore të mekanizmit kontabilist të kontabilitetit të dyfishtë, si e dhe bazë e mbindërtimit të tërësishtëm kontabilist dhe infrastrukturës. Njëpërmjet llogarive si elemente konstitutive të bilanceve të përmendur përcillet jo vetëm nga këndvështrimi statistikor, gjendja e mjeteve dhe burimeve të mjeteve, hyrjet dhe të dalat, por edhe nga këndvështrimi dinamik, në distancë kohore lëvizja e mjeteve dhe burimeve të mjeteve, hyrjeve dhe të dalave dhe rezultati financiar. Së këndejmë, edhe pohimi i pakontestueshëm sipas të cilit nga këndvështrimi analitik, llogaria paraqet pjesë të një tërësie dhe njëkohësisht tërësi e një pjese, në varësi nga aspekti i vetë mbikëqyrjes dhe analizës.

Nga këndvështrimi kontabilist llogaritë janë formularë në të cilët evidentohen gjendja dhe ndryshimet e mjeteve dhe burimeve të caktuara, si e dhe të shpenzimeve dhe hyrjeve veç e veç. Në llogaritë bëhet evidencimi sipas lëndës, karakterit dhe elementeve.

Evidentimi sipas **lëndës** do të thotë evidentim i çdo lloji të mjeteve dhe burimeve veç e veç, të shpenzimeve dhe të hyrjeve. Kjo do të thotë se gjendja dhe të gjitha ndryshimet e çdo mjeti, burimi, hyrjeje ose shpenzimi duhet të jenë të përqendruar në një formular (llogari). Në këtë mënyrë, në çdo kohë mund të shihet si ka qenë gjendja fillestare, çfarë ndryshime i kanë ndodhur mjetit përkatës, burimit, hyrjes, shpenzimit dhe si është gjendja e fundit nën ndikimin e të gjitha ndryshimeve që kanë ndodhur. Ashtu *për shembull*: Për mjetet e parave në ndërmarrjen mbahet llogaria *arka*. Në këtë llogari në çdo kohë mund të shihet. Në llogaritë bëhet evidencimi sipas lëndëve, karakterit dhe elementeve. Gjendja fillestare e mjeteve të parave, të gjitha hyrjet e parave në arkë dhe të gjitha dhëniet e parave nga arka, si edhe gjendja e fundit e fituar pas të gjitha pranimeve dhe dhënieve.

Llogaritë janë formularë në të cilët evidentohen gjendja dhe ndryshimet e mjeteve dhe burimeve të caktuara si edhe të të dalave të caktuara.

Në llogaritë bëhet evidencimi sipas lëndës, karakterit dhe sipas elementeve.

Evidentimi sipas **karakterit** do të thotë përkufizimi i veprimit të ngjarjeve sipas asaj a shkakton së paku dy ndryshime, prej të cilëve njëri doemos duhet të jetë pozitiv ndërsa tjetri negativ. Në llogaritë në të cilat evidentohen burimet, obligimet, ndryshimet pozitive kanë domethënien e zvogëlimit të obligimeve, ndërsa ndryshimet negative do të thonë rritje të tyre.

Llogaritë kanë kolona për numrin rendor, datën e ngjarjes, përshkrimin e ngjarjes, shumën, lidhjen me regjistrimin, etj.

Këto të dhëna emërtohen **elemente** të llogarive në varësi nga renditja e kolonave, llogaritë mund të kenë forma të ndryshme (do të mësohet më vonë) për qëllime edukative në shkollë do të shërbehemi me llogari në formën e shkronjës “t”. Shkak për aplikimin kësaj forme laike është pasqyrimi më i madh dhe marrja e hapësirës më të vogël.

Çdo llogari ka dy anë për shumën, prej të cilave njëra është pozitive ndërsa tjetra negative. Ana e majtë shënohet si pozitive me shenjën (+) plus ndërsa ana tjetër negative me shenjën (-) minus.

RREGULLAT PËR EVIDENTIMIN E LLOGARIVE

Që të mund të kuptohet mënyra e evidentimit të llogarive të caktuara, së pari duhet të përkufizohen llogaritë për mjetet dhe llogaritë për burimet.

Në anën e majtë (+) të llogarive të mjeteve evidentohen ndryshimet të cilat kanë domethënien e rritjes së tyre (përveç gjendjes së tyre fillestare). Në anën e djathtë (-) të llogarive të mjeteve evidentohen ndryshimet të cilat kanë domethënien e zvogëlimit të mjeteve.

Ky rregull mund të ilustruhet në mënyrën si vijon:

+	Llogari për mjetet	-
0. Gjendja fillestare 2 Zmadhimi i mjeteve	1. Zvogëlimi i mjeteve	

Rregulla për evidentimin e llogarive të mjeteve

Në anën e djathtë (-) të llogarive të burimeve, evidentohen ndryshimet të cilat do të thonë rritje të tyre (përveç gjendjes së tyre fillestare). Në anën e majtë (+) të llogarive për burimet evidentohen obligimet, ndryshimet të cilat kanë domethënien e zvogëlimit të burimeve.

Rregulla për evidentimin llogarive të burimeve të mjeteve

+	Llogaritë e burimeve	-
1. Zvogëlimi i burimeve	0. Gjendja fillestare 2. Rritja e burimeve	

Në çdo llogari ana e majtë shënohet me (+) plus, ndërsa ana e djathtë me (-) minus. Shënimi i anëve të llogarive si pozitive dhe negative nuk është e rastit. Për shembull, ana pozitive, në llogaritë për mjetet ka domethënien e rritjes së tyre, ndërsa si ngjarje afariste kjo do të thotë përmirësim i fuqisë ekonomike të ndërmarrjes. Kuptohet se në rastin e kundërt zvogëlimi mjeteve do të thotë dukuri negative, për shkak se zvogëlohet fuqia ekonomike. Te burimet kemi rast krejtësisht të kundërt. Burimet ,do të thonë dukuri negative për shkak se rritja e tyre do të thotë rritje e obligimeve të ndërmarrjes. Së këndejmi, edhe evidentimi i obligimeve është në anën e djathtë, anën negative të llogarive për obligimet. Zvogëlimi i obligimeve do të thotë dukuri pozitive andaj edhe evidentimi i tyre është në anën e majtë të llogarive për obligimet.

Çdo ngjarje shkakton së paku dy ndryshime prej të cilave njëri është pozitiv ndërsa tjetri negativ me ç'rast, në njërën llogari evidentohet në anën e majtë e në tjetrën në anën e djathtë.

Që të kuptohet evidentimi i ngjarjeve në llogaritë duhet të vihen ngjarjet në grupe të caktuara sipas ndikimit të tyre në llogaritë. Në fakt, përsëri, mbet në fuqi rregulli në vijim për evidentimin llogarive, sipas parimit të kontabilitetit të dyfishtë: çdo ngjarje shkakton së paku dy ndryshime prej të cilave njëri është pozitiv e tjetri negativ me ç'rast në njërën llogari evidentohen në anën e majtë ndërsa në tjetrën në anën e djathtë. Sipas kësaj, nuk ka plus pa minus.

Për atë se në cilën llogari do të evidentohen në anën e majtë e në cilën në anën e djathtë, varet nga lloji i ngjarjes kontabiliste. Përcaktimi i llogarive në të cilat do të evidentohet një ngjarje dhe përcaktimi i karakterit të ndryshimeve gjegjësisht anës së llogarisë në të cilën do të evidentohet një ngjarje, emërtohet **kontim**. Procesi i kontimit është thelbësor për kuptimin e evidentimit të llogarive por edhe të kontabilitetit në përgjithësi. Në bazën e kontimit është përcaktimi i lidhjes ndërmjet llogarive. Gjegjësisht, gjatë evidentimit çdo llogari është e ndërlidhur me ndonjë llogari tjetër. Ashtu për shembull, llogaria arka është e ndërlidhur me llogarinë Xhirollogari dhe me më shumë llogari të tjera në të cilat evidentohen pagesat nga arka. Lidhja e llogarive emërtohet **korrespondenca** e llogarive. Njohja e korrespondencës së llogarive paraqet kusht kryesor për kontimin e saktë. Ka ngjarje kur një llogari korrespondon vetëm me një llogari tjetër. Rast

Kontimi paraqet përcaktimi i: llogarive në të cilat ,do të evidentohet një ngjarje dhe karakteri i ndryshimit gjegjësisht ana e llogarisë në të cilën do të evidentohet.

i atillë paraqet për shembull, tërheqja e parave nga Xhironlogaria për pagesat rrjedhëse të arkës. Ka ngjarje kur një llogari korrespondon me dy ose më shumë llogari të tjera. Rast i atillë mund të jetë për shembull, furnizimi i mallrave tregtarë. Por, ka edhe ngjarje ku më shumë llogari korrespondojnë me më shumë llogari. Rast i atillë për shembull, paraqitet gjatë evidentimit të shpenzimeve.

Fjala kontim ka prejardhjen nga fjala italiane “konto” që do të thotë llogari. Gjithashtu, duhet të kihet parasysh se në praktikë haset ana e majtë e llogarive në vend me shenjën + (plus), të shënohet me “të japë” ose “ka borxh” por më korrekte është me fjalën “debit”. Shpeshherë ana e djathtë e llogarive në vend të shenjës - (minus) të shënohet me “të marrë” ose “kërkon” por më korrekte është me fjalën “kredi”.

Ndërlidhja e llogarive emërtohet korrespondenca e llogarive.

KATËR GRUPE TË NGJARJEVE PËR EVIDENTIMIN E MJETEVE DHE BURIMEVE

Që të mund të kuptohet mënyra e evidentimit të llogarive të caktuara, duhet të përkufizohen së pari llogaritë për mjetet dhe llogaritë për burimet. Duke e marrë parasysh faktin se të gjitha ngjarjet kur paraqiten ndryshime vetëm në llogaritë e mjeteve, ndryshime në llogaritë për burimet, si edhe ndryshimet ndërmjet llogarive për mjetet dhe burimet, mund të dallojmë katër grupe të ngjarjeve:

a) ngjarje të cilat shkaktojnë rritje të mjeteve në një llogari me zvogëlimin njëkohshëm të mjeteve në llogarinë tjetër;

b) ngjarje të cilat shkaktojnë rritje të mjeteve në një llogari me rritje të njëkohshme të burimeve në llogarinë tjetër;

c) ngjarje të cilat shkaktojnë zvogëlim të mjeteve në një llogari me zvogëlim të njëkohshëm të burimeve në llogarinë tjetër;

ç) ngjarje të cilat shkaktojnë rritje të burimeve në një llogari me zvogëlim të njëkohshëm të burimeve në llogari tjetër;

Evidentimi i ngjarjeve të lartpërmendura mund të sqarohet me shembuj, të cilët janë dhënë sipas renditjes së njëjtë:

a) Në ngjarjet e grupit të parë, paraqitet rritja e një mjeti, për këtë shkak rritja evidentohet në anën e majtë pozitive të llogarisë të hapur për atë mjet. Njëkohësisht, paraqitet zvogëlimi i mjeteve në llogari tjetër, të hapur për lloj tjetër të mjeteve. Ky zvogëlim do të thotë ndryshim negativ, dhe evidentohet në anën e djathtë negative të llogarisë. Për ngjarje të këtillë,

Katër grupe të ngjarjeve për regjistrimin e mjeteve dhe burimeve.

Ngjarje të cilat shkaktojnë rritje të mjeteve në një llogari me zvogëlim të njëkohshëm të mjeteve në llogari tjetër.

si shembull mund të shërbejë shembulli i lartpërmendur që ka të bëjë me paratë e tërhequra nga banka për pagesat rrjedhëse në arkën e ndërmarrjes.
Shembull: Më 18.01. sipas fragmentit nga banka me nr.15 janë tërhequr 1.000 denarë për nevojat e arkës.

Qe si do të evidentohet kjo ngjarje në llogaritë:

+ Ll/i Arka		+ Ll/i Xhirollogari -	
0) MT 20.000		0) MT 5.000	1) zvogëlim 1.000
1) rritje 1.000			

Nga evidentimi i llogarive mund të përfundohet:

1. **Ll/ia Arka** në këtë ngjarje korrespondon me **Ll/inë Xhirollogari**. Kjo do të thotë se gjendja e ngjarjes së përmendur fillestare) është 20.000 den.
2. Gjendja e hasur (saldoja fillestare) gjatë kësaj ngjarjeje është në **Ll/inë Arka** 20.000 denarë, e në **Ll/inë Xhirollogari** 5.000;
3. Paratë në **Ll/inë Xhirollogari** zvogëlohen për 1.000 denarë, ndërsa rritet gjendja në **Ll/inë Arka**.

(b) Në grupin e dytë të ngjarjeve vjen deri në rritjen e mjeteve të cilat evidentohen në anën e majtë, pozitive të një llogarie. Njëkohësisht paraqitet rritja e një burimi që evidentohet në anën e djathtë të llogarisë tjetër. Si shembull për ngjarje të këtillë mund të shërbejë marrja e kredisë prej 20.000 denarë nga banka. Kredia e marrë në këtë mënyrë përshkruhet në llogarinë transaksione të ndërmarrjes, për këtë shkak evidentohet në anën e majtë të **Ll/isë Xhirollogari**. Rritja e obligimeve ndaj bankës për kredinë e marrë, do të thotë ndryshim negativ dhe evidentohet në anën e djathtë të **Ll/isë Kredi për mjete qarkulluese**.

Shembull: Më 29.01. sipas fragmentit nr. 20 nga banka, është marrë kredi nga banka për MJprej 20.000 den. dhe paratë janë përshkruar në llogarinë. Kështu do të evidentohet kjo ngjarje në llogaritë përkatëse:

Ngjarje të cilat shkaktojnë rritje të mjeteve në një llogari me rritje të njëkohshme të burimeve në llogari tjetër.

+ Ll/i Xhirollogari -		+ Ll/ia Kredi nga bankat në vend -	
0) MT 50.000		0) MT 70.000	
1) rritje 20.000		1) rritje 20.000	

Nga evidentimi i sipërm i llogarive mund të konkludohet:

1. **Ll/ia Xhirollogari** kjo ngjarje korrespondon me **Ll/inë Kredi nga bankat në vend** ;
2. Gjendja e hasur (saldoja fillestare) para kësaj ngjarjeje është në **Ll/inë Xhirollogari** 50.000 denarë, ndërsa në **Ll/inë Kredi nga bankat në vend** 70.000 den.;
3. Janë rritur mjetet (paratë) në **Ll/inë Xhirollogari** për 20.000 denarë;
4. Janë rritur obligimet për kreditë- **Llogaria Kredi nga bankat në vend** për 20.000 denarë;

c) Te grupi i tretë i ngjarjeve vjen deri në zvogëlimin e një burimi që evidentohet në anën e majtë të llogarisë për burimin përkatës. Njëkohësisht zvogëlohen edhe mjetet në **Llogarinë Xhirollogari**, me ç'rast evidentohet në anën e djathtë në këtë llogari. Si shembull mund të shërbejë pagesa e obligimeve ndaj furnizuesve nga mjetet në Xhirollogarinë prej 50.000 denarë. Me këtë pagesë, zvogëlohen obligimet ndaj furnizuesve që evidentohet në anën pozitive të **Ll/isë Obligime ndaj furnizuesve**. Zvogëlimi i mjeteve të parave për këtë pagesë do të thotë ndryshim negativ në **Ll/në Xhirollogari**. Shembull: Më 15.02. sipas fragmentit nr.25 nga banka, janë paguar obligime ndaj furnizuesve nga mjetet në llogarinë transaksione për 50.000 den.

Ngjarje të cilat shkaktojnë zvogëlim të mjeteve në një llogari me zvogëlim të njëkohshëm të burimeve në llogarinë tjetër.

Qe si do të evidentohet kjo ngjarje në llogaritë përkatëse:

+ Ll/ia Xhirollogaria -	+ Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve -				
<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 50%; padding: 5px;">0)MP 80.000</td> <td style="width: 50%; padding: 5px;">1) zvog. 50.000</td> </tr> </table>	0)MP 80.000	1) zvog. 50.000	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 50%; padding: 5px;">1) zvog. 50.000</td> <td style="width: 50%; padding: 5px;">0)MP 70.000</td> </tr> </table>	1) zvog. 50.000	0)MP 70.000
0)MP 80.000	1) zvog. 50.000				
1) zvog. 50.000	0)MP 70.000				

Nga evidentimi i llogarive të sipërme mund të konkludohet:

1. **Ll/ia Xhirollogaria** në këtë ngjarje korrespondon me **Ll/inë Obligime ndaj furnizuesve**;
 2. Gjendja e hasur (saldoja fillestare) para kësaj ngjarjeje është në **Llogarinë Xhirollogari** 80.000, ndërsa në **Llogarinë Obligime ndaj furnizuesve** 70.000 denarë.
 3. Janë zvogëluar obligimet ndaj furnizuesve (ndryshime pozitive) për 50.000 denarë.
 4. Janë zvogëluar mjetet në Xhirollogarinë (ndryshime negative) për 50.000 den.
- Ngjarje të cilat shkaktojnë rritje të burimeve në një llogari me zvogëlimin e njëkohshëm të burimeve në llogari tjetër

Ngjarje që shkaktojnë rritje të burimeve të një llogarie me reduktimin e njëkohshëm të burimeve të llogarisë tjetër

ç) Te grupi i katërt i ngjarjeve vjen deri në zvogëlimin e një burimi të një llogarie me rritjen e njëkohshme të burimit në llogarinë tjetër.

Kjo praktikisht do të thotë ndryshim pozitiv i llogarisë së parë dhe ndryshim negativ i llogarisë tjetër. Shembull për grup të këtillë të ngjarjeve mund të shërbejë dhënia e kambialit një furnizuesit për 15.000 denarë. Me këtë zvogëlohen obligimet ndaj furnizuesve (ndryshim pozitiv) dhe rriten obligimet kambiale, që do të thotë ndryshim negativ në **Ll/inë Obligime për kambialet e lëshuar**.

Shembull: Për pagimin e obligimeve ndaj një furnizuesi, është lëshuar kambial prej 15.000 den.

Ja si do të evidentohet kjo ngjarje në llogaritë përkatëse:

+ Ll/ia Obligime ndaj furniz. -	+ Ll/ia Obligime për Kambialet e lësh. -
1) zvogël. 15.000	0) MP 25.000 1) rritur 15.000

1. Llogaria Obligime ndaj furnizuesve në këtë rast korrespondon me **Ll/inë Obligime për Kambialet e lësh.**

2. Saldoja fillestare para kësaj ngjarjeje është në **Llogarinë Obligime ndaj furnizuesve** 25.000 den., ndërsa në **Ll/inë Obligime për Kambialet e lësh.** 20.000 den.

3. Janë zvogëluar obligimet ndaj furnizuesve (ndryshim pozitiv) për 15.000 denarë;

4. Janë rritur obligimet kambiale (ndryshim negativ) për 15.000 denarë.

HAPJA E LLOGARIVE NË BAZË TË BILANCIT TË GJENDJES

Në fillim të çdo viti nën 1 janar hapen llogaritë me ç' rast në to shënohet gjendja fillestare. Më 31.12 çdo vit, ndërmarrjet përpilojnë të ashtuquajturin bilanc përfundimtar për gjithë e evidentimet të bëra për gjitha ngjarjet në vitin e kaluar. Bilanci i njëjtë shfrytëzohet si bilanc fillestar për vitin e ardhshëm. Ndërmarrjet e porsaformuara të cilat nuk është patjetër ta fillojnë punën e vet më 1 janar, por zakonisht ndonjë ditë tjetër në vitin, regjistrimet fillestare i bëjnë në bazë të bilancit fillestar. Mirëpo, ai bilanc fillestar nuk është njëkohësisht edhe bilanci përfundimtar i vitit të kaluar. Bilanci i këtillë fillestar përpilohet në bazë të regjistrimit të mjeteve dhe burimeve. Hapja e mjeteve bëhet me evidentimin e njëkohshëm të gjendjes të llogarive të caktuara, duke e bartur prej bilancit të gjendjes.

Kjo bartje bëhet me ndihmën e urdhrorit për evidentim dhe ditarit (do të sqarohen më vonë). Këtu sqarohet vetëm transferimi i drejtpërdrejtë i gjendjes nga bilanci fillestar i llogarive. Respektivisht, të gjitha pozitat e aktives së bilancit të gjendjes futen në llogaritë përkatëse për mjetet në anën pozitive (+). Të gjitha pozitat edhe nga pasivja e bilancit të gjendjes evidentohen në anën negative (-) të llogarive për burimet e mjeteve.

Përveç tjerave, në titullin e llogarisë mund të vërehet shkurtimi i fjalës llogari me “Ll-ri”. Kjo është moti e zakonshme në literaturën dhe në praktikën kontabiliste.

Gjendja fillestare e llogarive evidentohet si “Saldo fillestar”, por edhe kjo mund të shkurtohet, ashtu që do të shënohet vetëm “0”, që do të thotë gjendja e hasur e bilancit fillestar. Kjo gjendje e llogarive do të rritet ose do të zvogëlohet me anë të evidentimit vetëm në llogaritë përkatëse, pa përpiluar bilanc për çdo ngjarje kontabiliste.

Të gjitha pozitat e aktives së bilancit të gjendjes futen në llogaritë përkatëse për mjetet në anën pozitive (+). Të gjitha pozitat e pasives së bilancit të gjendjes, evidentohen në anën negative (-) të llogarive për burimet e mjeteve.

Aktive		Bilanci i gjendjes		Pasive	
1.	Xhirollogaria	10 000		Kapitali aksionar	72 000
2.	Arka kryesore	49 000		Kredi për MP	25 000
3.	Rezervat e prodhimit	10 000		Kreditit për OBS	20 000
4.	Kërkesa nga blerësit	60 000		Obligime ndaj furn.	15 000
		15 000		Rezerva statusore	12 000
	Gjithsej	144 000		Gjithsej	144 000

Në bazë të këtij shembulli të thjeshtëzuar të bilancit të gjendjes hapja e llogarive do të bëhet në mënyrën si vijon:

+ Ll/ia Arka kryesore -	+ Ll/ia Xhirollogaria -
0) MP 10 000	0) MP 49 000
+ Ll/ia Rezerva të prodhimeve -	+ Ll/ia Kërkesa nga blerësit -
0) MP 60 000	0) MP 15 000
	+ Ll/ia Pajisje -
	0) MP 10 000

Me evidentimin në anën majtë të llogarive përkatëse deri tani u transferuan gjendjet vetëm nga aktivja e bilancit fillestar. Pozitat pasive të këtij bilanci do të transferohen në anën e djathtë të llogarive të burimeve:

<p>+Ll/ia Kapitali aksionar -</p> <hr style="border: 0.5px solid black;"/> <table style="margin-left: auto; margin-right: auto; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="border-right: 1px solid black; padding: 5px;">0) MP 72 000</td> </tr> </table>	0) MP 72 000	<p>+ Ll/ia Kredi për MP -</p> <hr style="border: 0.5px solid black;"/> <table style="margin-left: auto; margin-right: auto; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="border-right: 1px solid black; padding: 5px;">0) MP 25 000</td> </tr> </table>	0) MP 25 000
0) MP 72 000			
0) MP 25 000			
<p>+ Ll/ia Kredi për MQ -</p> <hr style="border: 0.5px solid black;"/> <table style="margin-left: auto; margin-right: auto; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="border-right: 1px solid black; padding: 5px;">0) MP 20 000</td> </tr> </table>	0) MP 20 000	<p>+ Ll/ia Obligime ndaj furniz. -</p> <hr style="border: 0.5px solid black;"/> <table style="margin-left: auto; margin-right: auto; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="border-right: 1px solid black; padding: 5px;">0) MP 15 000</td> </tr> </table>	0) MP 15 000
0) MP 20 000			
0) MP 15 000			
<p>+ Ll/ia Rezerva statutore -</p> <hr style="border: 0.5px solid black;"/> <table style="margin-left: auto; margin-right: auto; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="border-right: 1px solid black; padding: 5px;">0) MP 12 000</td> </tr> </table>		0) MP 12 000	
0) MP 12 000			

% Kërkohet: Nga bilancet e gjendjes të përpiluar paraprakisht, të hapen llogaritë përkatëse për mjetet dhe burimet!

LLOJET E LLOGARIVE

Analizimi i ndarjes së llogarive mundëson njohje të mëtutjeshme më të mirë të kontabilitetit. Llogaritë mund të ndahen në grupe nga aspekte të ndryshme, me ç'rast të formohen ndarje të ndryshme. Të gjitha ndarjet këtu nuk mund të sqarohen andaj do të kufizohemi vetëm në më të rëndësishmet, respektivisht vetëm këto ndarje që janë më të domosdoshmet për kuptimin e bazave të kontabilitetit:

1. Llogari për mjetet dhe llogari për burimet,|
2. Llogari aktive, pasive dhe aktive – pasive
3. Llogari sintetike dhe analitike,|
4. Llogari të tërësishme, të pa tërësishme dhe korrektive
5. Llogari të gjendjes, suksesit dhe të përziera

1. LLOGARI PËR MJETET DHE LLOGARI PËR BURIMET

Kjo ndarje e llogarive është bilancore.

Kjo ndarje veç më është përpunuar. Shkurtimisht mund të thuhet se ndarja e këtillë e llogarive është bilancore. Gjegjësisht në bilancin e gjendjes, duke mos ndërhyrë në disa specifika, ndarja e pozitive bilancore bëhet sipas asaj se a bëhet fjalë për mjete ose burime. Së këndejmi është ndarja e llogarive të

mjeteve dhe llogarive të burimeve. Llogaritë për mjetet e tregojnë gjendjen fillestare, rritjet, zvogëlimet, si edhe gjendjen përfundimtare të çdo lloji të mjeteve të caktuara të ndërmarrjes. Llogaritë për burimet e paraqesin në mënyrën e njëjtë, gjendjen fillestare, rritjet, zvogëluar dhe gjendjen përfundimtare të çdo llojit të caktuar të obligimeve respektivisht burimeve të ndërmarrjes.

Në llogaritë e mjeteve, si që u sqarua, në anën e majtë evidentohet gjendja fillestare dhe rritjen e mjeteve ndërsa në anën e djathtë zvogëlimet e mjeteve. Si shembull do ta marrim LI/inë Arkë.

+ LI/ia ARKA		-
Fillestare	3.000	Pagesa saldo
Pagesa (rritje)	1.000	(zvogëlim) 2.000

Në llogaritë e burimeve, gjendja fillestare dhe rritja e obligimeve evidentohen në anën e djathtë. Në anën e tyre të majtë regjistrohen zvogëlimet e obligimeve.||

Si shembull do ta marrim LI/inë Kredi për mjete qarkulluese.

+ LI/ia Kredi për mjete qarkulluese		-
zvogëlim (pagesa e kredive)	20.000	Saldoja 56.000 fillestare
		Zmadhimi (fitimi i kredive të reja) 40.000

2. LLOGARI AKTIVE, PASIVE DHE AKTIVE - PASIVE

Llogaritë ndahen në aktive dhe pasive në varësi nga karakteri i saldës së tyre. Te llogaritë aktive shuma në anën pozitive është më e madhe se shuma e anës negative të llogarisë. Te llogaritë aktive saldoja gjegjësisht dallimi ndërmjet shumës së anës pozitive dhe negative rrjedh nga ana më e madhe pozitive. Prandaj thuhet se llogaritë aktive çdoherë kanë saldo aktive, saldo pozitive. Saldoja në këto llogari mund të jetë zero por asnjëherë nuk mund të jetë negative, respektivisht nuk mund të ndodhë atje shuma në anën e djathtë të jetë më e madhe se shuma në anën e majtë . Llogari aktive janë llogaritë e mjeteve (përveç disa përjashtimeve).

Kjo ndarje e llogarive bëhet sipas karakterit të tyre

Kjo ndarje e llogarive bëhet sipas karakterit të tyre

Si shembull do ta cekim **Ll/inë Arka**. Në Ll/inë Arka, evidentohen ndryshimet dhe mjetet e parave të lëshuara nga arka, ashtu që saldoja e kësaj llogarie tregon se sa mjete financiare ka firma në dispozicion në ditën e caktuar. Në rast se të gjitha mjetet e parave në dispozicion do të paguhen, në arkën nuk do të mbesë asnjë denar. Saldoja në këtë rast do të jetë zero. Analogjia e njëjtë mund të paraqitet te të gjitha llogaritë te të cilat evidentohen **mjetet**.

+	Ll/ia Arka	-
Pagesa në (zmadhim)	Pagesa nga (zvogëlim)	
Pagesë (rritje)5.000		

Saldoja e kësaj llogarie nga 12.000 den.,gjegjesisht 15.000-3.000 është pozitive pasi vjen nga shuma më e madhe në anën e majtë. Në llogaritë aktive, saldoja asnjëherë nuk mund të jetë pasive. Saldoja pasive në disa llogari për mjetet do të ishte absurde. Në shembullin me Llogarinë e sipërme, saldoja pasive do të thoshte të paguhen më shumë para nga arka sesa që ka pasur.

Te llogaritë pasive, shuma në anën e djathtë negative është më e madhe se shuma në anën e majtë pozitive.,Llogaritë pasive çdoherë kanë saldo pasive negative. Llogaritë pasive janë llogaritë e burimeve. Qe një shembull për llogari pasive:

+	Ll/ia Kredi për mjete qarkull	-
zvogëlim (pagesa e kredive) 10.000	saldoja 32.000 fillestare zmadhimi 8.000 (fitimi i kredive të reja)	

Saldoja e kësaj llogarie 30.000 den.,gjegjesisht 40.000-10.000 është negative, pasi vjen nga shuma më e madhe në anën e djathtë.

Llogaritë e burimeve janë jashtëzakonisht llogari pasive, llogaritë e mjeteve janë jashtëzakonisht llogari aktive.

Ekzistojnë disa llogari saldoja e të cilave mund të vijë nga shuma më e madhe në anën e majtë ose po nga shuma më e madhe në anën e djathtë. Këto llogari emërtohen **llogari aktive - pasive**. Saldoja te këto llogari në periudhë të caktuar ose në interval kohor më të gjatë mund të jetë aktive, e mandej të jetë pasive ose e kundërta. Ll/ia **Kërkesa nga blerësit**, për shembull zakonisht është llogari aktive.

Mirëpo, kjo llogari mund të jetë edhe pasive. Në rastin kur blerësit e paguajnë paraprakisht blerjen e prodhimeve të gatshme (avanca e pranuar) deri në çastin e dorëzimit të tyre, në **Ll/inë Kërkesa nga blerësit** paraqitet saldo negative. Megjithatë, është si rregull, fillimisht të dorëzohen prodhimet dhe pas një kohe të arkëtohet kërkesa për prodhimet e dorëzuara, në atë rast, në **Ll/inë Kërkesa nga blerësit** paraqitet saldo aktive, por qëndron fakti se kjo llogari është aktive-pasive, për shkak të mundësisë që saldoja të jetë aktive dhe pasive.

+ Ll/ia Kërkesa nga blerësit -	
2. Dorëzimi i prodhimeve - 150.000	1. Pranimi i prodhimeve-avancë 50.000

*Pas evidentimit të parë në Shembullin e sipërm (avanca e pranuar) **Ll/ia Kërkesa nga blerësit** është llogari pasive edhe pse në parim ajo është aktive. Pas evidentimit të dytë ajo llogari shndërrohet në llogari aktive.*

Rast i ngjashëm paraqet **Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve**, e cila më së shpeshti është pasive por në rastin e pagimit të avancës respektivisht kur furnizuesve u paguhet paraprakisht një pjesë ose tërë shuma e materialeve të porositura, bëhet llogari aktive. Trajtim aktiv-pasiv kanë llogaritë për realizimin e prodhimeve dhe shërbimeve të gatshme dhe llogaritë tjera për realizim. **Ll/ia Dallimet e kursit, Ll/ia Shmangie nga çmimi i planifikuar i kostos** etj.

3. LLOGARIA SINTETIKE DHE ANALITIKE

Llogari sintetike janë llogari grupore të përbashkëta. Ato ndahen në **analitike**, ose llogari veç e veç. Sipas kësaj, llogaritë analitike paraqesin pjesë të një tërësie. Në varësi nga lloji dhe nevojat e ndërmarrjes, një llogari sintetike mund të ndahet në dy ose më shumë, ndërsa në raste të caktuara në qindra llogari analitike.

Përveç sintetikeve dhe analitikeve ekzistojnë edhe të ashtuquajtura llogari subsintetike të cilat njëkohësisht janë edhe llogari sintetike edhe analitike.

Ll/ia Pajisje, për shembull është llogari sintetike. Ajo mund të ndahet në llogaritë si që janë **Ll/ia Makina, Ll/ia Pajisje dhe instalime, Ll/ia Mjete transportuese** etj. Këto llogari pra, mund të ndahen në llogari analitike të shumta. Ashtu për shembull, **Ll/ia Mjete transportuese** mund të ndahet në **Ll/i Automjete ngarkuese, Ll/ia Automjete udhëtuese, Ll/ia Automjete për transportin e brendshëm** etj.

Kjo ndarje e llogarive bëhet sipas ndarjes në bazë të planit kontabilist.

Sipas kësaj, **Llogaria Mjete Transportuese** është llogari subsintetike, për shkak se paraqitet në rol të dyfishtë – si analitike dhe si sintetike.

Shuma e shumave të anës pozitive dhe negative të një llogarie sintetike duhet të përkojë me shumën e shumave të anës pozitive dhe shumën e shumave të anës negative të të gjitha llogarive analitike të cilat paraqiten si pjesë të asaj llogarie sintetike. Në rast se ndodh që gjendja e shumës në të gjitha llogaritë analitike të mos përkojë me gjendjen e llogarisë sintetike, atëherë bëhet fjalë për gabim qoftë në evidentimin e llogarisë sintetike ose të ndonjëres nga llogaritë analitike.

Kjo ndarje e llogarive më së shpeshti vërehet te mjetet e përhershme.

4. LLOGARI TË TËRËMSISHME, TË PATËRËSISHME DHE KORREKTIVE

Llogaritë e tërësishme e paraqesin tërësisht gjendjen e mjetit të caktuar, të burimit, shpenzimit ose të hyrjes. **Ll/ia Arka**, për shembull, e paraqet në tërësi gjendjen e mjeteve të parave në arkë për shkak se është llogari e tërësishme. Ka llogari të cilat nuk janë të tërësishme. **Llogari e patërësishme**, për shembull është **Ll/ia Makina**, si edhe të gjitha llogaritë për mjetet e përhershme. Llogaritë për mjetet e përhershme si që do të shihet më vonë, në kontabilitetin mbahen sipas vlerës së tyre furnizuese.

Pasi të formohet vlera e tyre furnizuese, pas furnizimit të tyre, ato me atë vlerë do të paraqiten në llogarinë përkatëse përderisa janë në përdorim. Pjesa e harxhuar e mjeteve të përhershme regjistrohet në **llogarinë e veçantë korrektuese** – korrigjimi i vlerës së mjeteve të përhershme (amortizimi i akumuluar), të cilat hapen për çdo llogari veç e veç për mjetet e përhershme. Vlera e tanishme e mjetit të përhershëm do të fitohet kur nga vlera furnizuese do të hiqet korrigjimi i vlerës (amortizimi i akumuluar).

+ Ll/ia Makina -		Ll/ia Amortizimi + i akumuluar i makinave -	
e harxhuar 150.000		Vlera furniz. e - pjesa 6.000	

Nga gjendja e sipërme e llogarive mund të vërehet:

1. Vlera furnizuese e makinave është 150.000 den. Mjeti është furnizuar me atë vlerë dhe me atë vlerë do të mbahet përderisa është në përdorim.
2. Pjesa e harxhuar evidentohet në llogari tjetër, llogaria **Amortizimi i akumuluar** në të cilën çdo vit evidentohet pjesa e harxhuar e mjetit të përhershëm për vitin përkatës dhe ajo është 6.000 den.

3. Pjesa e pa harxhuar e makinave në shembullin e sipërm përcaktohet me anë të heqjes së saldosh në **Ll/inë Amortizimi i akumuluar i makinave** nga saldoja e **Ll/isë Makina**. Në shembullin e sipërm pjesa e harxhuar, respektivisht vlera është 144.000 den. ($150.000 - 6.000 = 144.000$). Sipas kësaj, llogaria **Ll/Makina** është llogari e pa tërësishme ndërsa llogaria **Amortizimi i akumuluar i makinave** është llogari korigjuese.

Vlera e pajisjes, pas vitit të parë do të jetë:

- (1) Vlera furnizuese e makinës: 150.000,-
- (2) Amortizimi i akumuluar i makinës: 6.000,-
- (3) Vlera e tanishme e makinës: 144.000,-

5. LLOGARI TË GJENDJES, LLOGARI TË SUKSESHME DHE TË PËRZIERA

Llogaritë e gjendjes e paraqesin gjendjen veç e veç të mjeteve dhe të burimeve në ditë të caktuar. Si që u tha më herët, në llogaritë e gjendjes evidentohet fillimisht gjendja fillestare, mandej të gjitha ndryshimet, që të mundet në fund të çdo periudhe përllogaritëse të përcaktohet gjendja përfundimtare kur në bazë të saldove përfundimtare të llogarive të gjendjes, përpilohet bilanci i fundit i gjendjes.

Llogaritë e sukseshme paraqesin efekt nga puna gjegjësisht ato shërbejnë për përcaktimin e rezultatit financiar. Llogaritë e sukseshme anë llogari në të cilat evidentohen hyrjet dhe të dalat (të rregullta dhe të jashtëzakonshme) nga puna. Llogaritë e sukseshme janë pjesë-pozita të bilancit të suksesit.

Ekzistojnë edhe llogari të njohura me emrin “**llogari të përziara**” në të cilat evidentohet në mënyrë të pazakonshme por jo edhe në mënyrë të palogjikshme. Fjala “llogari e përzier” mund të paraqesë ndryshime të përziara jo homogjene, ashtu që duket sikur ajo paraqet edhe gjendje edhe sukses. Mirëpo, kjo llogari nuk mund të paraqesë gjendje, ndërsa sukse si mund të përcaktohet vetëm në mënyrë të tërthortë.

Kjo ndarje e llogarive rrjedh nga përkatësia e raporteve financiare.

SALDOJA E LLOGARIVE

Saldoja e llogarive e paraqet dallimin ndërmjet shumës së anës pozitive dhe anës negative të llogarisë. Ajo paraqet rezultat i lëvizjes të karakterit të kundërt (pranim - lëshim = saldo). Saldoja

Saldoja e llogarive e paraqet dallimin ndërmjet shumës së anës pozitive dhe anës negative të llogarisë.

kuptohet edhe si mbetje, (në Ll./inë Arka për shembull saldoja gjegjësisht mbetja = para të pranuar - para të lëshuara). Saldoja e paraqet gjendjen e llogarisë në ditën e caktuar. Për shembull, saldoja e Llogarisë Xhirollogari tregon se sa para ka në Xhirollogarinë në ditën e caktuar. Saldoja përdoret edhe në kuptim të gjendjes. Bilanci i gjendjes paraqet listë të saldove në llogaritë e gjendjes e përpiluar sipas rregullave të caktuara. Saldoja e llogarive e paraqet dallimin ndërmjet shumës së anës pozitive dhe negative të llogarisë. Përdoret për barazimin e llogarive gjatë mbylljes së tyre në fund të periudhës për llogaritëse, për përcaktimin e gjendjes, për përpilimin e listës së mbyllur, për përpilimin e bilancit të gjendjes etj.

Forma
shkallëzore e
llogarisë

FORMAT E LLOGARIVE

Në varësi nga lloji dhe radhitja e kolonave në të cilat evidentohen të dhënat, gjegjësisht elementet, dallohen më shumë forma të llogarive. Katër format në vijim konsiderohen si më të shpeshta në praktikën: *shkallëzore, njëanësore, dyanësore dhe tabelore*.

Forma shkallëzore e llogarive ka kolonë për përshkrim dhe vetëm një kolonë për shuma. Karakteri i ndryshimit shënohet me plus (+) ose minus (-). Pas çdo ndryshimi llogaritet saldoja. Kjo formë gjen aplikimin gjatë evidentimit të depozitave kursyese. Haset edhe si evidentim sasior nëpër magazinat me emërtimin “kartela varëse”.

Shembull për evidentimin e llogarive në këtë formë është: Ndërmarrja “Slloga”, nga Ohri, gjatë tetorit 2008 në Ll./inë Kërkesa nga blerësi “Javor”, në formë shkallëzore e ka bërë evidentimin në bazë të të dhënave në vijim:

1. Gjendja fillestare - kërkesa prej vitit të kaluar 130.000 den.
2. Më 05.10 i janë shitur prodhime “Javor-it” sipas faturës nr 157 për 150.000 den.
3. Më 09.10 sipas fragmentit nga banka me nr 5. blerësi “Javor” ka paguar në Xhirollogarinë 140.000 den.
4. Më 14.10 i janë shitur prodhime “Javor-it” sipas faturës nr 55 për 50.000 den.
5. Më 19.10 sipas letrës nr 111 “Javor-it” i është aprovuar lirim prej 10.000 den.
6. Më 23.10 sipas fragmentit nga banka me nr.7 “Javor-i” ka paguar në Xhirollogarinë 80.000 den.
7. Më 26.10 sipas fragmentit nga banka me nr.8 “Javor-i” ka paguar në Xhirollogarinë 60.000 den.
8. Më 31.10 i janë shitur prodhime “Javor-it” sipas faturës nr. 14 për 30.000 den.

KËRKESA NGA BLERËSIT (FORMA SHKALLËZORE)

Data	Përshkrimi	Shenjë +ose-	Shuma
01.01	Gjendja fillestare	+	130.000
05.10	Janë shitur prodhime sipas faturës nr 157	+	150.000
	Gjendja	+	280.000
09.10	Arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr. 5.	-	140.000
	Gjendja	+	140.000
14.10	Prodhimet të shitura sipas faturës me nr 55.	+	50.000
	Gjendja	+	190.000
19.10	Aprovuar lirim sipas letrës me numër 111.	-	10.000
	Gjendja	+	180.000
23.10	Arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr. 7	-	80.000
	Gjendja	+	100.000
26.10	Arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr. 8	-	60.000
	Gjendja	+	40.000
31.10	Prodhimet të shitura sipas faturës me nr 14.	+	30.000
	Gjendja	+	70.000

Forma njëanësore e llogarive has në aplikimin praktik më të madh. Kjo formë ka kolonë për përshkrim dhe dy kolona për shumën, njëra për ndryshimet pozitive ndërsa tjetra për ndryshimet negative. Kjo formë jep të dhëna për qarkullimin e përgjithshëm, gjithashtu mund të përcaktohet saldoja pas çdo ndryshimi. Forma e cila më së shpeshti përdoret në praktikë është forma njëanësore e llogarisë.

Në bazë të të dhënave të njëjta nga shembulli paraprak, evidentimet në formën njëanësore do të bëheshin në mënyrën si vijon:

Forma njëanësore
të llogarive.

Data	Përshkrimi	Shuma		
		+	-	Saldoja
01.01	Gjendja fillestare	130.000	-	130.000
05.10	Janë shitur prodhime sipas f-rës nr 157	150.000	-	280.000
09.10	Arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr. 5.	-	140.000	140.000
14.10	Prodhime të shitura sipas f-rës nr. 55	50.000	-	190.000
19.10	Lirim i aprovuar sipas letrës me nr. 111.	-	10.000	180.000
23.10	Arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr. 7	-	80.000	100.000
26.10	Arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr. 8	-	60.000	40.000
31.10	Janë shitur prodhime sipas f-rës me nr. 14.	30.000	-	70.000
	Qarkullimi tetor 2008	360.000	290.000	70.000

Forma dyanëshe e llogarive ka anë të veçantë për ndryshimet pozitive dhe anë të veçantë për ndryshimet negative. Në këtë formë saldoja gjendet në

Forma dyanëshe
e llogarisë

fund të periudhave përlllogaritëse dhe rrallë përdoret në praktikë.

Në bazë të të dhënave të njëjta nga shembulli paraprak, është bërë evidentimi në formën dyanëshe të llogarisë.

KËRKESAT NGA BLERËSIT (FORMA DYANËSHE)

Data	Përshkrimi	Shuma	Data	Përshkrimi	Shuma
05.10	Gjendja fillestare	130.000	14.10	Arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr. 5.	140.000
09.10	Janë shitur prodhime sipas f - rës nr. 157	150.000	19.10	Është aprovuar lirim sipas letrës me nr. 111.	10.000
14.10	Janë shitur prodhime sipas	50.000	23.10	Arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr. 7	80.000
31.10	f-rës 55	30.000	26.10	Arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr. 8	60.000
	Janë shitur prodhime sipas f -rës 14.	360.000	31.10	Saldo për barazim	70.000
					360.000

forma tabelore e llogarisë

Në formën tabelore mund të mbahet evidencë për më shumë llogari në formular të njëjtë. I atillë është për shembull rasti me evidentimin e kërkesave të blerësve, obligimet ndaj furnizuesve dhe ngjashëm. Roli i saj është shumë më i madh kur duhet të sigurohen të dhëna mbi më tepër baza në formular të njëjtë. I atillë është për shembull rasti me evidentimin materialeve për të cilat për çdo lloj të materialit duhet të ketë në dispozicion të dhëna për sasinë, të pranuar, të lëshuara dhe të tjera në rezervë dhe për secilin prej tyre për sasinë, për çmimin dhe për vlerën. Kjo është forma e llogarisë që përdoret shpesh në praktikë. Më thjeshtë do ta paraqesim me shembull për kërkesat nga blerësit.

Shembull për evidentimin në këtë formë të llogarive:

Shoqëria tregtare "Omega" nga Velesi, evidencën e vet për kërkesa nga blerësit e mban në formë tabelore. Në janar 2009, kjo SHT ka formuar dokumentacion për ngjarjet në vijim:

- Më 01.01. gjendja fillestare të blerësi "Makpromet" nga Gostivari është 30.000 den.; "Gazella" nga Shkupi 20.400 den.; dhe "Trendi" nga Manastiri 10.000 den.
- Më 05.01. shitur "Trendi" nga Manastiri sipas f-rës nr. 127 mall për 16.000 den.
- Më 10.01. arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr.4 nga "Makpromet" prej Gostivari 10.000 den., prej "Gazella" Shkup 18.000 den. dhe nga "Trendi" nga Manastiri 2.000 den.

TEMA 3: Ngjarje dhe llogari kontabiliste


4. Më 17.01. shitur "Gazella" sipas f-rës nr. 224 mall për 10.000 den. llogaria.
5. Më 20.01. me letër nr. 577 , "Gazell"-ës i është aprovuar lirim prej 2.000 den.
6. M 24.01. sipas fragmentit nga banka me nr. 9 është arkëtuar nga "Makpromet" 5.000 den., prej "Gazellë"-s 3.000 den.dhe nga "Trendi" 7.000 den.
7. Më 30.01. sipas fragmentit nga banka me nr.10 arkëtuar nga "Makpromet" 1.500 den.
8. Më 31.01. shitur "Makpromet" sipas f-rës nr.880, mall për 15.000 den.

KËRKESA NGA BLERËSIT (FORMA TABELORE)

Data	Përshkrimi	Makpromet		Gazella		Trendi		Gjithsej	
		+	-	+	-	+	-	+	-
01.01	Gjendja fillestare	30.000	-	20.400	-	1 0.000	-	60.400	-
05.01	Shitur sipas f-rës nr. 127	-	-	-	-	16.000	-	16.000	-
10.01	Arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr.4	-	10.000	-	18.000	-	2.000	-	30.000
17.01	Shitur sipas f-rës nr. 224	-	-	10.000	-	-	-	10.000	-
20.01	Lirim i aprovuar me letër nr. 577	-	-	-	2.000	-	-	-	2.000
24.01	Arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr. 9	-	5.000	-	3.000	-	7.000	-	15.000
30.01	Arkëtuar sipas fragmentit nga banka me nr. 10	-	1.500	-	-	-	-	-	1.500
31.01	shitur sipas f-rës me nr. 880	15.000	-	-	-	-	-	15.000	-
	Qarkullim për muajin e 01.	45.000	16.500	30.400	23.000	26.000	9.000	101.400	48.500
	Saldo për barazim	-	28.500	-	7.400	-	17.000	-	52.900
	Gjithsej	45.000	45.000	30.400	30.400	26.000	26.000	101.400	101.400

Forma tabelore e llogarisë mundëson evidentim të shpejtë përmbledhës. Në këtë formë të llogarisë, në formë të tabelës, njëkohësisht evidentohen të dhënat sintetike për ndryshimet

ndryshimet dhe ndryshimet analitike edhe atë në pjesën e parë në mënyrë kronologjike e mandej në mënyrë sistematike, përmbledhëse dhe veç e veç. Përparësitë e kësaj forme të kontos janë: pasqyrimi, kursimi i hapësirës në vertikale, ndërsa mangësitë janë nuk mundëson ndarje të punës në



Account Name	
Debit	Credit

T-forma e llogarisë

kontabilitet, përkufizim të hapësirës në horizontale, numër i madh i kolonave paralele.

"T" forma e llogarisë përdoret gjerë në qëllime edukative. Shkak për aplikimin e saj është pasqyrimi dhe marrja e hapësirës së vogël,

Në kushte të përdorimit të teknikës kompjuterike të evidentimit të llogarisë në T - formë, nuk paraqiten forma të reja por, përdoret formë adekuate nga format klasike të llogarive. Për atë

se cila formë do të përdoret, varet nga ai softueriku i pranuari përkatësisht, respektivisht programi i përdorur.

NOCIONET KRYESORE

Ngjarja kontabiliste
Evidentimi
Kontimi
Korrespondenca e llogarive Llogari
Saldoja e llogarive Forma e llogarisë

Mendoni për këtë:

1. Dimitar Gjurçinoski udhëheq biznes, firmë për kompjuterë. Ai ka 200.000 den. saldo në llogari, para të gatshme. Ai ka nevojë për pajisje të re. Ajo pajisje do të kushtojë 25.000 den. Blerja e pajisjes do të nxisë nevojë për huazim, me qëllim që të paguhet pajisja. Gjurçinoski do që të shfrytëzojë, përdorë 8.000 den. para të gatshme nga biznesi i tij, me ç'rast për pjesën e mbetur do të marrë hua nga banka. Sa do të jetë huaja nga banka? Cilat ndryshime do të ndodhin në barazimin themelor kontabilist? A ka Gjurçinoski zgjidhje tjetër gjatë marrjes së vendimit se si ta blejë këtë pajisje?

PYETJE:

1. Çka është ngjarje dhe prej se përbëhet puna e ndërmarrjeve?
2. Si i kategorizojmë biznes aktivitetet?
3. Cilat janë aktivitetet financiare, investuese e cilat aktivitete operative?
4. Cilat biznes aktivitete afariste janë lëndë e evidencës kontabiliste?
5. Çka është ngjarje kontabiliste?
6. Çfarë ndryshimesh shkaktojnë ngjarjet kontabiliste?

7. A janë të gjitha biznes aktivitetet afariste lëndë e regjistrimit?
8. A janë ngjarjet kontabiliste lëndë e regjistrimit?
9. Cilat ngjarje janë ngjarje të pastra kontabiliste?
10. Numëro disa ngjarje afariste!
11. Numëro disa ngjarje kontabiliste dhe jep prova se janë ngjarje kontabiliste!
12. Definoje nocionin llogari?
13. Si bëhet evidentimi i llogarisë?
14. Sqaroje rregullin për evidentimin e llogarive të mjeteve!
15. Sqaroje rregullin për evidentimin e llogarive të kapitalit!
16. Sqaroje rregullin për evidentimin e llogarive të obligimeve!
17. Numëro katër lloje të ngjarjeve për evidentimin e mjeteve dhe të burimeve!
18. Cilat lloje të llogarive i njeh?
19. Numëroji karakteristikat e tyre!
20. Çka është saldoja e llogarisë?
21. Ku përdoret saldoja e llogarisë?
22. Theksoi përparësitë dhe anët negative të çdo forme të llogarisë!

USHTRIME:

1. Shoqëria aksionare "X" më ditën 31.12.2008 e ka gjendjen e mjeteve, obligimeve dhe kapitalit në vijim:

- Xhirollogaria-30.000 den.
- Arka-2.000 den.
- Kapital aksionar-?
- Obligime për kreditë e marra për MJQ-20.500 den.
- Kërkesa nga blerësit-10.000 den.
- Rezerva e mallrave tregtar-40.000 den.
- Obligime ndaj furnizuesve-10.200 den.

Të paraqitet në formë të shkurtuar bilanci i gjendjes dhe të paraqitet ndikimi mbi:

I. Rritjen e aktives dhe pasives: Më 12.01.2009 sipas fragmentit nga banka me nr.10 janë paguar 5.000 den. shuma e cila është marrë si kredi nga banka për MJQ.

2. Zvogëlimin e aktives dhe pasives: Më 13.01.2009 sipas fragmentit nga banka me nr.11, furnizuesit i janë paguar 6.000 den.

3. Ndryshimet strukturore në aktiven: Më 14.01.2009, sipas fragmentit nga banka me nr.12 blerësit kanë paguar në llogarinë e transaksionit 4.000 den.

4. Ndryshimet strukturore në pasiven: Më 15.01.2009, për kompensimin e obligimeve ndaj furnizuesve është lëshuar kambial për 4.000 den.

II. Shoqëria aksionare "Y" më ditën 31.12.2008 e kanë gjendjen e mjeteve, obligimeve dhe kapitalit në vijim:

- Obligime afatshkurta ndaj furnizuesve-100.000den.
- Obligime afatshkurta për kredi-50.000 den.
- Xhirollogaria-50.000 den.

- Rezerva e mallrave-90.000 den.
- Objekte ndërtimore-1.000.000 den.
- Para në arkë-10.000 den.
- Kapital aksionar-?

Të paraqitet në formë të shkurtuar bilanci i gjendjes dhe të paraqitet ndikimi mbi:

1. Rritjen e aktives dhe pasives: Më 05.01.2009 është pranuar fatura me nr.56 nga furnizuesi SHA “Ohis”, për blerjen e mallit tregtar për 5.000den.
2. Zvogëlimin e aktives dhe pasives: Më 10.01.2009 sipas fragmentit nga banka me nr.2, furnizuesit SHA “Pivara” i është paguar 15.000 den.
3. Ndryshimet strukturore në aktiven: Më 11.01.2009, sipas fragmentit nga banka me nr.3 nga llogaria e transaksionit janë tërhequr 5.000 den. me çek me para në dorë për nevojat e arkës.
4. Ndryshime strukturore në pasiven: Më 15.01.2009, janë kompensuar obligimet ndaj furnizuesve nga kredia e aprovuar për MJ 5.000 den.

III. Shënoni rritjen ose zvogëlimin që të paraqitet ndryshimi:

	<i>Mjete</i>	=	<i>Obligime</i>	+	<i>Kapital</i>
Pronari investon para në dorë	<i>rritje</i>				<i>rritje</i>
1. E paguan pjesën e kredisë					
2. Pagan me para në dorë për kompjuter					
3. Merr kredi nga banka					
4. Pranon para nga klientët					
5. Shet rezerva të mallrave					
6. Ka sjellë byro prej shtëpie për biznesin					
7. Ka blerë kamion me para në dorë					
8. Tërheq para të gatshme për nevoja personale					

IV. Pronari “NN”, ka investuar 15.000 den. në biznes - servis për pastrim kimik:

1. Ka blerë pajisje 2.000 den. të cilën e ka paguar me para në dorë
2. Ka huazuar 7.000 den. nga Tutunska banka,
3. Ka blerë rezerva 4.000 den. të cilat i ka paguar me para në dorë,
4. Ka blerë kamion 15.000 den. të cilin e ka paguar me para në dorë,
5. Ka paguar 3.000 den. për kompensimin e Tutunska banka.

	M	=	O	+	K
Gjendja fillestare	14.500		4.500		10.000
Investimet e pronarit “NN”,	+15.000				+15.000
Gjithsej	29.500		4.500		25.000

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

V. Shoqëria aksionare "XY", më ditën 31.12.2008 e ka gjendjen e mjetëve, obligimeve dhe kapitalit në vijim:

- Obligime afatshkurta ndaj furnizuesve-100.000 den.
- Obligime afatshkurta për kredi-50.000 den.
- Xhirollogari-60.000 den.
- Rezerva e mallrave-80.000 den.
- Objekte ndërtimore-1.100.000 den.
- Para në arkën-10.000 den.
- Kapital aksionar-?

Të paraqitet në formë të shkurtër bilanci i gjendjes dhe të paraqitet ndikimi mbi:

1. Rritjen e aktives dhe pasives: Më 10.01.2009, sipas fragmentit me nr.1, në Xhirollogarinë janë pranuar 10.000 den. nga SHA Banka komerciale si kredi afatshkurtër për MJQ.
2. Zvogëlimin e aktives dhe pasives: Më 30.01.2009, sipas fragmentit nga banka me nr.2, është paguar një pjesë e obligimeve sipas kredisë për MJ prej 2.000 den.
3. Ndryshimet strukturore të aktives: Më 31.01.2009, sipas fragmentit nga banka me nr.3, blerësi ka paguar në Xhirollogarinë shumë prej 2.000 den
4. Ndryshimet strukturore të pasives: Më 01.02.2009, për sigurimin e obligimeve ndaj furnizuesve është lëshuar çek për pagesën e faturës për 1.200 den.

VI. SHA "Meriks", gjatë muajit janar 2009, ka bërë regjistrimin në bazë të ,të dhënave në vijim:

0. Gjendja fillestare e Ll/isë Kërkesa nga blerësit 64.000 den. më ditën 01.01.
1. Në ditën 05.01. i janë shitur mallra tregtar sipas f-rës me nr. 14/09 "Elektra"-s për 16.000 den.
2. Në ditën 10.01. sipas fragmentit nga banka me nr. 3 "Elektra" ka paguar në Xhirollogarinë e SHA "Meriks" 16.000 den. shpagesë e borxhit sipas f-rës me nr.14/09.
3. Në ditën 14.01. i janë shitur mallra tregtar sipas f-rës me nr. 15/09 "Elektrës" për 20.000 den.
4. Në ditën 19.01. sipas letrës numër 10, "Elektrës" i është aprovuar lirim prej 2.000 den.
5. Në ditën 25.01. sipas fragmentit nga banka me nr.4 "Elektra", ka paguar në llogarinë e transaksionit të "Meriks", shumë me të cilën e paguan në tërësi borxhin e përgjithshëm nga faturat.

Të përpilohet:

- a Forma shkallëzuese e F/rës Kërkesa nga blerësi "Elektra",
- b) Forma njëanëshe e Ll/isë Kërkesa nga blerësi,
- c) Të hapet "T" llogaria për Ll/inë Kërkesa nga blerësi.

VII. SHA "Kontiteks", gjatë muajit shkurt 2009, e ka bërë regjistrimin e të dhënave në vijim:

0. Gjendja fillestare Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve 50.000 den. në ditën 01.02.

1. Në ditën 02.02., janë furnizuar mallra tregtar sipas f/rës me nr. 47/09 nga furnizuesi "Melita" për 15.000 den.

2. Në ditën 10.02., sipas fragmentit nga banka me nr.9, i është paguar furnizuesit "Melita" nga Xhirollogaria 15.000 den. si pagesë e borxhit sipas f/rës me nr. 47/09.

3. Në ditën 14.02., janë furnizuar mallra tregtar sipas f/rës me nr. 50/09 nga "Melita" për 20.000 den.

4. Në ditën 19.02., sipas letrës me nr. 12, furnizuesi "Melita" ka aprovuar lirim prej 3.000 den.

5. Në ditën 25.02. sipas fragmentit nga banka me nr. 10, i është paguar furnizuesit "Melita" nga Xhirollogaria 17.000 den. si pagesë e borxhit sipas f/rës me nr. 50/09.

Të përpilohet;

a) Forma shkallëzuese e Ll/isë Obligime ndaj furnizuesi "Melita"

b) Forma njëanësore e Ll/isë Obligime ndaj furnizuesit,

c) Të hapet llogaria "T" për Ll/inë Obligime ndaj furnizuesit.

Tema 4:

LIBRA KONTABILISTE

PËRMBAJTJA E TEMËS

Radhitja e procedurës kontabiliste
Analiza e transaksioneve afariste
në bazë të dokumenteve
burimore
Kontimi në urdhëresë
Regjistrimi në ditar
(evidenca kronologjike)
Regjistrimi i llogarive në librin
kryesor (evidenca sistematike)
Evidenca analitike (libra
ndihmëse)
Mbledhja e ndryshimeve të
llogarive dhe ditarit, përmbyllja e
tyre, përpilimi i pasqyrimeve dhe
bilanceve

QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi:

**-ta definojë nocionin kontim;
-konton në dokumentin-
urdhëresë për evidentim
-ta evidenton në ditar si
evidencë kronologjike;
-ta përshkruajë librin kryesor si
evidencë sistematike;
-ta kuptojë esencën e
evidencës analitike.**

RADHITJA E PROCEDURËS KONTABILISTE

Thënë në mënyrë të përgjithësuar, procedura kontabiliste përbëhet nga evidentimi në dokumentet kontabiliste dhe nga përpunimi i të dhënave kontabiliste të fituara në bazë të evidentimeve. Radhitja e procedurës kontabiliste zhvillohet në suazat e katër fazave në vijim:



Cikli kontabilist

1. Analiza e transaksioneve afariste në bazë të dokumenteve origjinale;
2. Kontimi në urdhëresë;
3. Evidentimi në ditar (evidenca kronologjike);
4. Evidentimi i llogarive nga libri kryesor (evidenca sistemore);
5. Evidenca analitike (librat ndihmës);
6. Përmbledhja e ndryshimeve të llogarive dhe ditarit, përmbyllja e tyre, përpilimi i pasqyrimeve dhe balanceve.

1. ANALIZA E TRANSAKSIONEVE AFARISTE NË BAZË TË DOKUMENTEVE ORIGINAL

Hapi fillestar në procesin e shënimit, evidentimit, është çasti i *identifikimit* të ngjarjes për shkak se çdo ngjarje, çdo transaksion duhet të dokumentohet se ka ndodhur, *dokumenti burimor*, fillestar, origjinal siguron dëshmi të duhur në një sistem kontabilist, për shënimin, për evidentimin e ngjarjes, transaksionit. Evidentimi i ngjarjes afariste pa ekzistimin e dokumentit është njëjtë me falsifikuat. Sot as që ekziston aktivitet në kompanitë për të cilin nuk përpilohet ose nuk pranohet dokument. Dokumentet vijnë çdo ditë nga të gjitha anët: nga subjektet e jashtëm me të cilët kompania ka bashkëpunim afarist, deri në dokumente interne të cilat vijnë nga të gjitha shërbimet e kompanisë. Organizimi i lëvizjes së dokumenteve paraqet punë të ndërlikuar dhe varet nga strukturimi organizativ i kompanisë. Në shumë kompani ekzistojnë persona ose shërbime të cilat e përcjellin rrjedhën e dokumentacionit. Çdo kompani, në mënyrë të vet e krijon dokumentacionin e vet. Por, përsëri, ajo duhet ta ketë formën dhe përmbajtjen e vet. Në çdo dokument duhet të ketë emër të dokumentit (që paraqet faturë, fletë përcjellëse, fletë pranim dhe ngjashëm), vendin dhe datën e lëshimit, prej kujt vjen, për kë është dedikuar, përshkrim të ndryshimit afarist të shkaktuar me sasi dhe me shuma dhe të jetë vërtetuar me vulë dhe me nënshkrim nga personi i autorizuar

Dokumenti origjinal siguron dëshmi të nevojshme në një sistem kontabilist, për evidentimin e ngjarjes dhe mjet në bazë të të cilit bazohet kontrolli mbi regjistrimet e bëra.



Evidenca kontabiliste nuk bëhet pa dokument

Nga njëra anë, dokumenti është dëshmi për ndryshimin e ndodhur, ndërsa nga ana tjetër, është mjet mbi të cilin bazohet kontrolli i regjistrimeve të bëra. Fatura e pranuar nga furnizuesi dëshmon për furnizimin në konto të hapur, kërkesa dëshmon për lëshimin e materialeve nga magazina, fragmenti nga banka dëshmon për ndryshimet - pranimi ose derdhjen e parave në Xhirologarinë etj.

Disa nga dokumentet përpilohen në ndërmarrjen dhe dëshmojnë për ngjarje interne, (ngjarje që ka ndodhur në vetë ndërmarrjen), ndërsa disa arrijnë nga jashtë nga subjekte të tjera dhe dëshmojnë për ngjarje eksterne (ngjarje që rrjedh nga kontaktimi afarist i ndërmarrjes me rrethinën e vet). Në varësi nga ajo se prej ku vijnë dokumentet, do t'i ndajmë në dy grupe: **dokumente interne dhe eksterna.**

-Dokumente interne janë ato të cilët lëshohen brenda në vetë kompaninë. Mund të jenë dokumente të cilat përdoren vetëm për përdorim intern si për shembull kërkesa, fletë pranimi, raportet për ndryshimin e çmimeve, listat e rrogave dhe ngj. Përveç kësaj, mund të jenë edhe dokumente të cilat lëshohen në mënyrë interne por u dërgohen komitentëve me të cilët ka bashkëpunim afarist. Dokumente të atilla janë: fletët përcjellëse, faturat gjatë dorëzimit të prodhimeve, mallrat ose shërbimet, arka-pranoi dhe arka-pagoi, ngarkime ose aprovime për rabat, propozime për kompensim dhe ngjashëm. Ky grup i dokumenteve intern emërtohet edhe dokumente dalëse.

-Dokumente eksterne janë ato të cilat pranohen në kompaninë ndërsa i lëshon ndonjë subjekt i jashtëm. Këtu radhiten fletët përcjellëse dhe faturat për pranimin e mallrave, prodhimeve ose shërbimeve, fragmentet nga banka, listat e kamatës, ngarkimet dhe aprovimet nga furnizuesit dhe ngj. Pasi të pranohet dokumenti, bëhet kontrolli i tij. Kontrolli do të thotë kontrollimi i korrektesisë formale të dokumentit (a i ka të gjitha elementet e nevojshme) dhe a e përshkruan në mënyrë të rregullt transaksionin që është bërë. Pasi të verifikohet dokumenti si korrekt, thuhet se ai dokument është likuiduar dhe më tutje dërgohet deri në mbajtjen e kontabilitetit për përpunim. Kontabilisti ose personi profesional i specializuar - konteri, e bën montimin e dokumentit. Kontimi mund të bëhet në vetë dokumentin ose në formular të veçantë - urdhëresë për kontim. Pas kësaj, dokumenti evidentohet në ditar dhe në librin kryesor. Urdhëresa për evidentim e fiton shifrën e vet sipas të cilës njihet dhe kërkohet pasi të arkivohet. Përpunimi i dokumenteve bëhet sipas parimit të kontinuitetit. Të kesh informatë të vërtetë dhe në kohë do të thotë evidentimi i vazhdueshëm, i përditshëm i dokumenteve. Rregullshmëria është një nga parimet themelore në kontabilitetin. Pas evidentimit, dokumentet duhet të rregullohen dhe të lihen në arkiv për ruajtje. Rregullimi i dokumenteve bëhet në regjistra, sipas radhës, ashtu si që përpunohen. Me rregull të veçantë ligjor është përcaktuar koha për ruajtjen e dokumenteve. Për shembull, dokumentet e ndërlydhura me pagesën e parave, ruhen përgjithmonë; së paku pesë vite ru-

Dokumente interne janë ato të cilët lëshohen brenda në vetë

Dokumente eksterne janë ato të cilat pranohen në kompaninë ndërsa i lëshon ndonjë subjekt i jashtëm.



Çdo dokument kontrollohet dhe verifikohet

tim e fiton shifrën e vet sipas të cilës njihet dhe kërkohet pasi të arkivohet. Përpunimi i dokumenteve bëhet sipas parimit të kontinuitetit. Të kesh informatë të vërtetë dhe në kohë do të thotë evidentimi i vazhdueshëm, i përditshëm i dokumenteve. Rregullshmëria është një nga parimet themelore në kontabilitetin. Pas evidentimit, dokumentet duhet të rregullohen dhe të lihen në arkiv për ruajtje. Rregullimi i dokumenteve bëhet në regjistra, sipas radhës, ashtu si që përpunohen. Me rregull të veçantë ligjor është përcaktuar koha për ruajtjen e dokumenteve. Për shembull, dokumentet e ndërlydhura me pagesën e parave, ruhen përgjithmonë; së paku pesë vite ru-

hen llogaritë periodike dh përfundimtare, faturat për dërgimin e mallrave dhe shërbimeve si edhe faturat e pranuar, ruhen së paku tre vite etj.

Kontimi paraqet një nga operacionet profesionale më thelbësore të cilat i realizojnë persona të lartë profesional në këtë fushë të ashtuquajtur “konterë

2. KONTIMI NË URDHËRESË

Me nocionin kontim nënkuptohet përcaktimi i llogarive në të cilat një ngjarje e dëshmuar me dokument vetjak do të shkaktojë ndryshime, dhe përcaktimi i karakterit të ndryshimit (ndryshim pozitiv ose negativ) që evidentohet në ato llogari. Kontimi si proces dhe fazë në suazat e procedurave kontabiliste paraqet një nga operacionet profesionale më thelbësore të cilat i realizojnë persona të lartë profesional në këtë fushë të ashtuquajtur “konterë”. Shembull: materiale të blera sipas f/rës me nr. 56/06, nga furnizuesi për 10.000 den. do të kontohet në atë mënyrë që do të përcaktohet se gjatë kësaj ngjarjeje vjen deri në ndryshim në llogaritë **“Rezerva e materialeve”** dhe **“Obligime afatshkurta ndaj furnizuesve”** me ç’rast në llogarinë e parë paraqitet ndryshim pozitiv ndërsa në të dytën ndryshim negativ.

Kontimi bëhet në formular-urdhëresë të veçantë për evidentim. Urdhëresa si formular i përmban kolonat: numri rendor, numri i llogarisë, si kolonë e dyfishtë, përshkrimi, lidhja dhe kolona e dyfishtë. Kontimi bëhet edhe në vetë dokumentin (faturë, kërkesë etj.) në mënyrë që do të vihet vulë në dokumentin i cili shtyp kolona për shifra në llogaritë dhe kolona për shuma (+ dhe -). Kontimi mund të bëhet në të dy mënyrat, paralelisht, duke përdorur edhe urdhëresa të veçanta për evidentim edhe kontim në vetë dokumentin. Urdhëresat për evidentim në praktikën paraqesin formularë të mëdhenj sa një fletë letër, përdoren edhe në formë më të shkurtër si gjysmë fletë.

Gjatë një dite mund të bëhet evidentimi në më shumë urdhëresa.



Kontimi në urdhëresë


URDHËRESA PËR EVIDENTIM nr 1.

N r.	Nr. i llogarisë		PËRSHKRIMI	Ligja	SHUMA	
	+	-			+	-
1.	1000	1200	Ll-ia Xhirollogari Ll-ia Kërkesa nga blerësit Paguat sipas fragmentit nga banka me nr.154	1. 1	45.000	45.000
2.	1000	1000	Ll-ia Llogaria kalimtare Ll-ia Xhirollogari Tërhequr për pagesa nga arka sipas fragmentit nga banka me nr. 236	1.2	20.000	20.000
3.	1020	1009	Ll-ia Arka Ll-ia Llogaria kalimtare Paguat sipas fragmentit nga arka me nr. 240	1.3	20.000	20.000
4.	2201	1000	Ll-ia Obligime ndaj furnizuesve Ll-ia Xhirollogaria Paguat sipas fragmentit nga banka me nr. 444	1.4	15.000	15.000
			Gjithsej		100.000	100.000

Përpiluar më xx. xx. xxx

Kontuar

Shefi i kontabilitetit



3. EVIDENTIMI NË DITAR (EVIDENTIMI KRONOLOGJIK)

Në ditar bëhen evidentime në bazë të urdhëresave për evidentim. Nga këndvështrimi formal, urdhëresa për evidentim ka pothuajse përmbajtje të njëjtë me ditarin. Urdhëresat për evidentim përpilohen për një ose më shumë ngjarje kontabiliste dhe përmbyllet në mënyrë veç e veç. Gjatë një muaji përpilohen disa qindra ose disa mijëra urdhëresa. **Ditari është i vetmi për tërë vitin.** Ngjarjet

General Journal					GJ1
Date	Account Title and Description	Ref.	Debit	Credit	
20X1					
Aug. 1	Cash		50,000		
	Notes Payable			50,000	
	Borrowed \$50,000				
3	Equipment		30,000		
	Cash			30,000	
	Purchased equipment				
6	Vehicles		20,000		
	Notes Payable			18,000	
	Cash			2,000	
	Purchased delivery truck				

Evidenca kronologjile
bëhet në ditar

Ngjarjet në ditar evidentohen me radhë kronologjike. Ditari është një për tërë vitin.

evidentohen në ditarin sipas rendit kronologjik. Gjegjesisht, në ditar, pas përfundimit të njëres anë, shumat e ndryshimeve në anën pozitive dhe negative transferohen në anën tjetër ashtu që në fund të vitit fitohet shuma e përgjithshme e ndryshimeve për tërë vitin.

Procedura për evidentim në ditar është si vijon:


1. Në kolonën e parë të ditarit shënohet numri rendor i ngjarjes kontabiliste (transaksionit);
2. Në kolonën e dytë vihet data kur ka ndodhur dhe është evidentuar ngjarja. Ngjarjet evidentohen në ditar sipas rendit kronologjik. Data na mundëson që në çdo kohë ta gjejmë ngjarjen që ka ndodhur atë ditë;
3. Në kolonën e tretë të dyfishtë regjistrohet numri i llogarisë sipas planit kontabilist edhe atë fillimisht llogaria në të cilën evidentohet në anën debitore (e cila ngarkohet me hua, rritet). Llogaria në të cilën evidentohet ana kreditore, (miratohet, zvogëlohet) është paraqitur në vijën vijuese dhe pak më djathtas nga llogaria e parë. Evidenca e këtillë ka ndërmend të bëjë dallim të dukshëm ndërmjet llogarisë e cila ngarkohet me borxh dhe llogarisë e cila aprovohet.
4. Në kolonën përshkrim regjistrohen emrat e llogarive dhe sqarim për transaksionin e bërë, për ngjarjen;
5. Kolona shuma është ndarë në kolonë për ndryshime pozitive dhe kolonë për ndryshime negative

DITARI faq. 1

Rend.	Data	Nr. i llogarisë		PËRSHKRIMI	SHUMA	
					Debit	Kredit
1.	12.01	1000	120	Ll-ia Xhirollogari Ll-ia Kërkesa nga blerësit Paguar sipas fragmentit nga banka me nr.154	45.000	45.000
2.	24.01	1020	1000	Ll-ia Arka Ll-ia Xhirollogari Tërhequr për pagesa të rregullta kasa sipas fragmentit nga banka me nr. 236	20.000	20.000
3.	27.01	2201	1000	Ll-ia Obligime ndaj furnizuesve Ll-ia Xhirollogari Paguar sipas fragmentit nga banka me nr.444	15.000	15.000
				Gjithsej	80.000	80.000

Pasi në ditar regjistrohen transaksionet sipas radhitjes si kanë ndodhur, ai emërtohet *libër për evidentim origjinal*

Ngjarjet evidentohen fillimisht në ditar mandej transferohen, evidentohen në llogaritë e librit kryesor.



4. EVIDENTIMI I LLOGARIVE NË LIBRIN KRYESOR (EVIDENCA SISTEMORE)

Ditari dhe llogaritë nga libri kryesor janë mjet, alete të cilat përdoren nga ana e kontabilistit. Rezultati përfundimtar është komplet i raporteve financiare dhe është pjesë shumë e rëndësishme e procesit kontabilist. Evidentimi në ditarin siguron kronologji, regjistrim të çdo transaksioni. Atëherë, mund të parashtrijmë pyetje. Pse mos i përgatisim, mos i bëjmë raportet financiare drejtpërdrejtë nga evidenca në ditarin? Vallë, nuk është punë e tepërt evidentimi i ngjarjeve në llogaritë nga libri kryesor? Në praktikë, numri i transaksioneve është ai madh që pothuajse realisht, është me të vërtetë e pamundshme të përjashtohen llogaritë nga libri kryesor si mjet. Llogaritë nga libri kryesor e japin gjendjen dhe ndryshimet e çdo mjeti, burimi, shpenzimi ose hyrjeje veç e veç.

Notes Payable		Cash in Bank	
Dr.	Cr.	Dr.	Cr.
3,000	15,000	5,000	1,500
		15,000	9,100
		8,000	3,500
		-	3,100
		28,000	17,200

Owner's Draw		Service Fees	
Dr.	Cr.	Dr.	Cr.
3,500			8,000

Office Furniture		Owners Equity	
Dr.	Cr.	Dr.	Cr.
9,100			5,000

Office Rent		Interest Expense	
Dr.	Cr.	Dr.	Cr.
1,500		100	

Libri kryesor

Në ditar nuk mund të shihet gjendja veç e veç e mjeteve, burimeve, shpenzimeve dhe hyrjeve. Për këtë arsye, ngjarjet nga ditarin evidentohen në llogaritë nga libri kryesor.

Evidentimi realizohet në atë mënyrë që shuma që gjendet në anën debitoare të një llogarie në ditar, përshkruhet, gjithashtu në anën debitoare të asaj llogarie nga libri kryesor. Shuma që gjendet në anën kreditore në llogari tjetër, shënohet në anën kreditore në llogarinë e njëjtë në librin kryesor. Në llogarinë e librit kryesor, pas çdo transaksioni, në kolonë të veçantë paraqitet saldoja e llogarisë.

Në praktikë më së shpeshti praktikohet forma njëanësore e llogarive.

Frekuenca e evidentimit të llogarive nga libri kryesor dallon ndërmjet kompanive, sipas shkallës së kompjuterizimit të sistemit të tyre kontabilist. Për shembull, në ndonjë sistem të kompjuterizuar shumat evidentohen në llogaritë e librit kryesor njëkohësisht kur evidentohen në ditarin. Në kontabilitetet e organizuara dhe të mbajtura me dorë, evidentimi bëhet veç e veç, për shembull në bazë ditore, javore ose mujore.

Në librin kryesor bëhet evidenca përmbledhëse sintetike.

Pavarësisht se kur bëhet evidentimi, procesi i evidentimit nuk ndryshon asgjë. Ai thjeshtë i organizon transaksionet nëpër llogaritë.

Libri kryesor paraqet evidencë përmbledhëse, sintetike.

<p style="text-align: center;">+ Ll-ia Xhirollogaria -</p> <table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 50%; border-right: 1px solid black; padding: 5px;">1. 45 000</td> <td style="padding: 5px;">2. 20.000</td> </tr> <tr> <td style="border-right: 1px solid black; padding: 5px;"></td> <td style="padding: 5px;">3. 15.000</td> </tr> </table>	1. 45 000	2. 20.000		3. 15.000	<p style="text-align: center;">+ Ll-ia Kërkesa nga blerësit -</p> <table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 50%; border-right: 1px solid black; padding: 5px;"></td> <td style="padding: 5px;">1. 45 000</td> </tr> </table>		1. 45 000
1. 45 000	2. 20.000						
	3. 15.000						
	1. 45 000						
<p style="text-align: center;">+ Ll-ia Arka -</p> <table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 50%; border-right: 1px solid black; padding: 5px;">2. 20 000</td> <td style="padding: 5px;"></td> </tr> </table>	2. 20 000		<p style="text-align: center;">Ll-ia Obligime ndaj + furnizuesve -</p> <table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 50%; border-right: 1px solid black; padding: 5px;">3. 15 000</td> <td style="padding: 5px;"></td> </tr> </table>	3. 15 000			
2. 20 000							
3. 15 000							

5. EVIDENCA ANALITIKE (LIBRA NDIHMËSE)



Evidenca analitike

Me evidencën analitike fitohen të dhëna më të hollësishme për mjetet, hyrjet dhe të dalat. Llogaritë e caktuara sintetike nga libri kryesor, respektivisht nga evidenca përmbledhëse, sintetike zbërthehen në llogari analitike që të fitohen informata më të hollësishme, dhe të veçanta. Evidenca analitike Sistemi i tërësishëm i fitimit të të dhënave të hollësishme, të zbërthyera, analitike e mban emrin **evidenca analitike**. Me evidencën analitike mundësohet që kontabiliteti të jetë më i pasqyrueshëm, më i azhurnuar, siguron kontroll më efikase në kontabilitetin dhe dhe sigurohet inspektimi analitik i punës së ndërmarrjes.

Evidenca analitike mund të formohet për çdo llogari sintetike, por a do të zbërthehen dhe sa do të zbërthehen llogaritë sintetike varet nga nevojat e ndërmarrjeve të caktuara. Evidenca analitike e cila mbahet më së shpeshti në çdo ndërmarrje është për:

- mjetet e parave në arkë,
- për kërkesat nga blerësit,
- për obligimet ndaj furnizuesve,
- për materialet,
- prodhimet dhe mallrat e gatshme,
- për inventarin,

Sistemi i tërësishëm për fitimin e të dhënave të hollësishme, të zbërthyera, analitike emërtohet evidenca analitike

- shpenzimet,
 - mjetet e përhershme etj.
- Shemb. Llogari analitike për kërkesat nga blerësit:

Llogaria sintetike:

+ Ll-ia Kërkesa nga blerësit -

0. 600.000	1. 300.000
------------	------------

Llogaritë analitike:

Ll-ia Kërkesa nga blerësi
+ Makpromet -

0. 150.000	1. 70.000
------------	-----------

Ll-ia Kërkesa nga
+ blerësi Biljana -

0. 450.000	1. 230.000
------------	------------

Shuma e anës pozitive të llogarisë sintetike është e njëjtë me shumat e anëve pozitive të llogarive të saj analitike. E njëjta është edhe me shumat e anëve negative.

6. PËRBLËDHJA E NDRYSHIMEVE TË LLOGARIVE DHE MDI-TARIT, PËRMBYLLJA E TYRE, RUAJTJA, PËRPILIMI I PASQ-YRIMEVE DHE BILANCEVE



Punë përfundimtar në fund të periudhës përlllogaritëse

Në fund të periudhës përlllogaritëse, përmbyllen llogaritë e hyrjeve dhe të dalave, përcaktohet rezultati financiar dhe përpilohen raportet financiare. Mandej përpilohet Bilanci i gjendjes, hapet gjendja fillestare për fillimin e vitit të ri afarist. Përmbyllja e llogarive ka të bëjë me llogaritë e hyrjeve dhe të dalave.

Llogaritë e mjeteve, Punë përfundimtare në fund të obligimeve dhe kapitalit janë llogari të përhershme, reale e periudhës përlllogaritëse që bartin me vete saldo dhe të njëjtën e transferojnë në periudhën e ardhshme përlllogaritëse, si gjendje fillestare. Llogaritë

Liamdale Company		
Trial Balance (prior to recording new transactions)		
Account	Debit Balance	Credit Balance
Cash	\$20,000	
Accounts receivable	9,000	
Inventory	8,000	
Insurance payable		\$700
Accounts payable		2,600
Notes payable (long term)		70,000
Capital stock		12,000
Retained earnings (beginning of year)		7,000
Sales of merchandise		22,000
Cost of goods sold	12,000	
Rent expense	8,000	
Salary expense	1,500	
Insurance expense	700	
Totals	\$54,200	\$54,300

Përpilimi i pasqyrimeve.

e hyrjeve dhe të dalave të cilat paraqiten gjatë periudhës përlllogaritëse, janë llogari të përkohshme dhe shërbejnë për përcaktimin e rezultatit nga puna. Ato, në fund të periudhës përlllogaritëse përmyllen me evidentim të kundërt dhe madhësitë e tyre pasqyrohen nëpërmjet kategorisë rezultati financiar në kapitalin si përfitim ose si humbje për periudhën. Hapi tjetër në vijim është përsëri kontrolli i: (1) njësimi të të gjitha saldove ka borxh dhe saldo kërkon dhe (2) nëse vallë të gjitha llogaritë e hyrjeve dhe të dalave kanë saldo zero. Nëse janë plotësuar dy kushtet paraprake, fillohet me përpilimin e Bilancit të gjendjes. Ky bilanc i përmban llogaritë e përhershme, me saldot e tyre. Saldot e llogarive nga Bilanci i gjendjes janë llogari të përhershme me saldot e tyre. Saldot e llogarive nga Bilanci i gjendjes janë saldo fillestare të llogarive në vitin e ri afarist. Ashtu, erdhëm deri në fundin dhe përsëri në fillimin e ciklit kontabilist. Nëse tani, të gjitha aktivitetet përfundimtare (Bilanci bruto, rregullimet, bilanci i rregulluar, lista e përmyllur, mbyllja dhe hapja e llogarive) do t'i punonim me dorë, do të na nevojiteshin rreth dy muaj. Zhvillimi i teknologjisë, kompjuterët dhe softuerët, sot na mundësojnë fleksibilitet të madh në punë, kursim të kohës dhe parave. Për krahasim, nëse më para na nevojiteshin gjashtëdhjetë ditë, sot na mjaftojnë edhe gjashtë ditë pune.

NOCIONET KRYESORE

Procedura kontabiliste
Cikli kontabilist
Transaksioni afarist
Dokumenti
Urdhëresa për evidentim
Ditari
Libri kryesor
Librat ndihmës
Evidenca kronologjike
Evidenca sistematike

PYETJE:

1. Shpjegoje procedurën kontabiliste!
2. Shpjego se prej cilave kolona përbëhet urdhëresa për evidentim!
3. Ku është dallimi ndërmjet ditarit dhe urdhëresës për evidentim?
4. Ku mbahet evidenca sistematike?
5. Prej se përbëhet libri kryesor?
6. Si bëhet transferimi i ndryshimeve prej urdhëresës për evidentim të llogarive në librin kryesor?
7. Për çka shërben evidenca analitike?

Mendoni për këtë:

1. Martina Bogdanovska mban libër kryesor dhe ditar për biznesin e saj: konsultim (këshilla) ekonomik - juridik. Ajo mendon se çka është më mirë të bëjë:

-t'i evidentojë ngarkimet dhe aprovimet në llogaritë dhe t'i ketë saldot në llogaritë për çdo ditë, të azhurnuara, up to date, ose -ta evidentojë çdo transaksion së pari në ditar që të ketë evidencë rrjedhëse?

Ndihmoni Bogdanovskës në zgjedhjen e procedurës. Sipas logjikës, cila vjen e para: ditari ose libri kryesor?

USHTRIME:

I. Ngjarjet kontabiliste në vijim të regjistrohesh në Ditari dhe në Urdhëresë për evidentim dhe në llogaritë "T"!

1. Më 15.01 sipas faturës me nr.5/09 janë blerë mallra në shumë prej 110.000 den. nga furnizuesi.
2. Më 16.01 sipas fragmentit nga banka me nr.3 prej parave në llogarinë trans aktive janë blerë 1.000 euro, llogaritur nga 62 den. për 1 euro, dhe të njëjtat janë kthyer në llogarinë devizore.
3. Më 17.01 prej mjeteve devizore është paguar obligim ndaj furnizuesit të huaj në shumë prej 1.000 euro.
4. Më 18.01 janë paguar rrogat e të punësuarve nga llogaria transaksuese e subjektit juridik në llogarinë trans aktive të të punësuarve në shumë prej 65.000 den.
5. Më 20.01 për pagesën e f/rës nr. 5/09 është lëshuar kambial,
6. Më 21.01 është fituar kredi afatshkurta dhe i njëjti është transferuar në llogarinë trans aktive sipas fragmentit me nr.4 nga Tutunska banka në shumë prej 30.000 den.
7. Më 22.01 janë shitur mallra sipas f/rës me nr. 32/09 blerësit "Omega" nga Ohri për 12.000 den.,
8. Sipas fragmentit me nr. 5 nga banka, kanë ndodhur ndryshime në llogarinë trans aktive.
 - a) janë paguar tatime dhe kontribute për 8.000 den.
 - b) janë tërhequr për nevojat e arkës 5.000 den
 - c) është arkëtuar nga blerësi "Omega" nga Ohri për pagesën e borxhit sipas f/rës me nr.32/09 në shumë prej 10.800 den.) është paguar kësti i parë i kredisë së aprovuar për MJ në shumë prej 3.000 den.
9. Falas i është dhënë kamion shoqërisë tregtare tjetër për 80.000 den. sipas vendimit me nr.12
10. Janë blerë materiale me para në dorë sipas faturës me nr. 34 në shumë prej 5.000 den.
11. Sipas fragmentit me nr. 6, janë paguar obligimet ndaj furnizuesit për MJ në shumë prej 18.000 den.

12. Sipas procesverbalit me nr.3, i janë kthyer materiale furnizuesit për shkak të cilësisë së dobët në shumë prej 3.000 den.
13. Sipas fragmentit me nr. 7, janë paguar në llogarinë e transaksionit nga aksionet e shitura shumë prej 200.000 den.
14. Është paguar nga arka për rroga të të punësuarve sipas fragmentit të arkës me nr.10, shumë prej 20.000 den.
15. Është paguar në plotësim kërkesa e furnizuesit "Omega", për çka është pranuar çek me shumën pre 1.200 den.
16. Sipas fragmentit me nr. 8, është paguar nga llogaria e transaksionit për nevojat e arkës shuma prej 25.000 den.
17. Është aprovuar kredi për MJ në shumë prej 14.000 den dhe e njëjta është harxhuar me qëllim për obligime afatshkurta ndaj furnizuesve.
18. Është pranuar fragment nga llogaria devizore në të cilën shihet se blerës i huaj ka bërë pagimin e 2.000 euro (kursi 62 den. për 1 euro).

Tema 5: PLANI LLOGARITËS

PËRMBAJTJA E TEMËS:

Plani llogaritës
Parimi i përpilimit të
planit llogaritës
Sisteme për përpilimin e
planit llogaritës
Funksionet e klasave

QËLLIMET E MËSIMIT:

Nxënësi:
-ta definojë nocionin plan llogaritës;
-t'i kuptojë qëllimet dhe detyrat e
planit llogaritës;
-ta kuptojë përmbajtjen e
planit llogaritës;
-t'i identifikojë llogaritë e
planit llogaritës.

PLANI LLOGARITËS

Kontabiliteti financiar duhet të jetë kontabilitet i njësuar, gjegjësisht të mbahet në mënyrën e njëjtë të të gjithë subjektet ekonomik të cilët janë të obliguar me ligj që të mbajnë kontabilitet

Kontabiliteti i ndërmarrjes mbahet në llogari - konto. Numri i llogarive në kontabilitetin mund të jetë i ndryshëm në ndërmarrje të ndryshme, bile edhe më të njëjtën në periudha të ndryshme kohore. Numri i madh i llogarive nga njëra anë dhe nevoja për njësim, uniformim nga ana tjetër, kërkojnë pasqyrim të rregullt të të gjitha llogarive që përdoren në evidencën, si parakusht që të evitohet konfuzioni.

Kontabiliteti financiar duhet të jetë kontabilitet i unifikuar gjegjësisht të mbahet në mënyrën e njëjtë të të gjithë subjektet ekonomike të cilët janë të obliguar sipas ligjit të mbajnë kontabilitet.

Unifikimi në evidencën kontabiliste arrihet me aplikimin e planit llogaritës unik. **Plani llogaritës paraqet përmbledhje ose listë e të gjitha llogarive në të cilat mbahet evidenca.** Kontabiliteti i unifikuar dhe ky është ai oficial, kontabiliteti financiar, në vendin tonë mbahet sipas planit llogaritës oficial i cili është i obligueshëm gjatë përpilimit të planeve llogaritëse analitike të organizatat individuale në sistemin ekonomik. Plani llogaritës zhvillohet nga korniza llogaritëse.



Plani kontabilist doracak për kontabilistin

Ndërsa **korniza llogaritëse** na jep bazë nismëtare për përpilimin e një pasqyrimi të tërësishëm të llogarive në ndërmarrjen. Në kornizën llogaritëse janë rregulluar kontot, llogaritë sipas një kriterit më të lartë, të përgjithësuar, në të cilën janë dhënë klasat (**10 klasa**). Plani llogaritës oficial, i obligueshëm të të gjithë subjektet ekonomike është zbërthyer në 10 klasa, çdo klasë zberthehet në 10 grupe ndërsa çdo grup në 1000 llogari sintetike.

Korniza llogaritëse oficiale është zbërthyer deri në shkallën e tretë (llogari sintetike). Zbërthimi prej shkallës së 4-t të llogarive analitike është e drejtë e realizuar e organizatave dhe ato këtë e bëjnë në mënyrë individuale, sipas nevojave të tyre.

Korniza llogaritëse është unike për të gjitha format organizative të prodhimtarisë dhe shërbimit dhe ka karakter të modelit për përpilimin e planeve llogaritëse analitike të ndërmarrjeve. Te ne, por edhe në shumë vende tjera, korniza llogaritëse është përcaktuar me rregull ligjor dhe në praktikë emërtohet plan llogaritës. Por, dallimi ndërmjet kornizës llogaritëse dhe planit llogaritës ekziston. Korniza llogaritëse është nomenklaturë e llogarive sintetike ndërsa plani llogaritës është nomenklaturë e llogarive analitike të cilat vijnë dhe ndërtohen në bazë të llogarive sintetike të dhëna në kornizën llogaritëse. Korniza llogaritëse është përcaktuar me rregull ligjor ndërsa planin llogaritës kompanitë e krijojnë vetë (mendohet për llogaritë analitike), në varësi nga nevojat e tyre. Korniza llogaritëse respektivisht llogaritë themelore nga plani llogaritës që sot aplikohet te ne, grupohen në dhjetë klasa prej 0 deri në klasën 9.

Korniza llogaritëse është e përcaktuar me rregull ligjor.

planin llogaritës kompanitë e krijojnë vetë (mendohet për llogaritë analitike)

QËLLIMET, DETYRAT DHE PARIMET E PLANIT LLOGARITËS

Duke e marrë parasysh faktin se numri i llogarive në kontabilitet mund të jetë i ndryshëm në ndërmarrje të ndryshme, bile edhe në të njëjtën në periudhë të ndryshme kohore, duet t' i kushtohet vëmendje e madhe përpilimit të planit llogaritës. Me atë rast, është mirë të nisët nga qëllimet në vijim:

-gjetje më e lehtë e llogarive, -përshpejtimi i evidencës kontabiliste, -thjeshtëzimi i punës në kontabilitet, -vendosja e rendit në evidencën kontabiliste, -përmirësimi i informimit kontabilist, -evitimi i konfuzionit në evidentimin, -menaxhimi i suksesshëm me ekonominë nacionale.

Për shkak se plani kontabilist është informuesi kryesor për ndryshimet ekonomike gjatë punës, me ndihmën e tij mbahet kontabiliteti. Detyrat e planit llogaritës mirë të përpiluar i cili do të mundësojë zberthim të lartë të kornizës llogaritëse zyrtare është të mundësojë: -mënyrë të njësuar e evidentimit, **(3)** -pranimi i pasqyrimit të rregullt

-gjuhë e përbashkët dhe mënyra e sigurimit të të dhënave -shfrytëzimi i të dhënave konkrete kontabiliste, -pranimi i të dhënave krahasimtare në punën afariste në plan intern dhe ekstern.

-informimi cilësor në ndërmarrjet, -racionalizim më i madh në evidentimin.

Në varësi nga qëllimet të cilat vihen para kontabilitetit, në teori janë formuar dy baza nismëtare, dy parime për përpilimin e planeve llogaritëse. Këto dy parime aplikohen gjatë renditjes së llogarive në planin llogaritës, a para së gjithash në llogaritë themelore - klasat.

Këto parime aplikohen edhe gjatë renditjes së llogarive brenda në klasat, në grupe dhe brenda në grupet e llogarive sintetike tre shifrore të cilat janë të obligueshme. Në literaturën kontabiliste hasim në dy parime: **parimi procesor dhe parimi bilancor.**

Sipas parimit procesor klasat sistematizohen sipas asaj se çfarë funksioni kanë në procesin prodhues. Sipas këtij **(3)** koncepti, radhitja e klasave duhet të përkojë me të njohurën **Formulë e Marksit** për lëvizjen qarkore të kapitalit **Para-Mall-Prodhimtari-Mall1-Para1**. Gjithashtu, sipas këtij parimi kontabiliteti duhet t' i përfshijë mjetet dhe pronën në të gjitha fazat e lëvizjes qarkore në çdo moment në të dy raportet financiare, të mund të japë informata sa mjete ka, respektivisht në cilën fazë gjendet prona. Sipas parimit procesor, në planin kontabilist së pari vijnë klasat të cilat kryesisht përfshijnë mjete, pronë, pastaj radhiten klasat në të cilat evidentohet shpenzimi i tyre pastaj prodhimtaria e prodhimeve të gatshme, hyrjet, shpenzimet dhe në fund klasat për burimet e mjeteve.

Qëllimet e planit kontabilist

Detyrat e planit kontabilist.

Parimi procesor i përpilimit të planit kontabilist.

Parimi i këtillë gjatë përpilimit të planit llogaritës është **parimi bilancor** i cili nisët nga qëllime krejtësisht ndryshe gjatë konceptimit të planit llogaritës. Ky koncept nisët nga qëllimi kryesor i kontabilitetit financiar, e ky është evidentimi i ngjarjeve afariste të cilat reflektohen mbi rezultatin e ndërmarrjes gjegjësisht mbi bilancin e suksesit dhe bilancin e gjendjes. Sipas këtij parimi, detyra e kontabilitetit është **matja e efikasitetit afarist** të ndërmarrjes e jo përcjellje e procesit të prodhimit. Për shembull, Franca është vend i cili e përdor këtë parim. Duke u nisur nga qëllimet e lartpërmendura, parimi bilancor si bazë fillestare për përpilimin e planit llogaritës, a para së gjithash të klasave ato duhet të zhvillohen sipas radhitjes së pozitive bilancore. Kjo do të thotë të fillohet me klasa në të cilat do të grupohen llogaritë në aktiven, mandej klasa për llogari nga pasiven, klasa për hyrjet, klasa për rezultatet nga puna dhe përvetësimi i tyre.

Parimi bilancor i përpilimit të planit kontabilist.

Sipas parimit procesor, plani llogaritës është zbërthyer si vijon:

Klasa 0

Kërkesa për kapital të regjistruar por të papaguar dhe mjete të përhershme.

Klasa 1

Mjete parash, letra me vlerë, kërkesa afatshkurta dhe shpenzime të paguara për periudhat e ardhshme dhe arkëtimi i paarritur i hyrjeve (ABP).

Klasa 2

Obligime, rezervime afatgjata për shpenzimet dhe për rreziqet dhe pagesa e shtyrë e shpenzimeve dhe hyrje në periudhat e ardhshme (PIBP).

Klasa 3

Rezervat e lëndëve të para, materiale, pjesë rezerve dhe inventar i imët

Klasa 4

Shpenzime, të dala nga puna

Klasa 5

E lirë (për përdorim intern-parallogaritje reparti dhe nevoja të tjera)

Klasa 6

Rezerva e prodhimitarisë, prodhime dhe mallra të gatshme

Klasa 7

Të dala dhe hyrje

Klasa 8

Rezultate nga puna

Klasa 9

Kapital, rezerva dhe evidencë jashtë bilancore

SISTEME PËR PËRPILIMIN E PLANIT LLOGARITËS

Në teori janë afirmuar më shumë sisteme për përpilimin e planit llogaritës si që janë sistemet e ngjyrave, numrave, sisteme decimale etj. Plani ynë llogaritës është përpiluar sipas sistemit decimal numëror. Sipas këtij sistemi, të gjitha llogaritë-konto janë ndarë në 10 konto themelore të emërtuara klasa dhe të shënuara me numrat prej 0 - 9. Çdo klasë zërthehet në 10 grupe me ç'rast fitohen 100 grupe, të llogarive të shënuara prej 0-99. Zbërthimi i planit llogaritës në grupe është zbërthim i shkallës së parë. Plani llogaritës nuk mund të zërthehet në gjerësi. Zbërthimi në thellësi është teorikisht i pakufizuar. Çdo grup zërthehet në 10 llogari sintetike me ç'rast fitohen 1000 llogari sintetike të shënuara prej 000-999.

Numrat e llogarive nuk kanë ndonjë domethënie aritmetike. Çdo simbol në shifrën e llogarisë tregon shkallë të zbërthimit, ndonjë përkatësi.

Shemb.

1	Mjete parash dhe kërkesa
1 2.	Kërkesa nga blerësit
1 2 0	Kërkesa nga blerësit në vend
	1 2 0 0 Blerës për mjete qarkulluese ku:
1	Klasa e kontos
12	Grupi i kontos
120	Konto sintetike
1200	Konto analitike

FUNKSIONET E KLASAVE

Klasa 0 - nga vetë emri i kësaj klase shihet se në të njëjtën janë rezervuar grupe dhe llogari për evidentimin e mjeteve të përhershme. Të gjitha llogaritë janë të gjendjes respektivisht paraqesin gjendje, sipas kësaj, saldoja e tyre mund të jetë pozitive ose 0. Këto llogari janë pozita bilancore të bilancit të gjendjes në pjesën e aktives. Kur gjendja e këtyre mjeteve rritet evidentohet në anën pozitive, ndërsa kur zvogëlohet në anën negative. Gjendja rritet me furnizimin e këtyre mjeteve ndërsa zvogëlohet me tjetërsimin e tyre.

Klasa 1 - në këtë klasë gjenden mjete rrjedhëse (qarkulluese), sipas kësaj, llogaritë në të njëjtën janë të gjendjes. Në drejtim të evidencës, vlejné rregullat e njëjtë si edhe për klasën 0. Në këtë klasë janë siguruar llogari për evidencën e dy llojeve dominues të mjeteve qarkulluese edhe atë: mjete parash dhe kërkesa.

Klasa 2 - në këtë klasë nuk evidentohen mjetet por obligimet afatshkurta. Llogaritë nga kjo klasë saldo negative. Llogaritë e kësaj klase janë burime të cilat paraqesin mjete vetjake ose mjetet e kujt i ka shfrytëzuar ndërmarrja ose nuk i ka kthyer. Këto llogari janë pozita bilancore të pasives së bilancit dhe emërtohen me llogari pasive. Gjatë rritjes së obligimeve evidentohet në anën negative, ndërsa gjatë zvogëlimit të tyre në anën pozitive. Saldot e këtyre llogarive janë negative ose 0 dhe paraqesin obligime të pa kompensuara.

Klasa 3 - Kjo klasë është e rezervuar për evidencën e një pjese të mjeteve qarkulluese me formë materiale. Sipas kësaj, këto llogari janë të gjendjes ndërsa evidenca është e njëjtë si për klasat 0 dhe 1. Në llogaritë e kësaj klase evidentohen mjetet prej furnizimit të tyre deri në çastin e shpenzimit të tyre. Prandaj, tërë evidenca njihet si evidenca e materialeve. Në suazat e saj ka llogari të cilat shërbejnë për formimin e vlerës së tyre furnizuese, llogari në të cilat evidentohen rezervat dhe llogaritë korrektuese.

Klasa 4 - Klasa 4 nuk tregon mjete por vlerën e mjeteve të harxhuara. Kjo klasë është një lloj ure për kalimin e mjeteve në efikasitet ose në të dala. Llogaritë nga kjo klasë nuk janë pozita bilanci dhe andaj nuk janë as aktive as pasive. Gjatë përpilimit të bilancit në fund të periudhave përlllogaritëse, këto llogari mbyllen nuk kanë saldo, ndërsa vlerat paraqiten në llogaritë e prodhimitarisë ose prodhimeve të gatshme. Rregullat për evidentim janë: kur bëhet shpenzimi evidentohet në anën pozitive të llogarisë përkatëse shpenzuese ndërsa kur bartet shpenzimi në prodhimitarinë evidentohet si negativ.

Klasa 5 - Klasa 5 është e lirë, ndërsa shoqëria tregtare vetë vendos nëse do ta shfrytëzojë ose jo. Për shkak se nuk është obliguese, klasa 5 nuk është pjesë e kontabilitetit financiar. Kjo klasë ka funksion të shënojë, mandej

mandej të japë informata të tipit sa shpenzime janë bërë, ku janë bërë, kush i ka bërë, për çka janë bërë, çka është prodhuar, me cilin çmim është prodhuar, në cilin prodhim ka humbje në të cilin ka fitim.

Klasa 6 - Llogaritë e kësaj klase duhet të sigurojnë evidencë për furnizimin e mallrave tregtare, rezervat e prodhimeve dhe mallrave, gjegjësisht ta paraqesin gjendjen e tyre në fund të periudhës përlllogaritëse. Rregullat për evidentim vlejné si edhe për të gjitha llogaritë aktive.

Klasa 7 - Klasa 7 përmban llogari në të cilat evidentohen hyrje dhe të dala. Prej këtyre llogarive përcaktohet suksesi i realizuar në një periudhë përlllogaritëse prandaj quhen llogari të suksesshme dhe janë zëra të bilancit të suksesit. Saldot e këtyre llogarive në fillim të periudhës janë 0, mandej rriten deri në mbylljen e tyre. Rregullat për evidentim janë: shpenzimi evidentohet në anën pozitive të llogarisë përkatëse shpenzuese ndërsa hyrjet evidentohen në anën negative të llogarisë përkatëse hyrëse.

Klasa 8 - Në këtë klasë janë llogari të cila kanë për detyrë ta përlllogarisin rezultatin financiar dhe ta sistematizojnë me çka edhe llogaritë e klasës 8 mbyllen pas kryerjes së funksionit të tyre. Sipas kësaj, ato nuk janë elemente (zëra bilancor) në asnjë bilanc.

Klasa 9 - Në këtë klasë janë llogaritë në të cilat janë burimet e mjeteve - kapitali. Ato janë llogari pasive, zëra bilancor të pasives së bilancit të gjendjes dhe vlejné rregullat për evidentimin e llogarive pasive.

Vërejtje:

Llogari aktive: klasa 0,1,3,5 dhe 6,

Llogari pasive: klasa 2 dhe 9,

Llogari harxhimesh: klasa 4,

Llogari të dalash she të hyrash: klasa 7,

Rezultate nga puna: klasa 8,

Llogaritë nga klasat 4, 7 dhe 8 në fund të vitit me përpilimin e llogarisë përfundimtare mbyllen dhe kanë saldo deri më 0.

Shoqëria tregtare vitin kalendarik rrjedhës e fillon me punë me klasat : 0,1,2,3,5,6 dhe 9.

NOCIONET KRYESORE

Plani llogaritës
Korniza llogaritëse
Klasa
Llogaria sintetike
Llogaria analitike

PYETJE:

1. Pse ka nevojë për përdorimin e planit llogaritës?
2. Definoje planin llogaritës!
3. Numëroi qëllimet e planit llogaritës!
4. Cilat janë detyrat e planit llogaritës?
5. Në bazë të cilave parime përpilohet plani llogaritës?
6. Riprodhoi emërtimet e klasave të planit llogaritës!
7. Sqaroje përmbajtjen e klasës 0 dhe të gjitha të tjerave (shemb. grupe në suazat e klasës 0)!
8. Sqaroje emërtimin e klasës, grupit në të cilin takon dhe emërtimin e llogarisë për shifrat: 120, 220, 440, 310, 630 dhe 660!
9. Njohje se cilës klasë i takojnë llogaritë (shemb. cilës klasë dhe grupi i takojnë Ll/itë: Xhirollogari, Pajisje, Rezerva, Rezerva e materialeve, Mallra...) nëpërmjet organizimit të kuizit.

SHEMBUJ PËR PËRVETËSIMIN E PËRMBAJTJEVE TË KLASAVE

1. Me faturën nr. 23/1 është blerë një makinë nga furnizuesi për 150.000 den., me çka është krijuar obligim në atë shumë.
2. Janë blerë materiale për 14.000 den., por fatura nuk është paguar. Mbet obligimi që të paguhet.
3. Obligimet ndaj furnizuesve në vlerë prej 164.000 den. janë paguar.
4. Me shitjen e punimit, prodhimeve, janë pranuar 70.000 den, që paraqet hyrje e ndërmarrjes.
5. Nga materialet në rezervë pas kërkesës me nr.2 janë lëshuar në prodhimtari për 10.000 den.
6. Janë shitur prodhime sipas faturës me nr.10, për 30.000 den., me çka është krijuar kërkesë nga blerësit.
7. Janë paguar dënime për kundërvajtje ekonomike për 4.000 den.
8. Banka aprovon dhe transferon mjete në[emër të kredisë afatgjate për 170.000 den.

Ndryshime t të paraqiten në urdhëresë për evidentim me ç'rast të përdoren vetëm shifrat dhe emri i plotë i klasave sipas planit llogaritës

Tema 6: EVIDENTIMI I QARKULLIMIT PAGESOR DHE KËRKESAVE ME PARA NË DORË DHE JO NË DORË

PËRMBAJTJA E TEMËS:

Mjete parash

Evidentimi i mjeteve të parave
në arkë

Evidentimi i mjeteve të parave
në Xhirollogarinë

Mjete parash dhe akreditime
të veçuara

Llogaria devizore

Letra me vlerë

Kërkesa (fatura që duhet të
arkëtohen)

Kërkesa nga blerësit Kërkesa të tjera
nga raportet afariste

Qëllimet e mësimit:

Nxënësi:

-ta evidentojë qarkullimin pagesor me
para në dorë

-ta evidentojë qarkullimin pagesor pa
para në dorë

-ta definojë nocionin kërkesa;

-t'i klasifikojë llojet e kërkesave;

-t'i evidentojë kërkesat nga blerësit dhe
kërkesat tjera.

MJETE PARASHË

Në literaturën ekonomike dhe praktikën afariste mund të vërehet se mjeteve të parave u është kushtuar shumë hapësirë dhe kohë. Dhe është shumë logjike, pasi paratë, si faktorë për ekonomizim dhe në përgjithësi për jetë, përgjithmonë kanë paraqitur problem. gjatë sigurimit të tyre. Në fakt, parë nga këndvështrimi ekonomik, mjetet e parave e paraqesin qarkullimin e gjakut të shoqërive tregtare dhe janë pjesa më mobile e aktives të bilancit të gjendjes. Në ambientin afarist bashkëkohor, disponimi me mjete të mjaftueshme likuide është parakushti kryesor për mbijetesën afatgjatë dhe për rritjen e ndërmarrjes. Çdo ndërmarrje "e shëndoshë" në mënyrë financiare, doemos duhet të ketë në dispozicion kuantum të caktuar të mjeteve likuide. Likuiditeti paraqet aftësi e ndërmarrjes që t'i paguajë obligimet e veta në kohë. Pjesa më e madhe e obligimeve, gjatë tërë ciklit jetësor të ndërmarrjes doemos të paguhet me para në dorë, për të cilën arsye, mjetet e parave konsiderohen si mjete më likuide prej të gjithave. Kërkesat nga blerësit janë mjete më pak likuide në krahasim me mjete e parave për shkak se hyrja e mjeteve të parave është çdoherë e ndërlidhur me arkëtimin e tyre, e cila po, ndonjëherë di të jetë e pasigurt. Rezervat e prodhimeve mund të jenë mjete likuide, por akti i shitjes së tyre, pasiguria nga arkëtimi prej blerësve i largon rezervat prej mjeteve lartë likuide.

Likuiditeti paraqet aftësi që ndërmarrja t'i paguajë në kohë obligimet e veta.

Mjetet e parave konsiderohen si më likuide prej të gjitha mjeteve.

Mjetet e parave përfshijnë: monedha, bankënota, çeqe dhe para në depozitë në bankat të cilat janë në dispozicion për pagesën e obligimeve të ndërmarrjes. Sipas planit llogaritës mjete e parave janë ndarë në:

- 100- para në Xhirollogari
- 101- mjete të veçuara të parave
- 102- para në arkë
- 103- llogari devizore
- 104- akreditiva devizorë
- 105- arka revizore
- 107- mjete tjera të parave

EVIDENTIMI I MJETEVE TË PARAVE NË ARKË

Pjesa më e madhe e qarkullimit pagesor ndërmjet personave juridike sipas rregullit bëhet jo me para në dorë, me virman, nëpërmjet llogarive të transaksionit në bankat komerciale, pa praninë e parave në dorë (bankënotave). Pagesa e këtillë ka përparësitë e veta (do i mësojmë më vonë). Por, në praktikë, një pjesë më e vogël e pagesave dhe e pranimeve të mjeteve të parave bëhet nëpërmjet arkës në ndërmarrjen, me para në dorë ose si thuhet në mënyrë popullore **cash**. Për pagesat e këtilla ekziston arka - mjetet e parave në arkë.

Për shkak të sigurisë dhe kontrollit të pagesave me para në dorë, shuma maksimale e parave që lejohet të ruhet nëpër arkat, kasat, është rregulluar me rregull dhe emërtohet si **maksimumi i kasës ose i arkës**. Ky maksimum varet prej madhësisë së ndërmarrjes, llojit të veprimtarisë, distancës së ndërmarrjes prej bankës dhe është përcaktuar me rregulla ligjore.

Në firmat më të mëdha, kemi më shumë kasa, në rast të atillë duhet të ekzistojë një arkë (kasë) e cila është qendrore, kryesore. Për çdo pagesë duhet të formohet dokument. Dokumentet më të rëndësishme janë urdhëresat e kasave: „kasa të pranojë" dhe "kasa të paguajë", mandej fatura. (Prej arkës më së shpeshti paguhet avance për udhëtime zyrtare, shërbime në bazë të riparimeve të imta, furnizime dhe ngjashëm).

Manipulimi me mjetet e parave në arkë, respektivisht pagesat në dhe nga arka i janë besuar personit që njihet si kontabilist me cilësi morale dhe profesionale të veçanta. Kontabilisti është i obliguar që t'i bëjë pagesat nga dhe në arkë dhe çdo ditë të përpilojë raport për pagesat nga dhe në arkë të quajtur **raport i arkës (kasës)**.

Raporti i arkës jep pasqyrim të hollësishëm për të gjitha hyrjet dhe të dalat e mjeteve të parave nga arka e ndërmarrjes të cilat kanë ndodhur ditën e caktuar, me specifikim të hollësishëm të apoenave të bankënotave dhe monedhave që kanë mbetur në kasë, të cilat si saldo e kasës barten në ditën në vijim. **Specifikimi i apoenave** është listë e bankënotave prej të cilave përbëhet saldoja përfundimtare e raportit të kasës.

(Në angazhimin që të minimizohen mundësitë për keqpërdorimin e mjeteve të parave në arkë, tregu devizor i paguar përditë, duhet të deponohet në llogarinë e transaksionit të subjektit juridik). Me këtë në mënyrë të konsiderueshme reduktohet shuma e mjeteve të parave në arkë, me çka realisht zvogëlohet mundësia që kontabilisti të bjerë në sprovë, në kundërshtim me ligjin, t'i keqpërdorë dhe t'i shfrytëzojë mjetet e parave për nevoja personale. Raporti i arkës së bashku me dokumentet dorëzohet në kontabilitet për evidentim.

Shembull për përpilimin e raportit të arkës:

I. Kontabilisti i ndërmarrjes "Tehnoma", më 29.01.2009, ka bërë raport arke në bazë të dokumentacionit në vijim:

0. Saldo e gjetur nga dita paraprake më 28.01.2009 shuma prej 5.000 den.
1. Tërhequr nga llogaria e transaksionit për pagesa rrjedhëse nga arka 100.000 den. sipas fragmentit me nr. 789,
2. Paguar punëtorit MM në emër të avancës për udhëtim zyrtar sipas urdhëresës për udhëtim 254, 10.000 den.
3. Paguar sipas faturës me nr.222 për riparime të rregullta të instalimit të ujësjellësit 2.000 den.,
4. Paguar për qira për dhjetor 2008 sipas dëftesës me nr. 777 shuma prej 12.000 den.,
5. Paguar sipas faturës me nr.123 për shërbime transporti shuma prej 3.500 den.

Maksimumi i kasës ose i arkës paraqet shumën maksimale të parave që lejohet të ruhen në arkë.

Raporti për pagesat nga dhe në arkë quhet raporti i arkës (kasës). Shembull për përpilimin e raportit të arkës:

6. Pazari ditor i paguar nga shitorja sipas kasa të pranojë me nr. 13 shumë prej 50.000 den.

Të përpilohet raport arke dhe të regjistrohet në urdhëresë për regjistrim!

N r.	dokument		PËRSHKRIMI	shuma		Ll/ia
	Pran.	lëshuar		Pran.	lëshuar	
1	24	13	Sipas fragmentit nr.789 tërhequr	100.000	10.000	1009
2			Sipas urdhëresës për udhëtim me nr.254 avancë e dhënë			171
3			Sipas faturës me nr.222 paguar për riparime rrjedhëse			412
4			Sipas dëftesës nr. 777 qira e paguar			414
5			Sipas faturës me nr.123 paguar për shërbime transportuese			410
6	25	16	Sipas fragmentit me nr. 790 pazari ditor i futur	50.000		751
			Gjithsej qarkullimi	150.000	27.500	102
			Gjendja prej ditës paraprake	5.000		
			Gjithsej pranuar	155.000		
			Gjithsej lëshuar	27.500		
			Gjendja më 29.01	127.000		

Specifikimi i apoenave,
 100 copa prej 1.000 den.=100.000;
 20 copa prej 500 den. = 10.000;
 170 copa prej 100 den.= 17.000;
 Gjithsej = 127.000

Arkëtar

Kontabilist

Karakteristikat e Ll/isë Arka dhe rregulla te evidentimit: Ll/ia Arka (102) është llogari aktive në të cilën në anën e majtë – debitore, përveç gjendjes fillestare (saldos fillestare) evidentohen të gjitha rritjet, respektivisht hyrje dhe pagesa të mjeteve të mjeteve të gatshme të parave në arkë (si pazar ditor i futur, para të tërhequra nga Xhironlogaria për pagesa të rrjedhshme nga arka etj.). Në anën e djathtë – kreditore evidentohen të gjitha zvogëlimet ose derdhjet dhe pagesat e mjeteve të parave të gatshme (furnizime më të imta, avance për udhëtime zyrtare, dreka afariste, shërbime më të vogla etj.). Saldoja e Ll/isë Arka është pozitive, aktive, pasi rrjedh nga ana më e madhe e majtë dhe pasqyron sa para ka në arkë. Saldoja mund të jetë edhe zero që do të thotë se nuk ka para në kasë, por assesi nuk mund të jetë negative.

rregulla për evidentim

+	102-Ll/ia Arka	-
0. Gjendja fillestare 1. Rritje: - pagesa në - pagesa nga		2. Zvogëlimi: - pagesa - derdhja
(+)	=	(-)

Urdhëresa për evidentim nr.1

N r.	llogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		borxh (+)	kërkon (-)
1.	102	1009 751	Ll/ia Arka Ll/ia Konto kalimtare Ll/ia Hyrje nga shitja Paguar, sipas raportit të kasës nr.1	150.000	100.000 50.000
2.	171 412 414 410	102	Ll/ia Kërkesa nga të punësuarit për avans për udhëtim zyrtar Ll/ia Shërbime për mirëmbajtje dhe mbrojtje Ll/ia Qira-lizinë Ll/ia Shërbime transportuese Arka Paguar, sipas raportit të kasës me nr.	10.000 2.000 12.000 3.500	27.000
			Gjithsej	177.500	177.500

Në llogarinë 1009-Konto kalimtare, njëkohësisht evidentohet tërheqja dhe pagesa e parave të gatshme në llogarinë e transaksionit të subjektit juridik. Për shembull, nëse tërhiqen para nga llogaria e transaksionit dhe ditën e njëjtë futen paratë në arkë, dokumenti kontabilist në arkën ekziston (raporti i kasës) por dokumenti (fragmenti nga banka) për ndryshimet e llogarisë së transaksionit merret ditën e ardhshme. Gjatë asaj kohe, ky ndryshim afarist do të evidentohet në 1009-Konto kalimtare (102/1009). Saldoja e 1009-Ll/ia Konto kalimtare, mund të qëndrojë një kohë të shkurtër (një ose dy ditë) derisa të merret dokumenti fragmenti nga banka. Me evidentimin e fragmentit, llogaria kalimtare -1009 mbyllet me Xhirollogarinë-1000.

Gjatë evidentimit të dokumentit PP-10, për ndryshimin ndërmjet gjendjes së kasës dhe Xhirollogarisë, do të paraqiten dy dokumente raporti i kasës dhe raporti i bankës. Që mos paraqiten evidentime të dyfishta, në arkën dhe në Xhirollogarinë, rregulla është: Gjatë evidentimit të fragmentit nga banka, përdoret llogaria 100-Ll/ia Xhirollogari me kundër llogari 1009-Ll/ia Llogaria kalimtare (100/1009 për Pazar ditor të paguar).

Shembuj për ushtrim:

I. Në bazë të të dhënave në vijim, duhet të përmbushen urdhëresat për arkën edhe atë:

a. Për “Arka të pranojë”,

1. Nr. i arkës të pranojë 456
2. Pranuar nga Mitre Mitreski nga Koçani rr. Goce Dellçev nr. 30
3. Shumën prej 20.000 den.
4. Në llogari të ndërmarrjes “Plastika” Veles
5. Qëllimi i pranimi: arkëtimi i kompensimit për shkurtimin e materialeve
6. Data e pranimi të parave 26.12.2009

6. Për “kasa të pranojë”

1. Paguar punëtorit Biljana Risteska nga Velesi rr. Mara Ugrinova nr 555.
2. Shuma prej 35.000 den.
3. Në llogari të “Plastika” Veles
4. Qëllimi i pagesës: udhëtim zyrtar
5. Pagesa është bërë më 26.12.2009
6. Nr. Kasës t’i paguajë: 370

Të bëhet raport i arkës në bazë të urdhëresave paraprahe nëse saldoja e arkës prej ditës paraprahe ka qenë 30.000 den.

Raporti i arkës të kontohet në urdhëresën për evidentim!

II. Në bazë të të dhënave në vijim, duhet të përmbushet dokumenti “llogaria rrugore”

1. Data e nisjes 24.01.2009 në ora 8
2. Dita e kthimit 29.01.2009 në ora 16
3. Mëditje për llogariten nga 1000 den.

III. Në bazë të të dhënave në vijim duhet të përmbushet dokumenti “faturë”

1. Material i furnizuar për zyra 5 topa letër me çmim prej 200 den. .për një më 29.01.2009

2. Toner 1 çmimi 1.500 den

3. Prej librarisë “Kultura”,

4. Për SHMK “Jovçe Tesliçkov”

Të paguhen llogaria e rrugës dhe fatura nga kasa

Të bëhet raporti i arkës më 29.01.2009 nëse paraprakisht

Saldo në arkën ka qenë 10.000 den.

Raporti i arkës të evidentohet në urdhëresën për evidentim!

IV. Të përpilohet raporti i arkës në ditën 24.01.2009, të regjistrohet në urdhëresë për evidentim të hapet Ll/i rrjedhëse në Ll/inë Arka në (102) nëse saldoja prej 01.2009 është 10.000 den.

1. Qira e paguar sipas dëftesës me nr.6, 6.000 den,

2. Paguar sipas faturës numër 5 për furnizimin e materialit 1000,

3. Para të pranuar nga shitja e mallrave nëpërmjet shitores, 20.000 den. me kasa të pranojë

4. Sipas urdhëresës për udhëtim, avancë e paguar për udhëtim zyrtar të personit NN, 5.000 nga kasa,

5. Me kasa të paguajë janë paguar shpenzimet për ujë 2.000 den,

6. Me faturën nr. 6 është blerë lëndë djegëse dhe vaj për 1000 den,

7. Është blerë material për pastrimin e hapësirave të punës dhe menjëherë është dhënë për shpenzim sipas kasa të paguajë 2.000 den.

EVIDENTIMI I MJETEVE TË PARAVE NË XHIROLLOGARINË

Ndërmarrjet janë të obliguara që pagesat e veta të mjeteve të parave t'i bëjnë jo me para në dorë, respektivisht pa transferimin fizik të mjeteve të parave. Në përputhje me rregullat pozitive ligjore, ndërmarrjet duhet mjetet e lira të parave t'i ruajnë në llogari të veçantë, gjegjësisht llogari të transaksionit të subjektit juridik, të hapur në ndonjërin prej bankave afariste. Një ndërmarrje mund të hapë më shumë se një llogari transaksioni në banka të ndryshme afariste.

Pagesa e mjeteve të parave nëpërmjet llogarisë së transaksionit bëhet me anë të lëshimit të *urdhëresave me virman*, që i nënshkruajnë persona të autorizuar nga ndërmarrja. Këto persona doemos duhet të kenë nënshkrime të deponuara në bankë, nëpunësit e së cilës janë të obliguar ta kontrollojnë autenticitetin e nënshkrimit të personit të autorizuar në çdo urdhëresë për pagesë, që do të parashtrohet nga ana e ndërmarrjes.

Ndërmarrjet janë të obliguara që pagesat e veta të mjeteve të parave t'i bëjnë jo me para në dorë, respektivisht pa transferimin fizik të mjeteve të parave.

Qarkullimi ditor e paraqet shumën e përgjithshme të mjeteve të gatshme të parave të fituara nëpërmjet shitjes së mallrave që bëhet nëpërmjet shitores.

Ndërmarrjet janë të obliguara që pagesat e mjeteve të parave t'i bëjnë pa para të gatshme, respektivisht pa transferim fizik të mjeteve të parave. Qarkullimi ditor paraqet shumë të përgjithshme të mjeteve të gatshme të parave të bëra nga shitja e mallrave që bëhet nëpërmjet shitores. Hyrja e parave në një llogari transaksioni vjen nga pagesat nga ana e blerësve në bazë të shitjes, kredive të pranuara, qarkullimit ditor të futur nga arka dhe ungj. **Qarkullimi ditor** paraqet shumën e përgjithshme të mjeteve të gatshme të parave të fituara nga shitja e mallrave që bëhet nëpërmjet shitores. Mjetet e parave të fituara në këtë mënyrë grumbullohen nga të gjitha shitoret në arkën e ndërmarrjes, mandej futen në llogarinë e transaksionit. Pagesat nga llogaria e transaksionit bëhen për pagesën e obligimeve ndaj furnizuesve, kompensimit të obligimeve të ndryshme ndaj shtetit, për pagesën e rrogës së punëtorëve, pagesës së kredive dhe ngjashëm. *Banka, për ndryshimet e gjendjes së llogarisë transaksione, çdo ditë kur ka ndryshime të llogarisë së transaksionit përpilon fragment ditor.* Ky fragment, së bashku me kopjen e urdhëresave për pagesë në dhe prej dërgohet në ndërmarrjen me ç'rast ajo informohet për të gjitha ndryshimet në llogarinë e vet të transaksionit. Njëkohësisht, fragmenti ditor shërben si dokument për evidentim në barrë dhe në dobi të llogarisë së transaksionit të ndërmarrjes. **Karakteristikat e Ll/isë Xhirollogari dhe rregullat për evidentim:**



Banka përpilon fragment ditor të bankës

Rregullat e evidentimit.

Evidentimi i ndryshimeve të llogarisë së transaksionit në ndonjë bankë afariste në kontabilitetin financiar bëhet sipas planit llogaritës të Ll/isë Xhirollogari. **Ll/ia Xhirollogari** (100) është llogari aktive e cila është në anën e majtë, përkaj gjendjes fillestare (saldoja fillestare) evidentohen të gjitha rritjet respektivisht hyrjet dhe pagesat e mjeteve të parave nga ana e blerësve në bazë të shitjes, kredive të marra, qarkullimit të futur ditor nga arka dhe ngj. në llogarinë e transaksionit. Në anën e djathtë – kreditore, evidentohen të gjitha zvogëlimet ose derdhjet dhe pagesat për pagimin e obligimeve ndaj furnizuesve, kompensimin e obligimeve të ndryshme ndaj shtetit, për pagimin e rrogës së punëtorëve, pagesën e kredive dhe ngj. Saldoja e Ll/isë Xhirollogaria është pozitive, aktive për shkak se rrjedh nga ana e majtë më e madhe dhe tregon se sa para ka shoqëria tregtare në llogarinë e transaksionit. Saldoja mund të jetë edhe zero në rast të bllokimit nga bankat komerciale për shkak të mos pasjes së mjeteve për kompensimin e obligimeve të arritura, që do të thotë se nuk ka para në llogarinë e transaksionit, por assesi nuk mund të jetë negative.

+	100-Ll/ia Xhirollogari	-
0. Gjendja fillestare		2. Zvogëlimi
1. Zmadhimi:		- pagesat nga
- pagesa në		- derdhja.
- pagesa nga		
(+)	≠	(-)

1. Shembull për evidentimin e pagesave nga dhe në Ll/inë Xhirollogari: Më 12.12.2009, SHA Stopanska bank ka përpiluar fragment ditor me nr.154 për ndërmarrjen “IMAKO”,

0. Saldoja paraprake 560.000

1. Pagesa nga ana e blerësit “Monting”, 130.000 den.

2. Rroga të paguara për muajin e 11-të 50.000 den.

3. Paguar furnizuesit “Makremont”, 120.000 den.

4. Përshkruar nga llogaria e transaksionit 200.000 den. nga kredia afatgjate e aprovuar nga Stopanska banka.

Ndërmarrja IMAKO duhet që fragmentin ditor nga banka ta evidentojë në urdhëresë për evidentim!

N. r.	llogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
1.	100	120	Ll/ia Xhirollogari	330.000	
		281	Ll/ia Kërkesa nga blerësit vendor		130.000
2.	271	100	Ll/ia Obligime afatgjata në bazë të huave dhe kredive	50.000	200.000
			Paguar sipas fragmentit nr. 154		
	220		Ll/ia Rroga neto	120.000	170.000
			Ll/ia Obligime: ndaj furnizuesit në vend		
			Ll/ia Xhirollogari paguar sipas fragmentit nr 154		
			Gjithsej	500.000	500.000

Të hapet llogari T” e llogarisë 100-Xhirollogari

2. Shembull për përmbushjen e urdhëresës për transfer

Firma e cila paguan - “KOMUNA” SHA Skopje në rr. Pero Nakov nr.55, Deponent i Stopanska banka, nr. i llogarisë transaksione 2100603454621, qëllimi i udhëzimit: pagesa e faturës nr. 444, emri i firmës pranuese: “OHIS”, Shkup, deponues i Tutunska banka, nr. i llogarisë së transaksionit 2100603321560, shuma prej 250.000 den.

Të përpilohet urdhëresë për transferim!

Është pranuar fragment nga banka nga i cili shihet se banka e ka realizuar urdhëresën, gjegjësisht se furnizuesit “OHIS” nga llogaria e transaksionit i është paguar obligimi prej 250.000 den.

Të evidentohet fragmenti në urdhëresë për evidentim dhe në librin kryesor.

3. Më 25.01.2009, Kontabilisti i ndërmarrjes “IMAKO”, ka tërhequr nga llogaria e transaksionit 24.000 den. Me çek nr. 123456 për pagesat rrjedhëse nga arka dhe mjetet i ka futur në arkë sipas raportit të arkës me nr.777.

Më 26.01.2009 është pranuar fragment nga Stopanska banka nga i cili shihet se janë tërhequr 24.000 den. Për nevojat e arkës.

Ndërmarrjet, për punë më të suksesshme prej mjeteve të llogarisë së transaksionit munden a në raste të caktuara janë të obliguar të veçojnë mjete parash në llogari të veçanta

Ndërmarrjet, për punë më të suksesshme nga mjetet e llogarisë së transaksionit munden a në raste të caktuara janë edhe të obliguara të ndajnë mjete parash në llogari të veçanta.

MJETE PARASHË TË VEÇUARA DHE AKREDITIVA

Ndërmarrjet, për punë më të suksesshme nga mjetet e llogarisë së transaksionit munden a në raste të caktuara janë edhe të obliguara të ndajnë mjete parash në llogari të veçanta. Mjetet e veçuara janë me destinim të caktuar dhe për atë qëllim edhe shfrytëzohen. Nga mjetet e parave në llogarinë e transaksionit, ndërmarrja mund të veçojë mjete për investime, për pagimin e çeqeve të lëshuar, për pagesën e doganave, për hapjen e akreditivave dhe për qëllime të tjera. Këto mjete parash i evidentojnë në llogari të veçanta në suazat e llogarisë sintetike 101-Mjete parash të veçuara dhe akreditiva. Për evidencë më të pasqyrueshme në suazat e kësaj llogarie themelore hapen llogari analitike dhe subanalitike.

Gjithashtu, nga mjetet e lira të parave në llogarinë e transaksionit, me kërkesë të furnizuesit ndërmarrja mund të hapë akreditiv dokumentar në valutë vendore. Akreditivi i hapur, në këtë rast shërben si garanci për furnizuesin se shuma e obligimit do të paguhet menjëherë pas prezantimit të dokumenteve nga ana e tij, me të cilat vërtetohet se e ka dorëzuar të parashikuarën me kontratën (materiale, mallra, inventar i imët dhe ngjashëm). Duke e marrë parasysh faktin se shfrytëzimi i mjeteve nga akreditivi i hapur është ndërlidhur me prezantimin e dokumenteve nga ana e furnizuesit në bankën, e cila menjëherë pastaj e realizon transferimin e mjeteve të parave nga akreditivi në llogarinë e furnizuesit, ky akreditiv njihet si akreditiv dokumentar.

Rregullat e evidentimit:

Veçimi në njëfarë mënyrë paraqet rritje të mjeteve dhe evidentohet në anën pozitive të llogarisë 101- Mjete parash të veçuara dhe akreditiva, ndërsa në anën negative të llogarisë 101- Xhirollogaria evidentohet si zvogëlim i parave nga kjo llogari. Gjatë shfrytëzimit të këtyre mjeteve, që zakonisht

Rregullat e evidentimit

do të thotë pagesë, evidentohen në anën pozitive të llogarive përkatëse nga klasa 2-Obligime..., ndërsa në anën negative të llogarisë 101-Mjete parash të veçuara dhe akreditiva. Nëse mjetet e veçuara të parave mbesin të pa harxhuara, kthehen në llogarinë e rregullt dhe zbatohet evidentimi i cili është i kundërt nga evidentimi gjatë veçimit.

Shembuj:

1. Më 15 janar për nevojat për furnizimin e një automjeti të lehtë ndërmarrja “Maktrejd” ka veçuar nga mjetet e parave në llogarinë e transaksionit sipas fragmentit nr.18 shuma prej 300.000 den. në llogari të veçantë.

2. Më 25 janar, nga mjetet e parave në llogarinë e transaksionit sipas fragmentit nr.19 janë veçuar 140.000 den. për pagesën e doganave.

3. Më 28 janar është pranuar fragmenti nga banka nr.20 nga i cili shihet se nga mjetet e parave të veçuara për pagesën e doganave është paguar dogana në shumë prej 120.000 den. ndërsa mbetja prej 20.000 den. është kthyer në llogarinë e transaksionit.

4 Më 4 shkurt, ndërmarrja “Maktrejd”, në lidhje me furnizimin e materialeve nga furnizuesi “Biljana”, Ohër i ka dhënë urdhëresë bankës të hapë akreditiv dokumentar në shumë prej 150.000 den. Banka, me fragmentin nr. 21 prej më 4 shkurt njofton se i ka hapur akreditiv furnizuesit në shumë prej 150.000 den. Pas furnizimit të bërë, më saktë më 20 shkurt me fragmentin me nr..22 banka njofton se furnizuesi “Biljana” e ka shfrytëzuar akreditivin në lartësi prej 120.000 den. ndërsa mbetja prej 30.000 den. është kthyer në llogarinë e transaksionit. Të evidentohen ngjarjet në urdhëresën!

Urdhëresa për evidentim

N. r.	llogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
1.	1010	100	Ll/ia Mjete parash të veçuara për investim në PSS Ll/ia Xhirollogari mjete parash të veçuara fragmenti nr. 18	300.000	300.000
2.	1012	100	Ll/ia Mjete par. të veç. për pagesën e doganave Ll/ia Xhirollogari mjete parash të veçuara fragmenti nr. 19	140.000	140.000
3.	265	1012	Ll/ia Obligime për pagesën e doganave dhe detyrimeve doganore të tjera	120.000	140.000
	100		Ll/ia Xhirollogari Ll/ia Mjete par. të veç. për pagesën e doganave dogana e paguar dhe para të kthyera sipas fragmentit nr.20	20.000	
4.	1015	100	Ll/ia Akreditiva të hapur në vend Ll/ia Xhirollogari Dokument i hapur për akred. sipas frag. me nr.21	150.000	150.000
4a.	220	1015	Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve në vend	120.000	150.000
	100		Ll/ia Xhirollogaria Ll/ia Akreditiva të hapur në vendin paguar furnizuesve me akreditiv dhe para të kthyera sipas fragmentit me nr. 22	30.000	
			Gjithsej	880.000	880.000

LLOGARIA DEVIZORE

Me nocionin llogari devizore nënkuptohen mjete parash efektive të huaja (valuta) si edhe kërkesa në para të huaja.

Nën llogarinë devizore nënkuptohen mjete parash efektive të huaja (valuta) si edhe kërkesat në para të huaja. Në praktikë, për shprehjen e të dy nocioneve, në mënyrë popullore përdoret nocioni deviza. Për transaksionet afariste me partnerët e huaj, ndërmarrja duhet të disponojë me para të huaja për pagesë.

Përfitimi i këtyre mjeteve të parave mund të jetë me: eksportin e prodhimeve, mallrave, si e dhe kryerjen e shërbimeve në tregjet e huaja dhe me furnizimin (blerjen) e devizave në tregun revizor në vend. Përfitimi dhe shfrytëzimi i të njëjtave shkakton ndryshime të ky lloji i mjeteve të parave të cilat gjejnë vend në evidencën.

Për evidentimin e mjeteve revizore të ndërmarrjes në planin llogaritës janë parashikuar kontot sintetike të obligueshme në vijim:

103- Llogaria devizore

104- Akreditiva devizore

105- Arka devizore

Në çdo ndërmarrje, në suazat e këtyre llogarive sintetike mund të hapen llogari analitike dhe për çdo lloj të mjeteve të huaja për pagim. Në kontabilitetin e ndërmarrjes evidentohet kundërvlera e devizave në denarë.

Mjetet devizore shfrytëzohen për furnizimin e mallrave, materialeve, pajisjes nga jashtë për hapjen e akreditivave për furnizuesit e huaj dhe ngjashme.

Si dokumentacion për evidentim shërbejnë faturat për prodhimet e shitura (eksportuara), shërbimet, faturat e pranuar nga furnizuesit e huaj për furnizimin e pajisjes, materiale dhe ngjashme; fragmentet nga banka për devizat e paguara nga blerësit e huaj, fragmentet nga banka, hapja e akreditivave, raportet nga arka devizore dhe ngjashme.

Rregulla për evidentim:

Kur furnizohen mjetet devizore me blerje në tregun devizor në vend,

fillimisht evidentohen mjetet e veçuara në denarë në anën pozitive (debitore) nga llogaria **1075-LI/ia Mjete parash te banka për furnizimin e devizave**, ndërsa në anën negative (kreditore) të llogarisë **100-LI/ia Xhirollogaria**. Mjetet e blera devizore transferohen në llogarinë devizore me ç' rast evidentohet në anën pozitive (debitore) të llogarisë **103-LI/ia Llogari devizore** si rritje e tyre, ndërsa në



Mjete parash devizore

anën negative (kreditore) nga llogaria **1075-LI/ia Mjete parash te banka për furnizimin e devizave** si zvogëlim i tyre. Nëse mjetet devizore fitohen me eksportim, ndërsa nëpërmjet arkëtimit të kërkesave nga jashtë evidentohen në anën pozitive (debitore) nga llogaria **103-LI/ia Llogari revizore** a në anën negative (kreditore) të llogarisë **121-LI/ia Kërkesa nga blerësit e huaj**.

Kur mjetet devizore përdoren për hapjen e akreditivave devizore, evidentohen në anën pozitive të llogarisë **104-LI/ia Akreditiva devizore** ndërsa në anën negative të llogarisë **103-LI/ia Llogari revizore**. Nëse në çastin e hapjes së akreditivit kursi devizor është zmadhuar, dallimi është pozitiv dhe paraqitet si hyrje dhe evidentohet në anën negative të llogarisë **765 - LI/ia**.

Si dokumentacion për evidentim shërbejnë:
-faturat për prodhimet sipas fragmenteve, shërbimeve, faturat e pranuar nga furnizuesit e huaj për furnizimin e pajisjes, materialeve dhe ngjashme,
- fragmentet nga banka për devizat e paguara nga blerësit e huaj,
-fragmentet nga banka për hapjen e akreditivave
-raportet nga arka revizore dhe ngj. Mjete parash devizore

Rregulla për evidentim

Hyrje në bazë të kamatave, dallimeve të kursit dhe të ngjashme.

Por nëse në çastin e hapjes së akreditivit kursi është zvogëluar paraqitet dallim negativ i kursit i cili si rritje e të dalave evidentohet në anën pozitive të llogarisë **485-LI/ia Dallime të kursit nga puna me subjektet e pa ndërlidhura**

Shembuj:

1. Ndërmarrja ka nevojë për mjete revizore dhe për atë qëllim veçon 60.000 den. Njëkohësisht, i jep urdhëresë bankës për furnizimin e 1.000 eurove. Banka me fragment e njofton ndërmarrjen se ka furnizuar 1.000 euro (1€=60den.) dhe i ka evidentuar në llogarinë devizore. Bankës i është dhënë urdhëresë të hapë akreditiv për furnizuesin e huaj prej 1.000 € llogaritur nga 1€=60den. Banka informon se akreditivi është i hapur. Nga banka është pranuar njoftim se nga akreditivi i hapur devizor furnizuesi i huaj ka përfituar 1.000 €. Me urdhëresë të ndërmarrjes bëhet mbyllja e akreditivit jashtë.

2. Prej mjeteve devizore në llogarinë devizore për nevojat e arkës devizore janë tërhequr 500 € (1€=61den.). Nga arka revizore, personit NN i janë paguar 500 € (1€=61den.) për udhëtim zyrtar në vend të huaj.

Urdhëresa për evidentim

N. r.	llogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
1.	1075	100	për furnizimin e devizave Ll/ia Xhirollogari mjete parash të veçuara për furnizimin e devizave	60.000	60.000
1a.	103	1075	Ll/ia Llogari devizore Ll/ia Mjete parash te banka për furnizimin e devizave të blera 1.000 euro nga 60den. për 1€	60.000	60.000
16.	104	103	Ll/ia Akreditiva devizorë Ll/ia Llogari devizore akreditiv i hapur devizor	60.000	60.000
1b.	221	104	Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve jashtë Ll/ia Akreditiva devizorë akreditiv devizor i shfrytëzuar	60.000	60.000
2.	105	103	Ll/ia Arka devizore Ll/ia Llogari devizore Tërhequr për arkën devizore	30.500	30.500
2a.	1711	105	Ll/ia Kërk. nga të punës. për avance për udhëtime zyrtare jashtë vendit Ll/ia Arka devizore avancë e dhënë në deviza	30.500	30.500
			Gjithsej	301.000	301.000

Për ushtrim:

- Ndërmarrja ka nevojë për mjete devizore dhe për këtë qëllim veçon në konton e veçantë për furnizimin e devizave 500.000 den. Njëkohësisht, i jep urdhëresë bankës të furnizojë 7.000 EUR. Banka me fragmentin nr. 556 e njofton ndërmarrjen se ka furnizuar 7.000 EUR dhe i ka evidentuar në llogarinë devizore me kurs prej 61.5 den për 1 euro.
- Me fragmentin nr. 557 banka njofton se blerësi nga Gjermania i cili ka pas borxh 2.000 EUR i ka bërë në llogarinë devizore llogaritur sipas kursit 61.5 den për 1 euro.
- Për punë investuese të realizuara në Afganistan, investuesi ka udhëzuar në llogarinë tonë devizore 3.000 dollarë Këto mjete kanë pasur kundërvlerë në denarë atë ditë 140.000 den.

LETRAT ME VLERË

Në qarkullimin pagesor, përveç parave në dorë janë të pranishme edhe letrat me vlerë si çequet, kambialet, obligacionet etj.

Në qarkullimin pagesor, përveç parave të gatshme janë të pranishme edhe letrat me vlerë si çequet, kambialet, obligacionet etj. Ato kanë afat të shkurtër të arritjes ose ruhen për tregti. Me to mund të bëhet pagesa gjegjësisht ato mund të eskontohen dhe me këtë të përdoren si mjete qarkulluese pa vështirësi më të mëdha

Çeku është urdhëresë për pagesë- letër me vlerë të cilën e lëshon debitori (trasanti) te banka (trasati) për shumën në të cilën thirret çeku, ajo e bën transferimin e mjeteve të parave të debitorit në dobi të llogarisë së transaksionit të kreditorit (remitentit). Trasanti çekun ja dorëzon remitentit i cili brenda afatit prej 8 ditësh ose 15 ditësh e parashtron për arkëtim. Afati prej 8 ditësh, nëse vendi i lëshimit është njëkohësisht edhe vendi i pagimit, ndërsa nëse nuk është njësoj atëherë afati është 15 ditë. Çeku parashtrohet së bashku me dokumentacionin shoqërues. Banka e kontrollon korrektësinë dhe nëse çdo gjë është sipas rregullave, remitenti e realizon të drejtën respektivisht e arkëton çekun. Nëse debitori nuk ka para në llogari, kërkohet arkëtim me anë gjyqësore ndërsa çeku i atillë mbet i protestuar.



Çeku



Kambiali

Kambiali si instrument për sigurimin e pagesës dhe instrument i pagesës (kur të drejtat nga ai kambial barten, barten- prej një personi në tjetër), nuk është asgjë tjetër përveç dokument me shkrim – letër me vlerë, me të cilën lëshuesi i kambialit – trasanti jep urdhëresë që shuma e shënuar në kambialin t'i paguhet remitentit – kreditorit. Këto kambiale janë çdoherë të valuara nga banka ose nga ndonjë organizatë tjetër me qëllim që në rast se brenda afatit të arritjes, shuma sipas kambialit nuk mund të paguhet nga mjetet e parave nga banka e trasantit (debitorit kryesor), kjo do të bëhet nga mjetet e parave nga banka e analistit (garantit të atij kambiali). Kambialin e valuar debitori (trasanti i cili njëkohësisht është edhe trasat pasi këto kambiale janë kambial personal, kambial të trasuar), ia dorëzon remitentit (kreditorit) për sigurimin e pagesës në bazë të mallrave të realizuar, shërbimeve dhe ngj. Afati i arritjes së këtyre kambialeve nuk mund të jetë më i gjatë se 90 ditë prej ditës së krijimit të raportit debitor - kreditor. Më së voni nga ai afat remitenti (në rast se në këtë afat nuk e ka kontuar ose indosar), gjegjësisht eskorteri (banka që e ka blerë kambialin) ose indosatori (personi të cilit i është bartur kambiali), kambiali së bashku me dokumentacionin tjetër (urdhëresa për pagesë dhe letra shoqëruese) e dorëzon për arkëtim në bankën për të cilën kambiali është domiciluar (banka në të cilën trasanti ka llogari). Pas kontrollit të bërë për korrektësinë, banka e bën transferimin e shumës së shënuar sipas kambialit nga llogaria e transaksionit dhe llogaritë tjera të trasantit ose avalistit në rast se trasanti nuk ka para ose nuk ka mjaft në dobi të llogarisë së transaksionit

të remitentit gjegjësisht llogarinë e transaksionit të eskontuesit ose indosatorit. Në rast se nuk mund të bëhet arkëtimi i eskontuesit sipas kambialit, banka bën protestimin në gjykatën kompetente. Sipas planit llogaritës për evidentimin e letrave me vlerë, janë rezervuar llogari nga grupi 11 – Letra me vlerë, ndërsa në suazat në të llogaritë themelore:

110- Çeqet

111- Kambialet

112- Obligacionet

113- Shkresat

117-Letra tjera me vlerë

119-Harmonizimi i vlerave të letrave me vlerë

Në llogaritë e përmendura bëhen regjistrimet e ndërlidhura me letrat me vlerë.

Evidentimet që kanë të bëjnë me kambialin si letra me vlerë më e aplikuar janë:

1. Në anën pozitive të llogarisë 1110-Kambialet të pranuar për sigurimin e arkëtitimit të kërkesave në vend, do të evidentohet shuma nominale e kambialit ndërsa në anën negative të llogarisë 120 -Kërkesa nga blerësit në vend për shumën e kërkesës pagesa e së cilës sigurohet me kambial, në anën negative të llogarisë 292- Hyrje të llogaritura paraprakisht evidentohet kamata.
2. Zbatohet evidentimi i kambialeve të dhënë për arkëtim edhe atë në anën pozitive të llogarisë 1113-Kambialet të dhëna për arkëtim ndërsa në anën negative të llogarisë 1110- Kambialet të pranuar për sigurimin e arkëtitimit të kërkesave.
3. Evidentohet arkëtimi i kambialeve të dorëzuara për arkëtim me ngarkim të llogarisë 100-Xhirollogari ndërsa për aprovim në llogarinë 1113-Kambialet të dhëna për arkëtim Kamata pas kambialit të pranuar dhe tani të arkëtuar bartet si hyrje me mbylljen e llogarisë 292-Hyrje të llogaritura paraprakisht e me aprovim të llogarisë hyrëse 765- Hyrje në bazë të kamatës.

Shembull për evidentim.

1. Për prodhimet e blera, blerësi sipas marrëveshjes jep kambial për sigurimin e arkëtitimit me shumë nominale prej 200.000 den, ndërsa kërkesa arkëtimi i së cilës sigurohet është 80.000. Në afatin ligjor kambiali është parashtruar për arkëtim dhe është arkëtuar.



Rregulla për evidentim

N. r.	llogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
1	1110		Ll/ia Kambiale të pranuar për sigurimin e arkëtimit të kërkesave në vend	200 000	
		120	Ll/ia Kërkesa nga blerësit në vend		180 000
		292	Ll/ia Hyrje të llogaritura paraprakisht kambiale pranuar		20 000
1a	1113		Ll/ia Kambiale të dhëna për arkëtim	200 000	
		1110	Ll/ia Kambiale të pranuar për sigurimin e arkëtimit të kërkesave në vend kambial i dorëzuar për arkëtim		200 000
			Ll/ia Xhirollogari Ll/ia Kambiale të dhëna për arkëtim kambial i arkëtuar		
16	100		Ll/ia Hyrje të llogaritura paraprakisht	200 000	
		1113	Ll/ia Hyrje në bazë të kamatës Hyrje të bartura		200 000
1B	292			20 000	
		765			20 000
			Gjithsej	620 000	620 000

KËRKESAT (LLOGARI TË CILAT DUHET TË ARKËTOHEN)



Kërkesat - llogari të cilat duhet të Arkëtohen)

Ndërmarrjet, për mjetet e veta të dhëna ose të lëshuara personave tjerë juridik ose fizik, fitojnë të drejtë në lartësi të atyre mjeteve në formë të kërkesës. Këto kërkesa mund të krijohen në bazë të shitjes së prodhimeve dhe mallrave, depozitave të dhënë, kërkesat nga të punësuarit, kërkesa nga avancat e dhëna për udhëtime zyrtare, kërkesa nga kambialet e pranuar, kërkesa nga shteti dhe institucione tjera, të cilat duhet të arkëtohen dhe kërkesa të tjera nga puna. Kërkesat janë mjete

edhe atë mjete qarkulluese (rrjedhëse) në formë kalimtare dhe karakteri i tillë është i kufizuar me kohë.

KËRKESAT NGA BLERËSIT

Kërkesat nga blerësit janë forma më masovike e kërkesave a përfitohen në bazë të shitjes së prodhimeve, mallrave, shërbimeve, materialeve, mjeteve të përhershme. Këto shitje mund të jenë në tregjet e vendit dhe jashtë, andaj edhe kërkesat mund të jenë nga blerësit e vendit dhe nga jashtë.

Kërkesa nga blerësi krijohet për shkak se blerësi nuk paguan menjëherë gjatë shitjes me para të gatshme, por blerësit i është shitur me pritje (në konto të hapur) ose me kredi me instrumente formale për kredi (kontratë ose deklarata për kthimin kredisë). Kur ndërmarrja i ka shitur prodhime, mallra dhe ngjashëm ndërmarrjes tjetër me pritje, në vend që të përfitojë para, do të përfitojë kërkesë. Për prodhimet ose mallrat e shitur blerësit i dërgohet dokument faturë. Fatura shërben si dokument për evidentimin e shitjes. Kërkesat nga blerësit në kontabilitetin zyrtar evidentohen në **grupin 12-Kërkesa nga blerësit**. Ky grup në planin llogaritës është ndarë në llogari të obligueshme:

120- Kërkesa nga blerësit në vend

121- Kërkesa nga blerësit nga jashtë

129-Harmonizimi i vlerave të kërkesave të blerësve

Rregullat për evidentim dhe karakteristikat e llogarisë.

Kërkesa nga blerësit: Kur blerësve u është shitur rriten kërkesat nga blerësit dhe evidentohet në anën pozitive të llogarisë.

Kërkesa nga blerësit. Kur blerësi do të paguajë kërkesa prej tij zvogëlohet dhe evidentohet në anën negative të llogarisë.

Kërkesa nga blerësit. Saldoja e llogarisë kërkesa nga blerësit sipas rregullit

Kërkesa nga blerësi lind për shkak se blerësi nuk paguan menjëherë gjatë shitjes por blerësit i është shitur me pritje.

Rregullat për evidentim

çdoherë është debitore (pozitive) dhe tregon se edhe sa duhet të paguajnë blerësit, prandaj këto konto në praktikë njihen si “llogari që duhet të arkëtohen”. Nëse ndodh që llogaritë përmendura paraprkasht të kenë saldo kreditore, atëherë nuk duhet të kompensohet me saldo debitore nga llogaritë tjera. Llogaria, gjegjësisht llogaritë me saldo kreditore paraqiten në pasiven e bilancit të gjendjes, për shkak se ato nuk janë mjet as formë kalimtare e mjetit – kërkesë, por janë obligim i ndërmarrjes ndaj blerësit konkret dhe këto mjete duhet t’ia kthejë ose kompensojë (rikujtim për karakterin e llogarisë aktive - pasive).

Shembuj:

1. Më 03.01 Ndërmarrja “Mobiglob”, nga Shkupi, sipas faturës me nr.125 ka shitur mall në vlerë prej 900.000den. tel. cel.100 nga 9.000 den. për një blerësit “Nova moda” Shumës i shtohet +18% TVSH. Çmimi i furnizimit si janë udhëhequr këto mallra në rezervë ka qenë 750.000 den.
2. Më 07.01, është marrë fragment nga banka në të cilin shihet se blerësi “Slloboda” e ka paguar në llogarinë e transaksionit “Mobiglob” shumën që e ka borxh në tërësi.
3. Sipas faturës me nr.785 i janë shitur blerësit prodhime të gatshme në vlerë prej 40.000 den. Vlerës së faturës i shtohet + 18% TVSH. Çmimi i koston sipas të cilit janë udhëhequr prodhimet e gatshme në rezervë ka qenë 30.000 den. Brenda afatit të kontraktuar është marrë fragment me nr. 444 nga i cili shihet se blerësi e ka paguar shumën që e ka borxh prej 47.200 den. në llogarinë e transaksionit.
4. Më 15.01 blerësit i është dërguar faturë nga Anglia për prodhime të gatshme të shitura 1.500 pallto për meshkuj me çmim prej 50 € për një dhe 1.500 pallto për femra me çmim prej 80 € për një.
5. Më 20.01. është pranuar fragment nga banka nga i cili shihet se blerësi i huaj nga Anglia ka paguar në llogarinë devizore 195.000 €. Kursi i të njëjtit ka qenë 61,5 den. për një €.
6. Sipas faturës me nr. 60 blerësit “MM” i janë shitur materiale për 50.000 den. + 18% TVSH Vlera furnizuese e materialit të shitur është 40.000 den. Në afatin për pagim, blerësi ka dërguar çek me nr. 0072 me të cilin e ka paguar shumën e tërë të faturës + 18%TVSH.

Urdhëresa për evidentim

N. r.	Ilogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
1.	120	751 260	Ll/ia Kërkesa nga blerësit në vend Ll/ia Hyrje nga shitja e prodhimeve, mallrave,... Ll/ia Obligime për TVSH mallra të dhënë sipas f-rës.125	1.062.000	900.000 162.000
1a.	701	660	Ll/ia Vlera furnizuese e mallrave të shitur Ll/ia Mallra në rezervë zvogël. i rezervave në magazinë	750.000	750.000
2.	100	120	Ll/ia Xhirollogaria Ll/ia Kërkesa nga blerësit në vend Arkëtuar nga blerësi, sipas fragmentit	1.062.000	1.062.000
3.	120	751 260	Ll/ia Kërkesa nga blerësit në vend Ll/ia Hyrje nga shitja e prodhimeve, mallrave... Ll/ia Obligime për TVSH prodhime të shitur sipas f-rës 785	47.200	40.000 7.200
3a.	700	630	Ll/ia Të dala në bazë të prodhimeve dhe shërbimeve të shitura Ll/ia prodhime në rezervë zvogël. i rezervave në magazinë	30.000	30.000
36.	100	120	Ll/ia Xhirollogaria Ll/ia Kërkesa nga blerësit në vend Arkëtuar nga blerësi, sipas fragmentit me nr.444	47.200	47.200
			Gjithsej	2.998.400	2.998.400

KËRKESA TË DYSHIMTA (TË KONTESTUARA)

Kur për ndonjë kërkesë do të paraqitet dyshim se nuk mund të arkëtohet për shkak të jo solvencës së debitorit (blerësit) atëherë ajo kërkesë bartet prej llogarisë në të cilën është mbajtur në llogarinë për kërkesa kontestuese dhe të dyshimta. Kërkesat të cilat blerësi nuk do që t'i kompensojë ose të njëjtat i konteston me ndonjë arsye të arsyeshme ose të pa arsyeshme, gjithashtu barten në llogarinë e përmendur.

Në llogarinë për kërkesa të dyshimta dhe kontestuese, kërkesat do të qëndrojnë deri në arkëtimin e tyre. Në këtë llogari evidentohen të gjitha shpenzimet e bëra në lidhje me sigurimin dhe arkëtimin e kërkesave. Shpesh herë, pjesë e kërkesave të dyshimta dhe kontestuese nuk arkëtohen ndërsa procedura për provën e tyre mund të zgjasë edhe më gjatë. Në rrethana të këtilla a që të arrihet përcaktimi i drejtë i rezultatit financiar, duke e parashtruar parimin e kujdesit, këto kërkesa si edhe disa të tjera të cilat kanë mbetur gjatë kohë të pa arkëtuara, shlyhen.

Shlyerja paraqet bartje të kërkesës si shpenzim dhe evidentim në llogarinë përkatëse për atë, ndërsa për shumën e asaj kërkesë do të regjistrohet në anën kreditore të llogarisë 129 – Harmonizimi i kërkesave në vlerë nga blerësit. Shlyerja përfundimtare bëhet në bazë të dokumenteve autentike me ç'rast regjistrohet në anën debitorë të llogarisë së përmendur për harmonizimin e vlerave 129 ndërsa në anën kreditore të llogarisë përkatëse në të cilën është mbajtur kërkesa e dyshimtë e shlyer.

Në rast se ndonjë kërkesë e cila ka qenë evidentuar si e dyshimtë ose si e kontestuar, konstatohet se nuk është e atillë, atëherë e njëjta ri evidentohet me zë të kundërt nga regjistrimi.

Mirëpo, në rast se ndonjë kërkesë është shlyer përkohësisht ose definitivisht, më vonë pjesërisht ose tërësisht arkëtohet, atëherë regjistrohet në anën debitorë të llogarisë 129 – Harmonizimi i kërkesave në vlerë nga blerësit ndërsa në anën kreditore llogari përkatëse nga grupi 77 – Hyrje tjera (afariste) kur kërkesa ka qenë pjesërisht e shlyer. Nëse kërkesa ka qenë definitivisht e shlyer atëherë në vend të llogarisë harmonizim në vlerë, ngarkohet llogaria 100 – Xhirollogaria

Shembull për evidentim 1:

Kërkesa nga blerësi “Bllok trans” prej 50.000 den. në afatin ligjor ka mbetur e pa arkëtuar. Kërkohet arkëtim me anë të gjyqit. Është parashtruar padi dhe në emër të taksave gjyqësore është paguar me para në dorë 5.000 den. Gjykata merr Vendim që blerësi ta paguajë borxhin së bashku me shpenzimet gjyqësore dhe kamatën në shumë prej 8.000 den. Vendimi gjyqësor është zbatuar dhe kërkesa është arkëtuar.

N. r.	llogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
1	1209		Ll/ia Kërk. të dyshimta dhe kontestuese.	50 000	
		1200	Ll/ia Blerës për mjete qarkull. pas padisë së parashtruar		50 000
1a	1209		Ll/ia Kërk. të dyshimta dhe kontestuese	5 000	
		102	Ll/ia Arka për taksa të paguara gjyqësore		5 000
16	1200		Ll/ia Blerës për mjete qarkulluese	63 000	
		1209	Ll/ia Kërk. të dyshimta dhe kontestuese		55 000
		765	Ll/ia Hyrje në bazë të kamatës kontest gjyqësor i fituar		8 000
1b	1000		Ll/ia Xhirologari	63 000	
		1200	Ll/ia Blerës për mjete qarkulluese kërkesë kontestuese e arkëtuar		63 000
			Gjithsej	181 000	181 000

KËRKESA TË TJERA NGA RAPORTET AFARISTE

Përveç kërkesave që krijohen nga shitja e rezultateve ose mallrave, ndërmarrjet mund të fitojnë edhe kërkesa të tjera në raportet afariste me persona të tretë. Këtu bëjnë pjesë të gjitha kërkesat, përveç kërkesave nga blerësit. Për kërkesat tjera nga raportet afariste në planin e kontos janë rezervuar grupet:

- 14-Kërkesa nga subjektet e ndërlidhur
- 15-Investime financiare afatshkurta
- 16-Kërkesa nga shteti dhe institucionet tjera
- 17-Kërkesa nga punëtorët dhe kërkesat tjera

Për të gjitha këto kërkesat në kontabilitet hapen llogari të veçanta për evidentimin e ndryshimeve që kanë të bëjnë me to. Evidentimi bëhet sipas parimit të njëjtë me të cilin bëhet evidentimi i ndryshimeve të kërkesat nga blerësit.

Shembuj:

1. Gjatë regjistrimit të prodhimeve të gatshme në magazinë është konstatuar shkurtim i rezervave në vlerë prej 45.000 den +18% TVSH. Për këtë shkurtim përgjegjës është magazinieri "MM". Organi i menaxhimit ka vendosur që magazinieri ta paguajë shkurtimin prej 53.100 denarë në tre këste të barabarta. Punëtori e ka paguar këstin e parë në arkë në përputhje me kasa të pranojë me nr. 222 prej 17.700 den (15.000+18%TVSH).

2. Ndërmarrja, prej mjeteve të veta të parave në llogarinë e transaksionit sipas fragmentit me nr. 12, blen 100 aksione prej Alkaloid-it me vlerë nominale 200 den. për një aksion.

3. Sipas kasa të paguajë nr. 141 punëtorit "NN" i është dhënë avancë për udhëtim zyrtar prej parave në arkë 3.500 den.

4. Në fund të periudhës përlllogaritëse gjendja në llogarinë për regjistrimin e TVSH është si vijon:

1601 TVSH për f-ra të pranuar për furnizime + 270. 000

2600 TVSH në f-rat e lëshuara për shitje - 200.000

Të krijohet kërkesë për TVSH më shumë të paguar. DHP e bën transferimin e mjeteve të parave sipas fragmentit me nr. 13.

5. Ka ndodhur zjarr në magazinën për prodhime të gatshme, janë shkatërruar prodhime me vlerë prej 15.000 den. Kompania e sigurimit, pas inspektimit të bërë dhe sipas procesverbalit pranon 10.000 den. Më vonë kjo shumë kompensohet nga kompania e sigurimit.

Urdhëresa për evidentim

N. r.	Ilogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
1.	172		Ll/ia Kërkesa nga të punësuarit për kompensimin e dëmit	53.100	
		751	Ll/ia Hyrje nga shitja e prodhimeve,		45.000
		260	mallrave...		8.100
1a.	102		Ll/ia Obligime për TVSH shkurtim i konstatuar me faj të "MM"		
		172	Ll/ia Arka	17.700	
			Ll/ia Kërkesa nga të punësuarit për kompensimin e dëmit është paguar kësti i I-rë për kompensimin e dëmit.		17.700
2.	150		Ll/ia Investime në aksione	20.000	
		100	Ll/ia Xhirollogaria janë blerë 100 aksione, sipas fragmentit		20.000
3.	171		Ll/ia Kërkesa nga të punës. për avancë për rrugë zyrt.	3.500	
		102	Ll/ia Arka avancë e dhënë punëtorit		3.500
4.	260		Ll/ia Obligime për TVSH	200.000	
	1608		Ll/ia Kërkesa për kthimin e TVSH-së	70.000	
		160	Ll/ia TVSH kërkesë e parashtruar për tatim të paguar më shumë		270.000
4a.	100		Ll/ia Xhirollogaria	70.000	
		1608	Ll/ia Kërkesë për kthimin e TVSH-së TVSH e kthyer sipas fragmentit me nr.13		70.000
			Gjithsej	434.300	434.300

NOCIONET KRYESORE

Likuiditeti
Qarkullimi pagesor me para në dorë Arka
Maksimumi i arkës
Raporti i arkës
Specifikimi i apoenëve
Qarkullimi pagesor pa para në dorë
Llogari transaksioni e subjektit juridik
Urdhëresa virmani
Qarkullimi ditor
Akreditiv
Xhirollogaria
Llogaria devizore
Letra me vlerë
Kërkesa

PYETJE:

1. Çka do të thotë pagesë me para në dorë dhe cilat pagesa bëhen me para në dorë?
2. Çka paraqet maksimumi i arkës?
3. Pse vetëm një person duhet të jetë përgjegjës për paratë në arkë (kasë)?
4. Cilat dokumente përdoren për pagesën e parave në dhe nga arka? (dokument për tërheqjen e parave nga llogaria e transaksionit për nevojat e arkës _____; dokument për pagesën e parave në arkë është _____?)
5. Çka paraqet dokumenti raporti i arkës (kasës)?
6. Çka do të thotë specifikimi i apoenëve?
7. Çka evidentohet në anën debitore e çka në anën kreditore të Ll/isë Arka dhe çka paraqet saldoja e kësaj llogarie?
8. Pse saldoja e Ll/isë Arka është aktive (pozitive)?
9. Çka do të thotë pagesa pa para në dorë?
10. Cili është dokumenti burimor për evidentimin në urdhëresën e Ll/isë Xhirollogari?
11. Sqaroje dokumentin fragment nga banka!
12. A ka secili të drejtë të tërheqë para nga llogaria e transaksionit e ndërmarrjes?
13. Kur kemi hyrje dhe kur kemi derdhje të parave në llogarinë e transaksionit?
14. Cili është funksioni i llogarisë 1009?
15. Çka është pazari ditor (qarkullimi)?
16. Ku futen paratë prej pazarit ditor?
17. Çfarë llogarie është Ll/ia Xhirollogari (llojet e llogarive)?
18. Çfarë paraqet saldoja e Ll/isë Xhirollogari?
19. A mund të harxhoni më shumë para të gatshme nga saldoja e kontos në bankë?

20. Mendo dhe diskuto pse është e obligueshme hapja e llogarisë së transaksionit në bankë?
21. Çfarë llogarish janë kërkesat?
22. Numëro disa lloje të kërkesave!
23. Sqaroi karakteristikat e llogarisë Kërkesa nga blerësit!
24. Sqaro se në cilin rast një kërkesë nga blerësi shndërrohet në kërkesë kontestuese!

Mendoni për këtë:

Mareli ka maksimum të arkës prej 3.000 den. Antonio Jovanov është i autorizuar të nënshkruajë çeqe të cilat i çon në bankë dhe tërheq para nga llogaria e transaksionit, por njëkohësisht është i ngarkuar me arkën, arka punon me maksimumin e kasës. Muajin e fundit pagesat janë rritur, ndërsa maksimumi është dashur të kompensohet disa herë. Çfarë këshillash mund tu jepni pronarëve duke e marrë parasysh faktorin kontrollues si edhe shumën në arkën?

USHTRIME PËR RAPORTIN E ARKËS:

I. Përpilo raport të arkës dhe mandej evidentojë në urdhëresën për evidentim në bazë të ndryshimeve në vijim në kasën më 07.03.2009:

1. Me çek të gatshëm nr. 12 prej llogarisë së transaksionit janë tërhequr 18.000 den.
2. Sipas urdhëresës për udhëtim me nr. 2 i është dhënë avancë për udhëtim zyrtar në Manastir të punësuarit NN në shumë prej 9.000 den.
3. Sipas kasa të pranojë është paguar pazari ditor i shitores nga shitja e prodhimeve të gatshme për 80.000 den.
4. Sipas faturës me nr.2 është paguar shërbimi për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e mjeteve 2.000 den., shpenzimet për panairë 3.000 den.
5. Sipas listës pagesore me nr.3, janë paguar obligimet ndaj të punësuarve për rroga neto 30.000 den.

Saldoja prej 06.03.2009 është 10.000 den.

II. Përpilo raport arke dhe mandej evidentojë në urdhëresë për evidentim në bazë të ndryshimeve në vijim në arkën më 09.03.2009:

1. Sipas faturës me nr.2, janë blerë dhe harxhuar pjesë rezerve për 2.000 den.
2. I është dhënë avancë për udhëtim zyrtar në vend punëtorit NN për 15.000 den.
3. Në bazë të faturës për udhëtim me nr.15, janë paguar shpenzime ditore dhe për udhëtim për 4.000 den.
4. Me kasa të pranojë, është futur pazar ditor nga shitja e mallrave në shitore për 1.000 den.
5. Me çek me nr. 189012 janë tërhequr para nga llogaria e transaksionit në shumë prej 30.000 den. për nevojat e arkës.
6. Me urdhëresë QP 10, në llogarinë e transaksionit është paguar 7.000 den.
7. Në bazë të faturës me nr.4, është paguar qiraja për hapësirat e punës prej 3.000 den.
8. Në bazë të faturës me nr.6 janë paguar shpenzimet PTT prej 2.000 den.

USHTRIME PËR EVIDENCËN

Ngjarjet kontabiliste në vijim të evidentohen në urdhëresën për evidentim!

1. Prej bankës është marrë fragmenti me nr .1 nga i cili shihet se në dobi të llogarisë së transaksionit blerësi “Trgokoop” nga Manastiri ka paguar 20.000 den. për pagesën e borxhit sipas f-rës me nr.11.
2. Me kërkesë të SHT, SHA “Tutunska banak” nga Velesi i ka aprovuar kredi për M 2.000.000 den. Shuma është paguar në dobi të llogarisë së transaksionit për çka është marrë fragmenti me nr.2.
3. Nga banka është marrë fragment me nr.3 nga i cili shihet se kontabilistit i është paguar në bazë të çekut të gatshëm me nr.123450 shuma prej 50.000 den.
4. Sipas raportit të arkës, paratë e tërhequra nga llogaria e transaksionit nga çeku me nr. 3450 janë paguar në arkë.
5. I është dhënë urdhëresë bankës t’ia paguajë nga llogaria e transaksionit f-rën me nr.21 furnizuesit “Javor” nga Manastiri në lartësi prej 120.000 den. urdhëresa është realizuar sipas fragmentit nga banka me nr. 4.
6. Në dobi të llogarisë së transaksionit është paguar nga realizimi i mallrave nëpërmjet shitores shuma prej 10.000 den., për çka është marrë fragmenti me nr. 5
7. Nga llogaria e transaksionit e SHT, me fragment me nr. 6 është paguar për pagesën e kredisë për MJ shuma prej 45.000 den.
8. Blerësi “NN” nga Negotina ka paguar në dobi të llogarisë së transaksionit është borxhi kryesor sipas f-rës me nr. 12 shuma prej 12.000 den. dhe 2.000 den. në emër të kamatës për pagesën jo në kohë për çka është marrë fragment me nr.7.
9. Me fragmentin me nr.8 nga banka jemi njoftuar se banka e ka bërë arkëtimin në emër të shërbimeve dhe provizionit bankier në shumë prej 5.000 den.
10. Nga banka është marrë fragment me nr. 9 nga i cili shihet se në dobi të llogarisë së transaksionit, blerësi “Uniprokom” nga Shkupi ka paguar 35.000 den. për pagimin e borxhit sipas f-rës me nr. 18 dhe 5.000 den. në emër të kamatës me vonesë për mospagimin në kohë.
11. SHA Stopanska banka i ka miratuar kredi afat shkurte SHT prej 900.000 den., shuma e paguar në dobi të llogarisë së transaksionit për çka është pranuar edhe fragmenti me nr. 10.
12. Për nevojat e arkës, prej llogarisë së transaksionit janë tërhequr 50.000 den. me çek me nr. 154323 për çka është marrë fragment me nr.11.
13. Sipas raportit të arkës me nr.5 shihet se arkëtari i ka paguar paratë në arkë në shumë prej 50.000 den.
14. I është dhënë urdhëresë bankës t’ia paguajë nga llogaria e transaksionit f-rën nr.18 furnizuesit “Trendi” nga Manastiri në shumë prej 150.000 den. për çka është marrë fragment me nr.12.

15. Në dobi të llogarisë së transaksionit, është paguar nga realizimi i mallrave nëpërmjet shitores, shuma prej 20.000 den. për çka është marrë fragmenti me nr. 13.
16. Nga mjetet në llogarinë e transaksionit me fragment nr.14, është paguar për pagesën e kredisë afat shkurte, shuma prej 60.000 den.
17. Për pagesën e detyrimeve doganore gjatë importit të pjesëve rezerve dhe materialeve, nga llogaria e transaksionit janë ndarë mjete për 300.000 den. për çka është marrë fragment me nr. 15.
18. Nga mjetet e parave për pagesën e detyrimeve doganore të cilat ishin ndarë paraprakisht, është paguar dogana për 250.000 den., ndërsa pjesa e mbetur 50.000 den. është kthyer në llogarinë e transaksionit për çka është marrë fragment me nr. 16.
19. Nga mjetet në llogarinë e transaksionit sipas fragmentit me nr.17, veçohen në konto të veçantë mjete të dedikuara për investime në shumë prej 400.000 den.
20. Prej mjeteve në llogarinë e transaksionit sipas fragmentit me nr.18 për mbulimin e çeqeve të lëshuara veçohen në konto të veçantë 110.000 den.
21. Për pagesën e detyrimeve doganore gjatë importit të pjesëve rezerve dhe materialeve nga llogaria e transaksionit janë veçuar mjete parash për 200.000 den për çka është marrë fragment me nr. 19.
22. Prej mjeteve të veçuara të parave për investime i është paguar furnizuesit për PSS për makinën e blerë 400.000 den.
23. Prej mjeteve të veçuara të parave për mbulimin e çeqeve të lëshuara janë paguar çeqet e prezantuar para furnizuesve për 110.000 den.
24. Prej mjeteve të parave për pagesën e doganës të cilat ishin veçuar paraprakisht, është paguar dogana për importin e materialeve për 180.000 den., ndërsa pjesa e mbetur prej 20.000 den. është kthyer në llogarinë e transaksionit sipas fragmentit të marrë me nr. 20.
25. SHT për furnizimin e devizave veçon në[konto të veçantë prej mjeteve në llogarinë e transaksionit 310.000 den. sipas fragmentit nr. 21.
26. I është dhënë urdhëresë bankës të blejë 5.000 € nga 62 den. për 1 €. Banka njofton se i ka blerë devizat dhe i ka transferuar në llogarinë devizore.
27. Bankës i është dhënë urdhëresë t'i hapë furnizuesit të huaj akreditiv për 5000 € nga 62 den. për 1 €. Banka njofton se akreditivi është i hapur.
28. Nga banka është pranuar njoftim se prej akreditivit devizor të hapur furnizuesi i huaj ka tërhequr 4.000 €.
29. Me urdhëresë të SHT bëhet mbyllja e akreditivit në vend të huaj dhe shuma prej 1000 € është pranuar në llogarinë e transaksionit.
30. Prej blerësit “Biljana” nga Ohri është pranuar kambial për pagesën e f-rës nr.88 për prodhime të gatshme të shitura me shumën 5.270 den.

31. Është pranuar çek prej blerësit “Uniprokom”, për sigurimin e pagesës së prodhimeve të gatshme të dorëzuara për 7.250 den.
32. Kambiali i pranuar për 5.270 den. dhe çeku për 7.250 den. janë parashtruar në bankë për arkëtim.
33. Është pranuar fragment nga banka me nr.22 nga i cili shihet se çeku dhe kambiali janë arkëtuar në dobi të llogarisë së transaksionit.
34. SHT për furnizimin e devizave veçon në konto të veçantë prej mjeteve në llogarinë e transaksionit 372.000 den sipas fragmentit nr. 23.
35. I është dhënë urdhëresë bankës të blejë 6.000 € nga 62 den. për 1 €. Banka njofton se i ka blerë devizat dhe i ka transferuar në llogarinë e transaksionit .
36. Bankës i është dhënë urdhëresë t’i hapë furnizuesit të huaj akreditiv për 6.000 € nga 62 den. për 1 €. Banka njofton se akreditivi është hapur.
37. Ng banka është pranuar njoftim se nga akreditivi devizor i hapur furnizuesi i huaj ka tërhequr 5.500 €.
38. Sipas urdhëresës së SHT bëhet mbyllja e akreditivit në vend të huaj dhe shuma prej 500 € është pranuar në Xhirollogarinë.
39. Janë shitur prodhime të gatshme nga shitorja për çka është pranuar çek për 1.200 den.
40. Çeku i pranuar është parashtruar në bankë për arkëtim.
41. Është marrë fragment nga banka nr. 24 nga i cili shihet se çeku është arkëtuar në dobi të llogarisë së transaksionit.
42. Sipas f-rës nr. 33, i janë shitur prodhime të gatshme blerësit “Biteks” nga Manastiri për 50.000 den. + 18%TVSH.
43. Çmimi i kostos sipas së cilit janë udhëhequr këto shitore në rezervë ka qenë 35.000 den.
44. Afati për pagesën e faturës ka qenë 10 ditë. Gjatë shitjes, blerësit i është aprovuar lirim prej 3% nga vlera e faturës nëse pagesa bëhet brenda afatit të parashikuar.
45. Blerësi shumën e ka paguar pas 20 ditëve në dobi të llogarisë së transaksionit për çka është marrë fragment nga banka me nr.25. (rabatin nuk e ka marrë).
46. Sipas f-rës nr.55, i janë shitur mallra tregtar blerësit ”Fikom”, nga Shkupi për 80.000 den + 18% TVSH.
47. Çmimi i kostos sipas të cilit janë mbajtur këto rezerva ka qenë 50.000 den.
48. Afati për pagimin e f-rës ka qenë 7 ditë. Gjatë shitjes, blerësit i është aprovuar lirim prej 5% nga vlera e faturës nëse pagesa bëhet brenda afatit të parashikuar.

49. Blerësi shumë e ka paguar në kohë në llogarinë e transaksionit për çka është marrë fragment nr.26 dhe e ka shfrytëzuar lirimin.

50. Në zjarr i cili ka ndodhur në magazinën për materiale në vlerë prej 20.000 den. Kompania e sigurimit, pas inspektimit të bërë sipas procesverbalit nr.5, e ka pranuar dëmin. Kjo shumë, më ,vonë është transferuar në llogarinë e transaksionit për çka është marrë fragment me nr.27.

51. Gjatë regjistrimit të prodhimeve të gatshme në magazine, është konstatuar shkurtim i rezervave në vlerë prej 65.000 den. Për këtë shkurtim përgjegjës është magazinieri “MM”. Organi i menaxhimit ka vendosur që magazinieri ta paguajë shkurticën prej 65.000 den, si edhe shumë përkatëse të TVSH-së prej 11.700 den.(18%). Punëtori e ka paguar shumë në arkë.

52. Ndërmarrja “Evropa”, sipas Vendimit të Këshillit Drejtues prej më 05.01.2009, përlllogarit shumë vjetore të humbjes në peshë pas tharjes, shpërbërjes, copave dhe prishjes së rezervave të mallit tregtar në shumë prej 120.000 den. Sipas procesverbalit nr. 256 të komisionit prej 04.07.2009, shuma e thyerjes dhe prishjes faktike të rezervës është 40.000 den. Sipas procesverbalit të komisionit me nr. 345 prej më 04.11.2009, shuma e thyerjes dhe prishjes faktike të rezervave është 60.000 den. Të bëhet barazimi i llogarive dhe të regjistrohet në mënyrë përkatëse dallimi (detyra është prej PVR).

53. SHT për magazinën që e ka marrë me qira sipas fragmentit nr.28 ka paguar më 03.01. për 6 muaj përpara nga llogaria e transaksionit 12.000 den. SHT bën parallogaritje të qirasë si shpenzim ashtu që deri në fund të periudhës përlllogarit qira për 6 muaj. Të mbyllen kontot në përkufizime kohore.

54. SHT në emër të reklamës dhe propagandës për tërë vitin ka paguar paraprakisht më 03.01. shumë prej 36.000 den. SHT bën parallogaritje të reklamës dhe propagandës si shpenzim.

55. Sipas f-rës nr.90, i janë shitur mallra tregtar blerësit “Prespa” nga Resnja për 120.000 den. +18% TVSH me afat pagese 30 ditë.

56. Çmimi i kostos sipas të cilit janë mbajtur mallrat në rezervë është 100.000 den.

57. Gjatë shitjes blerësit i është aprovuar lirim prej 3% nga vlera e faturës nëse pagesa bëhet brenda afatit prej 10 ditësh.

58. Blerësi, shumë e paguan pas 25 ditëve në dobi të llogarisë së transaksionit 100.000 den dhe çek 41.600 den. (nuk e ka shfrytëzuar lirimin).

59. Gjatë regjistrimit të prodhimeve të gatshme është konstatuar shkurtim prej 20.000 den. për çka fajtor është magazinieri. Për këtë shumë paguhet 18% TVSH.

60. Magazinieri e paguan shumë së bashku me tatimin në arkën kryesore në shumë prej 23.600 den.

61. SHT në emër të shpenzimeve të premive për sigurim për tërë vitin, ka paguar paraprakisht 24.000 den. SHT bën parallogaritje të premisë për sigurim si shpenzim.

62. SHT për furnizimin e devizave veçon në konto të veçantë nga mjetet në llogarinë e transaksionit 248.000 den. sipas fragmentit nr.30.
63. I është dhënë urdhëresë bankës të blejë 4.000 € nga 62 den. për 1 €. Banka njofton se i ka blerë devizat dhe i ka transferuar në llogarinë revizore.
64. Bankës i është dhënë urdhëresë t'i hapë furnizuesit të huaj akreditiv për 4.000 € nga 62 den. për 1 €. Banka njofton se akreditivi është hapur.
65. Nga banka është pranuar njoftim se nga akreditivi devizor i hapur, furnizuesi i huaj ka tërhequr 3.500 €.
66. Me urdhëresë të SHT bëhet mbyllja e akreditivit në vend të huaj dhe shuma prej 500 € është pranuar në llogarinë e transaksionit.
67. Janë shitur prodhime të gatshme nga shitorja për çka është pranuar çek në 2.400 den.
68. Çeku i pranuar është parashtruar në bankë për arkëtim.
69. Është marrë fragmenti nr.31 nga banka nga i cili shihet se çeku është arkëtuar në dobi të llogarisë së transaksionit.
70. Për pagesën e detyrimeve doganore gjatë importit të pjesëve reserve dhe materialeve sipas fragmentit nr. 32 nga Xhirollogaria janë veçuar mjete parash për 100.000 den.
71. Prej mjeteve të parave për pagesën e doganave, të cilat ishin veçuar paraprakisht, është paguar

Tema 7:

EVIDENTIMI I MATERIALEVE DHE SHPENZIMEVE

PËRMBAJTJA E TEMËS:

Evidentimi i rezervave Evidentimi i materialeve, pjesëve rezerve dhe inventarit të imët
Definimi i materialeve
Procedura dhe dokumentacioni gjatë furnizimit të materialeve
Çmimet e materialeve
Rregullat për regjistrimin e rezervave të materialeve
Shpenzime-nocioni
Shpenzime-llojet e shpenzimeve
Evidentimi i harxhimit të materialeve (me dhënien nga rezerva)
Evidentimi i harxhimit të materialeve (materiale të furnizuara të harxhuara)
Shërbime me karakter të shpenzimeve materiale Rezervimet e kalkuluar të shpenzimeve dhe rreziqeve Evidentimi i amortizimit Shpenzime jo materiale
Rroga dhe kompensime Renditja e harxhimeve

QËLLIMET E MËSIMIT:

Nxënësi:
-ta definojë nocionin rezerva;
-ta evidentojë furnizimin e lëndëve të para dhe materialeve edhe me çmime furnizimi edhe të planit;
-ta definojë nocionin shpenzime;
-t'i dallojë llojet e shpenzimeve;
-t'i njohë dokumentet për shpenzimet e krijuara;
-t'i evidentojë shpenzimet për lëndët e para, materialet, energjinë, pjesët rezerve dhe inventarin e imët;
-t'i evidentojë shërbimet;
-ta evidentojë amortizimin dhe shpenzimet jo materiale;
-t'i evidentojë rrogat dhe shpenzimet tjera për punën rrjedhëse;

EVIDENCA E REZERVAVE

Rezervat paraqesin mjete rrjedhëse (qarkulluese) që gjenden në magazinat e ndërmarrjeve

Duke u nisur nga nocioni rezerva ato, pavarësisht paraqesin mjete rrjedhëse (qarkulluese) që gjenden në magazinat e ndërmarrjeve. Jo vetëm në aspekt kontabilist, por edhe në aspekt ekonomik rezervat paraqesin aktive të rëndësishme në bilancin e gjendjes. Praktikisht, këto mjete janë kapital qarkulluese i cili është i paraprirë për kyçje në procesin e prodhimitarisë ose për kënaqjen e nevojave të konsumatorëve. Por, nga aspekti analitik, problematika e tyre trajtohet në bazë të rëndësisë për vazhdimësinë e reproduksionit edhe atë, si në planin mikro ashtu edhe në planin makro.

Si rezerva më të rëndësishme mund të konsiderohen llojet në vijim:

-prodhime të gatshme në rezervë, - mallra në rezervë;

-lëndë të para dhe materiale në rezervë, -pjesë rezerve në rezervë, -inventari i imët në rezervë, -ambalazhi dhe auto goma në rezervë etj.

Për evidentimin e rezervave në kontabilitet janë rezervuar klasat 3 dhe 6. Rikujtim:

Klasa 3: *Rezerva të lëndëve të para, materiale, pjesë rezerve dhe inventar i imët*

Klasa 6: *Rezerva e prodhimitarisë Prodhime dhe mallra të gatshëm*

Me nocionin materiale nënkuptohen sendet e furnizuara për punë, me qëllim që të harxhohen në vetë ndërmarrjen.

EVIDENTIMI I MATERIALEVE, PJESËVE REZERVE DHE INVENTARIT TË IMËT

DEFINIMI I MATERIALEVE

Me nocionin materiale nënkuptohen sendet e furnizuara për punë, me qëllim që të harxhohen në vetë ndërmarrjen.

Me nocionin materiale nënkuptohen sendet e furnizuara për punë, me qëllim që të harxhohen në vetë ndërmarrjen. Prej materialeve prodhohet prodhimi i gatshëm, instalohen në të ose po e mundësojnë prodhimitarinë ose shërbejnë për krijimin e kushteve normale për punë. Materialet e nevojshëm për punën e një ndërmarrjeje janë të shumtë dhe të llojllojshëm. Si materiale nuk trajtohen sendet që janë furnizuar për shitje, ato trajtohen si mallra tregtar.

Evidentimi i materialeve është shumë i rëndësishëm. Ai duhet të sigurojë të dhëna për gjendjen, për furnizimin dhe dorëzimin - harxhimin e materialeve për çdo lloj të materialeve veçmas.

Materialet mund të grupohen në mënyra të ndryshme dhe në baza të ndryshme. Grupimet më të shpeshta të materialeve janë: lëndët e para; lëndët djegëse dhe vaji; materialet ndihmëse; materialet për zyra; inventari i imët; ambalazhi dhe auto gomat.

Lëndët e para paraqesin pjesën kryesore thelbësore të prodhimit të ri. I atillë është shembulli me stofin nëpër konfeksionet, me drurin në fabrikat për mobilie, me miellin në furra dhe ngjashëm. **Lënda djegëse dhe vaji** e mundësojnë prodhimtarinë, ato janë zëra të rëndësishëm nëse merren parasysh çmimet enorme të energjisë. **Materialet ndihmëse** janë ato të cilat harxhohen në prodhimtarinë ose gjatë bërjes së ndonjë veprimtarie tjetër, mirëpo, ato nuk janë pjesë thelbësore e prodhimit të ri, nuk hyjnë në përbërjen e tij. Materialet për pastrim dhe mirëmbajtje për shembull janë materiale ndihmëse. **Material zyre** janë materialet të cilat përdoren në punën administrative. Të atilla janë letra, markerët dhe ngjashëm. **Me nocionin inventar i imët** nënkuptohen aletet për punë (si mjete të përhershme për shembull) të cilat trajtohen si mjete qarkulluese për shkak se kanë afat më të shkurtër se një vit të përdorimit dhe vlerë individuale të vogël. Këtu bëjnë pjesë lloje të ndryshme të aleteve dhe mjete të tj.



Lëndët e para të cilat përdoren në industrinë kimike



Pjesë rezerve

Për evidentimin e materialeve është rezervuar klasa 3.

Në suazat e kësaj klase janë rezervuar grupet në vijim:

30- Përlllogaritja e furnizimit

31- Lëndë të para dhe materiale

32- Pjesë rezerve

35-Inventar i imët dhe ambalazh

37- Depozite dhe paradhënie me avancë për lëndë të para dhe materiale, pjesë rezerve, inventar i imët, ambalazh dhe auto goma.



Inventar i imët

PROCEDURA DHE DOKUMENTACIONI GJATË FURNIZIMIT TË MATERIALEVE

Në bazë të nevojave të konstatuara për materiale për zhvillimin e pa penguar të prodhimtarisë, ndërmarrjet bëjnë marrëveshje për furnizimin e materialeve prej furnizuesve.

Ky dokument quhet **dokument i nisjes**, gjithashtu dërgojnë edhe **faturë**. Kur të arrijnë materialet, në magazinë përmbushet dokument i cili quhet **fletëpranim**.

Materialet në kontabilitet udhëhiqen me çmimet faktike ose paraprakisht të parashikuara. Çmimet e parashikuara mund të jenë standarde ose të plani, ndërsa në praktikën tonë paraqiten **çmimet e planit**. Gjatë furnizimit të materialeve përpilohet **kalkulimi** në të cilin përlllogaritet **vlera furnizuese** dhe **çmimi furnizues**.

Vlera furnizuese përbëhet prej **vlerës së faturës** (shuma e faturuar ndaj furnizuesit në faturën) plus **shpenzimet e varura**. Shpenzimet e varura janë shpenzimet transportin e materialeve, për bartjen, ngarkimin, shkarkimin, sigurimin, doganën dhe ngjashëm. Shpenzimet e varura dokumentohen dëshmohen me dokumentet të cilat arrijnë si që janë: faturat për transportin, listat e ngarkimit, konosamenti, parallogaritë doganore etj.

Dokumentacioni për furnizimin e materialeve:
 -dokumenti i nisjes,
 -fatura,
 -fletëpranimi,
 -fatura për transport,
 -listat e ngarkimit,
 -konosamenti,
 -parallogarit doganore etj.

Kur vlera furnizuese do të ndahet me sasinë që furnizohet, fitohet çmimi furnizues, gjegjësisht çmimi për njësi material furnizues. Për materialet mbahet evidencë analitike për çdo lloj të materialit. Kjo evidencë duhet të sigurojë të dhëna edhe për sasinë, për çmimin, për vlerën e çdo lloji të caktuar të materialit.

ÇMIMET E MATERIALEVE

Materialet në rezervë mbahen me:
-çmimet e furnizimit
- çmimet e planit.

Në kontabilitetin e planit, hyrja e materialeve, pjesët rezerve, inventari i imët, ambalazhi dhe autogolat mund të evidentohen me:

- çmimin e furnizimit dhe
- çmimin e planit, ndërsa daljen me:
- çmimin e furnizimit (metoda FIFO ose metoda LIFO) dhe
- çmimi i mesëm (mesatar)

Me nocionin **çmimi i furnizimit** nënkuptohet çmimi i faturuar i materialeve i zmadhuar për shpenzimet për furnizimin dhe distribuimin e tyre (transporti, ngarkimi, shkarkimi dhe ngjashëm.)

Për ato të cilët duan të dinë më shumë: (Në rast se materialet në kontabilitetin material mbahen me çmimet e furnizimit, gjatë lëshimit të tyre në prodhimtari, respektivisht në përdorim, sasia e dhënë parallogaritet sipas çmimit furnizues të parë. Nëse sasia nga çmimi i parë furnizues është mbaruar, parallogaritja bëhet sipas çmimit të dytë të furnizimit dhe ashtu më tutje. Kjo metodë e përlllogaritjes së harxhimit të materialeve në teori njihet me emrin metoda FIFO (first in - first out) -çmimi i parë hyrës, çmimi i parë i daljes.

Me nocionin çmimi mesatar i furnizimit nënkuptohet çmimi mesatar i furnizimit sipas së cilit regjistrohet dalja e materialeve në kartotekën materiale. Ky çmim parallogaritet në mënyrë që rezervat e vjetra - sipas sasive dhe vlerës - mblidhen me sasi të dhe vlerën e furnizimit të ri dhe shuma e vlerës së materialeve të caktuara ndahet me shumën e sasive.

Me nocionin çmimi i daljes hyrja-e parë i fundit, nënkuptohet çmimi i fundit i hyrjes me të cilin janë pranuar materialet, të shfrytëzohet për përlllogaritjen e materialit të kërkuar për nevojat e prodhimtarisë. Kjo metodë e përlllogaritjes së harxhimit të materialeve në teori njihet si metoda LI-FO (last in - first out))

Me çmimin e planit nënkuptohet çmimi interno i cili përcaktohet në fillim të vitit, për çdo material veç e veç në bazë të çmimeve të blerjes dhe shpenzimeve mesatare për furnizimin dhe distribuimin e tyre. Këto çmime planifikohen për shkak të lehtësisë të teknikës dhe përlllogaritjes së materialeve (që mos bëhet përlllogaritje e vazhdueshme çmimit mesatar të furnizimit). Ky çmim është i njëjtë tërë vitin prandaj edhe emërtohet si çmim i përherëshëm. Nëse materialet mbahen me çmimin planit, atëherë hyrja e tyre dhe dalja përlllogaritet me atë çmim. Dallimet ndërmjet vlerës së planifikuar dhe vlerës reale të materialeve të blera dhe të dhëna evidentohet vetëm në kont-

abilitetin financiar, nëpërmjet llogarive të veçanta për shmangie nga çmimi i përhershëm i materialeve.

Përlllogaritja e materialeve të harxhuara sipas secilës prej këtyre metodave ka si rezultat shumë të ndryshme të harxhimeve dhe shumë të ndryshme të materialeve të paraqitura në rezervë si mjet. Harxhimi i materialeve ka ndikim edhe mbi rezultatin financiar.

RREGULLAT PËR EVIDENTIMIN E REZERVAVE TË MATERIALEVE:

1. ME PËRDORIMIN E LLOGARIVE TË PËRKOHSHME PËR PËRLLLOGARITJEN E FURNIZIMIT:

a) Evidentimi i furnizimit të lëndëve të para, të materialeve, të pjesëve rezerve dhe inventarit të imët kur rezervat mbahen me çmimet e furnizimit:

Kur në kontabilitet do të arrijnë dokumentet për furnizimin e materialeve, zbatohet evidentim për formimin e vlerës furnizuese. Për formimin e vlerës furnizuese shërbejnë llogaritë prej grupit **30** të cilat pas formimit të vlerës furnizuese shuhen. Për faturën e pranuar të furnizuesit evidentohet në anën pozitive të llogarisë **300-Vlera pas përlllogaritjes së furnizuesit**. Njëkohësisht evidentohet në anën negative të llogarisë **220-Obligime ndaj furnizuesve**. Mandej evidentohen dokumentet e arritura për shpenzimet e varura. Shpenzimet e varura evidentohen në anën pozitive të llogarive llogaria **301-3. Shpenzime të varura** me evidentimin e njëkohshëm në anën negative të llogarisë **220-Obligime ndaj furnizuesve**. Në rast se ca shpenzime të varura janë paguar me para në dorë evidentohen në anën negative të llogarisë **102-Arka**. Në llogarinë **302-Dogana dhe detyrime të tjera të importit** evidentohet dogana që duhet të paguhet sipas parallogaritë për doganë për materialet e importuara.

Kur do të evidentohen të gjitha dokumentet për materialet e furnizuara, bëhet parallogaritja e vlerës furnizuese të materialeve dhe evidentohet pranimi i materialeve në rezervë për çka përpilohet dokumenti **fletëpranimi**.

Për përlllogaritjen e furnizimit zbatohet evidentimi në vijim: Në anën pozitive evidentohet në llogarinë **309-Përlllogaritja e furnizimit**, ndërsa në anën negative evidentohet në të gjitha llogaritë që paraprakisht janë paraqitur gjatë formimit të vlerës furnizuese. **Vlera sipas përlllogaritjes së furnizuesit, 301-Shpenzimet e varura-Dogana dhe detyrimet tjera të importit**. Me këtë evidentim shuhen llogaritë nga grupi 30 pasi ato janë llogari të përkohshme të cilat shërbejnë për formimin e vlerës furnizuese dhe mandej shuhen, nuk kanë saldo. Eventualisht, saldoja e tyre do të thotë se ende nuk është formuar vlera furnizuese për shkak të mos arritjes së të gjithë dokumenteve për furnizimin.

Evidentimi i furnizimit të lëndëve të para, të materialeve, të pjesëve rezerve dhe inventarit të imët kur rezervat mbahen me çmimet e furnizimit:

Me evidentimin në anën pozitive të llogarisë **309-Përlllogaritja e furnizimit** e kemi **çdoherë** vlerën furnizuese të materialeve të furnizuara. Mandej materialet pranohen në rezervë -për çka përmbushet dokumenti **fletëpranimi**. Sipas fletëpranimit, pranimi i rezervës evidentohet si në anën pozitive të llogarisë 310-Lëndë të para dhe materiale në rezervë, ndërsa në anën negative në llogarinë 309-Përlllogaritja e furnizimit. Me këtë shuhet edhe llogaria 309, ndërsa vlera e evidentuar në atë llogari bartet si vlerë e rezervës së materialeve.

Nëse janë blerë pjesë rezerve, ngarkohet llogaria **320-Pjesë rezerve në rezervë**, nëse është blerë inventar i imët ngarkohet llogaria **350-Inventar i imët në rezervë**, ndërsa nëse janë blerë ambalazh dhe autogola, ngarkohet llogaria **352-Ambalazhi dhe auto goma në rezervë** në anën negative (kreditore) në të gjitha rastet është llogaria **309-Përlllogaritja e furnizimit**, e cila mbulohet (saldohet).

Evidentimi i furnizimit të lëndëve të para, të materialeve, të pjesëve rezerve dhe inventarit të imët kur mbahen me çmime të planit.

b) Evidentimi i furnizimit të lëndëve të para, të materialeve, të pjesëve rezerve dhe inventarit të imët kur rezervat mbahen me çmimet e planit.

Paraprakisht u sqarua mënyra e evidentimit të furnizimit të mjeteve nga klasa 3, kur rezervat mbahen me vlerën furnizuese. Në rast se rezervat e mjeteve nga klasa 3 mbahen me vlerën e planit, llogaritë: 310, 350 dhe 352 ngarkohen për vlerën e planit. Llogaria 309 çdoherë kërkon për vlerën furnizuese ndërsa dallimi ndërmjet njërës dhe vlerës tjetër, do të evidentohet në llogarinë **319-Shmangie nga çmimet e lëndëve të para dhe materialet**. Shmangia është pozitive në rast se vlera e planit është më e madhe prej vlerës së furnizimit dhe evidentohet në anën negative (të llogarisë 319) dhe anasjelltas me vlerë plani më të vogël nga vlera furnizuese ka shmangie negative që evidentohet në anën pozitive (në llogarinë 319).

2. ME KALKULIM

Evidentimi me ndihmën e kalkulimit ,do të shpjegohet në mënyrë rrjedhëse, gjatë evidentimit të furnizimit.

Karakteristikat e Ll/i Rezerva e lëndëve të para dhe materialeve:
Në llogarinë **Rezerva e lëndëve të para dhe materiale** në anën pozitive evidentohet vlera e furnizimit e materialeve të blera ndërsa në anën negative vlera e materialeve të dorëzuara në prodhimtari. Në anën e majtë evidentohet edhe shuma e materialeve të kthyer nga prodhimtaria, ndërsa në anën e djathtë dëmi i shkaktuar, shkurtimet dhe ngjashëm. Saldoja në këtë llogari e paraqet shumën e materialeve me të cilat disponon firma në datën e caktuar.

+ <u>Ll/ia Rezerva e lëndëve të para dhe materialeve</u> -	
<p>0) Gjendja fillestare 1) Rritje: në prodhimtari -furnizim -të kthyer si gabimisht të kërkuara</p>	<p>2) Materialet e dorëzuara</p>
(+)	(-)

Shembuj:

Shembulli 1: Prej furnizuesit "Heraklea", nga Manastiri janë blerë sipas f-rës nr.148 lëndë të para edhe atë:

600m. lëkurë nga 500 den. për 1m.=300.000

400m. gjon nga 300 den. për 1m. =120.000

Gjithsej = 420.000

Në vlerën e furnizimit llogaritet +18%TVSH. Për transport dhe për bartjen e lëndëve të para është pranuar fatura nr.15 në 10.000 den +18%TVSH e cila më vonë është paguar prej arkës. Lëndët e para në rezervë evidentohen me vlerën e furnizimit.

N. r.	llogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
1.	300		Ll/ia Vlera sipas përlllogaritjes së furnizuesit	420 000	
	1601		Ll/ia TVSH në f-ra të pranuar për furniz.	75 600	
		2201	Ll/ia Obligime ndaj furniz. për mjetet qarkulluese për lëndë të para të blera sipas f-rës nr.148		495 600
1a.	3010		Ll/ia Shpenzime të varura për furniz. e mater.	10 000	
	1601		Ll/ia TVSH në f-ra të pranuar	1 800	
		2201	Ll/ia Oblig. ndaj furniz. për mjetet qarkulluese për transport sipas f-rës nr. 15		11 800
16.	2201		Ll/ia Obligime ndaj furniz. për mjetet qarkulluese	11 800	
		1020	Ll/ia Arka kryesore f-rë e paguar për transport me para në dorë		11 800
1b.	309		Ll/ia Përlllogaritja e furnizimit	430 000	
		300	Ll/ia Vlera sipas përlllogaritjes së furnizuesit		420 000
		3010	Ll/ia Shpenzime të varura vlera furnizuese e transferuar		10 000
1r.	310		Ll/ia Lëndë të para dhe mater. në rezervë	430 000	
		309	Ll/ia Përlllogaritja e furnizimit mater. të pranuar me vlerën furniz. Sipas fletëpranimit nr.		430 000
			Gjithsej	1.379.200	1.379.200

Zgjidhja e shembullit me aplikimin e kalkulimit:

Kalkulimi:	rezerva (310)	TVSH (160)	Obligim (220)
1. Vlera e faturës nr.	420.000	+ 75.600	= 495.600
2. Shpenzime të varura den.	10.000	+ 1.800	= 11.800
3. Vlera e furnizimit (1+2)	430.000	77.400	

Evidentimi i kalkulimit:

310 Ll/ia Lëndë të para dhe materiale në rezervë	430.000
1601 Ll/ia TVSH në f-ra të pranuar	77.400
220 Ll/ia Obligime ndaj furniz. në vend	495.600
220 Ll/ia Obligime ndaj furniz. në vend	11.800
lëndë të para të blera dhe të pranuar me vlerë furnizuese	

Shembull 2: Furnizimi i materialeve prej importi të cilët në rezervë mbahen me vlerën furnizuese.

Konfeksioni "Melina", për prodhimin e kostumeve për meshkuj ka porositur prej furnizuesit të vet nga Gjermania 300 metra stof me çmimin prej 10 € ose gjithsej 3000 €.

- Për furnizimin bërë është pranuar pro-faturë prej furnizuesit në bazë të së micës është hapur akreditiv në bankë me vlerë prej 180.000 den. që e paraqet kundërvlerën e shumës që është borxh prej 3000 € (1 € = 60 den.).
- Furnizuesi i huaj e distribuon stofin dhe dërgon faturë në shumë prej 3000 €.
- Gjatë kalimit të kufirit është paguar dogana në shumë prej 300 den.
- Tatimi i vlerës së shtuar është përlllogaritur dhe është paguar gjatë doganimit. Baza tatimore prej 18% e paraqet vlerën e të mirave të importuara (180.000 den.), të rritur për shumën e doganës së paguar (9300 den.) dhe ajo është 189.300. Tatimi i vlerës së shtuar i paguar gjatë doganimit është 34.074 den.
- Është pranuar faturë nga furnizuesi në vend për transportin e të mirave deri në magazinë në shumë prej 2.500 den. + TVSH (18 %) në shumë prej 450 den. ose vlerë të përgjithshme prej 2.950 den. (shpenzimet e transportit deri në vendin e parë të destinimit të fundit të së mirës në vend, janë përfshirë në bazën e doganimit që do të thotë se janë përfshirë edhe në bazën e tatimit).
- Është pranuar faturë nga transportuesi në vend për shërbimet e bëra gjatë importit në shumë prej 10.000 den. + TVSH (18 %) në shumë prej 1.800 den. ose vlerë të përgjithshme prej 11.800 den.
- Është bërë përlllogaritja për furnizimin e stofit të importuar.
- Prej akreditivit të hapur është paguar fatura e furnizuesit të huaj në shumë prej 180.000 den.

TEMA 7: Evidentimi i materialeve dhe shpenzimeve

Evidentimi:

N. r.	Ilogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
1	104	103	Ll/ia Akreditiva devizorë Ll/ia Llogari devizore akr. i hapur (3000 € nga 60 den.)	180 000	180 000
2	3000	221	Ll/ia Vlera e faturës e mater. Ll/ia Oblig. ndaj furniz. jashtë sipas faturës nga furniz. i huaj	180 000	180 000
3	302 1606	265 260	Ll/ia Dogana dhe detyrime tjera import. Ll/ia TVSH i paguar gjatë importit të të mirave Ll/ia Obligime për dogana dhe për detyrime tjera Ll/ia Obligime për TVSH dogana dhe TVSH e përlog. gjatë importit	9 300 34 074	9 300 34 074
4	265 260	100	Ll/ia obligime për dog. dhe detyrime tjera Ll/ia Obligime për TVSH Ll/ia Xhirollogaria dogana e paguar dhe TVSH gjatë importit	9 300 34 074	43 374
5	301 1601	220	Ll/ia Shpenzime të varura Ll/ia TVSH në faturat e pranuara Ll/ia Obligime ndaj furniz. në vend. sipas f-rës për transport	2 500 450	2 950

TEMA 7: Evidentimi i materialeve dhe shpenzimeve

6	301 1601	220	LI/ia Shpenzime të varura	10 000	11 800	
			LI/ia TVSH në f-ra të pranuar LI/ia Obligime ndaj furniz. në vend për shërbime transporti	1 800		
7	309	3000	LI/ia Përlllog. e furniz. të mater. LI/ia Vlera e faturës së mater. LI/ia Dogana dhe detyrime të tjera	201 800	180 000	
		302	LI/ia Shpenzime të varura për përloç. e furnizimit			9 300
		301				12 500
7a	310	309	LI/ia Lëndë të para dhe mater. në rezervë LI/ia Përlllog. e furniz. të mater. e pranuar në magazinë	201 800	201 800	
8	221	104	LI/ia Oblig. ndaj furniz. jashtë vendit LI/ia Akred. devizore për pagesë sipas dërgesës së huaj	180 000	180 000	
			Gjithsej	1045098	1045098	

Pasi përdorimi i llogarive nga grupi 30 nuk është i obligueshëm, evidentimi zbatohet me kalkulim paraprakisht të përpiluar:

Kalkulimi:

1. Vlera e faturës den. 180.000
2. Shpenzime të varura den. 9.300
3. Shpenzime të varura den. 2.500
4. Shpenzime të varura den. 10.000
5. Vlera e furnizimit (1+2+3+4) 201.800

Evidentimi i kalkulimit:

310	LI/ia Lëndë të para dhe materiale në rezervë	201.800
1601	LI/ia TVSH në f-ra të pranuar	34.074
1601	LI/ia TVSH në f-ra të pranuar	2.250
221	LI/ia Obligime ndaj furniz. në vend të huaj	180.000
260	LI/ia Obligime për TVSH	34.074
220	LI/ia Obligime ndaj furniz. në vend	14.750
265	LI/ia Obligime për dogana dhe detyrime dog. materiale të blera dhe pranuar me vlerë furnizuese	9.300

Evidentimi kur materialet mbahen me vlerën e planit.

Shembulli 3: Prej furnizuesit në vend është pranuar fatura për materialet e distribuara prej 100.000 den. + 18 % TVSH. Për transportin e materialeve të blerë është pranuar faturë 5.000 den. + 18 % TVSH ndërsa për shkarkimin dhe vendosjen është paguar me para në dorë 1.000 den. Sipas fletëpranimit materialet pranohen në rezervë sipas vlerës së planit 120.000 denarë.

TEMA 7: Evidentimi i materialeve dhe shpenzimeve

N. r.	llogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
3	3000	2201	LI/ia Vlera e faturës së mater.	100 000	118 000
	1601		LI/ia TVSH në f-ra të pranuar për furniz.	18 000	
3a	3010	2201	LI/ia Shpenzime të varura për furniz. e materialeve	5 000	5 900
	1601		LI/ia TVSH në f-ra të pranuar	900	
36	3010	1020	LI/ia Shpenzime të varura për furniz. e materialeve	1 000	1 000
			LI/ia Arka kryesore shkarkim i paguar me para në dorë		
3B	309	3000	LI/ia Përlllogaritja e furnizimit	106 000	100 000
			LI/iaa Vlera sipas përlllog. të furniz.		
			LI/ia Shp/nz. të varura		
			LI/ia Shp/nz të varura		
3r	310	3010	Vlera e bartur furniz.	5 000	1 000
			3010		
3r	310		LI/ia Lëndë të para dhe mater. në rezervë	120 000	

TEMA 7: Evidentimi i materialeve dhe shpenzimeve

		309	Ll/ia Përlogaritja e furnizimit		106 000
		319	Ll/ia Shmangia nga çmimi i mater.		14 000
			mater. të pranuar sipas vlerës së planit		
			Gjithsej	350.900	350.900

Pasi përdorimi i llogarive nga grupi 30 nuk është i obligueshëm, evidentimi pa përdorim është si vijon:

Kalkulimi:

1. Vlera e faturës Den. $100.000 + 18\ 000\ \text{TVSH} = 118.000$
 2. Shpenzime të varura Den. $5.000 + 900\ \text{TVSH} = 5.900$
 3. Shpenzime të varura të gatsh. Den. 1.000
- Vlera furnizuese Den. 106.000
- Shmangie nga çmimet Den. 14.000
- Vlera e planit Den. 120.000

Evidentimi pas kalkulimit:

- 310 Ll/ia Lëndë të para dhe materiale në rezervë 120.000
- 1601 Ll/ia TVSH në fatura të pranuar 18.900
- 2201 Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve 123.900
- 1020 Ll/ia Arka kryesore 1.000
- 319 Ll/ia Shmangia nga çmimet e mater. 14.000
- Materiale të blera dhe të pranuar sipas vlerës furnizuese.

Dokumentet dhe evidenca kontabiliste e furnizimit të pjesëve rezerve dhe inventarit të imët është e njëjtë si edhe evidenca e materialeve por për to në planin llogaritës ka llogari të veçanta. Shihe planin llogaritës.

Shembuj për ushtrim:

Të evidentohen në urdhëresë për evidentim , në llogaritë nga libri kryesor dhe në llogaritë në librin ndihmës dokumentet e pranuar në vijim për furnizimin e materialeve në ndërmarrjen “Gramont” Veles.

1. Është pranuar **fatura me nr. 453** prej furnizuesit “Premium” , Shkup për materialet e furnizuara në vijim:

5000 kg çimento me çmimin 10 den. për kg.

2000 copa tulla me çmimin 7 den. për copë.

3000 kg. gëlqere me çmimin 5 den. për kg.

Në faturën e furnizuesit është përlllogaritur + **18% TVSH**. Për transportin e materialeve është pranuar **fatura me nr. 753** nga ndërmarrja transportuese “Transshped” Shkup në shumën 8000 den. + 18% TVSH. Për shkarkimin i është paguar me para në dorë personit fizik “NN” 1000 den sipas **faturës nr.23**.

Të formohet vlera furnizuese dhe çmimi furnizues i materialeve të furnizuara me përdorimin e llogarive për përlllogaritjen e furnizimit nga grupi **30**. Sipas **fletëpranimit 487** materialet pranohen në rezervë në magazinë me vlerën furnizuese - çmime.

2. Ndërmarrja “Gramont” i jep **urdhëresë** Stopanska bankë-s, Veles që prej mjeteve të[parave nga llogaria të paguhet fatura e furnizuesit “Premium” në shumë prej _____. dhe fatura e furnizuesit “Transshped” prej ____ den. Banka me **fragmentin nr. 963** njofton se i ka paguar furnizuesit “Premium” _____ den. dhe furnizuesit “Transshped” _____ den.

Të përmbushen të gjithë dokumentet e përmendur.

3. Në detyrën e sipërme, materialet e furnizuar, ishte cekur të pranohen në rezervë me çmimet **furnizuese** me të cilat edhe u pranuan. Materialet mund të evidentohen në rezervë me çmimet e planit. Të evidentohet pranimi i materialeve në rezervë me **fletëpranim** me supozim se materialet mbahen me çmimet e planit të cilat për çimenton janë 13 den. ndërsa për tullat janë 9 den. ndërsa për gëlqeren është 7 den.

4. Të bëhet kalkulimi nr. 258 për materialet e furnizuara. Shpenzimet e varura krahasohen në mënyrë proporcionale me sasinë e materialeve.

-Të evidentohet furnizimi i materialeve sipas kalkulimit nr. 258.

“Gramont” Veles

Veles 01. 03. 2009

KALKULKIMI NR.28

I bërën bazë të:

1. Fatura e furnizuesit ‘’Premium’’ Shkup nr. 453
2. Fatura për transportin me nr. 753 e ‘’Transshped’’ Shkup
3. Ftura me nr.23 për shkarkim

Nr.	Lloji i materialit	Masa për një	Sasia	Çmimi i faturës		Shpenzimet e varura		Vlera furnizuese		TVSH		Vlera e planifikuar	
				Veçmas	Gjithsej	Veç.	Gjith.	Veç.	Gjith.	Veç.	Gjith.	Veç.	Gjith.
1	Çimento												
2	Tulla												
3	Gëlqere												
	Gjithsej												

Kalkuluesi

Shefi i furnizimit

SHPENZIME-NOCIONI DHE LLOJET

Nocioni, roli dhe rëndësia e shpenzimeve

Shpenzimet janë shpenzime të shprehura me vlerë dhe puna që është pjesë përbërëse e çmimit të kostos të rezultateve.

Shpenzimet përherë kanë qenë komponenti kyç në punën e çdo subjekti ekonomik. Subjektet ekonomik janë bartës të aktiviteteve ekonomike a dihet s nuk ka aktivitet pa krijimin e shpenzimeve. Shpenzimet janë harxhime të mjeteve dhe punës të shprehur në vlerë, që është pjesë përbërëse e çmimit të rezultateve. Krijimi i tyre është i ndërlidhur me krijimin e rezultateve – prodhime. Shpenzimet e përgjithshme të bëra për prodhimtarinë e caktuar e paraqesin çmimin e kostos së asaj prodhimtarie. Prej lartësisë së shpenzimeve varet edhe madhësia e rezultatit financiar të realizuar. Shpenzime më të ultë do të thotë rezultat financiar më i madh, prandaj shpenzimet shihen si faktor prej të cilit varet sukcesi i punës së ndërmarrjes. Profitabiliteti si qëllim arrihet me rritjen e çmimit të shitjes, a me anashkalimin e komponentit shpenzues, mirëpo, është i njohur fakti se pakujdesia për shpenzimet në periudhë më të gjatë do ta sjellë në pyetje mbijetesën e çdo ndërmarrjeje .



Shpenzimet janë faktori nga i cili varet sukcesi i punës

Llogaritë në të cilat evidentohen shpenzimet quhen llogari shpenzuese. Gjatë periudhës përlllogaritëse çdoherë kur krijohen shpenzime evidentohen në llogaritë për shpenzime në anën e tyre pozitive. Në fund të periudhës përlllogaritëse këto llogari mbyllen dhe nuk kanë saldo. Shpenzimet mund të ndahen sipas kriterëve të ndryshëm. Sipas këndvështrimit kontabilist, ndarjet më të rëndësishme të shpenzimeve janë:

- shpenzime sipas llojeve natyrore
- shpenzime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta
- shpenzime sipas vendeve
- shpenzime sipas bartësve
- shpenzime faktike, të planit dhe standarde
- shpenzime fikse, gjysmë variable dhe variable.

Llojet e shpenzimeve

Grupimi i shpenzimeve sipas **llojeve të natyrshme** të tyre është ndarje fillestare e cila tregon se nga cili lloj i mjeteve rrjedhin shpenzimet, gjegjësisht cili lloj i mjeteve financiare është harxhuar , më saktë sa janë harxhuar materiale, inventar i imët, amortizimi, sa mjete parash janë paguar për rroga, për shërbime dhe kontribute dhe ngjashëm.

Këto lloje shpenzime quhen edhe lloje të natyrshme të harxhimeve për shkak se grupimi i tyre bëhet sipas natyrës së mjeteve fizike që harxhohen dhe natyrës së mjeteve të parave të harxhuara pavarësisht në rezultatet për të cilat kanë të bëjnë.

Shpenzimet nga ndarjet tjera nuk janë shpenzime jashtë llojeve të natyrshme por janë shpenzimet e njëjta të cilat pasi të identifikohen, ristrukturohen, respektivisht ri klasifikohen për qëllime të ndryshme sipas nevojës së kushteve konkrete.

Lloje të natyrshme të harxhimeve janë: materialet e harxhuara, rrogat, amortizimi, shërbimet, kontributet dhe shpenzime të tjera të ngjashme në barë të çmimit të kostos.

Shpenzimet që rrjedhin nga puna janë lëndë e evidencës së obligueshme kontabiliste. Për evidentimin e tyre është rezervuar **klasa 4 – Shpenzime dhe të dala nga puna**. Në suazat e kësaj klase janë formuar grupet:

40- Shpenzime për lëndë të para, materiale, energji, pjesë rezerve dhe inventar i imët;

41- Shërbime me karakter të shpenzimeve materiale;

42- Rezervime për harxhime dhe rreziqe;

43- Amortizimi dhe harmonizimi në vlera i mjeteve afatgjata dhe afatshkurta;

44- Shpenzime jo materiale nga puna;

45- Shpenzime të tjera nga puna e aktiviteteve të rregullta;

47- Rroga dhe kompensime;

48- Shpenzime në bazë të kamatave, dallimeve të kursit dhe shpenzime të ngjashme;

49- Radhitja e shpenzimeve.

Nga kjo rrjedh se klasa katër është e dedikuar për evidentimin e harxhimeve sipas llojeve. Pas kësaj përfshirjes së parë të harxhimeve në kontabilitetin, të njëjtat edhe më tutje evidentohen, përlllogariten dhe grupohen nga aspekte të tjera për shembull, sipas rezultateve që janë bërë, njësitë përlllogaritëse ku janë bërë dhe ngjashëm. Në përlllogaritjen e prodhimit sipas mundësisë për përfshirje në çmimin e rezultateve, ndarja e shpenzimeve është në:

a) të drejtpërdrejta

b) të tërthorta

Shpenzimet e drejtpërdrejta janë ato për të cilat edhe gjatë krijimit të tyre dihet se për cilin rezultat kanë të bëjnë, ashtu që në mënyrë të drejtpërdrejtë mund të shpërndahen sipas rezultateve të caktuara (prodhime dhe shërbime). Shpenzimet e atilla janë rrogat për përpunim, materiali për përpunim dhe të ngjashme.

Shpenzimet indirekte janë ato të cilat nuk mund të shpërndahen drejtpërdrejtë në rezultate të caktuara gjatë krijimit të tyre.

Ato janë të njohura edhe si shpenzime të përgjithshme ose shpenzime regjie. Bëhet fjalë për shpenzime të përbashkëta të cilat kanë të bëjnë për më shumë rezultate të cilat paraprakisht lidhen për vende të caktuara të shpenzimeve, ndërsa mandej shpërndahen në mënyrë të drejtpërdrejtë në prodhimet.

Klasa 4 është përpunuar në bazë të ndarjes së shpenzimeve sipas llojeve të natyrshme.



Shpenzimet duhet të zvogëlohen.

Ndarja në **shpenzimet sipas vendeve dhe sipas bartësve** është bërë në aspekt të shpërndarjes së tyre nëpër sektorë, reparte, njësi ekonomike si vende të shpenzimeve dhe sipas rezultateve si bartës të shpenzimeve. Shpenzimet nëpër vende më tutje shpërndahen nëpër bartës, respektivisht sipas rezultateve. Në varësi nga ajo a bëhet fjalë për shpenzime të cilat

Janë parashikuar paraprakisht, ose janë krijuar faktikisht, shpenzimet ndahen në: **faktike, të planit dhe shpenzime standarde.**

Shpenzimet faktike janë shpenzime me të vërtetë të bëra në periudhën përlllogaritëse. Të dhënat për shumën e tyre në një periudhë fitohen nga kontabiliteti. Këto shpenzime quhen edhe shpenzime për periudhën.

Shpenzimet e planit janë shpenzime të parashikuara për periudhë të caktuar të ardhshme. Baza për planifikimin e tyre janë shpenzimet faktike nga periudhat e kaluara dhe parashikimet e harxhimeve për periudhën për të cilën planifikohen, për çka këto shpenzime konsiderohen edhe si shërbime normale që duhet të krijohen në kushte normale për punë.

Shpenzimet standarde janë përcaktuar në bazë të metodave shkencore, për përcaktimin e tyre përdoren metoda shkencore dhe lëvizja e çmimeve në periudhën vijuese. Si të atilla ato janë masë e vërtetë e ekonomizimit në punën në këto ndërmarrje ku janë vendosur.

Ndarja në **shpenzime fikse, variable dhe gjysmë fikse** është definuar në aspekt të asaj se si reagojnë shpenzimet në ndryshimet në vëllimin e prodhimit, respektivisht të të punësuarit të kapacitetit.

Shpenzimet fikse janë ato të cilat në shumën e tyre të përgjithshme mbesin të njëjta pavarësisht nga shkalla e punësimit të kapacitetit, të atilla janë: amortizimi (kohor), kamatat për kreditë për mjete të përhershme, qiratë, shpenzimet për sigurim dhe ngjashëm.

Shpenzimet variable janë lloj i atillë i shpenzimeve të cilat në shumën e tyre të përgjithshme ndryshojnë (kanë variacione) me ndryshimin e vëllimit të prodhimit. Ato rriten me rritjen e prodhimit ose po bien poshtë me zvogëlimin e saj, raport të atillë kanë: materialet për përpunim, rrogat për përpunim dhe ngjashëm.

Shpenzimet gjysmë fikse (gjysmë variable) janë ato shpenzime të cilat nuk ndryshohen në proporcion me shfrytëzimin e kapacitetit. Ato rriten kur rritet prodhimtaria, por jo në proporcion të njëjtë dhe anasjelltas. Ato mbesin të njëjta në zona të caktuara të prodhimit. Shpenzime të atilla janë: shpenzimet për ndriçimin e reparteve, rrogat e punëtorëve të regjisë etj. Në teori dhe në praktikë njihen edhe të ashtuquajtur **shpenzime marginale**, ato janë shpenzime të cilat paraqiten si rezultat i nevojës për menaxhim më efikas në fushën e shpenzimeve dhe nivelin e caktuar të punësimit të kapacitetit që duhet të arrihet.

Ju tërheqim vëmendjen se përfshirja e parë e shpenzimeve është në kontabilitetin financiar edhe atë sipas llojeve të tyre. Si pasojë në kontabilitetin e shpenzimeve ato përfshihen sipas vendeve të shpenzimeve dhe sipas bartësve të shpenzimeve me qëllim që të formohet gjegjësisht të kalkulohet çmimi i kostos së rezultateve.



Shpenzimet duhet të zvogëlohen.

Përfshirja kontabiliste e shpenzimeve kalon nëpër fazat në vijim: përfshirje e llojeve të natyrshme të shpenzimeve për ndërmarrjen si tërësi, shpërndarja e llojeve të natyrshme të shpenzimeve nëpër vende dhe nëpër bartës të shpenzimeve, përllogaritja interne nëpërmjet vendeve të shpenzimeve dhe përllogaritja përfundimtare e shpenzimeve nëpër bartës.

A) EVIDENTIMI I HARXHIMIT TË MATERIALEVE (me dhënien nga rezerva)

Kur flasim për harxhimin e materialeve në kuptim më të gjerë të fjalës mendohet për harxhimin e pjesëve rezerve, inventarin e imët, ambalazhin dhe auto gomat. Të gjitha këto mjete paraprakisht furnizohen ndërsa më vonë jepen për nevojat e prodhimit. Dhënia e materialeve nga magazina për nevojat e punës bëhet me dokument të veçantë **-LISTË KËRKESASH**. Dokumentin e lëshojnë persona të autorizuar - udhëheqësit e reparteve ose seksioneve të tjera dhe me të i japin urdhëresë magazinierit t'i japë - për nevojat e seksionit në fjalë - mjetet e shënuara në listën e kërkesës. Në bazë të këtij dokumenti magazinieri i jep mjetet dhe në kolonë të veçantë të këtij dokumenti (ose me dokument të veçantë- fletë dërgesë) e shënon sasinë e dorëzuar. Materiali i dhënë i cili në fund të periudhës përllogaritëse ka mbetur i papërdorur, si edhe mbeturinat eventuale të cilat krijohen pas përpunimit kthehen në magazinë me ç'rast përpilohet dokument i veçantë -fletë kthesë e cila është e ngjashme me listën kërkesë. Gjatë shlyerjes së inventarit të imët, ambalazhit dhe auto gomave përpilohet procesverbal në bazë të të cilit evidentohet shlyerja.

Dhënia e materialeve nga magazina për nevojat e punës bëhet me dokument të veçantë **-LISTË KËRKESASH**.

a) Harxhimi i lëndëve të para dhe materialeve

Në bazë të kërkesave për harxhimin e materialeve zbatohen regjistrimet në vijim:

+ 400, 401, 404, 405 -	+ 310 320,350 -
I Mater. dhe pjes. rezer. të dhëna	

Nga prezantimi skematik rrjedh se:

Gjatë dhënies së materialeve-zvogëlimi i aktives me rritjen e shpenzimeve. Për materialet e harxhuara ngarkohet llogaria 400, ndërsa aprovon llogaria 310. Ndërsa për pjesët rezerve të dhëna ngarkohet llogaria 404, a aprovon llogaria 320.

Materialet e kthyer si edhe mbetjet e pranuar e rrisin aktiven, ndërsa i zvogëlojnë shpenzimet.

Shembulli 1: Për materialet e dhëna

Sipas listës së kërkesës janë dhënë materialet në vijim:

- material për përpunimin e prodhimeve të gatshëm	100 000
- lëndë djegëse dhe vaji	15 000
- material për zyra	8 000
- material për mirëmbajtje	5 000

Evidentimi:

N. r.	Ilogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
1.	4000		Ll/ia Lëndë të para dhe mater. të harxh.	100 000	
	4011		Ll/ia Lënda djegëse e harxhuar	15 000	
	4003		Ll/ia Mater. për zyra i harxh.	8 000	
	4005		Ll/ia Mat. të harxhuara për pastrim	5 000	
		3100	Ll/ia Lëndë të para dhe mater. në rezervë		100 000
		3105	Ll/ia Lënda djegëse dhe vaji në rezervë		15 000
		3104	Ll/ia Materiale të mbetura sipas listës së kërkesës me nr.		8 000
		3109			5 000
			Gjithsej	128.000	128.000

Shembulli 2: Për materialet e kthyera dhe mbetjet e pranuar

Sipas fletë kthesës nga prodhimtaria janë kthyer materiale në shumë prej 10000 den. dhe mbetje gjatë përpunimit të materialeve në shumë prej 6000 den.

Evidentimi:

N. r.	llogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
2.	3100		Ll/ia Lëndë të para dhe mater. në rezervë	10 000	
	3106		Ll/ia Mbetje në rezervë	6 000	
		400	Ll/ia Lëndë të para dhe mater. të harxh. sipas fletë kthesës nr.		16 000
			Gjithsej	16 000	16 000

Ky evidentim mund të zbatohet edhe me aplikimin e stornos së kuqe.

b) Harxhimi i inventarit të imët, i auto gomave dhe ambalazhit

Për dallim nga materialet, inventari i imët, ambalazhi dhe auto gomat nuk harxhohen menjëherë por në mënyrë të njëpasnjëshme, në varësi prej afati i tare i zgjatjes, prandaj harxhimi i tyre përcaktohet nëpërmjet shlyerjeve. Shlyerja e këtyre mjeteve mund të bëhet: 100% gjatë dhënies për përdorim (sende që thyhen shpejtë -gota për ujë, bokall); 50% gjatë dhënies në përdorim dhe 50% gjatë shlyerjes së tyre.

Nxjerrja nga përdorimi (sende me afat më të gjatë të jetës prej mbi një vit, ndërsa vlerën e kanë të vogël sa që do të ishte e papërshtatshme shlyerja me shkallë kalkuluese të bëhet çdo muaj), me shkallën kalkuluese të shlyerjes (sende vlera e të cilave është më e madhe për të cilën arsye, në bazë të afatit të tyre të jetës harxhimi llogaritet sipas shkallës kalkuluese të shlyerjes, shpërndahet në mënyrë të barabartë në shpenzimet e periudhës përkatëse të përllogaritjes). Këto sende kanë afat më të gjatë të jetës por shlyerja mund të jetë më së shumti për 5 vite dhe kjo do të thotë se çdo vit shlyhen me shkallë prej 20%. Në varësi prej mënyrës së shlyerjes, evidentimi dallon te harxhimi dhe riparimet e inventarit të imët, ambalazheve dhe auto gomave.

b1) kur shlyerja bëhet 100% gjatë dhënies

Kur për nevojat e prodhimitarisë jepen: inventar i imët, ambalazh dhe auto goma me 100% shlyerje, në rastin e tillë ndodhin

Dhënie e inventarit të imët me shlyerje 100% .

Ndryshime në aktiven me ç'rast rriten shpenzimet e këtij lloji të mjeteve ndërsa zvogëlohen rezervat. Me vlerën e plotë të mjeteve të dhëna ngarkohet llogaria 405-Shlyerja e inventarit të imët a si zvogëlim të rezervave do të kërkojnë llogaritë 350-Inventar i imët në rezervë dhe 352-Ambalazhi dhe auto goma në rezervë.

Shembulli 1: Sipas listës së kërkesës nr.1, janë dhënë në përdorim sende të inventarit të imët me shlyerje 100% në vlerë prej 500 den.

Evidentimi:

4050	Ll/ia Shlyerja e inventarit të imët	500
350	Ll/ia Inventar i imët në rezervë	500

Dhënë me shlyerje 100%

Dhënia e inventarit të imët me shlyerje 50% .

b2) kur shlyerja bëhet 50% gjatë dhënies në përdorim dhe 50% gjatë shlyerjes

Kur për nevojat e prodhimtarisë jepet inventar i imët, ambalazh ose auto goma me 50%shlyerje, në rast të atillë, vetëm gjysma e vlerës së tyre me vetë dhënien i rrit shpenzimet e këtij lloji ndërsa gjysma tjetër paraqet lloj tjetër të mjeteve, respektivisht mjete në përdorim dhe zbatohet evidentimi në anën pozitive të llogarisë 405- për 50% nga vlera, në anën pozitive të llogarive 351-Inventar i imët në përdorim, 353-Ambalazhi dhe auto goma në përdorim, ndërsa për vlerën e përgjithshme të sendeve të dhëna do të zvogëlohen rezervat dhe do të kërkojnë llogaritë 350 dhe 352. Për shkak se janë dhënë sende me afat më të gjatë të jetës, të mundshme janë edhe riparimet e tyre. Riparimet i zmadhojnë shërbimet për mirëmbajtje si shpenzime dhe evidentohen ë anën pozitive të llogarisë 412-Shërbime për mirëmbajtje ndërsa në anën negative në varësi nga krijimi, do të gjenden llogaritë nga grupi 10- Mjete parsh ose 22-Obligime ndaj furnizuesve.

Shembulli 2:

Sipas listës së kërkesës me nr. 2 është dhënë inventar i imët në përdorim për 40.000 den. me 50% shlyerje.

Evidentimi:

405	Ll/ia Shlyerja e inventarit të imët	20 000
351	Ll/ia Inventar i imët në përdorim	20 000
350	Ll/ia Inventar i imët në rezervë	40 000

Dhënë me shlyerje 50%.

b3) Kur shlyerja bëhet me shkallën kalkuluese

Pjesë të caktuara të inventarit të imët, ambalazhit dhe auto gomave, për nevojat e prodhimit mund të jepen edhe me shlyerje kalkuluese.

Bëhet fjalë për sende të cilat kanë afat më të gjatë të jetës, por për shkak të vlerës së vogël nuk janë në suazat e mjeteve të përhershme. Kur sendet e këtilla do të jepen në përdorim, ndodhin ndryshime vetëm në strukturën e aktives, (2)respektivisht rriten mjetet e këtij lloji në përdorim, ndërsa zvogëlohen rezervat. Realizohet evidentimi në anën pozitive të llogarive 351 dhe 353, ndërsa në anën negative në llogaritë 350 dhe 352. Zakonisht, në fund të periudhës përllogaritëse bëhet shlyerja me ç'rast rriten shpenzimet e këtij lloji të mjeteve dhe realizohet evidentimi në anën pozitive të llogarisë 405 - Shlyerja e inventarit të imët në anën negative të llogarisë 357 - Harmonizimi i vlerave evidentohet në shlyerjen e bërë. Pasi janë dhënë mjetet që të shërbejnë periudhë kohore më të gjatë, mënjanimi i dëmtimeve eventuale gjegjësisht riparimet që bëhen i zmadhojnë shërbimet si shpenzime dhe realizohet regjistrimi në anën pozitive të llogarisë 357, me ç'rast rritet vlera e mjeteve të dhëna, ndërsa në anën negative llogaritë e grupit 10 - mjete parash ose 22 - Obligime ndaj furnizuesve. Gjatë shlyerjes së mjeteve të dhëna në këtë mënyrë, për vlerën e pashlyer ngarkohet llogaria korigjuese 357 për shlyerjen e llogarisë 405, ndërsa për vlerën e përgjithshme do të kërkojë llogaria 351 ose 353 në varësi nga ajo se çka shlyhet.

Dhënia e inventarit të imët me shlyerje kalkuluese.

Shembulli 3:

1. Sipas listës së kërkesës nr. 3 është dhënë në përdorim
 - inventari i imët 80.000 den.,
2. Në fund të periudhës përllogaritëse bëhet shlyerje:
 - e inventarit të imët 30% ($80\ 000 \times 30 : 100 = 24\ 000$)
3. Sipas listës së kërkesës nr. 3 janë dhënë në përdorim
 - auto goma 30.000 den
4. Në fund të periudhës përllogaritëse bëhet shlyerja:
 - e auto gomave sipas t/km të kaluara 35% ($30\ 000 \times 35 : 100 = 10.500$)
5. Sipas listës së kërkesës me nr. 3 është dhënë në përdorim
 - ambalazhi 40 000 den.
6. Në fund të periudhës përllogaritëse bëhet shlyerja:
 - e ambalazhit 40% ($40\ 000 \times 40 : 100 = 16\ 000$)
7. Sipas procesverbalit shlyhet ambalazhi për shkak të amortizimit fizik. Vlera furnizuese e ambalazhit është 20.000 den. ndërsa për shlyerjen e bërë 8000 den. (40% të bilancit të gjendjes është shlyer) dhe si mbetje vlerësohet në 2000 den.

Evidentimi:

N r.	Ilogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
1	351	350	Ll/ia Inventar i imët në përdorim	80 000	80 000
			Ll/ia Inventari imët në rezervë inv.i im. i dhënë me shlyerje të kalk.		
2	4050	35710	Ll/ia Shlyerja e inventarit të imët	24 000	24 000
			Ll/ia Harmon. i vler. të inv. të im. në përdorim shlyerja e bërë		
3	3531	3521	Ll/ia Auto goma në përd.	30 000	30 000
			Ll/ia Auto goma në rezervë auto goma të dhëna me shlyerje kalk.		
4	4052	35712	Ll/ia Shlyerja e auto gomave	10 500	10 500
			Ll/ia Harmon. i vler. të auto gomave në përdorim shlyerja e bërë e auto gomave		
5	3530	3520	Ll/ia Ambalazhi në përdorim	40 000	40 000
			Ll/ia Ambalazhi në rezervë ambalazhi i dhënë me shlyerje kalkuluese		
6	4051	35711	Ll/ia Shlyerja e ambalazhit	16 000	16 000
			Ll/ia Harmon. i vler. të ambalazhit në përdorim		

			harmon. i vler. të ambalazhit shlyerje e bërë e ambalazhit		
7	35711		Ll/ia Harmon. i vlerave të ambalazhit	8 000	
	3106		Ll/ia Mbetje në rezervë	2 000	
	4051		Ll/ia Shlyerja e ambalazhit	10 000	
		3530	Ll/ia Ambalazhi në përdorim		
			për ambalazh të shlyer		20 000
			Gjithsej	220.500	220.500

B) EVIDENTIMI I HARXHIMIT TË MATERIALEVE (materiale furnizuese të harxhuara)

Këto shpenzime janë të ndërlidhura me materialet që nuk mund të magazinohen dhe në rast të atillë furnizimi i tyre, njëkohësisht është edhe harxhimi i tyre. Si dokument për evidentimin e tyre është pranuar faturë prej furnizuesve për shkak se paralelisht me rritjen e shpenzimeve rriten edhe obligimet ndaj furnizuesve.

Shembull:

1. Për energjinë e harxhuar elektrike është pranuar faturë për 20.000 denarë plus 18% TVSH ose vlera e përgjithshme 23.600 den.

Evidentimi:

1) 401- Ll/ia Energjia e harxhuar 20.000

1601- Ll/ia TVSH sipas faturës së pranuar 3.600

220-Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve 23.600

Për energji elek. të harxhuar sipas f-rës nr.

SHËRBIME ME KARAKTER TË HARXHIMEVE MATERIALE

Si shërbime me karakter të shpenzimeve materiale shërbimet e kryera nga ana e ndërmarrjeve ose personave juridik të cilët veprimtarinë e vet e kanë regjistruar për kryerjen llojit të këtillë të shërbimeve. Në suazat e këtyre shërbimeve bëjnë pjesë: shërbimet transportuese, shërbimet për mirëmbajtje dhe mbrojtje, shërbime panairi dhe ngjashëm. Për të gjithë ato, sipas planit llogaritës janë rezervuar llogari në suazat e grupit **41-Shërbime me karakter të shpenzimeve materiale** edhe atë:

- 410- Shërbime transportuese
- 411- Shërbime të jashtme për përpunimin e prodhimeve
- 412- Shërbime për mirëmbajtje dhe mbrojtje
- 413- Shpenzime për panairë
- 414- Qira, lizinë
- 419-Shërbime të tjera



Firmat shfrytëzojnë shërbime nga subjektet tjera

Si dokumentacion për ngjarjen e këtij llojit të shërbimeve janë pranuar fatura dhe sipas tyre evidentohen në mënyrë kontabiliste.

Shembull për evidentim:

1. Për transportin e bërë të mallit, është pranuar faturë nr. 45/05 nga furnizuesi "X" për 4.500 den. cilës vlerë i shtohen 18% TVSH me vlerë të përgjithshme prej 5.310 denarë.
2. Ndërmarrja, nga kooperanti i vet ka pranuar f-rë për shërbim të kryer prej 7.000 den. plus TVSH 18% në shumë të përgjithshme prej 8.260 den.
3. Për hapësirën afariste për pjesëmarrje në panair është pranuar f-rë për 20.000 den. plus 18% TVSH a në shumë të përgjithshme prej 23.600 den.

Evidentimi:

1) 410- Ll/ia Shërbime transportuese	4500	
1601- Ll/ia TVSH në f-ra të pranuar		810
220- Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve		5.310
<u>Sipas f-rës nr.45/05 për transportin e bërë</u>		
2) 411- Ll/ia Shërbime të jashtme	7.000	
1601- Ll/ia TVSH në f-ra të pranuar		1.260
220- Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve		8.260
<u>Sipas f-rës për shërbimet e bëra</u>		
3) 413- Ll/ia Shpenzime për panairë	20.000	
1601-Ll/ia TVSH në f-ra të pranuar		3.600
220- Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve		23.600
<u>Sipas f-rës nr.</u>		

Shërbimet si harxhime mund të jenë lëndë e përkufizimeve kohore, respektivisht si të paguara paraprakisht të evidentohen në llogaritë e grupit 19-

Shpenzime të paguara për periudhat e ardhshme (AVR), ndërsa si të llogaritura në grupin 29- Pagesa e shtyrë e shpenzimeve (PVR). Shembull për AVR kemi kur paguhet me avancë prej disa muajsh (më së shumti deri më 12m) për qira për hapësirë afariste dhe ngj.

REZERVIME TË KALKULKUARA TË SHPENZIMEVE DHE RREZIQEVE

Rezervimet e kalkuluara janë lloj i veçantë i shpenzimeve gjegjësisht bëhet fjalë për rezervime afatgjate që paraqesin përlllogaritje anticipuese të shpenzimeve për të cilat besohet me siguri të madhe se do të ndodhin në periudhat në vijim. Ato rezervohen dhe përlllogariten në mënyrë anticipuese pasi për to janë realizuar hyrje në shumë të plotë në periudhën kur përlllogariten. Nëse shpenzimet e këtilla nuk rezervohen, nëse nuk llogariten në periudhën kur janë realizuar hyrjet, do të shkaktojnë evidentim në periudhat e mëvonshme kur nuk realizohen hyrje dhe në atë bazë, do t'i rrisin të dalat, dhe me këtë do ta zvogëlojnë rezultatin financiar.

Rezervimet tipike dhe më të zakonshme janë për mirëmbajtjen investuese të mjeteve për punë, ripërtëritjen e pasurive, rreziqet afatgjate, shpenzimet për garanci etj. respektivisht shpenzimet të cilat me siguri të madhe pritet të ndodhin në periudhën e mëvonshme llogaritur prej kohës së shitjes së rezultateve që i kanë shkaktuar. Për evidentimin e këtyre rezervimeve në planin llogaritës oficial është parashikuar grupi 42 me llogaritë bazike në vijim:

420- Rezervimi i shpenzimeve për kompensimin e dëmeve

421- Rezervimi i pensioneve të të punësuarve

422- Rezervime për mirëmbajtjen investuese

423- Rezervime për garanci

429- Rezervime të tjera afatgjata për shpenzime dhe rreziqe. Prej strukturimit të llogarive shihet edhe dedikimi i këtyre shpenzimeve. Bëhet fjalë për rezervime afatshkurta dhe afatgjate të shpenzimeve materiale dhe rreziqeve. Për të gjitha rezervimet në çastin e kalkulimit ngarkohet llogaria përkatëse në suazat e të numëruarave më lartë, ndërsa aprovohet llogaria përkatëse 289-Rezervime të tjera afatgjate për rreziqe dhe shpenzime.

Gjatë shfrytëzimit të mjeteve të krijuara nëpërmjet rezervimit realizohet evidentimi i cili paraqet shuarje të obligimit kur rezervimi do të pushojë dhe eventualisht pjesa e pa harxhuar bartet si hyrje ndërsa ai veç më i harxhuar si dalje.

Shembull për evidentim:

1. Ndërmarrja parashikon të bëjë remont të përgjithshëm të makinave pas 5 viteve dhe për atë qëllim për vit bën rezervimin e shpenzimeve materiale në shumë prej 100.000 den. Pas skadimit të 5 viteve, është bërë remonti dhe nga furnizuesit në vend është pranuar f-rë për 550.000 den.

Evidentimi i shembullit:

2) 422- Ll/ia Rezervime për mirëmbajtje investuese	100.000
289- Ll/ia Rezervime të tjera afatgjata	100.000
<u>Për rezervimin e bërë për 1 vit</u>	
2a) 412- Ll/ia Shërbime për mirëmbajtje	550.000
220- Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve	550.000
<u>Remont i bërë sipas f-rës nr.</u>	
26) 289- Ll/ia Rezervime të tjera afatgjata	500.000
422- Ll/ia Rezervime për mirëmbajtje investuese	50.000
412-Ll/ia Shërbime për mirëmbajtje	550.000
<u>Për mbylljen e rezervimit</u>	

EVIDENCA E AMORTIZIMIT

Amortizimi paraqet shprehje në vlerë e shpenzimit të mjeteve të përhershme.

Amortizimi paraqet shprehje në vlerë e shpenzimit të mjeteve të përhershme. Me harxhimin pjesë pas pjese, e transferojnë vlerën e vet në prodhimet e gatshme, respektivisht transformimin në vlerë në mjete rrjedhëse.

Pasi të përcaktohet vlera furnizuese e një mjeti të përhershëm, vlerësohet afati im tij i jetës. Kur do të ndahet vlera furnizuese e mjetit të përhershëm me numrin e viteve të përdorimit të parashikuar, do të fitohet **amortizimi vjetor** që quhet edhe **kuota e amortizimit**. Kur do të ndahet kuota e amortizimit me 12, do të fitohet **amortizimi mujor**, respektivisht harxhimi mujor i mjetit të përhershëm. Shuma e harxhimit mujor të të gjitha mjeteve të përhershme e paraqet amortizimin mujor të firmës, e cila është lëndë e evidentimit çdo muaj në ditën e fundit të muajit, me qëllim që të përcaktohet shuma e harxhimeve të përgjithshme të firmës.

Për shumën e harxhimit vjetor të mjeteve të përhershme, çdo vit zvogëlohet vlera furnizuese. Njëkohësisht, me atë zvogëlim rriten edhe harxhimet e përgjithshme për shumën për të cilën zvogëlohet vlera furnizuese e mjetit të përhershëm. Bazë për përlllogaritjen e amortizimit paraqet vlera furnizuese e revalorizimit, në përputhje me MSS. Shkallët (vjetore) të amortizimit të cilat aplikohen për përlllogaritjen e amortizimit vjetor janë përcaktuar me Nomenklaturën e mjeteve për amortizim.

Llojet e amortizimit të mjeteve të përhershme:

1. Amortizimi kohor;
2. Amortizimi funksional dhe
3. Amortizimi racional



Llojet e amortizimit

Gjatë **amortizimit kohor**, faktori kohor është posaçërisht i rëndësishëm për lartësinë e amortizimit. Niset nga supozimi logjik se dhëmbi i kohës i ha mjetet e përhershme, gradualisht por sigurt ashtu që pas intervalit të caktuar kohor mjetet e përhershme do ta humbin dobishmërinë ose vlerën e tyre përdoruese krejtësisht. Që të përcaktohet amortizimi kohor, është e domosdoshme të përcaktohet numri i viteve të përdorimit të dobishëm të një mjeti të përhershëm. Me ndarjen e vlerës furnizuese me numrin e viteve të përdorimit të parashikuar, fitohet amortizimi për një vit, respektivisht kuota e amortizimit. Nëse vlera furnizuese e një mjeti të përhershëm është 20.000 denarë ndërsa afati i parashikuar i përdorimit është 5 vjet, atëherë amortizimi vjetor është 4.000 den. ($20.000:5=4.000$). Amortizimi shumë shpesh shprehet në përqindje. Kuota e amortizimit fitohet në përqindje kur numri 100 do të ndahet me numrin e viteve të përdorimit të dobishëm të mjetit të përhershëm. Në shembullin tonë kuota e amortizimit është 20% ($100:5=20$).

Amortizimi funksional përcaktohet jashtëzakonisht në bazë të intensitetit të përdorimit të mjetit të përhershëm. Afati i zgjatjes gjatë këtij lloji të amortizimit nuk merret parasysh. Te makinat për shembull, amortizimi do të varet prej numrit të orëve të punuara nga makinat në periudhë të caktuar, te mjetet transportuese numri i ton kilometrave të kaluar, te licencat numri i prodhimeve të prodhuara etj.

Te **amortizimi racional** merren parasysh të dy faktorët: intervali i kaluar kohor dhe intensiteti i përdorimit. Nuk ka dyshim se amortizimi racional është më i saktë. Numër i madh i mjeteve të përhershme amortizohen me kalimin e kohës edhe pse ato nuk përdoren aspak, si që mund të jetë rasti me automobilat për udhëtim. Bile, mund të paramendohet për disa vite, pa përdorim, një mjet i përhershëm aspak mos amortizohet në mënyrë fizike, me siguri do të jetë vjetruar në aspekt ekonomik. Është logjike sipas kësaj, gjatë përcaktimit të amortizimit të merret parasysh si intensiteti i përdorimit ashtu edhe koha e kaluar. Por, a amortizimi racional vështirë përcaktohet.

Llojet e metodave për përlllogaritjen e amortizimit

1. Metoda proporcionale
2. Metoda degressive ose
3. Metoda progresive.

Amortizimi proporcional do të thotë përcaktimi i kuotave të pa ndryshuara të njëjta të amortizimit gjatë tërë afatit të përdorimit të një mjeti të përhershëm. Amortizimi kohor paraqet shembull për amortizim konstant.

Gjatë **amortizimit degresiv** Kuotat e amortizimit prej viti në vit zvogëlohen ashtu që në vitin e parë amortizimi është më i madhi ndërsa në vitin e fundit më i vogli.

Amortizimi progresiv do të thotë që vitin e parë kuota e amortizimit të jetë më e vogla mandej gradualisht të rritet ashtu që në vitin e fundit të jetë më e madhja.

Evidentimi në lidhje me amortizimin

Nga këndvështrimi kontabilist, si edhe çdo lloj tjetër i shpenzimit i cili duhet të evidentohet me qëllim që të fitohet çmimi i saktë i kostos së prodhimeve të gatshme. Për atë qëllim, në ditën e fundit të muajit, çdo muaj evidentohet amortizimi i përlogaritur në anën e majtë të **LL/isë Amortizimi**, me evidentim të njëkohshëm në anën e djathtë të **LL/isë Amortizimi i përlogaritur** në fund të vitit, nën 13 dhjetor, amortizimi i përlogaritur gjatë tërë vitit evidentohet në anën pozitive të **LL/isë Amortizimi i përlogaritur** në anën e djathtë të **LL/isë Amortizimi i akumuluar**, në të cilën përndryshe akumulohen shlyerjet vjetore. Kur do të kalojë afati i përdorimit të mjetit të përhershëm, natyrisht se në **LL/inë Amortizimi i akumuluar** do të ketë shumë të akumuluar të njëjtë me vlerën furnizuese të mjetit të përhershëm. Nëse supozojmë se edhe mjeti i përhershëm është krejtësisht i shfrytëzuar, sa që nuk mund të shërbejë më atëherë do të duhet të zbatohet evidentimi për fshirjen e mjetit të përhershëm nga evidenca. Likuidimi i mjetit të përhershëm bëhet me anë të evidentimit të akumulimit të amortizimit të tërësishëm në anën e majtë të **LL/isë Amortizimi i akumuluar** i mjetit të përhershëm përkatës dhe në anën e djathtë për **mjetet e përhershme**. Me këtë do të shuhet të dy llogaritë. (rekomandimi: duhet që firma gradualisht të veçojë nga llogaria e transaksionit mjete parash në llogari të veçantë **LL/ia Mjete të veçuara të parave për mjete të përhershme**, pjesën e amortizimit veç më të përlogaritur, ashtu që pas skadimit të afatit të përdorimit do të ketë mjete të mjaftueshme të parave që në tërësi të zëvendësohet mjeti i përhershëm i harxhuar. Në këtë mënyrë sigurohet reproduktimi i thjeshtë, ndërsa njëkohësisht sigurohet integriteti i mjeteve të përhershme

Shembull:

1. Firma “Al Maks” nga Strumica në ditën 24.12.2004, ka furnizuar një makinë vlera furnizuese e formuar e së cilës është 60.000 denarë, ndërsa afati i zgjatjes së kësaj makine është përcaktuar për përdorim pesëvjeçar. Kjo firmë, si e kërkojnë rregullat, ka filluar të përlogarisë amortizim prej muajit të kaluar, respektivisht 01.01.2005. Në firmën “Al Maks” nga Strumica, do të zbatohen evidentimet në vijim në librat afaristë në lidhje me amortizimin, si edhe në fund në lidhje me likuidimin e kësaj makine:

përlllogaritja:

HB=60.000 n=5 vjet

GA=60.000:5=12.000 amortizimi vjetor

MA=12.000:12=1.000 amortizimi mujor

Evidentimi i shembullit:

1) 430-LI/ia Amortizimi me shkallë minimale	1.000	
02991- LI/ia Amortizimi i përlllogaritur i makinave	1.000	
<u>Amortizimi i përlllogaritur për m 01.2005</u>		
a) 430- LI/ia Amortizimi	1.000	
02991- LI/ia Amortizimi i përlllogaritur i makinave	1.000	
<u>Amortizimi i përlllogaritur për m.02.2005</u>		
<u>Ky zë përsëritet edhe 10 herë deri në fund të vitit</u>		
1b) 02991- LI/ia Amortizimi i përlllogaritur i makinave	12.000	
02922 LI/ia Amortizimi i akumuluar i makinave	12.000	
<u>Shlyerja vjetore e makinave për vitin 2005</u>		
1v) 02991- LI/ia Amortizimi i përlllogaritur i makinave	12.000	
02922 LI/ia Amortizimi i akumuluar i makinave	12.000	
<u>Shlyerja vjetore e makinave për vitin 2006</u>		
<u>Ky zë përsëritet edhe 3 herë (në fund të vitit 2007, 2008 dhe 2009)</u>		
1g) 02922 LI/ia Amortizimi i akumuluar i makinave	60.000	
02220 LI/ia Makina	60.000	
<u>Likuidimi i makinës së amortizuar dhe të shlyer</u>		

SHPENZIMET JOMATERIALE

Në suazat e shpenzimeve si lloj i veçantë veçohen edhe këto të ashtuquajtur shpenzime jo materiale. Konsiderohen jo materiale për shkak se nuk lindin si shpenzime të sendeve ose mjeteve të punës dhe në një farë mënyrë janë shpenzime, por pasi hyjnë në çmimin e kostos së rezultateve, doemos duhet të jenë shpenzime. Për evidentimin e tyre është rezervuar grupi 44- Shpenzime jo materiale nga puna, ndërsa në suazat e saj janë llogaritur:

- 440- Mëditje për udhëtime zyrtare dhe për shpenzime të udhëtimit
- 441- Kompensim i shpenzimeve të të punësuarve
- 442- Shpenzime për promovim, për propagandë, për reklamë, reprezentim dhe sponsorizim.
- 443- Premi për sigurimi
- 444- Tatime, kontribute, kuota anëtarësimi dhe ngjashme.
- 447- Shërbime bankiere
- 448- Shpenzime të tjera jo materiale.

Në llogarinë 440- Mëditje për udhëtime zyrtare, evidentohen shpenzimet të cilat krijohen nga udhëtimet zyrtare në vendin dhe jashtë. Si dokumentacion për evidentim janë llogaritë e rrugës, Pas parashtrimit të llogarisë rrugore rriten shpenzimet, ndërsa zvogëlohen mjetet e parave ashtu që ngarkohet llogaria 440, ndërsa aprovohet llogaria 102-Arka

Në anën pozitive të llogarisë 441 evidentohen të gjithë kompensimet e të punësuarve të cilat u takojnë sipas rregullave, më së shpeshti bëhet fjalë për pagesat me ç'rast zvogëlohen mjetet e parave ashtu që do të kërkojë llogari përkatëse nga grupi 10-Mjete parash.

Në anën pozitive të llogarisë 442 evidentohen shpenzimet krijimi i të cilave është në bazë të faturës së pranuar, prandaj më së shpeshti kërkon llogaria 220-Obligime ndaj furnizuesve në vend.

Në llogarinë 443 evidentohen shpenzimet në bazë të sigurimit të mjeteve dhe në realitet ato janë premitë të cilat rrjedhin nga policat e sigurimit. Për shkak se bëhet fjalë për pagesa të bëra paraprakisht, këto shpenzime në shumicën rasteve janë lëndë e përkufizimeve kohore. Për preminë e paguar ngarkohet llogaria përkatëse nga grupi 19- AVR, ndërsa do të kërkojë llogaria 100- Xhirollogaria. Premia si shpenzim përkufizohet nëpër muaj me ç'rast evidentohet në anën pozitive të ll-isë 443, ndërsa në anën negative ll-ia përkatëse e gr.29- PVR.

Në anën pozitive të ll-isë 444 evidentohen tatimet e paguara, kontributet etj. pavarësisht nga rezultati, me ç'rast do të kërkojë ll-ia 100- Xhirollogaria.

Në llogarinë 447 evidentohen shërbimet nga bankat, ndërsa në anën negative çdoherë është llogaria 100- Xhirollogaria.

Shembuj:

1. Pas kthimit nga udhëtimi zyrtar personi paraqet ll-i udhëtimi për 3.000 denarë prej të cilave 2.000 denarë mëditje dhe 1.000 denarë bileta udhëtimi. Fatura e udhëtimit është paguar.
2. Për transportin e punëtorëve në punë dhe prej pune është pranuar fatura për 10.000 denarë me + 18% TVSH.
3. Prej prodhimeve vetjake, partnerëve afarist si reprezentim u janë dhënë prodhime të gatshme në vlerë prej 5.000 denarë, për këto prodhime përllogaritet 8% TVSH ndërsa çmimi i kostos është 4.000 denarë.
4. Prej kompanisë të sigurimit është pranuar polica e sigurimit të mjeteve prej 100.000 denarë.
5. Prej llogarisë së transaksionit është paguar sipas fragmentit nga banka 10.000 denarë në emër të kontributeve në odën ekonomike.
6. Për shërbime bankiere është paguar nga llogaria e transaksionit 2.000 denarë.

Evidentimi:

1) 4400- Ll/ia Mëditje për udhëtime zyrtare	2.000	
4402- Ll/ia Kompensim për shpenzimet për udhëtim	1.000	
102- Ll/ia Arka		3.000
<u>Fatura e paguar për udhëtim</u>		
2) 4410- Ll/ia Kompensimi i shpenzimeve për transport	10.000	
1601- Ll/ia TVSH në faturat e pranuar	1.800	
220- Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve		11.800
<u>Për transport sipas f-rës nr.</u>		
3) 4424- Ll/ia Shpenzime për reprezentim	5.900	
755- Ll/ia Hytje në bazë të përdorimit të prodhimeve vetjake	5.000	
260- Ll/ia Obligime për TVSH	900	
<u>Prodhime të gatshme të dhëna për reprezentim</u>		
3a) 7005- Ll/ia Të dala në bazë të prodhimeve të përdorura	4.000	
630- Ll/ia Prodhime në rezervë		4.000
<u>Rezerva të zvogëluara</u>		
4) 443- Ll/ia Premi për sigurim	100.000	
220-Ll/ia Obligime ndaj furnizuesve		100.000
<u>Për policë të pranuar</u>		
5) 4445- Ll/ia Shpenzime për kontribute		
Oda ekonomike	10.000	
100- Ll/ia Xhirollogaria		10.000
<u>Kontribute të paguara në odën</u>		
6) 447- Ll/ia Shërbime bankiere	2.000	
100- Ll/ia Xhirollogaria		2.000
<u>Provizioni bankier i paguar</u>		

RROGA DHE KOMPENSIME

Rrogat e kalkuluara si shpenzim për ndërmarrjen paraqesin obligime afatshkurta ndaj të punësuarve të cilat duhet të kompensohen brenda afatit të arritjes. Kusht për kompensimin këtyre shpenzimeve është që ndërmarrja të disponojë me mjete parash në llogarinë e transaksionit në bankë. Rrogat janë elementi konstitutiv i çmimit të kostos së rezultateve.



Të punësuarit punojnë për kompensim mujor

Ato e gjejnë vendin në evidencën kontabiliste, ndërsa si dokument shërbejnë listat e pagimit (lista e rrogave).

Rrogat e kalkuluara si shpenzim për subjektin afarist paraqesin obligim afatshkurta ndaj të punësuarve, i cili duhet të kompensohet brenda afatit të arritjes. Kusht për kompensimin e këtij obligimi është që subjekti afarist të disponojë me mjete të mjaftueshme të parave në llogarinë e transaksionit.

Kategoria ekonomike rroga bruto definohet si bazë prej të cilës llogariten dhe paguhen kontributet. Rroga bruto paraqet përmbledhje e rrogës neto, e tatimit personal në rrogë dhe kontributet (kontributi për SPI të obligueshëm, kontributi për sigurimin e obligueshëm shëndetësor, kontributi për sigurimin e obligueshëm në rast të papunësisë, kontributi plotësues për sigurimin e obligueshëm shëndetësor në rast të lëndimit në punë dhe sëmurjes profesionale).

rroga bruto=rroga neto+tatimi personale në rrogë+kontribute

Rregullat e evidentimit:

Rregullat e evidentimit:

1. Në anën pozitive të II-isë 470- Rroga të kalkuluara evidentohet shuma bruto e rrogave, në anën pozitive të II-isë 471-Kompensime të kalkuluara evidentohet shuma bruto e kompensimeve, në anën negative të II-isë 270- Obligime për rroga evidentohet shuma bruto e përgjithshme.
2. Zbatohet evidentimi që paraqet përkufizim të rrogave. Në anën pozitive të II-isë 270- Obligime për rroga paraqitet shuma e përgjithshme e rrogave bruto ndërsa në anën negative të llogarisë 271- Rroga neto evidentohet shuma neto e rrogave, në anën negative të II-isë 272- Kompensime të rrogave neto evidentohet shuma neto e kompensimeve, në anën negative të II-isë 273- Tatime nga rroga evidentohet tatimi personal dhe në anën negative të II-isë 274- Kontribute nga rroga evidentohen kontributet që rrjedhin nga rregullat ligjore.
3. Zbatohet evidentimi i rrogave të paguara me ç'rast zvogëlohen obligimet të cilat rrjedhin nga rrogat dhe ngarkohen II-itë: 271, 272, 273 dhe 274 për shumat e përlllogaritura paraprakisht për shumën e përgjithshme si zvogëlim i mjeteve të parave do të kërkojë llogaria përkatëse nga grupi 10-Mjete parash gjegjësisht II-itë 100 ose 102 në varësi nga ajo se prej ku bëhet pagesa.

Shembulli 1:

1 Në SHPK “ECO-Company” sipas përlllogaritjes së përpiluar për rrogë bruto, rroga për një të punësuar për muajin mars në vitin rrjedhës është 20.000 denarë, prej të cilave në emër të kontributeve nga rroga janë 5.400 denarë, ndërsa në emër të tatimit personal janë 756 denarë. Bëhet përlllogaritja dhe pagesa e rrogës.

TEMA 7: Evidentimi i materialeve dhe shpenzimeve

Përlllogaritja e rrogës:

N.

rend.	Përshkrimi	Normë	Shuma
1.	Rroga bruto – baza për përlllogaritje		20.000
2.	Kontributi për SPI të obligueshëm	18,00 %	3.600
3.	Kontributi për sigurimin e obligueshëm shëndetësor Shkalla Shuma	7,30 %	1.460
4.	Kontributi plotësues për sigurimin shëndetëso të obligueshëm në rast të lëndimit në punë dhe sigurimi profesional	0,50 %	100
5.	Kontributi për sigurimin e obligueshëm në rast të papunësisë (kontributi për punësim)	1,20 %	240
6.	Kontribute – Gjithsej (2+3+4+5)	27,00 %	5.400
7.	Bruto rroga e zvogëluar për kontribute (1-6)		14.600
8.	Lirimi personal		7.035
9.	Baza tatimore për përlllogaritjen e tatimit personal në hyrje (7-8)		7.565
10.	Tatimi personal në hyrje	10%	756
11.	Rroga neto (1-6-10)		13.844

Në bazë të këtyre të dhënave do të zbatohen regjistrimet në vijim të rrogës në ditar:

N r.	llogaria		PËRSHKRIMI	Shuma	
	+	-		+	-
1	470	270	Ll/ia Rroga të kalkuluara	20.000	
			Ll/ia Obligime për rroga dhe kompensime nga rroga në bazë të përlllogaritjes për muajin 03		20.000
1a	270	271	Ll/ia Obligime për rroga	20.000	
		273	Ll/ia Rroga neto		13.844
		274	Ll/ia Tatimi personal		756
			Ll/ia Kontribute nga rroga krijimi i obligimit për rrogë bruto për muajin 03		5.400
16	271	100	Ll/ia Rroga neto	13.844	
	273		Ll/ia Tatimi personal	756	
	274		Ll/ia Kontribute nga rroga	5.400	
			Ll/ia Xhirollogaria obligime të paguara nga rroga bruto për muajin 03		20.000
			Gjithsej	60.000	60.000

Shembulli për evidentim 2:

Prej listës pagesore mujore janë fituar të dhënat në vijim:

1. Rroga neto 500.000
2. Tatimi personal 70.000
3. Kontribute nga rroga 20.000
4. Rroga bruto (1+2+3) 690.000

Ndërmarrja pagesën e bën nëpërmjet bankës në të cilën ka llogari transaksioni.

Evidentimi:

1) 470- Ll/ia rroga të kalkuluara		690.000
270- Ll/ia Obligime për rroga dhe kompensime		690.000
<u>Sipas listës pagesore për muajin</u>		
1a) 270- Ll/ia Obligime për rroga dhe kompensime		690.000
271- Ll/ia Rroga neto		500.000
273- Ll/ia Tatime nga rroga		70.000
274- Ll/ia Kontribute nga rroga		120.000
<u>Sipas përlllogaritjes së rrogave bruto (rroga të përkufizuara)</u>		
1b) 271-Ll/ia Rroga neto		500.000
273- Ll/ia Tatime nga rroga		70.000
274- Ll/ia Kontribute nga rroga		120.000
100-Ll/ia Xhirrollogaria		690.000
<u>Sipas fragmentit nga banka për rroga të paguara për muajin</u>		

Llogaritë nga kl. 4 në fund të periudhës përlllogaritëse duhet të kenë saldo 0.

RENDITJA E SHPENZIMEVE

Evidentimi i shpenzimeve sipas llojeve nëpër llogaritë përkatëse nga klasa 4 e paraqet përfshirjen e tyre të parë. Gjatë periudhës përlllogaritëse për evidentimin e shpenzimeve hapen në varësi nga lindja e shpenzimeve në punë. Këto llogari janë llogari të përkohshme për shkak se në fund të periudhës përlllogaritëse mbyllen.

Në ndërmarrjet tregtare shpenzimet e lindura nga puna nga klasa 4 barten drejtpërdrejtë në klasën 7 si shpenzime nga puna edhe atë me regjistrimin në anën pozitive (debitore) të llogarisë dalëse 703- Të dala në bazë të mallrave dhe materialeve të shitur në anën negative (kreditore) të llogarisë 4901-Renditja e shpenzimeve drejtpërdrejtë në barrë të hyrjeve të përgjithshme. Pas transferimit të shpenzimeve në klasën 7 llogaritë nga klasa 4 ndërmjet veti mbyllen me ngarkimin e llogarisë 4901, a me aprovim të llogarive nga klasa 4 të përdorura gjatë periudhës përlllogaritëse. Llogaritë aprovohen për shumën nga evidentimet në anën e tyre pozitive (debitore).

Në ndërmarrjet prodhuese bartja e mëtutjeshme e shpenzimeve është diçka më e ndërlikuar. Në këto ndërmarrje shpenzimet së pari transferohen

në klasën e lirë 5. Transferimi mund të jetë gjatë periudhës përlllogaritëse paralelisht me evidentimin e shpenzimeve në llogaritë e klasës 4-Shpenzime. Nëse transferimi nuk është mbaruar gjatë periudhës përlllogaritëse, realizohet në fund të periudhës. Shpenzimet e krijuara dhe të evidentuara në ll-itë përkatëse nga klasa 4 fillimisht transferohen në klasën 5 - të rregulluar paraprakisht, të lirë për pranimin e shpenzimeve. Në këtë klasë transferohen shpenzimet që hyjnë në çmimin e kostos të rezultateve ndërsa ato të cilat hyjnë në këtë çmim, transferohen drejtpërdrejtë në klasën 7- Të dala dhe hyrje edhe atë me evidentimin në anën pozitive të llogarisë 700- Shpenzime në bazë të prodhimeve të shitura ndërsa në anën negative të ll-isë 4901- Radhitja e shpenzimeve drejtpërdrejtë në bazë të hyrjes së përgjithshme. Në klasën 5-E lirë transferohen shpenzimet që hyjnë në çmimin e kostos së rezultateve. Transferimi është sipas llojeve në ll-itë përkatëse të grupit 50- Shpenzime sipas llojeve të tyre, në anën e tyre pozitive, ndërsa për shumën e përgjithshme kërkon llogaria 4900-Radhitja e shpenzimeve për përlllogaritjen e prodhimeve dhe shërbimeve. Shpenzimet e transferuara më tutje shpërndahen në të drejtpërdrejta dhe indirekte.

Për ato që duan të dinë më shumë: (Shpenzimet e drejtpërdrejta transferohen drejtpërdrejtë si shpenzime nëpër bartësit e llogarive analitike në suazat e bazikes 520-Prodhi i rezultateve. Transferimi është në bazë të përlllogaritjes interne (pasqyrës), ndërsa për shumën e përgjithshme aprovon llogaria 509-Transferimi i shpenzimeve nëpër vendet e shpenzimeve dhe bartësve.

Shpenzimet e drejtpërdrejta nga grupi 50-Shpenzimet sipas llojeve të tyre, transferohen nëpër vendet e shpenzimeve në llogaritë përkatëse në grupin 51-Shpenzime nëpër vendet e shpenzimeve edhe atë me ngarkimin e tyre a me aprovimin e ll-isë 509-Transferimi i shpenzimeve nëpër vende dhe nëpër bartës për shumën e përgjithshme. Transferimi është në bazë të përlllogaritjes interne. Shpenzimet indirekte të transferuara kështu me anë të përlllogaritjeve shpërndahen nëpër bartës me evidentimin në anën pozitive të llogarive në suazat e bazikes 590-Prodhi i rezultateve a me aprovimin e drejtpërdrejtë të llogarisë 51- shpenzime nëpër vende dhe nëpër bartës në të cilat kanë qenë paraprakisht këto shpenzime Me këtë shpërndarje dhe evidentim shpenzimet indirekte u shtohen atyre të drejtpërdrejtave dhe e formojnë çmimin e plotë të rezultatit. Në bazë të përlllogaritjes përcaktohet vlera e prodhimeve të gatshme dhe vlera e prodhimeve të pambaruara. Prodhimet e përfunduara e lëshojnë klasën 5- E lirë dhe transferohen në ll-inë 630-Prodhi në rezervë, ndërsa prodhimet e papërfunduara si prodhimtari në rrjedhë transferohet në ll-inë 600-Prodhimtari, ndërsa për vlerën e përgjithshme do të kërkojë llogaria 529-Transferimi i shpenzimeve nëpër prodhime. Ky transferim paraqet transformim të shpenzimeve në vlerë të prodhimtarisë të papërfunduar dhe të përfunduar, ndërsa edhe njëra edhe tjetra janë pozita bilancore në bilancin e gjendjes).

Pas gjithë këtyre evidentimeve fillohet me mbylljen e ndërsjellë të ll-ive nga klasa 4 –Shpenzime edhe atë me ngarkimin e llogarisë 4900-Radhitja e shpenzimeve për përlllogaritjen e prodhimeve dhe shërbimeve, të gjitha llog-

aritë tjera nga klasa 4 do të aprovohen për shumat me të cilat paraprakisht kanë qenë të ngarkuara dhe në fund të periudhës përlllogaritëse do të mbesin të mbyllura. E njëjta bëhet edhe me llogaritë e klasës 5-E lirë.

NOCIONET KRYESORE

Rezerva
Çmimi furnizues
Çmimi i planit
Kalkulimi
Shpenzime
Kërkesa
Amortizimi
Radhitja e shpenzimeve

PYETJE:

1. Çka nënkuptohet me nocionin lëndë të para dhe materiale?
2. Bëre dallimin ndërmjet materialeve, mallrave tregtar dhe prodhimeve të gatshme. Trego shembuj?
3. Çfarë duhet të sigurojë evidence e materialeve?
4. Si grupohen materialet?
5. Cilët janë dokumentet për furnizimin e materialeve?
6. Me cilat çmime mund të evidentohen materialet në rezervë?
7. Çka është vlera furnizuese dhe si formohet? Çka janë shpenzime të varura? Çka paraqet vlera e faturës?
8. Me cilët dokumente dokumentohen shpenzimet e varura?
9. Cilat llogari përdoren për formimin e vlerës furnizuese të materialeve?
10. Pse për llogaritë për formimin e vlerës furnizuese themi se kanë karakter të përkohshëm?
11. A kanë këto llogari saldo dhe si interpretohet e njëjta?
12. Kur shuhen llogaritë për përlllogaritjen e furnizimit?
13. Definoni nocionin shpenzime!
14. Çfarë ndikimi kanë shpenzimet mbi rezultatin financiar?
15. Si emërtohen llogaritë në të cilat evidentohen shpenzimet?
16. Në bazë të cilave kritere bëhet ndarja e shpenzimeve?
17. Shpjegoje ndarjen e shpenzimeve sipas llojeve natyrore!
18. Shpjegoji ndarjet tjera të shpenzimeve!
19. Si emërtohet dokumenti në bazë të së cilit bëhet dhënia e materialeve nga magazina?
20. Si emërtohet dokumenti në bazë të së cilit bëhet pagesa e materialeve nga reparti prodhues?

21. Në cilën mënyrë mund të bëhet shlyerja e inventarit të imët?
22. Definoje nocionin amortizimi!
23. Sqaroji llojet e amortizimit!
24. Sqaroji metodat për përlllogaritjen e amortizimit!
25. A duhet llogaritë e klasës 4 në fund të periudhës përlllogaritëse të kenë saldo?

Mendoni për këtë:

Një kamion për distribuim i cili ka kushtuar 180.000 den., para tre vitesh është përdorur në punën e firmës. Ai kamion tani kushton 90.000 den., ndërsa pronari mendon për kamion të ri. Çfarë ka ndodhur për tre vitet e kaluar kur është përdorur kamioni? Pronari a i ka pasur parasysh të gjitha shpenzimet e mundshme të biznesit të tij? Çfarë është lënë anash, është lëshuar? Si ka ndikuar kjo në fitimin (profitin) ose humbjen për secilin nga tre vitet kur është përdorur kamioni? Çka do i rekomandoni pronarit në drejtim të asaj se si ta ndryshojë këtë gjendje, çka të bëjë në ardhmëri?

USHTRIME PËR EVIDENCË:

Ngjarjet kontabiliste në vijim të evidentohen në urdhëresën për evidentim!

1. Prej furnizuesit “Heraklea” nga Manastiri janë blerë sipas f-rës nr. 148 lëndë të para edhe atë:

600m. lëkurë nga 500 den. për 1m.

400m. gjon nga 300 den. për 1m.

Në vlerën furnizuese përlllogaritet +18% TVSH. Për transportin dhe bartjen e lëndëve të para është pranuar f-ra me nr. 10.000 den.+18%TVSH, e cila më vonë është paguar nga arka. Lëndët e para në rezervë evidentohen me çmimet furnizuese. Të evidentohet pranimi i faturave për furnizimin, transportin dhe rezerva e lëndëve të para me çmime furnizuese.

2. Prej furnizuesit “Bargalla” nga Shtipi janë blerë sipas f-rës 432 materiale edhe atë:

200 kg. nga 300 den. për 1 kg.

Në vlerën furnizuese përlllogaritet 18% TVSH. Për transportin është pranuar dhe është paguar me para në dorë f-ra për 2.000 den.+18%TVSH. Materialet në rezervë evidentohen me çmimet furnizuese. Të evidentohet pranimi i faturave për furnizimin dhe transportin e rezervës së materialeve me çmime furnizuese.

3. Prej furnizuesit “Makpetroll” nga Shkupi është blerë lëndë djegëse dhe vaj sipas f-rës nr. 48 edhe atë:

400l. naftë nga 25den. për 1l.

600l. benzinë nga 30den. për 1l.

100 boca gazi nga 200den për 1bocë

Në vlerën furnizuese përllogaritet +18% TVSH. Për transportin dhe bartjen është pranuar f-ra për 4.800 den.+18%TVSH. Në rezervë lënda djegëse dhe vaji mbahet me çmime plani edhe atë

nafta 35den x 400l.

benzina 30den. x 600l.

gazi 230den x 100boca.

Të evidentohet pranimi i faturave për furnizimin dhe transportin e rezervave të lëndës djegëse dhe vajit dhe shmangia nga çmimet e planit.

4. Prej furnizuesit “Astibo” nga Shtipi janë blerë sipas f-rës nr. 76 materiale edhe atë:

120m. stof meshkujsh 250den. për 1m.

60m. stof femrash x 200den. për 1m.

500m. pëlhurë x 40den. për 1m.

Në vlerën furnizuese përllogaritet +18% TVSH. Për transportin dhe bartjen e materialeve është pranuar f-ra me nr.45 për 1.760 den.+18%TVSH. Materialet në rezervë evidentohen me çmime të planit. Çmimet e planit për materialet janë:

stof meshkujsh 260den. x 120m.

stof femrash 210den. x 60m.

pëlhurë 50den. x 500m.

Të evidentohet pranimi i faturave për furnizimin dhe transportin e rezervës të materialeve dhe pagesa e faturës për transportin nga Xhirollogaria.

5. Prej furnizuesit Euris, nga Shkupi sipas faturës nr.15, janë blerë lëndë të para edhe atë:

150kg. miell x 25den.

120 kg. sheqer x 35den.

Në vlerën furnizuese përllogaritet +18% TVSH. Për transportin dhe bartjen e lëndëve të para është pranuar f-ra nr. 17 në 800den. + 18% TVSH e cila më vonë është paguar nga arka. Lëndët e para në rezervë evidentohen me çmime furnizuese.

Të evidentohet pranimi i faturës për furnizimin dhe transportin, rezerva e lëndëve të para dhe pagesa e faturës për transportin nga arka.

6. Prej furnizuesit “Teteks” nga Tetova janë blerë materiale sipas f-rës nr. 80 edhe atë:

150m. stof femrash x 250den. për 1m.

100m. stof meshkujsh x 150den. për 1m.

Në shumën e faturës është shtuar 18% TVSH. Për transportin dhe bartjen e materialeve është pranuar f-ra me nr.18 dhe është paguar nga llogaria e transaksionit shuma prej 8.000den. + 18% TVSH. Materialet në rezervë evidentohen me çmime plani edhe atë:

stof femrash 240den. x 150m.

stof meshkujsh 120den. x 100m.

Të evidentohet pranimi i faturave për furnizimin dhe transportin, rezervat e

materialit dhe pranimi i faturës për transportin nga llogaria e transaksionit.

7. Prej furnizuesit “11 Tetori” nga Prilepi janë blerë pjesë rezerve të ndryshme sipas faturës me nr.313 për 19.000 den. + 18% TVSH. Për transportin e pjesëve rezerve të furnizuara është pranuar fatura me nr.242 nga Galeb-i prej Ohri në 4.000 den. + 18% TVSH. Për shkarkimin dhe vendosjen e pjesëve rezerve të arritura është pranuar fatura dhe është paguar me para në dorë nga arka në 1.200 den. +18% TVSH. Pjesët rezerve në rezervë evidentohen me vlerën furnizuese. Të evidentohet pranimi i faturave për furnizimin dhe transportin dhe rezerva e pjesëve rezerve, si edhe pagesa e faturës për shkarkimin dhe vendosjen.

8. Prej furnizuesit “EMO” nga Ohri janë blerë pjesë rezerve të ndryshme sipas faturës nr.242 për 80.000den. + 18% TVSH. Për transportin e pjesëve rezerve të furnizuara është pranuar fatura nr. 42 prej ATP “Proleter” nga Shkupi në 10.000den. + 18% TVSH. Pjesët rezerve në rezervë evidentohen me vlerën e planit prej 100.000 den. Të evidentohet pranimi i faturave për furnizimin dhe transportin e rezervës së pjesëve rezerve.

9. Prej furnizuesit “Rudnik” nga Zletova është blerë sipas faturës nr.21 inventari i imët edhe atë:

140 copa lopata x 260den.

100 copa sëpata x 290den.

Në vlerën e faturës përlllogarit +18% TVSH. Për transportin është pranuar f-rra me nr.15 nga “Ballkantransi” nga Shtipi për 2.400 den +18% TVSH. Inventari i imët në rezervë evidentohet me vlerën furnizuese. Të evidentohet pranimi i faturave për furnizimin dhe transportin e rezervës së inventarit të imët.

10. Prej furnizuesit “Sileks” nga Kratova është blerë sipas faturës nr.32 inventar i imët edhe atë:

60 copa çekanë x 820den.

70 copa lopata x 700den.

Në vlerën e faturës përlllogarit +18% TVSH. Për transportin është pranuar f-rra me nr.15 nga “Transkopi” prej Shtipi në shumë prej 4% nga vlera furnizuese +18% TVSH. Inventari i imët në rezervë evidentohet me vlerën e planit edhe atë:

Për çekanët 860den. x 60 copa

Për lopatat 720den. x 70 copa

Të regjistrohet pranimi i faturave për furnizimin dhe transportin e rezervave të inventarit të imët.

11. Prej furnizuesit “Slloboda” nga Ohri është blerë sipas faturës nr.43 inventari i imët edhe atë:

30 peshore muri x 1100den.

40 peshore tryeze x 1200den.

Në vlerën e faturës përlllogarit +18% TVSH. Për transportin është pranuar f-rra nr. 18 nga “Ballkantransi” prej Shtipi dhe është paguar nga arka shuma me para të gatshme prej 7.000 den. +18% TVSH. Inventari i imët në rezervë

evidentohet me vlerën e planit. Vlerat e planit janë 10% më të mëdha se ato faktike. Të evidentohet pranimi i faturave për furnizimin dhe transportin e rezervave të inventarit të imët.

12. Prej furnizuesit “Euris” nga Shkupi janë blerë materiale sipas faturës nr.143 edhe atë:

material A-300m. x 200den.

material B-500m. x 400den.

material V-400m. x 300den.

Në vlerën e faturës përllogaritet +18% TVSH. Për transportin është pranuar f-ra me nr.180 me shumën prej 38.000 den. +18% TVSH. Materialet në rezervë evidentohen me çmimin e planit në shumë prej 350.000 den. Të evidentohet pranimi i faturave për furnizimin dhe transportin e rezervave të materialeve.

13. Sipas kërkesës nr. 11 për nevojat e prodhimtarisë nga magazina janë dhënë materiale edhe atë:

130m, material A nga 740den. për 1m.

200m. material B nga 380den. për 1m.

800m, material nga 90den. për 1m.

14. Sipas kërkesës nr. 22 për nevojat e prodhimtarisë nga magazina janë dhënë materialet edhe atë:

150m. stof meshkujsh nga 82 den. për 1m.

200m. stof femrash nga 34 den. për 1m.

15. Sipas kërkesës nr.33 për nevojat e prodhimtarisë nga magazina janë dhënë materiale edhe atë:

300 l. benzinë nga 34 den për 1l.

400l. naftë nga 28 den. për 1l.

16. 44 për harxhime nga magazina janë dhënë materialet për zyra në vijim edhe atë:

200 lapsa nga 10 den

40 topa letër nga 500 den

17. Sipas kërkesës nr.55 nga magazina janë dhënë materiale për pastrimin e hapësirave për 4.320 den.

18. Sipas kërkesës nr.15 për nevojat e prodhimtarisë nga magazina janë lëshuar materiale edhe atë:

material “A” 200 kg. nga 100 den. për 1 kg. material “B” 150 kg. nga 110 den. për 1 kg. material “B” 250 kg. nga 150 den. për 1 kg.

19. Nga reparti është kthyer material “B”-50 kg. në magazinë si i kërkuar me gabim me fletë kthesë nr.5.

20. Sipas përllogaritjes së ngrohtores locale të ndërmarrjes është harxhuar për muajin e 10 tëngjill për 9.000 den. Në bazë të kërkesës ky shpenzim të evidentohet.

21. Sipas kërkesës nr.12 janë dhënë pjesë rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve për punë edhe atë:

pjesë rezerve “A”-160 copa nga 30 den. për 1 copë

pjesë rezerve “B”-200 copa nga 20 den. për copë.

22. Sipas kërkesës nr.24 për mirëmbajtjen e prodhimeve të shitura brenda afatit të garantuar janë dhënë pjesë rezerve për 3.200 den.
23. Sipas kërkesës nr. 41 janë dhënë pjesë rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve për punë edhe atë:
 - kushineta-20 copa nga 500 den. për 1 copë
 - rripa -10 copa nga 2.500 den. për 1 copë
24. Sipas kërkesës nr.80 janë dhënë pjesë rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve për punë edhe atë:
 - thika për gërshërë-100 copa nga 220 den. për 1 copë
25. Sipas kërkesës nr.7 është dhënë inventar i imët në përdorim me 100% shlyerje:
 - 10 komplete servis për kafe nga 300 den. për një.
 - 20 komplete servis për ujë nga 350 den. për një
26. Sipas kërkesës nr.10 është dhënë në përdorim ambalazh me 100% shlyerje:
 - 50 copa thes nga 50 den.
 - 60 copa arka nga 60 den.
27. Sipas kërkesës nr.4 janë dhënë auto goma me 100% shlyerje:
 - 80 copa auto goma të brendshme nga 600 den.
 - 60 copa auto goma të jashtme nga 2.500 den.
28. Me fletë kthyese është kthyer inventar i imët:
 - 5 komplet servil për kafe nga 300 den. për një
 - 10 komplet servil për ujë nga 350 den. për një
29. Sipas kërkesës nr.8 janë dhënë me 100% shlyerje pjesë rezerve
 - “X”-50 copa nga 500 den.
 - “Y”-40 copa nga 400 den.
30. Sipas kërkesës nr.23 është dhënë në përdorim inventar i imët me 50% shlyerje:
 - 40 copa shpuese betoni eletrike nga 1.200 den.
 - 20 copa çekanë nga 200 den.
31. Sipas kërkesës nr.32 janë dhënë në përdorim auto goma me 50% shlyerje
 - 25 copa auto goma të brendshme nga 700 den.
 - 70 copa auto goma të jashtme nga 2.800 den.
32. Sipas kërkesës nr.8 nga magazina janë dhënë në përdorim me 50% shlyerje inventar i imët, auto goma dhe ambalazh
 - 100 copa lopata nga 500 den
 - 80 copa arka nga 400 den
 - 60 copa auto goma të brendshme nga 300 den.
33. Sipas kërkesës nr.24 nga magazina janë dhënë në përdorim me 50% shlyerje ambalazhet:
 - ”A”,-30 copa nga 700 den.
 - “B”-60 copa nga 400 den.
34. Sipas kërkesës nr.1 nga magazina janë dhënë në përdorim auto goma me shlyerje kalkuluese:

- 100 copa SAVA auto goma të jashtme nga 2.700 den.
150 copa Goodyear auto goma të jashtme nga 3.000 den.
200 copa Misheline auto goma të jashtme nga 3.100 den. Të regjistrohet shlyerja mujore kalkulative, nëse afati i përdorimit është 10 muaj.
35. Sipas kërkesës nr.2 nga magazina është dhënë në përdorim inventar i imët me shlyerje kalkulative:
20 copa çekanë nga 250 den.
30 copa dara nga 200 den.
Të regjistrohet shlyerja mujore kalkulative, nëse afati i përdorimit është 2 vjet.
36. Sipas kërkesës nr.3 është dhënë në përdorim ambalazhi:
70 copa thasë nga 70 den.
60 copa kutia kartoni nga 80 den.
Të regjistrohet shlyerja mujore kalkulative nëse afati i përdorimit është 6 muaj.
37. Për energjinë e harxhuar elektrike në muajin janar është pranuar fatura nr.14 nga EVN Maqedoni në shumë prej 2.520 den.+18%TVSH.
38. Për pagesën e faturës nr.14 furnizuesit i është dhënë kambial për 2.974 den.
- 39.Për energjinë e harxhuar elektrike në muajin është pranuar fatura nr.33 nga EVN Maqedoni në shumën prej 5.410 den+18%TVSH
40. Sipas fragmentit nr.3 është paguar në shumën e transaksionit shuma prej 6.384 den.
41. Për energjinë e harxhuar elektrike në muajin janar, është pranuar fatura nr.44 prej EVN Maqedoni në shumë prej 4.800 den.+18%TVSH
42. Për pagesën e faturës nr.44 furnizuesit i është dhënë kambial për 2.800 den., ndërsa pjesa e mbetur është paguar në llogarinë e transaksionit.
43. Sipas kërkesës nr.22 për nevojat e prodhimit janë dhënë nga magazina materiale edhe atë:
material "A", 150m. nga 200 den. për 1m.
material "B", 200 m. nga 110 den. për 1m.
material "V", 250 m. nga 300 den. për 1m.
44. Nga reparti është kthyer material "B", - 50m. në magazinë si i kërkuar me gabim me fletë kthimi nr.5.
45. Sipas përlllogaritjes së ngrohtores lokale të ndërmarrjes, është harxhuar thëngjill në muajin e 12-të për 10.000 den. Në bazë të listës së kërkesës, ky shpenzim të regjistrohet.
46. Prej furnizuesit "Galea" prej Shtipi janë blerë pjesë të ndryshme rezerve sipas faturës me nr. 15 për 50.000 den.+18%TVSH. Për transportin e pjesëve rezerve të furnizuara është pranuar fatura nr.25 prej "Millaz Bogdanci" në 8.000 den.+18%TVSH. Për shkarkimin dhe vendosjen e pjesëve rezerve të arritura është pranuar fatura në 1.000 den. dhe është paguar me para në dorë nga kasa. Pjesët rezerve në rezervë evidentohen sipas vlerës furnizuese. Sipas kërkesës nr.8 janë dhënë pjesë rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve për punë në vlerë prej 35.000 den.
Të evidentohet furnizimi i pjesëve rezerve; faturat për transportin, për shkarkimin dhe vendosjen. Pjesa e faturës për shkarkimin; rezerva e pjesëve rezerve si edhe dhënia e pjesëve rezerve sipas listës së kërkesës.

47. Prej furnizuesit “Sileks” nga Kratova sipas faturës nr.11 është blerë inventar i imët
100 copa lopata nga 300 den.
50 copa sëpata nga 350 den. Në vlerën e faturës përlogarit 18%TVSH. Për transportin është pranuar faturë nga “Mllaz Bogdanci” në shumë prej 5.000 den.+18%TVSH. Fatura për transportin është paguar nga llogaria e transaksionit. Inventari i imët në rezervë evidentohet sipas vlerës së planit prej 47.000 den. Sipas kërkesës nr.111 është dhënë inventar i imët në përdorim me 50% shlyerje. Vlera e përgjithshme e inventarit të imët është 30.000 den. Me fletë kthimi nr.1 është kthyer inventari i imët me vlerë prej 2.000 den.
48. Prej furnizuesit “Mishelin” nga Shkupi sipas faturës nr.22 janë blerë auto goma në shumë prej 80.000 den. Në vlerën e faturuar është përfshirë edhe TVSH në shumë prej 12.200 den.
Për transport është pranuar fatura me nr.222 në shumë prej 10.000 den. në të cilën shumë është përfshirë TVSH në shumë prej 1.525 den. Auto gomat në rezervë mbahen me çmimin furnizues.
Sipas kërkesës me nr.25 janë dhënë auto gomat në vlerë prej 50.000 den. me 100% shlyerje.
49. Sipas kërkesës nr.1 nga magazina janë dhënë në përdorim auto goma me shlyerje kalkulative prej 850.000 den. Të evidentohet shlyerja mujore kalkulative nëse afati i përdorimit është 10 muaj.
50. Sipas kërkesës nr.2 nga magazina është dhënë në përdorim inventar i imët me shlyerje kalkulative në vlerë prej 250.000 den. Të evidentohet shlyerja kalkulative mujore nëse afati i përdorimit është 16 muaj.
51. Sipas kërkesës nr.3 nga magazina është dhënë në përdorim ambalazh me shlyerje kalkulative me vlerë prej 120.000 den. Të evidentohet shlyerja kalkulative mujore nëse afati i përdorimit është 6 muaj.
52. Për transportin e bërë të mallrave është pranuar fatura nr.13 nga ATP 2Galeb”, Ohër në shumë prej 4.500 den.+18%TVSH ose vlera e përgjithshme e faturës është 5310 den. Fatura është paguar prej llogarisë së transaksionit.
53. Për bisedat telefonike të bëra është pranuar fatura nr.63 për 24.000 den.+18% TVSH.
54. Fatura nr.63 është paguar nga llogaria e transaksionit për çka është pranuar fragment nga banka.
55. Prej SHT “Mehanika” është pranuar fatura nr.73 për përpunimin e tërësishëm të gjysmë prodhimeve në 38.000 den.+18%TVSH.
56. Fatura furnizuesit “Mehanika” i është paguar me kambial.
57. Prej bankës është pranuar fragment sipas të cilit është bërë pagesa e kambialit të dhënë.
58. Për servisimin e bërë të elektromotorit është pranuar fatura nr.14 për 23.000 den.+18%TVSH
59. Është pranuar fatura nr.76 prej organizatorit të Panairit të Shkupit për 2.000 den. Fatura është paguar prej llogarisë së transaksionit.
60. SHT. për qiranë e hapësirave afariste e ka pranuar faturën nr. 28 në 18.000 den.

61. Sipas faturës nr.4 prej arkës është paguar 4.800 den. për ushqim të blerë të dedikuar për punëtorët me ushqim të përforcuar.

62. Të bëhet përlllogaritja vjetore e amortizimit të PSS nëse janë në dispozicion të dhënat në vijim:

a) salla e fabrikës

vlera furnizuese=8.500.000 den.

shkalla e amortizimit=3%

b) makina

vlera e furnizimit=6.640.000 den. shkalla e amortizimit=12,5%

63. Është pranuar fatura prej TVM për 20.000 den. për propagandën e bërë.

64. Për mallrat e blerë të dedikuar për reprezentim nga arka është paguar me para në dorë shuma prej 6.800 den.

65. Prej prodhimeve vetjake janë dhënë prodhime për reprezentim për 20.000 den, kësaj vlere i shtohet 18% TVSH ose 3.600 den.

66. Për premi për sigurimin e PSS është blerë polica nr.00455 nga kompania e sigurimit për 32.600 den.

67. Banka ka bërë arkëtimin e provizionit bankier nga mjetet e llogarisë së transaksionit 850 den.

68. Për kontrollimet e bëra shëndetësore nga instituti për medicinën e punës është pranuar fatura nr.44 për 6.320 den.

69. Për shërbime kontabiliste të ndryshme të bëra është pranuar f-ra nr. 5 nga "Knigobiro" në shumën 10.200 den.

70. Punëtorit NN i është paguar avancë për udhëtim zyrtar në vend me para në dorë në shumën prej 8.400 den.

71. Punëtori ka paraqitur faturë udhëtimi sipas së cilës shpenzimet janë:

-për mëditje=3.000 den.

-për shpenzime udhëtimi = 5.400 den.

72. Punëtorit MM i është dhënë[avancë për udhëtim zyrtar në vend të huaj 300€ nga 60 den. Për 1€ dhe 2.300 den. nga arka kryesore.

73. Pas udhëtimit zyrtar të realizuar punëtori MM ka paraqitur faturë udhëtimi sipas së cilës shpenzimet janë:

-për mëditje në vend = 1.500 den.

-për mëditje në vend të huaj =12.000 den. (2 mëditje x 100€)

-për shpenzime udhëtimi në vend të huaj =8.400 den. (140€) –për shpenzime udhëtimi në vend =2.000 den.

Dallimi në kundërvlerë në denarë është paguar nga arka.

74. Sipas përlllogaritjes mujore (lista pagesore) të krijohet obligim për rrogën neto, tatimi personal dhe kontributet nga rroga, si edhe të njëjtat të paguhen edhe atë:

tatimi personal=117.616 den.

kontributi nga rroga=325.110 den.

rroga neto =637.380 den.

rroga e tërë (bruto)=1.080.106 den.

Të kalkulohet tërë rroga dhe të paraqiten obligimet sipas asaj baze. Të zbatohet evidentimi për pagesën e rrogës neto:

a) nëpërmjet llogarisë së transaksionit

75. Sipas përlllogaritjes mujore (listës pagesore) të krijohet obligimi për rrogën neto, tatimin personal dhe kontributet nga rroga, si edhe të njëjtat të paguhen edhe atë:

tatimi personal =120.350 den.

kontributi nga rroga =350.000 den.

rroga neto=650.000 den.

rroga e tërë (bruto)=1.120.000 den.

Të kalkulohet tërë rroga dhe të paraqiten obligimet në atë bazë. Të zbatohet evidentimi për pagesën e rrogës neto nëpërmjet llogarisë së transaksionit.

76. Sipas përlllogaritjes mujore (lista pagesore) të krijohet obligimi për rrogën neto, tatimin personal dhe kontributet nga rroga, si edhe të njëjtat të paguhen edhe atë:

tatimi personal =13.000 den.

kontribut nga rroga =35.000 den.

rroga neto=42.000 den.

rroga e tërë (bruto)=90.000 den.

Të kalkulohet rroga e tërë dhe të paraqiten obligimet në atë bazë. Të zbatohet evidentimi për pagesën e rrogës neto nëpërmjet llogarisë së transaksionit.

77. SHT bën kalkulimin e kompensimit nga rroga gjatë pushimit mjekësor në shumë prej 82.450 den. Nga kjo shumë në emër të tatimit personal është shuma prej 12.300 den., ndërsa në emër të kontributeve 24.380 den. Kompensimi për rrogë është paguar nga llogaria e transaksionit në shumë prej 45.770 den., ndërsa tatimet dhe kontributet gjithashtu nga llogaria e transaksionit.

78. SHT gjatë periudhës përlllogaritëse në kontot e klasës 4 ka regjistruar 2.000.000 den. Një pjesë e këtyre shpenzimeve, në lartësi prej 300.000 den. janë shpenzime të periudhës dhe transferohen drejtpërdrejtë në kontot për shpenzimet e periudhës përlllogaritëse, ndërsa 1.700.000 den. janë shpenzime për rezultate dhe transferohen në kontot përkatëse të klasës 5 në kontabilitetin e repartit. Me supozim të zbatohen të gjitha regjistrimet përmbyllëse. SHT i mbyll kontot nga klasa 4.

Tema 8:

EVIDENCA E OBLIGIMEVE DHE KAPITALI (burimet e mjeteve)

PËRMBAJTJA E TEMËS:

Burimet e mjeteve
Kapitali si burim i mjeteve
Kapitali i dominuar (i përhershëm)
Obligimet si burime të mjeteve
Obligime afatgjate
Obligimet rrjedhëse

QËLLIMET E MËSIMIT:

Nxënësi:
-t'i definojë nocionet obligime dhe kapital;
-t'i grupojë obligimet rrjedhëse (afatshkurta) dhe jo rrjedhëse (afatgjate);
-ta kuptojë evidencën kontabiliste të obligimeve ndaj furnizuesve dhe obligimet tjera,
-ta grupojë kapitalin dhe rezervat

BURIMET E MJETEVE

Në evidencat e obligueshme kontabiliste të ndërmarrjes përveç evidencës së mjeteve mbahet edhe evidenca e burimeve të mjeteve. Evidenca e mjeteve i përfshin ndryshimet e mjeteve, ndërsa evidenca e burimeve të mjeteve ka të bëjë me ndryshimet e tyre që shkojnë në drejtim të rritjes ose zvogëlimit të tyre.

Duke u nisur nga bilanci i gjendjes si pasqyrim i të gjitha mjeteve dhe të gjitha burimeve të mjeteve, mjetet janë pozita bilancore në aktiven, ndërsa burimet janë pozita bilancore në pasiven dhe sipas parimit të balancës bilancore, ekziston barazi ndërmjet madhësisë së mjeteve në aktiven dhe madhësinë burimeve në pasiven. Evidenca e burimeve, si edhe evidenca e mjeteve mbahet në llogaritë e përmbajtura në planin kontabilist. Sipas planit kontabilist për evidencën e burimeve të mjeteve janë rezervuar llogaritë në:

Klasa 9-Kapitali, rezervat dhe evidenca jashtë bilancore, ose Klasa 2-Obligime, rezervime afatgjata për shpenzime dhe rreziqe, dhe pagesa e shtyrë e shpenzimeve dhe hyrjeve

Nga llogaritë e obligueshme del se evidenca e burimeve do të ketë të bëjë me kapitalin dhe me obligimet.

Burimet janë pozita bilancore në pasiven dhe sipas parimit të balancës bilancore ekziston barazi ndërmjet madhësisë së mjeteve në aktiven dhe madhësinë e mjeteve në pasiven.

KAPITALI SI BURIM I MJETEVE

Kapitali i paraqitur në pasiven e bilancit të gjendjes si burim i mjeteve paraqet dallimin ndërmjet vlerës së përgjithshme në aktiven dhe shumën e përgjithshme të obligimeve në pasiven e bilancit edhe atë si burime të mjeteve, respektivisht nëpërmjet formulës:

Kapitali = Mjete e përgjithshme-Obligimet e përgjithshme

Kapitali si burim i mjeteve i përfshin të gjitha resurset financiare të cilat janë angazhuar, janë investuar në ndërmarrjen nga ana e pronarëve të ndryshëm, pa dallim në kohën dhe në bazën e angazhimit të tyre. Në suazat e kësaj numërohet edhe rezultati financiar i pashpërndarë i ndërmarrjes. Parë në mënyrë funksionale, gjegjësisht ku dhe pse është investuar, si është materializuar në aktiven, atëherë kapitali paraqet pronë, mjet dhe është paraqitur në aktiven. Duke u nisur nga ajo, kush ka investuar, kapitali i kult është, atëherë ai paraqitet si burim, si obligim ndaj pronarit dhe është paraqitur në pasiven.

Kapitali në pasiven paraqitet si kapital vetjak dhe i huaj. Shenja vetjak asocon në pronësinë mbi kapitalin nga ana e ndërmarrjes si subjekt

Kapitali = Mjete e përgjithshme-Obligimet e përgjithshme

Kapitali është obligim i ndërmarrjes ndaj pronarëve të vetë.

juridik, për shkak se ajo, në fakt nuk ka kapital të vet. Ajo fiton mjete, kapital dhe obligime për kryerjen e detyrave, por nuk është pronare. Në të gjitha rrethanat, ndërmarrja nuk është titullar i pronësisë, ajo ka obligim ndaj pronarëve të mjeteve të investuara, të cilat janë të dedikuara për kryerjen e aktivitetit. Në kushte të pronësisë private, aksionare grupe ose pronësi të përzier, kapitali në pasivën nën kategorinë vetjak do të thotë, investime të cilat paraqesin obligim, i cili arrit i fundit për kompensim, respektivisht nuk kompensohet derisa ndërmarrja funksionon. Interesi i pronarëve të kapitalit përputhet me interesin e ndërmarrjes dhe prandaj thuhet se është kapital vetjak.

Ky kapital sipas cilësisë, është burimi më i mirë për shkak se nuk ka përkufizime kohore dhe përkufizime dedikimi në përdorimin e tij. Kapitali vetjak mund të mbikëqyret si: **i përhershëm (i nominuar)** nëse paraqet investim me karakteristikat e përmendura paraprakisht dhe **kapitali i pa nominuar**, nëse është përfituar në plotësim nga puna e ndërmarrjes.

Sipas planit përllogaritës për evidencën e kapitalit si burim i mjeteve janë rezervuar llogari në klasën **9-Kapital, rezerva dhe evidenca jashtë bilancore**, ndërsa në të llogaritë nga grupet:



Kapitali është burim i mjeteve

- 90- Kapital i regjistruar i pa paguar;**
- 91- Kapital themelor i regjistruar i cili nuk është paguar;**
- 92- Premi të aksioneve të emetuara;**
- 93- Rezerva e revalorizuar;**
- 95- Përfitimi i akumuluar dhe përfitimi i vitit financiar;**
- 96- Humbja e transferuar dhe humbja e vitit financiar**

Grupi 96-Humbja e transferuar dhe humbje e vitit financiar paraqet grup të llogarive korrektuese, respektivisht llogari në të cilat regjistrohet kapitali në bazë të humbjes së paraqitur në punën, qoftë të bëhet fjalë për humbjen e bartur ose për humbjen në vitin rrjedhës. Shumat e regjistruara në llogaritë përkatëse të këtij grupi hiqen nga shuma e përgjithshme të kapitalit vetjak.

Evidenca (regjistrimi): Ngarkohet kontoja përkatëse e mjeteve në aktiven, në varësi nga ajo se në cilën formë investohet kapitali: mjete parash, mjete jo materiale, ndërsa aprovohen kontot 910 ose 911 gjegjësisht 912. **Karakteristikat e Ll/isë Kapital**

Rregullat për evidentimit

+	Ll/isë Kapital	-
1) Zvogëlimi	0) Gjendja fillestare	
	2) Rritja	

KAPITALI I NOMINUAR (I PËRHERSHËM)

-shtetëror, aksionar, privat- A) Vetjak-kapital aksionar

a-1) Kapital themelor i regjistruar i cili është paguar

Kapitali investuar në shoqëritë aksionare emërtohet kapital aksionar ose kapital vetjak. Kapitali vetjak në shoqërinë thjesht paraqet tepricë të mjeteve, pronë mbi obligimet respektivisht:

$$M (\text{ mjete }) - O (\text{ obligime }) = K (\text{ kapital })$$

Kapitali vetjak emërtohet edhe pronë neto, mjete neto. Këtë kapital e përbëjnë të gjitha investimet e aksionarëve (investime të pronarëve) dhe përfitimi i shoqërisë (përfitime të mbajtura - përfitimi i akumuluar).

Kapitali aksionar (vetjak) është ndarë në numër të madh të pjesëve, njësi që quhen aksione. Ato janë letra me vlerë të cilat mbahen në Depozitarin qendror të letrave me vlerë. Të drejtat dhe obligimet sipas këtyre letrave me vlerë lindin në çastin regjistrimit të tyre.

Çdo aksion kryesisht i posedon të drejtat në vijim:

1. Të drejtë në pjesëmarrje proporcionale në shpërndarjen e përfitimit dhe humbjes.
2. Pjesëmarrje në drejtorinë e firmës.
3. Të drejtë në pjesëmarrje në shpërndarjen e pronës pas likuidimit.
4. Të drejtë në pjesëmarrje në shpërndarjen proporcionale të aksioneve nga emetimet e reja.

Nëse shoqëria ka vetëm një lloj të aksioneve atëherë bëhet fjalë për aksione të rëndomta. Për shkak të kënaqjes së investuesve në shoqërinë, ndonjëherë mund të emetohen edhe aksione prioritare. Pronarëve të këtyre aksioneve u paguhet dividendë, me shkak të fikse edhe para shpërndarjes së dividendit për aksionet e rëndomta. Përveç kësaj, zakonisht pronarët e këtyre aksioneve nuk kanë të drejtë në votë. Në anën e përparme të çdo aksioni ka numër të printuar që e paraqet vlerën nominale për të njëjtën. Përveç vlerës nominale, aksionet kanë edhe vlerë tregu. Në të shumtën e rasteve vlera e tregut është më e madhe se vlera nominale. Vlera nominale e paraqet përgjegjësinë maksimale të aksionarëve për obligimet e shoqërisë.

Te shoqëritë aksionare ekziston shprehja "aksionet e aprovuara". Bëhet fjalë për numrin e aksioneve që një shoqëri mund t'i lëshojë në përputhje me statutin. Nocioni aksione të emetuara paraqet aksione të shitura realisht. Aksionet, në duart e personave jashtë ndërmarrjes emërtohen *aksione në pronë të aksionarëve*. Numri i aksioneve në pronësi të aksionarëve nuk është patjetër të jetë i njëjtë me numrin e aksioneve të emetuara. Me aksionet është ndërlidhur nocioni "Aksione trezorë". Ato janë aksione të blera nga ana e shoqërisë të cilat paraprakisht janë shitur. Këto aksione quhen edhe personale. Ndryshimet te kapitali aksionar krijohen gjatë emetimit të aksioneve.

Kapitali aksionar (vetjak) është ndarë në numër të madh të pjesëve, njësi që quhen aksione.

Aksionet e rëndomta.

Aksionet prioritare.

Aksionet trezorë

Vendim për emetim merr me akt të veçantë, themeluesi gjegjësisht kuvendi i shoqërisë. Nëse aksionet emetohen sipas vlerës nominale, atëherë aprovon llogaria e kapitalit themelor, me titullin Kapital aksionar- aksione të rëndomta, ose Kapital aksionar- aksione me prioritet. Nëse aksionet janë emtuar me vlerë më të madhe se ajo nominale, atëherë bëhet



fjalë për premi të realizuar mbi vlerën nominale dhe ajo shumë paraqitet në llogarinë Premi nga aksionet e emtuara (të rëndomta ose me prioritet), ndërsa, nëse vlera nominale është më e vogël nga ajo e shitjes, atëherë shitet me diskon dhe e njëjta paraqitet në llogarinë Diskoni i aksioneve të emtuara (të rëndomta ose me prioritet) me ngarkimin e llogarisë së përmendur.

Rregulli është që çdoherë të evidentohen me vlerën nominale, pa dallim nëse janë të rëndomta ose me prioritet.

Shembulli për evidentim 1:

Ndërmarrja shet 2.000 aksione të rëndomta me vlerë nominale prej 100 denarë për një aksion.

1) 100-LI/ia Xhirollogaria	200.000	
9100-LI/ia Kapitali aksionar i aksioneve të rëndomta		200.000
<u>Aksione të rëndomta të shitura</u>		

Shembulli për evidentim: 2

Ndërmarrja shet 2.000 aksione të rëndomta nga 110 denarë për një aksion me vlerën nominale prej 100 denarë

2) 100-LI/ia Xhirollogaria	220.000	
9100-LI/ia Kapitali aksionar - aksione të rëndomta		200.000
9200-LI/ia Premi nga aksionet e rëndomta të emtuara		20.000

Aksione të shitura me premi

Shembulli për evidentim 3:

Ndërmarrja shet 2.000 aksione të rëndomta nga 80 denarë për një aksion me vlerën nominale prej 100 denarë.

3) 100-LI/ia Xhirollogaria	160.000	
9201-LI/ia Diskon i aksioneve të rëndomta		40.000
9100-LI/ia Kapitali aksionar - aksione të rëndomta		200.000

Aksione të shitura me diskon

Premia e evidentuar në anën negative të llogarisë 920-Premia për aksionet e emtuara e rrit saldon e llogarisë së kapitalit aksionar, ndërsa dis-

koni i evidentuar në anën negative të llogarisë së njëjtë e zvogëlon saldon e llogarisë Kapital aksionar.

Shembulli për evidentim 4:

Ndërmarrja shet 1.000 aksione me prioritet me vlerë nominale veçmas prej 100 denarë me çmimin e shitjes prej 120 denarë.

4) 100-LI/ia Xhirollogaria	120.000
9110-LI/ia Kapital aksionar - aksione me privilegj	100.000
9203-LI/ia Premi të aksioneve të privilegjuara	20.000
<u>Aksione prioritare të shitura</u>	

a - 2) Kapital i regjistruar i pa paguar

Aksionet mund të shiten në bazë të regjistrimit paraprak të numrit dhe të vlerës për të cilën ka qëllim të blerjes. Me atë rast, obligimi për pagesë në lartësinë e çmimit të shitjes paguhet me këste, e jo menjëherë në çastin e shitjes. Me atë rast, shoqëria i mban të aksionet derisa të paguhet edhe kësti i parë. Kjo ngjarje e lidhur me kapitalin aksionar gjen vend në evidencë. Për shumën e aksioneve të regjistruara rriten kërkesat për aksionet e regjistruara dhe evidentohet në anën pozitive të llogarisë përkatëse nga grupi 00 - Kërkesa për kapital të regjistruar të pa paguar për vlerën e shitjes, për vlerën nominale si rritje e kapitalit të pa paguar do të kërkojë llogaria përkatëse nga grupi 90-Kapital i regjistruar, i pa paguar. Dallimi eventual do të evidentohet në anën pozitive gjegjësisht negative të llogarisë 920-Premi të aksioneve të emetuara. Kësti i paguar, i zmadhon mjetet e parave ndërsa zvogëlohen kërkesat për aksionet e regjistruara dhe evidentohet në anën pozitive të llogarisë 100-Xhirollogaria në anën negative të llogarisë nga grupi 00-Kërkesa për kapital të regjistruar a të pa paguar. Kjo llogari, pas pagesës së këstit të fundit do të mbesë e mbyllur. Pas pagesës së kësteve dorëzohen dhe për vlerën nominale ngarkohet llogaria nga grupi 90-Kapital i regjistruar i pa paguar, si zvogëlim i saj, a do të kërkojë llogaria përkatëse nga grupi 91-Kapital themelor i regjistruar i cili është paguar si rritje e kapitalit aksionar.

Shembulli për evidentim 1:

Shiten m kredi 500 aksione të rëndomta me vlerë nominale individuale prej 100 denarë, ndërsa me çmim të shitjes prej 110 denarë për një aksion. Pagesa është në dy këste dhe çdo këst është 55 denarë për aksion. Kësti i parë duhet të paguhet për dy muaj ndërsa e dyta për 4 muaj. Pas kalimit të dy muajve është paguar kësti i parë.

1) 000-LI/ia Kapital i regjistruar i pa paguar aksione të rëndomta	55.000
9000-LI/ia Kapital i regjistruar i pa paguar aksione të rëndomta	55.000
9200-LI/ia Premi të aksioneve të rëndomta	5.000
<u>Aksione të regjistruara të pa paguara</u>	

1a) 100-LI/ia Xhirollogaria	27.500
000-LI/ia Kapital i regjistruar i pa paguar	27.500
<u>Kësti i parë i paguar</u>	
Ky regjistrim do të përsëritet për këstin e dytë	
1b) 9000-LI/ia Kapital i regjistruar i pa paguar	50.000
9100-LI/ia Kapital aksionar	50.000
<u>Aksione të dorëzuara</u>	

Shembulli për evidentim 2:

Prej aksioneve të rëndomta të shitura paraprakisht shoqëria aksionare blen 200, me çmim prej 120 denarë për një.

2) 0470-LI/ia Aksione personale të blera (trezorë)	24.000
100-LI/ia Xhirollogaria	24.000
<u>Aksione personale të blera</u>	

Vërejtje: Rritja (zvogëlimi) i kapitalit mund të arrihet edhe si shpërndarje e një pjese të përfitimit (humbjes), me anë të fitimit si dhuratë ose kur themeluesit e investojnë depozitën e vetë. Rasti i parë nga ato të përmendura paraprakisht bën pjesë në sferën e kapitalit nominal dhe do ta përpunojmë gjatë përpunimit të temës Rezultate financiare. Në dy raste tjera në vijim evidentimi bëhet me ngarkimin e llogarive nga klasat 0, 1, 3 ose 6, dhe me aprovim të llogarisë nga klasa 9.

OBLIGIMET SI BURIME TË MJETEVE

Obligimet janë burime të huaja të mjeteve

Përveç kapitalit si burim vetjak dhe i përhershëm i mjeteve, si lloj i veçantë i burimeve janë obligimet. Ato trajtohen si burime të huaja për shkak se janë të kufizuar me afat dhe brenda afatit duhet të paguhen. Në varësi nga afati, paraqiten si obligime afatgjata dhe obligime afatshkurta.



Obligimet janë kapital i huaj

A) OBLIGIMET AFATGJATA

Paraqesin burime të mjeteve me afat të arritjes më të gjatë se një vit. Rrjedhin nga shitja e letrave afatgjate me vlerë dhe nga kreditë afatgjate. Për evidentimin e këtyre obligimeve sipas planit llogaritës janë rezervuar llogari nga grupi 28-Obligime afatgjata dhe rezervime afatgjata për rreziqe. Në suazat e këtij grupi gjenden llogaritë :
280-Obligime afatgjata ndaj subjekteve të ndërlidhur

- 281- Obligime afatgjata në bazë të huave dhe kredive
- 282- Obligime afatgjata ndaj subjekteve me të cilat është ndërlidhur subjekti në bazë të investimit
- 283- Obligime afatgjata për avance, depozita dhe paradhënie
- 284- Obligime afatgjata ndaj furnizuesve (në bazë të punës)
- 285- Obligime afatgjata në bazë të letrave me vlerë
- 286- Obligime afatgjata të tjera
- 287- Rezervime për pensione dhe obligime të ngjashme
- 288- Rezervime për tatime dhe kontribute
- 289- Rezervime afatgjata të tjera për rreziqe

E përbashkët për gjithë këto obligime është se si të krijuara paraqiten në anën negative të llogarive përkatëse ndërsa pagesa si zvogëlim i tyre evidentohet në anën pozitive.

Shembulli për evidentim 1:

Shoqëria aksionare Alkaloid ka lëshuar obligacione me vlerë nominale prej 200.000 denarë, me shkallë amatore vjetore prej 10%. Shkalla e tregut është 10% dhe prandaj vlera e shitjes do të jetë e njëjtë me vlerën nominale prej 200.000 denarë. Me supozim se obligacionet janë emetuar më 1 janar dhe të jenë me afat prej pesë vitesh do të evidentohet:

Obligime afatgjate në bazë të letrave me vlerë.

1) 100-LI/ia Xhirollogaria	200.000
2850-LI/ia Obligacionet e shitura	200.000
<u>Për obligacionet e shitura</u>	
1a) 4837-LI/ia Kamata në obligacione	20.000
100 -LI/ia Xhirollogaria	20.000
<u>Kamata e paguar më 31.12</u>	
<u>Ky evidentim do të përsëritet pesë here</u>	
1b) 2850-LI/ia Obligacione të shitura	200.000
100-LI/ia Xhirollogaria	200.000
<u>Obligacion i emetuar i paguar</u>	

Shembulli për evidentim 2:

Për pagesën e obligimeve ndaj furnizuesve për mjetet e përhershme, ndërmarrja shfrytëzon kredi afatgjate nga banka në shumën 100.000 den. Anuiteti i përlloritur është 15.000 den. prej të cilave 10.000 pagesa dhe 5.000 kamata. Anuiteti dhe kamata janë paguar.

Obligime afatgjate në bazë të huave nga bankat.

2) 2200-LI/ia Obligime ndaj furnizuesve për PSS	100.000
2810-LI/ia Kredi nga bankat në vend për PSS	100.000
<u>Për kredi afatgjate të aprovuar</u>	

2a) 2810-LI/ia Kredi nga bankat në vend për PSS	10.000
4835-LI/ia Kamata për borxhet afatgjata	5.000
2573-LI/ia Obligime për anuitetin e përllogaritur	10.000
2572-LI/ia Obligime për kamatat e përllogaritura	5.000
<u>Anuitet dhe kamatë e përllogaritur</u>	
2b) 2573-LI/ia Obligime për anuitet të përllogaritur	15.000
2572-LI/ia Obligime për kamata të përllogaritura	5.000
100-LI/ia Xhirrollogaria 1	5.000
<u>Anuitet dhe kamatë e paguar</u>	

B) OBLIGIMET RRJEDHËSE

Obligimet rrjedhëse janë burimi më masovik i mjeteve. Rrjedhin nga puna e përditshme e subjekteve juridike. Ato janë në lidhje të drejtpërdrejtë me furnizimin e ndërmarrjes dhe shfrytëzimin e mjeteve të huaja. Kanë afat të shkurtër të arritjes, por derisa të mos paguhen trajtohen si burime të mjeteve. Për shkak të afatit të shkurtër të arritjes, zakonisht nuk janë të ndërlidhura me pagesën me këste. Për evidentimin sipas planit llogaritës, janë rezervuar llogaritë nga klasa 2-Obligime, rezervime afatgjate për shpenzime dhe rreziqe. Në suazat e kësaj klase janë llogaritë e grupeve:

21- Obligime afatshkurta në bazë të letrave me vlerë

22- Obligime afatshkurta ndaj furnizuesve dhe obligime për avancë dhe depozitë dhe paradhënie

24- Obligime afatshkurta ndaj subjekteve të ndërlidhur

25- Obligime afatshkurta në bazë të huave dhe kredive

26- Obligime afatshkurta për tatime , kontribute dhe detyrime tjera

27- Obligime afatshkurta për rroga dhe obligime tjera afatshkurta

29-Pagesa e shtyrë e shpenzimeve (PVR)

Për evidencë më të pasqyruar në suazat e grupeve të përmendura, përveç llogarive themelore janë përcaktuar edhe llogaritë analitike. Si të krijuara, këto obligime, evidentohen në anën negative të llogarive në grupet e përmendura. Arritja dhe pagesa shkakton zvogëlim të obligimeve por edhe zvogëlim të mjeteve të parave të ndërmarrjes. Kjo evidentohet në anën pozitive të llogarive të obligimeve ndërsa në anën negative në llogaritë përkatëse të grupit 10-Mjete parash.

Obligime afatshkurta në bazë të letrave me vlerë

Shembulli për evidentim 1:

Për furnizimin e materialeve, furnizuesit nga Shkupi i është dhënë kambiali për 150.000 denarë, me afat prej 60 ditësh dhe kamatë prej 5.000 denarësh. Brenda afatit të arritjes kambiali është parashtruar për arkëtim dhe është paguar.

1) 2201-LI/ia Obligime ndaj furnizuesve për MJ 145.000

 2111-LI/ia Diskon në kambialet e lëshuar 5.000

 2110-LI/ia Shuma nominale e kambialit të lëshuar 150.000

Kambiali lëshuar

TEMA 8: Evidenca e obligimeve dhe kapitali

1a) 2110-LI/ia Shuma nominale e kambialit	150.000
100-LI/ia Xhirollogaria	150.000
<u>Kambiali paguar</u>	

1b) 4834-LI/ia Kamata për obligimet rrjedhëse	5.000
2111-LI/ia Diskon në kambialet e lëshuara	5.000
<u>Kamata e bartur (paraqitja si shpenzim)</u>	

Shembulli për evidentim 2:

Prej furnizuesit “Struzhanka” nga Struga janë blerë lëndë të para sipas f-rës nr.6 për 58.000 den. Kësaj shume i shtohet 18% TVSH. Prej mjeteve në Xhirollogarinë është paguar f-ra nr.6 në shumë prej 68.440 den., sipas fragmentit nr.10 nga banka.

Obligime afatshkurta ndaj furnizuesve

2) 310-LI/ia Lëndë të para dhe materiale në rezervë	58.000
160-LI/ia TVSH paraprakisht	10.440
2201-LI/ia Obligime ndaj furnizuesve për MJ	68.440
<u>Lëndë të para të blera sipas f-rës nr.6</u>	

2a) 2201-LI/ia Obligime ndaj furnizuesve për MJ	68.440
100-LI/ia Xhirollogaria	68.440
<u>F-ra e paguar sipas fragmentit nr.100</u>	

Obligime afatshkurta në bazë të huave nga bankat.

Shembulli për evidentim 3:

Ndërmarrjes i është aprovuar kredi afatshkurtër për mjete qarkulluese në shumë prej 100.000 den. me 5% kamatë, a me afat të pagesës pas 3 muajsh në shumë të njëfishtë. Brenda aftit të kontraktuar kredia është kthyer.

3) 100-LI/ia Xhirollogaria	100.000
250-LI/ia Kreditim nga bankat në vend	100.000
<u>Kredi afatshkurte e aprovuar</u>	

3a) 250-LI/ia Kredi nga bankat në vend	100.000
483-LI/ia Kamata nga puna me subjekte të pa ndërlidhur	5.000
2573-LI/ia Obligime për anuitet të përlllogaritur	100.000
2572-LI/ia Obligime për kamatat e përlllogaritura	5.000
<u>Anuitet dhe kamatë e përlllogaritur</u>	

3b) 2573-LI/ia Obligime për anuitet të përlllogaritur	100.000
2572-LI/ia Obligime për kamatat e përlllogaritura	5.000
100-LI/ia Xhirollogaria	105.000
<u>Për kredi dhe kamatë të kthyer</u>	

Obligime afatshkurta ndaj shtetit.

Shembulli për evidentim 4:

Tatimi i vlerës së shtuar sipas faturave të pranuar është 30.000 den, ndërsa tatimi i vlerës së shtuar sipas faturave të lëshuara për shitje është 35.000 den. Bartet obligim për pagesën e të njëjtës dhe e njëjta është paguar.

4) 2600-LI/ia TVSH në fatura të lëshuara	35.000
1601-LI/ia TVSH në fatura të pranuar	30.000
2608-LI/ia Obligime për pagesën e dallimit të TVSH-së	5.000
<u>Obligimi i bartur për TVSH</u>	

4a) 2608-LI/ia Obligime për pagesën e dallimit të TVSH	5.000
100-LI/ia Xhirollogaria	5.000
TVSH e paguar	

NOCIONET KRYESORE

Kapitali i dominuar;
Kapitali i pa dominuar;
Kapitali aksionar; Aksion;
Aksion me prioritet;
Aksion i trezuar;
Kapital i regjistruar i papaguar;
Obligime afatgjata;
Obligime afatshkurta.

PYETJE

1. Çka janë burimet e mjeteve?
2. Në cilat klasa të planit llogaritës gjenden burimet e mjeteve?
3. Shpjegoje formulën për përcaktimin e kapitalit nëse dihen mjetet dhe obligimet!
4. Sqaroji karakteristikat e llogarisë Kapital!
5. Çfarë të drejta mundëson posedimi i aksioneve në shoqërinë aksionare?
6. A ka dallim ndërmjet aksionit të rëndomtë dhe me prioritet?
7. Cilat aksione i emërtojmë aksione trezori?
8. A ka dallim ndërmjet vlerës nominale dhe të tregut të aksionit?
9. Sqaroji obligimet afatgjata!
10. Shpjegoji obligimet rrjedhëse!
11. Në cilën klasë dhe grup gjenden obligimet afatgjata dhe rrjedhëse?

USHTRIME PËR EVIDENCËN: Ngjarjet kontabiliste në vijim të evidentohen në urdhëresën për evidentim!

1. Gajtë themelimit të SHA “Dier” nga Kumanova, e njëjta ka pranuar nga themeluesi MJP falas edhe atë:
 - tokë ndërtimore -650.000 den.
 - barakë -320.000 den.
 - mjet transportues -30.000 den.
2. Gjatë shpërndarjes së përfitimit të realizuar në periudhën përlllogaritëse e njëjta është shpërndarë:
 - për kapital shtetëror -32.000 den.

-për kapital aksionar -52.000 den.

3. Gjatë shpërndarjes së përfitimit të realizuar për dedikime tjera, është shpërndarë për:

-rezerva ligjore-8.200 den.

-rezerva statutore -6.000 den.

-rezerva të lira-4.000 den.

4. Është bërë mbulimi i humbjes së rezervave ligjore për 4.800 den. Të bëhet transferimi i mjeteve të parave të rezervave në dobi të Xhirollogarisë.

5. Në fund të vitit bëhet harmonizimi i vlerave të MJP edhe atë:

a) për objekte ndërtimore-34.000 den.

për korrigjimin e vlerës së objekteve ndërtimore -4.000 den. (amortizimi i akumuluar)

b) për pajisjen-25.000 den.

për korrigjimin e vlerës së pajisjes-5.000 den.

(amortizimi i akumuluar)

5. Me kërkesë të SHA banka i ka aprovuar kredi për MJP (afatgjatë) për 380.000 den. Shuma është transferuar në dobi të llogarisë së transaksionit.

6. Me vendim të organit të menaxhimit është marrë vendim të bëhet transferimi i kredisë afatgjate prej 80.000 den. në kredi afat shkurte.

7. Për pagesën e obligimeve ndaj furnizuesve nga banka është aprovuar kredi afatgjate prej 140.000 den. i cili është transferuar në llogarinë e transaksionit.

8. Është përlllogaritur anuiteti i kredisë afatgjate prej 8.500 den. dhe kamatë në atë kredi prej 500 den. Të evidentohet përlllogaritja dhen pagesa e anuitetit dhe kamatës.

9. Prej furnizuesit “Struzhanka” nga Struga janë blerë lëndë të para sipas faturës me nr. 6 për 58.000 den. Kësaj shume i shtohet 18%TVSH.

10. Prej mjeteve në llogarinë e transaksionit është paguar f-ra nr.6 prej 68.440 den. sipas fragmentit nga banka me nr.10.

11. Prej furnizuesit “Semos” nga Shkupi, është pranuar fatura nr.26 në 44.000 den. për makinën e blerë. Kësaj shume i shtohen =18%TVSH.

12. Për shkak të pagesës jo në kohë të faturës nr.26 nga llogaria e transaksionit është paguar në emër të borxhit kryesor 51.920 den. dhe në emër të kamatës ndëshkuese 5.000 den sipas fragmentit nr.11.

13. Janë furnizuar materiale nga furnizuesi “Selena” nga Shtipi të cilët sipas fletëpranimit nr.11 janë pranuar në rezervë për 18.000 den. Fatura për materialet e pranuar nuk është pranuar.

14. Prej furnizuesit “Selena” nga Shtipi është pranuar fatura nr.66 në 18.000 den.

15. Është bërë transporti i mallrave prej shoqërisë transportuese “ETA” nga

Strumica për 48.000 den. Fatura për transportin nuk është pranuar.

16. Prej furnizuesit "ETA" është pranuar fatura nr. 76 në 50.000 den. Të bëhet evidentimi për vlerën më të madhe të faturës së pranuar.

17. Për furnizimin e materialit nga blerësi është pranuar avancë në 80.000 den. sipas fragmentit nr.1. Brenda aftit të kontraktuar këtij blerësi i është dërguar materiali, vlera e tij është 85.000 den. Blerësi, pas pranimit të materialit dhe faturës, dallimin e transferon në llogarinë e transaksionit.

18. SHT. sipas fragmentit nr.2 ka pranuar depozitë parash nga SHT tjetër, partner afarist, në shumë prej 50.000 den. Sipas fragmentit nr.12, depoziti në shumën prej 50.000 den. është kthyer, plus kamata e përlllogaritur prej 5.000 den.

19. SHA prodhimet e veta i shet me ambalazh kthyese. Si garanci se ambalazhi do të kthehet nga ana e blerësit sipas fragmentit nr. 3 në emër të paradhënies janë pranuar 15.000 den. Në përputhje me procesverbalin e bërë është përcaktuar se vlera e ambalazhit të kthyer është 14.000 den, dallimi prej 1.000 den. të evidentohet si hyrje.

20. Për energji elektrike të harxhuar në muajin është pranuar faturë në shumë prej 6.350 den.

21. Për energji elektrike të harxhuar në muajin është paguar me çek të baruar në shumë prej 6.350 den. Më vonë është pranuar fragment nga banka nga i cili shihet se çeku është paguar nga llogaria e transaksionit.

22. Është pranuar fatura nr.14 për mallrat e blerë 84.250 den.

23. Për pagesën e faturës nr.14 është lëshuar kambial në 84.250 den. pa kamatë.

24. Është pranuar fragment nga banka nga i cili shihet se është realizuar pagesa sipas kambialit të lëshuar në shumë prej 84.250 den.

25. Për pagesën e obligimeve të arritura ndaj furnizuesve është lëshuar kambiali në 56.000 den. me afat të arritjes prej 60 ditësh dhe kamatë prej 8.000 den. brenda afatit për arritje, kambiali është parashtruar për pagesë dhe është paguar.

26. SHT në përputhje me dokumentacionin e parashtruar dhe kontratën e lidhur nr.15 prej bankës së caktuar në vend ka pranuar hua në shumë prej 207.000 den. me afat pagese prej 9 muajsh. Shuma mujore e kamatës për huan e pranuar afat shkurte është 5.000 den. Të evidentohet pranimi i huas dhe kthimi njëmuajor i anuitetit dhe kamatës.

27. Tatimi i vlerës së shtuar (TVSH) në faturat e pranuar është 25.000 den., ndërsa TVSH në faturat e lëshuara për shitje është 53.000 den. Krijohet obligimi për pagesë dhe e njëjta është paguar.

28. Në periudhën përlllogaritëse në kontot për TVSH është bërë evidentimi në vijim: Konto 160, në anën debitore 55.000 den., ndërsa në anën kreditore 2.000 den. Konto 260, në anën debitore 3.500 den., ndërsa në anën kreditore 35.500 den. A duhet SHT të paguajë plus TVSH për periudhën e kaluar dhe të ndërmerren dhe zbatohen evidentimet përfundimtare.

Tema 9:

TË HYRA DHE TË DALA

PËRMBAJTJA E TEMËS:

Nocioni dhe grupimi i të hyrave Nocioni dhe grupimi i të dalave Përm-bajtja dhe forma e bilancit të suksesit

QËLLIMET E MËSIMIT:

Nxënësi:

- ta definojë nocionin të hyra dhe të dala sipas MSS,
- të dallojë llogari hyrëse dhe të daljes,
- t'i grupojë llogaritë e dhëna të hyrjes dhe të dalave,
- ta shpjegojë përmbajtjen dhe formën e bilancit të suksesit,
- të përmbushë bilanc të suksesit

NOCIONI DHE GRUPIMI I TË HYRAVE

Të hyrat paraqesin hyrje ose rritje tjera të mjeteve si rezultat i punës rrjedhëse në kompaninë.

Të hyrat paraqesin hyrje ose rritje të tjera të mjeteve të kompanisë në bazë të shitjes së prodhimeve ose mallrave, shërbimeve të bërë dhe aktiviteteve të tjera. Të hyrat në bilancin e suksesit paraqiten në tre kategori (grupe):

Të hyra nga veprimtaria themelore Të hyrat nga shitja e prodhimeve dhe shërbimeve janë elementi më i rëndësishëm i të hyrave nga veprimtaria themelore, për shkak se janë rezultat i aktiviteteve kryesore rrjedhëse ose qendrore të kompanisë. Përveç tyre këtu bëjnë pjesë edhe hyrjet nga shitja e materialeve, hyrjet nga përdorimi i prodhimeve vetjake dhe shërbimet dhe të ngjashme;

Të hyrat nga aktivitetet tjera. Në këtë grup bëjnë pjesë hyrjet nga aktivitetet investuese (kamata), hyrjet nga dallimet e kursit, hyrjet nga shitja e mjeteve të përhershme, hyrjet nga subvencionet e ndryshme, kompensimet dhe të ngjashme.

Të hyrat e jashtëzakonshme të cilat nuk rrjedhin nga aktivitetet e rregullta të kompanisë, rrjedhin nga aktivitetet e rregullta të kompanisë si që janë për shembull hyrjet nga shitja e jashtëzakonshme e një pjese të konsiderueshme të mjeteve të përhershme dhe hyrjet tjera nga aktivitetet e jashtëzakonshme.



Të hyrat duhet të zmadhohen

e grupeve të hyrjes dhe këto janë grupet 75, 76, 77, 78:

Sipas MSS 18: Të hyrat janë zmadhimi i dobive ekonomike gjatë periudhës përlllogaritëse në formë të të hyrave ose të zmadhimit të mjeteve ose zvogëlim-it të obligimeve të cilat rezultojnë me zmadhimin e kryegjësë, përveç atyre që kanë të bëjnë me kontributet nga ana e pjesëmarrësve në kryegjënë.

Në planin llogaritës të hyrat gjenden në llogaritë

Grupi: 75 – Të hyra nga shitja

Grupi: 76 – Të hyra nga pjesëmarrja në investimet

Grupi: 77 – Të hyra afariste të tjera

Grupi: 78 – Të hyra të jashtëzakonshme të pazakonta

Rregullat për evidentimin dhe karakteristikat:

Të hyrat gjenden në anën e djathtë të Bilancit të suksesit që paraqet raport financiar të dytë. Llogaritë e hyrjes bëjnë pjesë në kategorinë e llogarive të suksesshme. Të hyrat çdoherë evidentohen në anën e djathtë – kreditore gjatë krijimit të tyre, dhe vetëm në fund të periudhës përlllogaritëse evidentohen në anën e majtë – debitore. Çdo ndërmarrje përpiqet që të ketë numër më të madh të të hyrave, pasi që me një pjesë duhet t'i mbulojë të dalat e krijuara ndërsa me pjesën tjetër ta vazhdojë të punuarin.

Rregullat për evidentimin

NOCIONI DHE GRUPIMI I TË DALAVE

Të dalat paraqesin derdhje ose zvogëlime të tjera të mjeteve si rezultat i punës rrjedhëse të kompanisë. Të dalat janë shprehje financiare e shpenzimeve të mjeteve dhe punës që përmbahen në prodhimet e gatshme dhe shërbimet që u janë shitur blerësve. Të dalat janë shprehje e shpenzimeve gjatë punës së rregullt si edhe aktivitetet e furnizimit. Ngjashëm me prodhimet edhe ato paraqiten në tre kategori themelore (grupime):

Të dala nga veprimtaria themelore, të cilat janë rezultat i aktiviteteve themelore, kryesore të kompanisë. Ato janë shpenzime për prodhimet dhe shërbimet e shitura, vlera furnizuese e mallrave të shitur, shpenzimet për amortizimin e mjeteve të përhershme, rrogat dhe kompensimet e të punësuarve, shërbimet me karakter të shpenzimeve materiale (qiraja, transporti, reklamat,...) dhe të ngjashme.

Shpenzimet nga aktivitetet tjera janë shpenzime në bazë të kamatave, të dallimeve negative të kursit, vlera e pa shlyer e mjeteve të përhershme të patjetërsuara etj.

Shpenzime të jashtëzakonshme- zëra të pazakonshme të cilat nuk rrjedhin nga puna e rregullt dhe nuk pritet të paraqiten, si për shembull, shlyerje të jashtëzakonshme, tjetërsime të mjeteve të cilat janë krijuar papritmas dhe me vlerë të madhe, humbje për shkak të dëmtimit të mjeteve ose për shkak të katastrofës natyrore.

Sipas MSS 18: Të dalat janë zvogëlime të dobive ekonomike gjatë periudhës përlllogaritëse në formë të derdhjeve ose amortizimit të mjeteve ose krijimit të obligimeve të cilat rezultojnë me zvogëlimin e kryegjësë, përveç atyre që janë të ndërlidhura me shpërndarjen e pjesëmarrësve në kryegjënë.

Dallimi ndërmjet shpenzimeve dhe të dalave shpenzimet janë harxhime të parave për furnizime, për shërbimet e bëra, për parapagimet, për qiratë dhe ngj. Për shembull: Pronari i ndërmarrjes “Aleks” ka furnizuar material për 20.000 den. Këto 20.000 den. për ndërmarrjen “Aleks” janë shpenzim. Muajin e ardhshëm këto materiale janë shitur 5.000 den. Tani këto 5.000 den. janë të dala ndërsa 15.000 den. tjera janë pronë, mjete të ndërmarrjes “Aleks”. Sipas kësaj, shpenzimet në ndërmarrjen në periudhën e caktuar transformohen ose në të dala të periudhës ose mbesin mjete deri në fund të periudhës.

Dallimi ndërmjet të dalave dhe shpenzimit. Kur flasim për shpenzimet, me rëndësi të madhe është të bëjmë dallim ndërmjet shpenzimit dhe të dalës. Këto dy nocione shpeshherë përzihen, veçanërisht kur bëhet fjalë për shpenzimet nga puna e rregullt. Por, shpenzimet janë të ndërlidhura me përlllogaritjen e rezultatit, ndërsa shpenzimet janë të ndërlidhura me harxhimin e tyre në procesin e prodhimitarisë. Domethënë, që kompania të prodhojë ose të kryejë shërbime, nevojiten mjete dhe punë të cilat maten me para dhe e përbëjnë çmimin e prod-

Të dalat paraqesin derdhje ose zvogëlime të tjera të mjeteve si rezultat i punës rrjedhëse të kompanisë.




Të dalat duhet të zvogëlohen

himeve ose shërbimeve të prodhuara. Shpenzimet të cilat bëjnë pjesë në çmimin e kostos, mbesin në rezervë derisa mos shiten prodhimet. Në çastin kur prodhimet do të shiten, shpenzimet transformohen në të dala të prodhimeve të shitura.

Shembull për dallim (shpenzim-harxhim-e dalë):

Nëse blejmë një makinë dhe të njëjtën e paguajmë 100.000 den., atëherë sot do të kemi shpenzim 100.000 den. Të supozojmë se me këtë makinë do të mund të prodhohen 1.000.000 prodhime gjatë afatit të saj të përdorimit, atëherë çdo prodhim duhet të absorbojë 0,1 den. nga shpenzimi për makinën në periudhën kur do të prodhohet prodhimi dhe ajo pjesë e shpenzimit do të shndërrohet në harxhim dhe do të përlllogaritet në çmimin e kostos. Të supozojmë se janë prodhuar 100.000 prodhime, atëherë 10.000 den. të shpenzimit shndërrohen në harxhim. Me supozim që të shiten 50.000 prodhime atëherë 5.000 den. prej harxhimit shndërrohen në të dalë.

Shpenzim
Harxhimi
Të dala



Në planin llogaritës të hyrat gjenden në llogaritë e grupeve hyrëse, dhe këto janë grupi 70 dhe grupi 72.

Grupi 70-Të dala të prodhimeve të shitura, të mallrave, shërbimeve dhe materialeve

Grupi 72 – Të dala të jashtëzakonshme

Rregullat për evidentimin dhe karakteristikat:

Të dalat gjenden në anën e majtë të Bilancit të suksesit që paraqet raport të dytë financiar, andaj lirshëm mund të thuhet se të dalat janë llogari të suksesshme. Të dalat çdoherë evidentohen në anën e majtë – debitore gjatë krijimit të tyre, dhe vetëm në fund të periudhës përlllogaritëse kur mbyllen evidentohen në anën e djathtë – kreditore.

Shembuj:

1. Sipas faturës nr. 5466/07, i janë shitur prodhime të gatshme blerësit “Te-diko” për 50.000 + 18% TVSH. Çmimi i kostos së prodhimeve të gatshme sipas fletës së dërgimit është 35.000 den.

2. Sipas f-rës nr. 94/07 janë shitur prodhime të gatshme në Treg të huaj për 2.000 € (1€=61.3den). Çmimi i kostos së prodhimeve të gatshme sipas dokumentit të dërgimit është 100.000 den.

3. Sipas f-rës nr. 8566/07 janë shitur mallra tregtar blerësit “Tineks” për 20.000 den. + 18% TVSH. Vlera furnizuese e mallit tregtar është 15.000 den. Blerësi “Tineks” e ka paguar shumën në Xhirollogarinë sipas fragmentit nr.45 për pagesën e faturës.

Të evidentohen nngjatjet në urdhëresën për evidentim me ndihmën e arsimtarit. Nxënësit të hapin “T” llogari të llogarive të suksesshme dhe t’i ndajnë qartë llogaritë të hyrjes nga llogaritë e të dalave.

PËRMBAJTJA DHE FORMA E BILANCIT TË SUKSESIT

Bilanci i suksesit dhe bilanci i gjendjes, paraqesin dy pjesë themelore komplementare të ndërmarrjes dhe rezultate të punës së përgjithshme të ndërmarrjes si organizëm i tërësishëm i një sistemi afarist. Me fjalë të tjera, nëse në bilancin e gjendjes është prezantuar gjendja e mjeteve dhe e burimeve të mjeteve me të cilat disponon ndërmarrja në ditën e caktuar, bilanci i suksesit paraqet një lloj të raportit financiar për efektet e arritura të paraqitura si rezultat financiar i arritur në periudhë të caktuar përlllogaritëse, në numrin më të madh të rasteve të vitit kalendarik.

Analoge me vërejtjet paraprake që kanë të bëjnë me përbërjen e bilancit të gjendjes dhe bilancit të suksesit si pasqyrim tabelor sistematik i të gjitha të dalave dhe të gjitha të hyrave të grupuara sipas rregullave të caktuar mund të prezantohet në formë të **formës dyanëshe** dhe si raport gazetaresk në formë **njëanëshe-formë raportuese**. Në vetë bilancin e suksesit, që të kuptohet më mirë ballafaqimi i të dalave të përgjithshme me të hyrat e përgjithshme a me qëllim që të fitohet rezultati financiar i fituar (përfitimi ose humbja) nga puna e përgjithshme aplikohet forma dyanëshe e cila është më e aplikueshme edhe për qëllime edukative. Në bilancin e suksesit të paraqitur në këtë mënyrë në anën e majtë gjenden të dalat e përgjithshme ndërsa në anën e djathtë të hyrat e përgjithshme. Kjo në realitet do të thotë se ana e majtë të bilancit të suksesit është e shpenzimeve ndërsa e djathta ana hyrëse. Me fjalë të tjera, parë nga këndvështrimi kontabilist, **bilanci i suksesit është një llogari sintetike** në të cilën janë paraqitur saldot e të gjitha llogarive në të cilat evidentohen të dalat dhe të hyrat e ndërmarrjes në një periudhë përlllogaritëse. Me këtë bilanc përcaktohet rezultatit financiar - profiti ose përfitimi, respektivisht humbja në një periudhë përlllogaritëse. Rezultati financiar i përcaktuar bartet në bilancin e gjendjes. Pas evidentimit të realizuar, bilanci i gjendjes është në balancë - aktivja është e barabartë me pasiven gjegjësisht mjetet janë të barabarta me kapitalin dhe me obligimet.

Në suazat e anës së majtë - të daljes të bilancit të suksesit bëjnë pjesë dy grupet themelore të shpenzimeve:

- I. Shpenzimet e rregullta
- II. Shpenzimet e jashtëzakonshme

Bilanci i suksesit paraqet raport financiar për efektet e arritura të paraqitura si rezultat financiar i arritur në periudhën e caktuar përlllogaritëse.

Në grupin e parë bëjnë pjesë:

1. Të dalat në bazë të prodhimeve të gatshme të shitura dhe shërbimeve
2. Vlera furnizuese e mallrave të shitura
 - Vlera furnizuese e mallrave tregtar të shitur nga magazina
 - Vlera furnizuese e mallrave të shitur nëpërmjet shitoreve,
3. Vlera furnizuese e materialeve të shitur, e pjesëve rezerve dhe inventarit të imët
4. Të dala në bazë të mallrave të shitur, materialeve dhe të dalat e periudhës,
Ndërsa në grupin për të dalat e jashtëzakonshme bëjnë pjesë:
 1. Kërkesat e shlyera,
 2. Kamatat me vonesë të paguara
 3. Shkurtime të vlerave materiale,
 4. Dallimet negative nga përkufizimet kohore ...

Në suazat e anës së djathtë- të hyrjeve të bilancit të suksesit bëjnë pjesë dy grupet themelore të të hyrave:

- I. Të hyrat e rregullta dhe
 - II. Të hyrat e jashtëzakonshme. Në grupin e të hyrave të rregullta janë:
 1. Të hyrat nga shitja e prodhimeve, mallrave, shërbimeve
 - Të hyrat nga shitja e mallrave tregtar nga magazina,
 - Të hyra nga shitja e mallrave nga shitorja,
 2. Të hyra nga shitja e materialeve, pjesëve rezerve dhe inventarit të imët,
 3. Të hyra në bazë të përdorimit të prodhimeve personale
- Ndërsa në grupin e të hyrave të jashtëzakonshme janë:
1. Kërkesa të arkëtuara të shlyera,
 2. Kamata me vonesë të arkëtuara,
 3. Prej tepricave të vlerat materiale,
 4. Dallimet pozitive nga përkufizimet kohore...

Gjatë përbërjes së bilancit të suksesit, pozita të dala në bazë të prodhimeve të gatshme të shitura dhe shërbime, në fakt paraqet çmim të kostos së prodhimeve të gatshme dhe shërbime. Nëse pra kihet parasysh se qëllimi i përbërjes së bilancit të suksesit është përcaktimi i rezultatit financiar në kuptim të fitimit kose humbjes në fund të vitit kalendarik duhet të realizohen operacione të caktuara kontabiliste edhe atë:

1. Së pari duhet të përcaktohet shuma e përgjithshme e të dalave të rregullta dhe të dalave të jashtëzakonshme
2. Mandej duhet të përcaktohet shuma e përgjithshme e të hyrave të rregullta dhe të hyrave të jashtëzakonshme
3. Në fund duhet të bëhet krahasimi i shumës së përgjithshme të të dalave me shumën e përgjithshme të të hyrave. Gjatë këtij krahasimi në rast se shuma e të hyrave është më e madhe se shuma e të dalave, rezultati financiar paraqet përfitimi i cili transferohet në anën e majtë dhe vendoset balancimi bilancor. Por, në rast se shuma në anën e të dalave është më e madhe se shuma e të hyrave, rezultati financiar i përcaktuar paraqet humbje e cila transferohet në anën e djathtë të bilancit dhe vihet në balancim. Përfitimi në bilancin e suksesit paraqitet si:

Procedura për
përpilimin
bilancit të
suksesit.

- përfitim para tatimit, si dallim ndërmjet të hyrave dhe të dalave dhe
- përfitim pas tatimit ose përfitim neto i cili fitohet kur prej tatimit do të veçohet tatimi mbi fitimin. Përfitimi neto është ajo kategori e cila më tutje është lëndë e shpërndarjes.

Në kompanitë e mëdha të cilat bilancin e suksesit e përpilojnë në përputhje me rezultatin financiar, përfitimi ose humbja përcaktohet si rezultat financiar nga puna e rregullt, rezultat financiar nga aktivitetet e jashtë zakonshme dhe rezultat i përgjithshëm financiar.

Në bilancin e suksesit përmbahen të gjitha të dalat dhe të hyrat. Të dhënat për vlerat e të dalave dhe të hyrave gjenden në llogaritë e suksesshme të cilat hapen në librin kryesor. Saldot e llogarive sintetike të caktuara të suksesshme ose grupet e llogarive të suksesshme transferohen si pozita bilancore në bilancin e suksesit. Vijon shembulli.

Bilanci i suksesit
I përbërë më datë 31.12.2009

N r.	PËRSHKRIMI	Shuma		PËRSHKRIMI	Shuma	
		veçmas	gjithsej		veçmas	gjithsej
1	1. Të dalat e rregullta			1	1. Të hyra të rregullta	
2	Të dala në bazë të prodhimeve të gatshme të shitura	265.000			Të hyra nga prodhimet e shitura	345.000
	Vlera furnizuese e mallrave tregtar të shitur	70.000		2	Të hyra nga shitja e mallrave tregtare	100.000
	Të dala të rregullta të përgjithshme		335.000		Të hyra të përgjithshme të rregullta	
3	2. Të dala të jashtëzakonshme	7.500			2. Të hyra të parakohshme	
4	Gjithsej të dala të jashtëzakonshme	2.000			Kamata të inkasuara me vonesë	1.500
5	Të dala të përgjithshme	1.000		3	Tepricë	3.000
	Përfitimi		10.500		Të hyra të përgjithshme të parakohshme	
	Kamata me vonesë të paguara		345.500		Kamata të inkasuara me vonesë	1.500
	Kërkesa të shlyera			4	Tepricë	3.000
	Dëmet nga shkaqet objektive		104.000		Të hyra të përgjithshme të parakohshme	4.500
	Вкупно		449.500		Gjithsej	449.500

NOCIONET KRYESORE

Të hyra
Të dala
Harxhim
Shpenzim
Bilanci i suksesit

PYETJE

1. Definoni nocionin e hyrë?
2. Cilat janë të hyrat nga veprimtaria themelore?
3. Cilat të hyra bëjnë pjesë në grupin e të hyrave nga aktivitetet tjera.
4. Definoje nocionin e dalë?
5. Cilat janë të dalat nga veprimtaria themelore?
6. Cilat të dala bëjnë pjesë në grupin e të dalave nga aktivitetet tjera?
7. A ka dallim ndërmjet nocioneve shpenzim, harxhim, e dalë dhe nëse ekziston shpjegoje të njëjtin!
8. Trego shembull në lidhje me pyetjen paraprake!
9. Definoje nocionin bilanci i suksesit?
10. Në cilën formë mund të përpilohet bilanci i suksesit?

Mendoni për këtë

ANTONIO APLIKON PËR HUA

Antonio Jovanov, pronari i firmës për akullore e cila shet nga frigoriferi klientëve në kalim, do që ta zgjerojë aktivitetin e vet në një zinxhir të marketeve. Shitja e akullores rritet për mesatarisht 8% në çdo tremujor. Sipas kësaj, në mënyrë përkatëse është rritur edhe profiti. Antonio-ja është punëtor shumë i zellshëm dhe konservativ në harxhimin. Ai ka takim me bankierin të cilit duhet t'i parashtrijë kërkesë për hua me të cilën planifikon ta zgjerojë biznesin. Para se të përgatitet për atë takim ai ju lut ju si nëpunës financiar kryesor, ta kopjoni bilancin tremujor të suksesit për dy vitet e fundit, por të mos parashtrihen edhe bilancet e gjendjes. Antonio-ja veç më ka një hua të konsiderueshme nga një bankë tjetër, e cila është e evidentuar në librat. Në fakt, ai shumë pak para të veta ka investuar në biznesin e tij.

Çka mendoni ju? Mendoni se bankieri do i huazojë edhe më para Antonio-s?

USHTRIME PËR PËRPILIMIN E BILANCIT TË SUKSESIT

1. Në bazë të të dhënave në vijim, të llogarive të të hyrave dhe të dalave të Shoqërisë *Element*, gjatë vitit 2009 duhet të përpilohet bilanci i suksesit.

TEMA 9: Të hyra dhe të dala

- Të hyra nga shitja e prodhimeve, shërbimeve dhe mallrave në tregun vendor-100.000 den,
- Të hyra nga shitja e materialeve - 35.000 den,
- Të hyra nga kamatat-15.000 den,
- Dallime pozitive të kursit-10.000 den,
- Të hyra nga shitja e MJP-50.000 den,
- Të hyra nga arkëtimi i penaleve, shpërblimeve dhe ngj.-20.000 den,
- Përfitim?
- Të dala nga prodhimet dhe shërbimet e shitura 80.000 den.
- Vlera furnizuese e materialeve të shitur-20.000 den,
- Të dala të përcaktuara në plotësim prej viteve të mëparshme-40.000 den,
- Vlera e pashlyer dhe shpenzimet tjera për tjetërsimin dhe amortizimin e pronës së përhershme-35.000 den,
- Shkurtimi -15.000 den.

Tema 10:

REZULTATI FINANCIAR

PËRMBAJTJA E TEMËS:

Rezultati financiar Përcaktimi i të
hyrave dhe të dalave
Përcaktimi kontabilist i rezultatit
Përcaktimi i fitimit neto
(fitimi pas tatimit)
Shpërndarja e fitimit

QËLLIMET E MËSIMIT:

Nxënësi:
-ta përcaktojë rezultatin nga puna
-t'i analizojë rezultatet nga puna

REZULTATI FINANCIAR

Subjektet e përcaktojnë rezultatin financiar si fitim ose si humbje para tatimit dhe fitim ose humbje pas tatimit. Sipas rregullave për përcaktimin përdoret formular i përcaktuar në veçanti për bilancin e suksesit.

Përcaktimi doemos duhet të vijojë pas regjistrimeve të realizuara të të gjitha ndryshimeve afariste dhe përlllogaritjeve. Së pari përcaktohen të dalat në mënyrë që harxhimet nga klasa 4 transferohen në llogaritë përkatëse të klasës 6 dhe 7 në varësi nga ajo a bëhet fjalë për ndërmarrje prodhuese ose tregtare.

Ndërmarrjet prodhuese, respektivisht shoqëritë si edhe ato që merren me veprimtari shërbyese, në fund të periudhës përlllogaritëse, një pjesë të shpenzimeve të klasës 4 e evidentojnë në barrë të llogarive nga grupi 60, a në dobi të llogarisë 490-Radhitja e harxhimeve. Nëse subjekti ka vendosur harxhimet e prodhimit të t'i evidentojë në klasën 5 saldot e borxheve dhe kërkesave të klasës 4 dhe 5 doemos duhet të jenë të harmonizuara. Me realizimin e prodhimeve, harxhimet transferohen në klasën 7.

Ndërmarrjet tregtare, gjegjësisht shoqëritë në fund të periudhës përlllogaritëse gjatë evidentimeve përfundimtare, shpenzimet nga klasa 4 i transferojnë në klasën e grupit 70, me regjistrimin 70/4901.

Përcaktimi i të hyrave dhe të dalave të përgjithshme bëhet me mbledhjen e shumave të llogarive nga klasa 7.

Pas evidentimeve të bëra, përcaktohet rezultati nga puna.

1. Përcaktimi i të hyrave dhe të dalave

Duke u nisur nga fakti se rezultati financiar rrjedh nga të hyrat e përgjithshme dhe të dalat e përgjithshme respektivisht është dallimi i tyre, së pari do të duhet të fillohet me përcaktimin e tyre.

a) Përcaktimi i të hyrave të përgjithshme

Të dhëna për të hyrat merren nga llogaritë nga grupet e të hyrave dhe ato janë: 75, 76, 77, 78, me supozim se gjendja e tyre është:

Grupi: 75 = Të hyra nga shitja	7.725.000
Grupi: 76 = Të hyra nga pjesëmarrja në investime	1.756.000
Grupi: 77 = Të hyra afariste të tjera (pa llogarinë 779)	842.500
Grupi: 78 = Të hyra të jashtëzakonshme të pazakonta	337.000

Gjithsej 10.660.500

b) Përcaktimi i të dalave të përgjithshme

Të dhëna për të dalat merren nga llogaritë e grupeve të daljeve dhe këto janë: Grupi 70 dhe Grupi 72.

Grupi 70 = Të dala nga prodhimet e shitura	9.775.000
Grupi 72 = Të dala të jashtëzakonshme	300.000

Gjithsej 10.075.000

Rezultati financiar i firmave në fund të periudhës mund të jetë përfitim ose humbje.

c) Bilanci i suksesit

Në bilancin e suksesit në bazë të të hyrave dhe të dalave përcaktohet dallimi si fitim gjegjësisht si humbje. Në këtë bilanc, veçanërisht gjetet dallimi ndërmjet të hyrave të rregullta dhe të dalave të rregullta dhe dallimi veçanërisht ndërmjet të hyrave të jashtëzakonshme dhe të dalave të jashtëzakonshme. Në bazë të të dhënave, bilanci i suksesit është si vijon:

1. Të hyra nga puna e rregullt (gr.75,76,77,-779)	10.323.500
2. Të dala nga puna e rregullt	<u>-9.775.000</u>
3. Fitimi nga puna e rregullt para tatimit	548.500
4. Të hyra të jashtëzakonshme 78 + II-ia 779)	337.000
5. Të dala të jashtëzakonshme	<u>300.000</u>
6. Fitimi nga aktivitetet e jashtëzakonshme	37.000
7. Fitimi bruto para tatimit (3+6)	585.500

2. Përcaktimi kontabilist i rezultatit

Përcaktimi kontabilist i rezultati paraqet bartje e të hyrave të përgjithshme dhe e të dalave të përgjithshme në grupin 79-Dallimi i të hyrave dhe të dalave.

Të hyrat e rregullta dhe të dalat e rregullta barten në llogarinë 790-Dallimi nga të hyrat dhe të dalat nga puna e rregullt, ndërsa të hyrat e jashtëzakonshme dhe të dalat e jashtëzakonshme barten në llogarinë 791 -Dallimi i të hyrave dhe të dalave nga aktivitetet e jashtëzakonshme. Të hyrat barten në anën negative të llogarisë së përmendur ndërsa të dalat në anën pozitive. Evidentimi është si vijon:

1) 75 - Gr. Të hyra nga shitja	7.725.000
76 - Gr. Të hyra nga pjesëmarrja e investuesve	1.756.000
77 - Gr. Të hyra të tjera kushtimore	842.500
790 - LI/ia Dallimi i të hyrave dhe të dalave nga puna e rregullt	10.323.500
<u>Të hyra të rregullta të bartura</u>	
1a) 78 - Gr.Të hyra të jashtëzakonshme	337.000
791 - LI/ia Dallimi i të hyrave dhe të dalave nga aktivitetet e jashtëzakonshme	337.000
<u>Të hyra të jashtëzakonshme të bartura</u>	
1b) 790 -LI/ia Dallimi i të hyrave dhe të dalave nga puna e rregullt	9.775.000
70 - Gr.Të dala nga prodhimet e shitura	9.775.000
<u>Të dala të rregullta të bartura</u>	
1c) 791 -LI/ia Dallimi i të hyrave dhe të dalave nga aktivitetet e jashtëzakonshme	300.000
72-Gr.Të dala të jashtëzakonshme	300.000
<u>Të dala të jashtëzakonshme të bartura</u>	

Pas evidentimeve të bëra të gjendjes të llogarive 790 dhe 791, gjendja është si vijon:

<table style="margin-left: auto; margin-right: auto; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="text-align: center;">+</td> <td style="text-align: center;">790</td> <td style="text-align: center;">-</td> </tr> <tr> <td style="border-top: 1px solid black; text-align: center;">9.775.000</td> <td style="border-top: 1px solid black; text-align: center;"> </td> <td style="border-top: 1px solid black; text-align: center;">10.323.500</td> </tr> </table>	+	790	-	9.775.000		10.323.500	<table style="margin-left: auto; margin-right: auto; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="text-align: center;">+</td> <td style="text-align: center;">790</td> <td style="text-align: center;">-</td> </tr> <tr> <td style="border-top: 1px solid black; text-align: center;">300.000</td> <td style="border-top: 1px solid black; text-align: center;"> </td> <td style="border-top: 1px solid black; text-align: center;">337.000</td> </tr> </table>	+	790	-	300.000		337.000
+	790	-											
9.775.000		10.323.500											
+	790	-											
300.000		337.000											

që do të thotë se llogaria 790 dhe 791 ka tepricë të hyrjeve edhe atë 585.500, respektivisht 37.500 dhe realizohen evidentimet në vijim:

1ç) 790 - Ll/ia Dallimi i të hyrave dhe të dalave nga puna e rregullt	548.500
800 - Ll/ia Fitimi nga puna e rregullt para tatimit	548.500
<u>Mbyllja e klasës 7</u>	
1d) 791 - Ll/ia Dallimi i të hyrave dhe të dalave nga aktivitetet e jashtëzakonshme	37.000
830 -Ll/ia Fitimi nga aktivitetet e jashtëzakonshme	37.000
<u>Mbyllja e klasës 7</u>	

Përcaktimi i fitimit neto (fitimi pas tatimit)

Në fitimi bruto nga puna e rregullt dhe fitimit bruto nga aktivitetet e jashtëzakonshme sipas rregullave paguhet tatim: tatimi i llogaritur e zvogëlon fitimin dhe formohet fitimi neto, respektivisht fitimi pas tatimit. Pas përlllogaritjes së tatimit, evidentimi është si vijon:

1dh) 800 - Ll/ia Fitimi nga puna e rregullt para tatimit	548.500
810 - Ll/ia Tatimi në fitimin nga puna e rregullt para tatimit	54.850
820 - Ll/ia Fitimi nga puna e rregullt pas tatimit	493.650
<u>Fitimi i përcaktuar neto</u>	
1ë) 830 - Ll/ia Fitimi nga aktivitete e jashtëzakonshme	37.000
840 - Ll/ia Tatimi në fitimin nga puna e jashtëzakonshme	3.700
850 - Ll/ia Fitimi nga aktivitete e jashtëzakonshme pas tatimit	33.300
<u>Për fitim neto</u>	
1f) 820 - Ll/ia Fitimi nga puna e rregullt pas tatimit	493.650
850 - Ll/ia Fitimi nga aktivitete e jashtëzakonshme.	33.300
871 - Ll/ia Fitimi për vitin financiar pas të gjitha tatimeve	526.950
<u>Fitimi i përcaktuar për vitin financiar</u>	

Shpërndarja e fitimit



Fitimi i përcaktuar shpërndahet. Shpërndahet në fakt fitimi pas tatimit, respektivisht fitimi neto. Sipas dispozitave të nenit 483 të Ligjit për shoqëritë tregtare, kuvendi gjegjësisht kuvendi i bashkëshoqëruesve ose vetë bashkëshoqëruesit vendosin për përdorimin e fitimit sipas llogarisë vjetore.

Me vendimin për përdorimin e fitimit paraqitet çdo dedikim veçmas. Me vendimin nuk mund të bëhen ndryshime në llogarinë vjetore të shoqërisë. Shpërndarja e fitimit mund të bëhet për:

- një pjesë të fitimit për mbulimin e humbjeve nga vitet paraprake;
- një pjesë të fitimit për zmadhimin e kapitalit të përhershëm;
- një pjesë të fitimit për zmadhimin e investimeve të përhershme;
- një pjesë të fitimit për dividendë dhe kompensime të tjera të investuesve ;
- një pjesë të fitimit për rezerva;
- një pjesë të fitimit për pagimin e të punësuarve;
- një pjesë të fitimit për hyrjet personale të pronarëve;
- një pjesë të fitimit për dedikime tjera;
- mbetja nga fitimi - fitim i pa shpërndarë.

Për shpërndarjen e bërë zbatohet evidentimi me ngarkimin e llogarisë 871 - Fitimi për vitin financiar pas të gjitha tatimeve, për shumën e përgjithshme kërkojnë llogaritë nga grupi 88 - Shpërndarja e fitimit.

Pas shpërndarjes së bërë zbatohet evidentimi në anën pozitive të llogarive të grupit 88 - Shpërndarja e fitimit pas të gjitha tatimeve, a do të kërkojnë llogaritë për të cilat kanë të bëjnë pjesët e veçuara të klasës 2 dhe 9.

Me zbatimin e evidentimit mbyllet të gjitha llogaritë nga klasa 8 si llogari me karakter të përkohshëm.



Humbja është rezultat financiar negativ.

NOCIONET KRYESORE

Rezultati financiar
 Fitimi bruto
 Fitimi neto
 Humbja

PYETJE

1. Sqaroje procedurën për përcaktimin e rezultatit financiar me procedure kontabiliste!
2. Sqaroje procedurën për përcaktimin e rezultatit financiar me bilanc të suksesit!
3. Çka paraqet fitimi bruto?
4. A paguhet më shumë tatim për fitimin e bruto fitimit më të lartë?
5. Si mund të shpërndalet fitimi neto?
6. Në fund të periudhës përlllogaritëse prej një viti, cilat llogari duhet të kenë saldo 0?
7. Çfarë rezultati financiar është humbja?

Mendoni për këtë:

1. Viktorija Panova është pronare e tre supermerkateve. Secili prej tyre gjendet në pjesë të ndryshme të qytetit. Ajo ka realizuar disa vite fitim. Mirëpo, vitin e kaluar ka pas humbje. Ajo është e interesuar ta zbulojë shkaku për humbjen. Panova mban një libër kryesor për gjithë biznesin. Çka do t'i kishit rekomanduar të bëjë në atë drejtim dhe pse?

USHTRIME PËR EVIDENCË

Ngjarjet kontabiliste në vijim të evidentohen në urdhëresë për evidentim!

1. Të përcaktohet fitimi i realizuar nëse në kontot e bilancit të suksesit gjendja është si vijon:

	debit(+)	kredi(-)	saldo
7013- Ll/ia Vlera furnizuese e mallrave të shitur me të madhe	60.000	20.000	40.000
7014- Ll/ia Vlera furnizuese e mallrave të shitur me pakicë	80.000	26.000	54.000
7020-Ll/ia Vlera furnizuese e materialeve të shitura	30.000	/	30.000
703-Ll/ia Të dala në bazë të mallrave dhe materialeve të shitur	25.500	/	25.500
7510-Ll/ia Të hyra nga shitja e prodhimeve, mallrave dhe shërbimeve në tregun vendor	/	60.000	60.000
7512-Ll/ia Të hyra nga shitja e prodhimeve dhe mallrave nëpërmjet shitoreve vetjake	16.000	80.000	64.000

7560-LI/ia Të hyra nga shitja e lëndëve të para dhe materialeve	/	35.000	35.000
779- LI/ia Të hyra afariste të tjera të pa përmendura	/	8.000	8.000

2. Të përllogaritet dhe të evidentohet fitimi i realizuar nëse gjendja e saldove në kontot e librit kryesor është si vijon:

700- LI/ia Të dala në bazë të prodhimeve dhe shërbimeve të shitur -20.000 den.

701- LI/ia Vlera furnizuese e mallrave të shitur -20.000 den.

702- LI/ia Vlera furnizuese e materialeve të shitur, pjesëve rezerve dhe inventarit të imët-5.000 den.

703- LI/ia Të dala në bazë të mallrave dhe materialeve të shitur-7.000 den.

720-LI/ia Të dala të jashtëzakonshme 3.000 den.

751-LI/ia Të hyra nga shitja e prodhimeve, mallrave dhe shërbimeve në tregun vendor-45.000 den.

756-LI/ia Të hyra nga materialet e shitur, pjesëve rezerve dhe inventarit të imët-7.000 den.

779-LI/ia Të hyra afariste të tjera të pa përmendura -10.000 den.

782-LI/ia Të hyra të jashtëzakonshme të paparashikuara 5.000 den.

Të bëhet shpërndarja e fitimit e përcaktuar në shumë prej 12.000 den. Fitimi i realizuar shpërndahet 10% për tatimin mbi fitimin ndërsa pjesa e mbetur të shpërndahet për:

40% për zmadhimin e kapitalit të pronarëve,

10% për rezerva ligjore,

40% për rroga

10% për fitimin pashpërndarë.

Të zbatohen evidentimet e nevojshme që kanë të bëjnë me evidentimin e klasës 8. Prej Xhirollogarisë është veçuar në llogari të veçantë për rezerva ligjore.

3. Të përcaktohet dhe të evidentohet humbja e paraqitur në periudhën përllogaritëse janar-dhjetor nëse gjendja e kontove të librit kryesor është si vijon:

700- LI/ia Të dala në bazë të prodhimeve dhe shërbimeve të shitura-20.000 den.

701- LI/ia Vlera furnizuese e mallrave të shitur-30.000 den.

702- LI/ia Vlera furnizuese e materialeve, pjesëve rezerve dhe inventarit të imët të shitur-10.000 den.

703- LI/ia Të dala në bazë të mallrave dhe materialeve të shitur-15.000 den.

7009-LI/ia të dala të tjera në bazë të prodhimeve dhe shërbimeve të shitur-15.000 den.

720-LI/ia Të dala të jashtëzakonshme - 8.000 den.

751-LI/ia Të hyra nga shitja e prodhimeve, mallrave dhe shërbimeve në tregun vendor-40.000 den.

756-LI/ia Të hyra nga shitja e materialeve, pjesëve rezerve dhe inventarit të imët-15.000 den.

779-LI/ia Të hyra afariste të tjera të pa përmendura-7.000 den.

782-LI/ia Të hyra të jashtëzakonshme të pa parashikuara-2.000 den.

Të zbatohen evidentimet e duhura që kanë të bëjnë me mbylljen e klasës 7 dhe 8. Humbja të mbulohet;

a) 60% të rezervave ligjore, a 40% mbet e pambuluar,

b) mbulohet në barrë të kapitalit vetjak.

avancë	-pagesa paraprake në transaksion të caktuar shitblerës, afarist
shpenzime administrative	-të gjitha harxhimet janë të ndërlidhura me menaxhimin e tërë organizatës, sipas karakterit janë harxhime të përgjithshme indirekte
aksion	-letër me vlerë me të drejta të caktuara, burim i kapitalit aksionar
kapitali aksionar	-kapitali vetjak i ndërmarrjes, shoqërisë tregtare, e paraqet kërkesën nga ana e pronarëve, aksionarëve, mbi mjetet respektivisht pronën e ndërmarrjes. Përbëhet prej dy pjesëve: kapitali themelor dhe përfitimi i mbajtur i pashpërndarë.
amortizimi i akumuluar	-shuma e pjesës së amortizuar, të pa harxhuar të mjetit të caktuar të përhershëm në periudhën e caktuar
lokacioni	-metoda me ndihmën e së cilës shpenzimet e përgjithshme ose indirekte shpërndahen nëpër njësi organizative të caktuara (seksione, qendra profituese). Këto shpenzime më tutje mund të shpërndahen në prodhime dhe shërbime, por mundet edhe si të dala të periudhës të mbulohen nga të hyrat e përgjithshme në periudhën përllogaritëse.
amortizimi, depresimi	-pjesë e vlerës së mjeteve të përhershme e cila si harxhim do të kalkulohet në çmimin e kostos së rezultateve ose po do të trajtohet si e dalë në periudhën përllogaritëse dhe do t'i kundërvihet të hyrave të realizuara në atë periudhë.
shuma amortizuese	-shuma e fituar nga përllogaritja e amortizimit të ndonjë mjeti të përhershëm
llogaria analitike	-llogaria analitike, element përbërës i një llogaria sintetike
analiza e aktiviteteve	-identifikimi i detajuar dhe përshkrimi i aktiviteteve në një shoqëri tregtare
akreditiv	-letër kreditore garantuese me të cilën garantohet pagesa e obligimeve
aktiva	-nacion i cili shpreh pronë të përgjithshme, mjete të një subjekti afarist
bilanc provues i agjustuar	-bilanc provues i përpiluar pas bërjes së të gjitha regjistrimeve korrektive dhe regjistrimeve të tjera parambyllëse të llogarive në librin kryesor, të cilat nëse janë bërë në mënyrë korrekte, bilanci provues i agjustuar do të ketë anë kreditore dhe debitore të balancuar
agjustim	-procedurë financiare interne për sjelljen e gjendjes së llogarive në librin kryesor up to date. Është e domosdoshme para përpilimit të llogarisë vjetore, por edhe gjatë vitit përllogaritës. Ajo është pjesë e procedurave kontabiliste të planifikuara

formula	-formula e cila e tregon raportin ndërmjet mjeteve, obligimeve dhe kapitalit të pronarëve. Kjo formulë përlllogaritet në mënyrën si vijon
kontabiliste bazike	<i>mjetet-obligimet+kapitali i pronarëve</i> . Formula bazike kontabiliste doemos duhet të jetë çdoherë e balancuar
bilanc	-raporti financiar
bilanc i gjendjes	-raporti financiar për gjendjen e pronës (mjetet) dhe burimet e mjeteve (kapitali dhe obligimet) në ditën e caktuar e njohur si dita e balancimit. Çdo pozitë bilancore në fakt e paraqet gjendjen e mjetit të caktuar ose burimit të mjetit, për të cilat në librin kryesor në kontabilitetin e ndërmarrjes është hapur llogaria përkatëse sintetike. Bilanci i gjendjes i cili përpilohet më 31.12 (gjegjesisht fundi i vitit afarist) është pjesë përbërëse e llogarisë vjetore të një ndërmarrjeje, institucioni ose subjektit tjetër juridik i cili në përputhje me rregullat ligjore është i obliguar të mbajë kontabilitet.
bilanc i suksesit	-raport financiar i cili e tregon rezultatin financiar të një subjekti afarist në periudhë të caktuar kohore (një muaj, tre muaj, gjashtë muaj, vit). Çdo pozitë bilancore në bilancin e suksesit e tregon gjendjen e të hyrave dhe të dalave në periudhë të caktuar përlllogaritëse, e ndërmarrë nga saldoja e kontove të të hyrave dhe të dalave në librin kryesor në kontabilitetin e subjektit. Bilanci i suksesit i përpiluar për një periudhë prej një viti afarist është pjesë përbërëse e llogarisë vjetore të subjektit afarist.
arka	-njësia organizative ku bëhen pagesat në dhe nga kasa, kutia në të cilën ruhen para të gatshme në subjektin afarist, institucionin dhe ngjashme, në kontabilitetin llogari e arkës.
raporti i arkës	-ditari special për pagesat e bëra në dhe nga kasa në një ditë.
blanko	-raport i pa përmbushur, i zbrazët financiar, instrument për pagesë, dokument doganor dhe të ngjashme.
llogaria e bllokuar	-llogaria e subjektit të caktuar afarist nëpërmjet së cilës nuk lejohen pagesa të mjeteve financiare për shkak të shkaqeve të caktuara si që janë procedura për falimentim, stërngarkimi me borxh dhe ngjashëm.
boniteti	-gjendja ekonomike-financiare e subjektit afarist, e vlerësuar në bazë të treguesve financiarë për aktivitetin e tij afarist.
brendi	-pjesë e pronës jo materiale të një subjekti afarist
numri i llogarisë	-simbol i llogarive të shpërndara në kornizën e kontos dhe planin e kontos në bazë të metodologjisë shkencore.
fitimi bruto	-fitimi i realizuar nga të gjitha aktivitetet në një subjekt afarist para tatimit të saj.

hua banke	-obligim rrjedhës ose afatgjatë, burimi i mjeteve.
deklarata doganore	-dokument në bazë të së cilit kontabiliteti evidenton obligim për pagesën e doganës.
kontabiliteti i dyfishtë	-sistem i evidencës së tërësishme dhe të rumbullakuar të të gjitha transaksioneve financiare afariste në një subjekt afarist, institucion, organizim dhe ngjashëm.
debit	-ana e borxhit ose plus (+) i llogarisë
cikli afarist	-koha mesatare ndërmjet furnizimit të materialit i cili kyçet në procesin e prodhimit të së prodhimeve dhe shërbimeve dhe realizimi final monetar i atyre prodhimeve dhe shërbimeve.
transaksioni afarist	-ngjarje ekonomike e cila mund të shprehet në nocione financiare dhe të cilat ndikojnë në mjetet dhe burimet e tyre në një subjekt afarist.
librat afarist	-evidenca e përgjithshme e mbajtjes së kontabilitetit për ngjarjet afariste në një subjekt afarist.
llogaria revizore	-llogaria në të cilën evidentohen mjetet devizore me të cilat disponon një subjekt afarist.
harxhimet direke	-shpenzime të cilat drejtpërdrejtë përfshihen në çmimin e kostos së rezultateve (prodhimeve dhe shërbimeve), si që janë materialet për përpunimin e rezultateve dhe angazhimi për përpunimin. Edhe gjatë krijimit të këtyre shpenzimeve dihet për cilin o prodhim ose shërbim kanë të bëjnë.
diskon	-lirimi gjatë shitjes së prodhimeve dhe shërbimeve të cilat i zvogëlojnë të hyrat
mëditje	-harxhimi rrjedhës në punën e një subjekti afarist i ndërlidhur me udhëtime të caktuara afariste të të punësuarve.
ditar	-libër afarist në përbërjen e kontabilitetit të dyfishtë në të cilin sipas rendit kronologjik çdo ditë bëhet evidentimi i ngjarjeve afariste-kontabiliste të paraqitura. Ditari, së bashku me librin kryesor janë librat afarist kryesor në sistemin e kontabilitetit të dyfishtë.
fitim	-fitimi paraqet rritje të kapitalit të ndërmarrjes si rezultat i aktivitetit të rregullt dhe të parregullt të ndërmarrjes. Përcaktohet si dallim ndërmjet të dalave të përgjithshme dhe të hyrave të përgjithshme dhe paraqitet si fitim pas tatimit (bruto fitim) dhe fitim pas tatimit (fitimi neto). Fitimi është element i bilancit të suksesit, ndërsa si përfitim i shpërndarë paraqitet si pozitë edhe në bilancin e gjendjes në ndërmarrjen.

investime financiare afatgjate	-ajo pjesë e mjeteve afatgjate e cila është angazhuar në investime monetare më gjatë se një vit.
data e pagesës	-data kur një kompani ua paguan dividendët aksionarëve të vetë.
efektiviteti	-kryerja e aktiviteteve me shpenzime sa më të vogla
fi-fo	-metoda për vlerësimin e vlerës së rezervës së harxhuar të materialit, rezerva e mallit, lëndës djegëse. Shënon çmim të parë hyrës dhe të parë dalës për përlogaritje.
mjete fikse	-prona e ndërmarrjes afati i përdorimit i së cilës është më gjatë se një vit, element i bilancit të gjendjes.
harxhime fikse	-shpenzime të cilat në shumën e vetë të përgjithshme mbesin të njëjta pavarësisht nga shkalla e shfrytëzimit të kapacitetit. Ato mbesin të njëjta edhe në rast se kapaciteti shfrytëzohet në mënyrë optimale edhe atëherë kur aspak nuk shfrytëzohet. Shpenzime fikse janë për shembull: amortizimi, kamatat e kredive për mjete të përhershme, qiraja, shpenzimet për sigurimin etj.
obligimi financiar	-obligime ndaj institucioneve financiare, obligime për letrat e lëshuara me vlerë, elementet e bilancit të gjendjes së një subjekti afarist.
gjendja financiare	-gjendja e një subjekti afarist e përcaktuar me analizën e pronës së tij dhe obligimeve dhe kapitalit të tij.
filiale	-filiali, njësia afariste, ekspozitura e subjektit të caktuar, institucioni.
forma e llogarisë	-mënyra e prezantimit të llogarive në sistemin ne kontabilitetit të dyfishtë
amortizimi funksional	-metoda për përcaktimin e shumës së amortizimit të mjeteve të përhershme e cila bazohet në rezultatin e realizuar nga mjetet e përhershme.
fatura	-dokument për furnizimin ose shitjen e prodhimeve, mallrave dhe shërbimeve në bazë të së cilit përpilohet kalkulimi dhe bëhet evidenca kontabiliste.
raporte financiare	-nocioni për shprehjen e setit të raporteve të cilat i përpilon kontabiliteti financiar në të cilat hyjnë: bilanci i gjendjes, bilanci i suksesit, raporti i parave të gatshme, vërejtjet dhe raportet tjera dhe të gjitha elementet përbërëse të llogarisë vjetore të ndërmarrjes.
kontabiliteti financiar	-kryesisht, në mënyrë qendrore gjegjësisht afariste, ka të bëjë për tërësinë e ndërmarrjes dhe para së gjithash është drejtuar kah raportet e ndërmarrjes me botën e jashtme, me rrethinën, respektivisht shfrytëzuesit e jashtëm.

mjeti financiar	-cilido mjet në formë të parave të gatshme, e drejtë kontraktuese të pranohen para të gatshme ose mjet financiar tjetër nga ndërmarrja tjetër, e drejtë kontraktuese të këmbehen instrumente financiare me ndërmarrje tjetër në kushte potenciale të volitshme dhe instrument pronësor i ndërmarrjes tjetër.
viti fiskal	-cilado periudhë kontabiliste 12 mujore e shfrytëzuar për matjen e performansave të një subjekti ekonomik, mund të fillojë më 1 janar dhe të përfundojë më 31 dhjetor, që do thotë të përputhet me vitin kalendarik por edhe nuk është patjetër.
periudha fiskale	-nacion tjetër për vit fiskal.
libri kryesor	-libri afarist kryesor në sistemin e kontabilitetit të dyfishtë në të cilin në llogaritë sintetike evidentohen ndryshimet afariste me anë kronologjike.
kryegjëja	-e përfaqëson të drejtën e pronarëve mbi mjetet në ndërmarrjen. Ajo është vlera e kapitalit që u takon pronarëve të ndërmarrjes pa dallim nga forma e pronësisë. Kryegjëja përlllogaritet si dallim vlerës së mjeteve dhe obligimeve të paraqitura në bilancin e gjendjes. Në fakt, kryegjëja është e njëjtë me mjetet neto në ndërmarrjen.
llogaria vjetore	-përlllogaritja e performansave financiare për një vit fiskal. Përbëhet prej raporteve financiare themelore dhe raporte tjera plotësuese. Përmbajtja e saj rregullohet me rregullat e Ministrisë së Financave.
para në dorë	-para në arkë, Xhiro dhe depozita me të parë
rrjedha e parave në dorë	-hyrje dhe derdhje të parave të gatshme dhe të ekuivalentëve të gatshëm.
grupi	-ndërmarrja amë dhe të gjitha ndërmarrjet e saj.
gudvill	-dallimi ndërmjet vlerës së cilën është i gatshëm ta paguajë blerësi për biznesin e caktuar (ndërmarrje) dhe vlera korekte e paraqitur e mjeteve neto në bilancin e gjendjes së asaj ndërmarrjeje. Ekzistojnë më shumë arsye pse blerësi është i prirë të paguajë më shumë për biznesin e blerë sesa që është vlera e mjeteve të tij. Disa nga ato arsye janë: reputacioni i mirë i ndërmarrjes, besimi te konsumatorët , kuadri cilës,or, lokacioni etj. Sipas kësaj, gudvilli e paraqet dallimin ndërmjet vlerës kontabiliste të vlerësuar në mënyrë korekte, dhe vlerës ekonomike të një ndërmarrjeje.

hipoteka, pengu	-prona e lënë peng, si siguri për pagesën e huave afatgjata.
prona	-pronësia, mjetet e një subjekti afarist.
prona, ndërtesa dhe pajisja	-mjete afatgjate të prekshme, pjesë e pronës së përhershme të një subjekti të cilat do të shfrytëzohen në mënyrë të vazhdueshme në biznesin në periudhë më të gjatë kohore.
shpenzime indirekte	-shpenzime të cilat nuk munden drejtpërdrejtë të shpërndahen nëpër rezultate të caktuara gjatë paraqitjes së tyre. Ato njihen edhe si shpenzime të përgjithshme ose të regjisë. Ato janë shpenzime të përbashkëta të cilat kanë të bëjnë me më shumë rezultate dhe të cilat fillimisht ndërlidhen për vendet e caktuara të shpenzimeve dhe në prodhimet dhe shërbimet shpërndahen në mënyrë ndërmjetësuese, indirekte, me ndihmën e çelësave të caktuar. Shpenzimet e drejtpërdrejta njihen edhe si shpenzime primare ndërsa shpenzimet indirekte edhe si shpenzime sekondare.
raport për ndryshimet në kapitalin	-paraqet një pasqyrim të shkurtër në të cilin përmbahen ndryshimet në kapitalin pronësor në periudhën përlllogaritëse. Ky raport është edhe një formë e lidhjes bashkuese ndërmjet bilancit të gjendjes dhe bilancit të suksesit.
raport për gjendjen financiare	-raporti financiar i cili e paraqet gjendjen e pronës, gjegjësisht të mjeteve dhe obligimet e tyre në ditën e caktuar.
emri i brendit	-emër i njohur për identifikim in e prodhimeve, shërbimeve ose firmave.
dokumenti origjinal	-dokument i cili përdoret si bazë për evidencën kontabiliste.
kapaciteti	-aftësia të ruhet, pranohet ose përmbahet; shuma maksimale e cila mund të ruhet ose përmbahet; vëllimi maksimal i cila mund të prodhohet.
kapitali	-sipas konceptit financiar kapitali është sinonim për mjetet neto ose kryegjëja e ndërmarrjes.
humbja kapitale	-dallimi ndërmjet vlerës shitëse më të vogël dhe vlerës aktuale më të madhe gjatë shitjes së mjeteve të përhershme si edhe dallimi ndërmjet çmimit më të vogël të shitjes dhe çmimit më të lartë të blerjes gjatë tjetërsimit të letrave me vlerë nga portofoli i firmës.
struktura kapitale	-burimet dhe shumat e kapitalit që përdoren për financimin e mjeteve kapitale të biznesit; burimet e kapitalit përfshijnë obligime afatgjata, aksione të rëndomta, me prioritet si edhe fitimi i mbajtur.
kesh të gatshme	-pagesat me para në dorë në biznes dhe jashtë biznesit.

mbajtje e kontabilitetit	-pjesë e sistemit kontabilistë të cilën bëhet evidentimi i dokumentuar dhe i rreptë formal në të cilin në[mënyrë kronologjike dhe sistematike evidentohen ndryshimet afariste të paraqitura.
regjistrime korrektuese	-regjistrime të bëra për shkak të zbatimit të parimit përlllogaritar kontabilist të transaksioneve, të cilat shtrihen në dy ose më shumë periudha kontabiliste
kredi	-ana kërkuese ose minusi (-) i një llogarie.
kompleksitet	-pjesë të cilat janë të ndërlidhura ndërmjet veti.
korniza e kontos	-baza në të cilën ndërmarrjet i zhvillojnë planet individuale llogaritëse të veta në përputhje me nevojat e tyre për informata vlerash të ndryshme. Përderisa korniza e kontos është nomenklaturë e llogarive më së shpeshti sintetike tre shifrore, e përcaktuar nga organi përkatës shtetëror ose profesional. Nga kjo del se korniza llogaritëse është nocion më i gjerë se plani llogaritës dhe në të më së shpeshti është bërë analizimi tre shkallor i llogarive. Ajo më së shpeshti përcaktohet për numrin më të madh të ndërmarrjeve ose po për ndërmarrjet e një ekonomie nacionale. Në kushtet tona kornizën e atillë të kontos e përcakton Ministria e Financave me Urdhëresë përkatëse.
llogari kontra	-llogaria saldoja e së cilës merret ose shtohet nga për të llogarinë e ndërlidhur në raportet financiare.
kontrolli	-fuqia e udhëheqjes me politikën financiare dhe afariste të disa ndërmarrjeve.
llogaria korrektuese	-ka për detyrë ta korrigojë, rregullojë vlerën e ndonjë mjeti të evidentuar në ndonjë llogari tjetër, jo të tërësishme.
rezervat e fundit	-rezerva në dispozicion në fund të periudhës përlllogaritëse.
shkurtimet	-në rast se gjendja faktike e mjeteve është më e vogël vlera kontabiliste fajin e të cilit mund ta bartë personi përgjegjës, kompania e sigurimit dhe në barrë të vetë ndërmarrjes.
licencë	-të drejtë ekskluzive për formulën, teknikën, teknologjinë ose dizajnin; evidentimi ligjor se dikush është i kualifikuar për kryerjen e disa aktiviteteve; pjesë e pronës fikse në lloj jo material.

LI-FO	-metoda për vlerësimin e shpenzimit të rezervave. Sipas metodës LI-FO, çmimi hyrës i fundit- çmimi i parë i daljes (last in first out), harxhimi i materialit të kërkuar si harxhim llogaritet sipas çmimit të materialit të fundit të furnizuar. Pasi të harxhohet ai material, fillohet me përlogaritjen e çmimit të furnizimit të parafundit i cili tani e ka rolin e sasisë së fundit të furnizuar dhe gjithë ashtu me radhë.
masa likuiduese	-shuma e mjeteve të parave të cilat krijohen me shitjen e mjeteve të ndër marrjes që është në procedurë të likuidimit dhe me të cilat mjete të parave paguhen obligimet e ndërmarrjes.
likuiditeti	-një nga treguesit themelorë për efikasitetin e punës së subjekteve ekonomike. E mat aftësinë e ndërmarrjes t'i kompensojë obligimet e arritura ndaj furnizuesve.
shpenzime margjinale	-harxhime plotësuese për prodhimin e njësisë plotësuese për prodhime dhe shërbime
standarde kontabiliste ndërkombëtare	-parimet dhe rregullat kontabiliste për procedurat dhe politikat kontabiliste në subjektet afariste të përpiluara dhe të publikuara në Komitetin për standarde kontabiliste ndërkombëtare.
Komiteti për standarde kontabiliste ndërkombëtare	-trup profesional i pavarur qëllimi i të cilit është të arrijë unifikim i parimeve kontabiliste, i standardeve të cilat përdoren gjithkund nëpër botë për njoftimin financiar në organizatat afariste dhe të tjera. Është formuar në vitin 1973 . Prej vitit 2001 është riemëruar në Këshill për standardet kontabiliste.
menaxhmenti	- procesi i identifikimit, matjes, analizimit,
kontabiliteti drejtues	interpretimi dhe lajmërimi i informatave me qëllim të realizimit të qëllimeve të organizatës, orientuar para së gjithash kah shfrytëzuesit e brendshëm, menaxherët dhe të punësuarit tjerë.
matje	-procesi i përcaktimit të shumave të parave sipas të cilëve elementet e raporteve financiare do të pranohen në bilancin gjendjes dhe bilancin e suksesit.
mendim	-pjesa e raportit revizor ku paraqitet opinioni përfundimtar i revizorit në raport me raportet e përpiluara financiare.
prodhimtari e papërfunduar	-prodhime pjesërisht të përfunduar dhe të shërbimeve (rezultateve) që nuk janë të gatshëm për shitje.
fitimi neto	-kur nga bruto fitimi si dallim ndërmjet të hyrave dhe të dalave të përgjithshme, do të hiqen të gjitha tatimet dhe llojet tjera të shpenzimeve, realizohet fitimi neto, i cili më tutje mund të shpërndahet për dedikime të ndryshme.

kapitali nominal	-shuma e kapitalit e cila fitohet me shumëzimin e numrit të aksioneve të emetuara me çmim nominal për një aksion dhe e paraqet kapitalin fillestar ose inicial i cili është publikuar në emetimin primar të aksioneve.
qarkullimi	-sa herë që prodhim i caktuar do të shitet, rezerva do të ripërtërihet përsëri për periudhë të caktuar kohore fikse.
qarkullimi i mjeteve	-mënyra e matjes së profitabilitetit dhe efikasitetit të mjeteve të cilat përdoren për bërjen e shitjes dhe përcaktohet me ndarjen e shitjes neto me mjetet e përgjithshme mesatare.
qarkullimi i kapitalit	-të hyra nga shitja të ndara me kapital të investuar, masa për shfrytëzimin efikas të kapitalit të investuar
obligime	-një pjesë e burimeve të mjeteve, të cilat ndër marrja e caktuar i ka përfituar nga transaksionet që kanë të bëjnë me sigurimin e mjeteve, shfrytëzimin e shërbimeve ose përfitimit të dobive të tjera. ndërmarrja duhet obligimet e veta t'i kompensojë brenda afati të kontraktuar dhe nën shërbimet kontraktuese dhe në rast se do ta ruajë kredibilitetin të të punësuarit, të furnizuesit, të kreditorët dhe partnerët afarist të tjerë, Obligimet janë element i bilancit të gjendjes së ndërmarrjes.
obligacione	-letra afatgjate me vlerë, me përfitime fikse të cilat paraqesin instrument kreditor për grumbullimin e mjeteve plotësuese për financimin e aktivitetit të caktuar dhe të cilat duhet të paguhet me kamatë në periudhën kohore saktë të përcaktuar ose në orar të dhënë të kohës.
të dala të paguara me avancë	-të dala të cilat janë paguar me avancë, me ç' rast janë ende të pa realizuara, si për shembull pagesa e policës për sigurimin për tre vjet paraprakisht.
revizor i autorizuar	-personi i cili e ka dhënë provimin për revizor që të mund të bëjë revizion financiar të raporteve
kontabilist i autorizuar	-personi i cili ka marrë certifikatë profesionale për mbajtjen e kontabilitetit.
kapitali fillestar	-gjatë formimit të ndërmarrjes të shoqërisë aksionare bëhet emetimi primar i aksioneve që të grumbullohet kapitali për financimin e biznesit, ashtu që kapitali i cili grumbullohet me shitjen e parë të aksioneve, paraqet kapital fillestar.
kompensimi	-përmbushja e obligimeve të ndërmarrjes.
çmimi i plotë kostoja	-harxhime të përgjithshme të bëra për prodhimin e një njësie prodhim

regjistrimi	-përcaktimi faktik i mjeteve dhe obligimeve nëpërmjet numërimit të tyre, vërtetimit, grumbullimit dhe shumëzimit dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabiliste.
portofoli	-një grup ose set i investimeve ose huave të cilat janë krijuar me qëllim që të japin proporcion më të mirë ndërmjet hyrjeve dhe rreziqeve të investuesit dhe kreditorit.
premia	-shuma e cila paguhet gjatë blerjes së policës për sigurim; shuma e cila e tejkalon vlerën nominale të obligacionit gjatë lëshimit të tij.
fitimi i bartur	-fitimi neto i pashpërndarë i cili bartet në periudhën përlllogaritëse vijuese dhe është pjesë e bilancit të gjendjes
humbja e bartur	-në rast se humbja nuk mund të mbulohet nga burimet e parashikuara, ajo bartet në periudhën përlllogaritëse vijuese dhe është pjesë e bilancit të gjendjes.
bartja e shpenzimeve	-shpenzimet të cilat evidentohen sipas llojeve hyrëse dhe janë lëndë e bartjes dhe shpërndarjes nëpër vende të shpenzimeve dhe nëpër bartës të shpenzimeve me qëllim që të përcaktohet çmimi i rezultateve.
të hyra të përlllogaritura të pa arkëtuara	-të hyra për të cilat është bërë shërbim ose janë dorëzuar prodhime por ende nuk evidentohen si të hyra. Që të evidentohet hyrja, duhet që llogaria për kërkesa të debitohet ndërsa llogaria për hyrje të kreditohet.
partneritet	-ndërmarrje në pronësi të dy ose më shumë personave.
përlllogaritës	-njihet edhe si periudhë përlllogaritëse, paraqet
periudhë	periudhë kohore në të cilën përlllogaritja e rezultatit financiar të ndërmarrjes. Ajo është periudhë ndërmjet dy bilanceve të gjendjes ose periudhë për të cilën përpilohet bilanci i suksesit. Periudha përlllogaritëse më e madhe është periudha prej një viti, e cila për numrin më të madh të ndërmarrjeve përputhet me vitin kalendarik, mund të jetë edhe një muaj, tremujor, gjashtëmujor ose nëntëmujor.
të hyra	-paraqesin rritje të resurseve ekonomike në ndërmarrjen për shkak të hyrjes së mjeteve ose zvogëlimit të obligimeve, prej aktivitetit të zakonshëm të ndërmarrjes, respektivisht prej shitjes së prodhimeve dhe shërbimeve, si edhe sipas kushteve të tjera si që janë kamatat, rentat dhe bazat tjera. Të hyrat janë element i bilancit të suksesit.
bilanc provues	-përpilimi i raportit ku bëhet krahasimi i anëve ka borxh dhe kërkon të llogarive të përgjithshme nga libri kryesor që të shihet nëse ka shmangie.

të dala	-paraqesin zvogëlime të resurseve ekonomike për shkak të derdhjes dhe zvogëlimit të mjeteve ose krijimit të obligimeve, si rezultat i aktiviteteve afariste të përditshme të ndërmarrjes. Të dalat janë element i bilancit të suksesit të ndërmarrjes.
të dala të periudhës	-evidentimi i të dalave mund të jetë periodik dhe përlllogaritet në mënyrën si vijon: përcaktohet vlera e rezervave të prodhimeve të gatshme dhe prodhimeve të pa mbaruara më 01.01, përcaktohet shuma e harxhimeve të bëra deri në ditën kur bëhet përlllogaritja, vlera e këtyre shpenzimeve i shtohet vlerës së rezervave fillestare të prodhimeve të gatshme dhe prodhimtarisë të pa përfunduar dhe fitohet vlera e investimeve të përgjithshme në periudhën dhe në fund prej vlerës së investimeve të përgjithshme hiqet vlera prodhimtarisë të pa përfunduara dhe rezerva e prodhimeve të gatshme në ditën e përlllogaritjes dhe dallimi i fituar i jep të dalat e periudhës.
kuptueshmëri	-cilësia e informatave kontabiliste në raportet financiare, sipas të cilave informata është e kuptueshme në rast se mund ta kuptojë shfrytëzuesi i cili ka njohuri mesatare për aktivitetet afariste dhe ekonomike të kontabilitetit.
revalorizim	-përcaktimi i përsëritur i vlerës së mjeteve, obligimeve dhe kapitalit, më së shpeshti e shkaktuar nga ndryshimet e nivelit të çmimeve.
revizion	-procedura për kontrollimin e saktësisë së të dhënave në raportet financiare. Mund të jetë shtetërore dhe komerciale.
shtëpi revizore	-ndërmarrje e autorizuar nga ana e shtetit për kryerjen e aktiviteteve revizore dhe për përgatitjen e raporteve revizore.
raport revizori	-kontrolli i pavarur i raporteve financiare të ndërmarrjeve nga ana e shtëpive revizore të autorizuara, të cilat konfirmojnë se raportet prezantohen në parime korrekte dhe në përputhje me parimet kontabiliste përgjithësisht të pranuar.
saldimi i llogarisë	-procedura e cila bëhet në fund të periudhës përlllogaritë kur përcaktohet saldoja përfundimtare e llogarive të caktuara nga libri kryesor me krahasimin e anëve ka borxh dhe kërkon dhe bartja e saldës në raportet financiare.
saldo	-dallimi ndërmjet anëve ka borxh dhe kërkon të llogarive nga libri kryesor.

llogaria sintetike	-llogaria e fituar me anë të analizimit gradual të llogarive në kornizën e kontos, e shënuar me simbolin tre shifror (shihe numrin kontabilist). Mund të përbëhet prej më tepër llogarive analitike.
dokument kontabilist	-është dokument i shkruar i cili përdoret si bazë për regjistrimin dhe kontrollimin e regjistrimeve të bëra dhe e cila kohë pas kohe paraqet mjet provues për vërtetësinë e ngjarjes së ngjarjes së caktuar afariste gjegjësisht kontabiliste. Çdo dokument ka formën e vetë dhe elementet e veta. Elementet të cilat i përmban çdo dokument më së shpeshti janë: data dhe vendi i lëshimit të dokumentit, emri i dokumentit, vetë ngjarja për shembull, një faturë e daljes për shitje duhet të përmbajë sasinë e shitur, çmimin, shumën e përgjithshme, lirimin në rast se ka, avanca e refuzuar në rast se paraprakisht është marrë avancë. Në dokumentin duhet të jenë edhe emrat e firmave ose personave të cilët marrin pjesë në ngjarjen afariste, vula dhe nënshkrimi i personave të autorizuar.
kontabilist	-personi i cili është licencuar nga shteti në të cilin jeton dhe i cili vendos sistem për futjen dhe evidentimin e të dhënave financiare; personi i cili e bën revizionin e të dhënave financiare; personi i cili i ruan të dhënat e kompanisë për transaksionet financiare.
vlera kontabiliste	-dallimi ndërmjet mjeteve të përgjithshme të kompanisë dhe obligimeve të saj; dallimi ndërmjet vlerës furnizuese të mjeteve të përhershme dhe amortizimit të akumuluar.
plan përlllogaritës	-instrumenti kryesor në kontabilitetin. Plani kontabilist zhvillohet nga korniza e kontos. Korniza e kontos është baza mbi të cilën ndërmarrjet i zhvillojnë planet e tyre individuale në përputhje me nevojat e tyre për informatat e ndryshme të vlerave. Plani përlllogaritës paraqet nomenklaturë të llogarive analitike të një ndërmarrjeje, të zhvilluara nga llogaritë sintetike në kornizën e kontos, ndërsa në përputhje me nevojat dhe specifikat e një ndërmarrjeje ose grupit të ndërmarrjeve të afërme. Në planin kontabilist pra, sipas nevojave për informata për gjendjen dhe ndryshimet të mjetet, kapitali dhe obligimet, harxhimet, rezultatet, të dalat dhe të hyrat e një ndërmarrjeje konkrete, është bërë zbërthimi i llogarive sintetike nga korniza e kontos të llogarive analitike dhe subanalitike. Plani kontabilist është bazë për organizimin e kontabilitetit në ndërmarrjen.

llogaria	-instrumenti kryesor i sistemit të kontabilitetit të dyfishtë, paraqet tregues të caktuar, këndvështrim të caktuar. Llogaria merr identitetin e formave të caktuara të mjeteve, të dalave dhe të hyrjeve, të harxhimeve dhe i përfshin proceset të cilat shkaktojnë ndryshime të tyre: furnizimi, prodhimtaria, realizimi dhe shpërndarja. Detyra e çdo llogarie është ta përcaktojë madhësinë e vlerës së kategorisë ekonomike të shënuar në emrin e saj dhe t'i paraqesë ndryshimet e vlerave të cilat krijohen te ajo kategori në periudhë të caktuar. Paraqitet në më shumë forma (dyanëshe, njëanëshe, shkallëzore, tabelore, T-forma për qëllime edukative). Në praktikë më së shpeshti përdoret forma njëanëshe e kontos.
ngjarje kontabiliste	-ngjarje kontabiliste është ngjarje afariste e cila mund të matet në vlerë, në para dhe e cila me ngjarjen e saj shkakton ndryshime te kategoritë kontabiliste: mjete, obligime, kapital, të dala dhe të hyra.
procedura kontabiliste, cikli kontabilist	-set i proceseve të cilat mundësojnë identifikim, regjistrim dhe sistematizim të ngjarjeve kontabiliste dhe procesuimi i tyre dhe mandej në formë të informatave bëhet transferimi te shfrytëzuesit.
numri kontabilist	-numri i unifikuar i cili shënon një llogari në kornizën e kontos dhe në panin kontabilist.
standardet kontabiliste	-rregullat kontabiliste, procedurat dhe udhëzimet e shkruara nga asociacionet kontabiliste profesionale.
kontabilitet	-procesi i identifikimit, matjet dhe njoftimi i informatave ekonomike me qëllim të sigurimit të gjykimit të informuar dhe marrjes së vendimeve nga ana e shfrytëzuesve të informatave. Kontabiliteti paraqitet si sistem kontabilist informativ dhe është një ga nënsistemet themelore në sistemin informativ në ndërmarrjen. Sistemi informativ kontabilist sipas natyrës është sistem informativ formal, në çdokuptim të fjalës. I përfshin të gjitha karakteristikat e një sistemi, duke i përfshirë qëllimet, etapat, detyrat, shfrytëzuesit dhe mjetet. Sistemi informativ i një firme ka fushëveprim gjithëpërfshirës. Shtrihet në të gjithë shfrytëzuesit jashtë firmës. Kjo ka të bëjë edhe me sistemin informativ kontabilist. (SIK)...
kërkesa të dyshimta	-pamundësia të arkëtohet kërkesa për shkak të falimentimit ose bankrotimit të debitorit dhe për këtë arsye bëhet vlerësimi i kërkesës së atillë si e dyshimtë kontestuese.

standard	-rregull për atë se si duhet diçka të duket dhe çka duhet të përmbajë, respektivisht rregulli për karakteristikat të cilat materiali, prodhimi ose shërbimi duhet të kenë, ose të kënaqin. Standardi është kualitet i përcaktuar.
stornimi	-metoda për korrigjimin e regjistrimeve të gabueshme me përdorimin e metodës së stornos së thjeshtë dhe të stornos së kuqe.
investime rrjedhëse	-investime të cilat mund të realizohen shpejtë dhe nuk ruhen më gjatë se një vit.
mjete rrjedhëse	-mjete realizimi i të cilave dhe koeficient i qarkullimit i të cilave është më së paku një herë në vit.
tregti	-aktivitetet e ndërmjetësimit ndërmjet prodhuesve dhe konsumatorëve dhe nëpërmjet bërjes së qarkullimit, duke blerë prodhime ose mallra prej njëres palë që t'ia shesin palës tjetër.
aksione të thesarit	-pjesë e aksioneve paraprakisht të emetuara të cilat ndërmarrja në periudhën e caktuar i blen.
harxhime	-paraqesin një nga kategoritë ekonomike më të rëndësishme. Ato janë kategori shumë e rëndësishme. Shpenzimet janë faktori i drejtpërdrejtë të cilët e determinojnë çmimin e kostos së rezultateve (prodhimet dhe shërbimet), dhe me këtë janë edhe një nga faktorët më të rëndësishëm të rezultatit të punës të ndërmarrjes. Shpenzimet më së shpeshti definojnë si shprehje monetare e harxhimit të mjeteve dhe punës e cila kalkulohet në çmimin e kostos së punës dhe prodhimeve si rezultate. Ky definicion nuk i merr parasysh ato shpenzime të cilat nuk kalkulojnë në çmimin e kostos së rezultateve, kur nuk përcaktohet çmimi i plotë i kostos. Një pjesë e harxhimeve të përgjithshme të cilat në mënyrë primare evidentohen si lloje të natyrshme të harxhimeve në rastin kur përcaktohet çmimi jo i plotë i kostos së rezultateve përkufizohen nga harxhimet e rezultateve dhe trajtohen si harxhime (të dala) të periudhës në të cilën janë krijuar. Një pjesë e shpenzimeve të cilat ndërlidhen me rezultatet, pjesa e cila është e përfshirë në rezervat e prodhimtarisë së pambaruar, gjysmë prodhimet dhe prodhimet e gatshme nuk transformohen në të dala në periudhën kontabiliste ato do të transformohen në të dala në periudhën përlllogaritëse me shitjen e rezervave.
shpenzime për kërkime dhe zhvillim	-shpenzime të bëra për futjen dhe testimin e prodhimeve të reja, shërbimeve, procedurave, teknologjive.

rezultati	-prodhimi ose shërbimi për të cilin bëhen harxhime, bartësit e shpenzimeve.
harmonizimi i llogarisë	-ndryshimi, ndërrimi ose korigjimi i llogarive me qëllim që të bëhen të dhënat më precize
valuta	-para, prej letre ose metali të cilat përdoren si instrument për këmbim.
afati i jetës	-afati i pritur i përdorimit të një mjeti i cili është lëndë e amortizimit.
tatimi i hyrjes	-tatimi i vlerës së shtuar i llogaritur gjatë blerjes së prodhimeve, mallrave dhe shërbimeve. Përkundër tij qëndron tatimi dalës i vlerës së shtuar i cili përlllogaritet gjatë shitjes së prodhimeve, mallrave dhe shërbimeve.
përfitimi i mbajtur	-kërkesat nga ana e aksionarëve për mjetet të cilat janë përfituar nga biznesi; përfitimet e akumuluar të korporatës prej fillimit të saj minus çdo humbje, dividendë ose transferime të kapitalit.
humbja	-humbja paraqet zvogëlim të kapitalit të ndërmarrjes, si dallim ndërmjet të dalave të përgjithshme dhe të hyrave më të vogla të përgjithshme nga aktiviteti i rregullt dhe i parregullt i ndërmarrjes në një periudhë përlllogaritëse. Humbja është element i bilancit të suksesit, a si humbje e pambuluar paraqitet edhe në bilancin e gjendjes së ndërmarrjes.
lista përmbyllëse	-formulari në të cilin bëhet përmbledhja e qarkullimit dhe saldove, kontrollimi i korrektesisë së regjistrimeve, grumbullimi i qarkullimit dhe përcaktimi i saldove.
regjistrime përmbyllëse	-regjistrime në ditarin dhe në librin kryesor në fund të periudhës përlllogaritëse për harmonizimin e vlerës së mbajtjes së kontabilitetit me vlerën faktike të kategorive kontabiliste, për bashkimin e dy kontove të përkohshme në saldo zero me qëllim të përpilimit të llogarisë vjetore, përfundimtare dhe hapjes së terrenit për periudhën e re përlllogaritëse.
përfitimi	-dallimi ndërmjet të hyrave të përgjithshme dhe të dalave të përgjithshme.
parashkrimi	-procesi në të cilin mjetet e caktuara bëhen joadekuate për përdorim para harxhimit fizik të tyre, për shkak të zhvillimit të shpejtë tekniko-teknologjik dhe ndryshimeve të shpejta të tregut.
ndikimi i rëndësishëm	-pjesëmarrja e mundshme në politikën e vendimmarrjes financiare dhe afariste por jo edhe kontroll mbi atë politikë..
çek	-urdhëresë e shkruar për pagesën e shumës së shënuar të parave; instrument pagese me para në dorë.

Literatura:

1. T. Rusevski, B. Nedev, Z. Bozhinovska, Lj. Janevski, Z. Minovski, "Hyrje në kontabilitetin", Shkup 2004;
2. T. Rusevski, B. Nedev, Z. Bozhinovska, Lj. Janevski, Z. Minovski, "Përmbledhje e detyrave", Shkup 2005;
3. Desa B. Kosarkoska, "Kontabiliteti", Ohër 2006;
4. Desa B. Kosarkoska, "Ushtrime kontabiliteti", Ohër 2006;
5. Trajko A. Rusevski, Sasha TTVrtkoviq "Kontabiliteti financiar", Shkup 2006;
6. Trajko A. Rusevski, "Kontabiliteti-detyra, zgjidhje dhe album", Shkup 2003;
7. Sillobodan Markovski, "Kontabiliteti", Shkup 1992;
8. Zdravko Zdravkovski, "Kontabiliteti-mësimi dhe praktika", Prilep 2004;
9. Ljubço Stojçeski, Aleksandar Kostadinovski, "Bazat e kontabilitetit", Shkup 2007;
10. Trajko Rusevski, "Kontabiliteti", Shkup 1992
11. Trajko Rusevski, "Kontabiliteti për fillestarë", Shkup 1997
12. Sasho Kozhuharov, Pavlina Vitanova, Anita Srçeska, "Kontabiliteti", Shkup 2006;
13. Trajçe Kolev, "Analiza kontabiliste", Shkup 2007
14. Serafim Tomovski, Ljubisha Janev, Zorica Bozhinovska, Desa Kosarkoska, "Bazat e kontabilitetit", Shkup 1994;
15. Serafim Topmovski "Përmbledhje e detyrave për bazat e kontabilitetit", Shkup 2002;
16. Trajko Rusevski, "Plani i kontos dhe tabelat", Shkup 2009;
17. T. Rusevski, B. Nedev, Z. L Lazarov, Lj. Janevski, Z. Minovski, "Përmbledhje e detyrave për bazat e kontabilitetit", Shkup 2007;
18. Ligji për kontabilitetin- Gazeta Zyrtare e R. M. 42/93;
19. Ferri Piero(ed.), Prospects for the European Monetary System, Macmillan, London, 1990;
20. Grup autorësh, Manuali i madh financiar, Libri 1 dhe 2, Pasqyrimi ekonomik, Beograd 1975;
21. Ligji për shoqëritë tregtare, Shkup 2003;
22. Ligji për letrat me vlerë, Shkup 2001;
23. P. Jovanovski, "Menaxhimi financiar", Shkup 2005;
24. P. Jovanovski, "Tregjet financiare dhe institucionet", Shkup 2004;
25. B. Shukljevi, Lj. Drakuleski, "Menaxhimi i biznesit të vogël", Shkup 2004;
26. Rafajllovski konsallting "Reprezent", Shkup 2001.

PËRMBAJTJA

Faqe

Hyrje -----	3
Tema 1: Bazat e kontabilitetit -----	5
Kontabiliteti si burim i informatave dhe si formë e komunikimit-----	6
Shfrytëzuesit e informatave kontabiliste-----	7
Nocioni, domethënia dhe roli i kontabilitetit financiar-----	10
Rregullativa profesionale në profesionin kontabilist -----	13
Parimet kontabiliste dhe rregullat-----	22
Kontabiliteti i dyfishtë-----	19
Tema 2: Mjetet, obligimet dhe kapitali -----	17
Mjetet -----	23
Mjetet e përhershme -----	24
Mjetet jo materiale (investimet) -----	24
Mjetet materiale (investimet) -----	25
Mjete financiare afatgjate (investimet)-----	27
Mjete rrjedhëse (qarkulluese)-----	27
Burimet e mjeteve -----	29
Kapitali (kryegjëja) -----	29
Obligimet -----	31
Formula bazike (fundamentale) kontabiliste -----	32
Bilanci i gjendjes (nocioni, forma dhe përmbajtja)-----	34
Parimet e bilancimit-----	36
Tema 3: Ngjarjet kontabiliste dhe llogaritë -----	46
Nocioni ngjarje kontabiliste -----	47
Grupet bazike të ngjarjeve dhe ndikimi i tyre mbi bilancin gjendjes -----	49
Rritja e shumës së bilancit -----	50
Zvogëlimi i shumës së bilancit -----	53
Ndryshimet strukturore në aktiven -----	54
Ndryshimet strukturore në pasiven -----	55
Nocioni llogari-----	57
Rregullat për evidentimin e llogarive -----	59
Katër grupet e ngjarjeve për regjistrimin e mjeteve dhe burimeve-----	61
Hapja e llogarive në bazë të bilancit të gjendjes-----	64
Llojet e llogarive -----	66
Llogari për mjetet dhe llogari për burimet -----	66
Llogari aktive, pasive dhe aktive-pasive-----	67
Llogari sintetike dhe analitike -----	69
Llogari të tërësishme, të pa tërësishme dhe korrektive -----	70
Llogari të gjendjes, suksesit dhe të përziera-----	71
Saldoja e llogarive -----	71
Format e llogarive -----	72
Tema 4: Librat e kontabilitetit -----	81
Radhitja e procedurës kontabiliste -----	82
Analiza e transaksioneve afariste në bazë të dokumenteve bazike -----	82
Kontimi në urdhëresë-----	84
Evidentimi në ditar (evidenca kronologjike)-----	85

Evidentimi i llogarive në librin kryesor (evidentimi sistemor)-----	87
Evidentimi analitik (libra ndihmës)-----	88
Përmbledhja e ndryshimeve në llogaritë dhe në ditarin, përmbyllja e tyre, përpilimii pasqyrimeve dhe bilanceve-----	89
Tema 5: Plani përlllogaritës -----	93
Plani përlllogaritës -----	94
Qëllimet, detyrat dhe parimet e planit përlllogaritës -----	95
Sistemet e përpilimit të planit përlllogaritës-----	97
Funksionet e klasave-----	98
Tema 6: Evidentimi i qarkullimit pagesor me para në dorë dhe jo me para në dorë dhe kërkesa -----	101
Mjete parash -----	102
Evidenca e mjeteve të parave në arkën-----	102
Evidenca e mjeteve të parave në Xhirollogarinë-----	107
Mjete e veçuara të parave dhe akreditivat-----	110
Llogaria devizore -----	112
Letra me vlerë -----	116
Kërkesa (llogari të cilat duhet të arkëtohen) -----	119
Kërkesa prej blerësve -----	119
Kërkesa të dyshimta dhe kontestuese -----	122
Kërkesa të tjera nga raportet afariste -----	123
Tema 7: Evidentimi i harxhimeve materiale -----	133
Evidenca e rezervave -----	134
Evidenca e materialeve, pjesëve rezerve dhe inventarit të imët -----	134
Definimi i materialeve-----	134
Procedura dhe dokumentacioni gjatë furnizimit të materialeve-----	135
Çmimet e materialeve -----	136
Rregullat për regjistrimin e rezervave të materialeve -----	137
Harxhime-nocioni -----	148
Harxhime - llojet e harxhimeve -----	148
Evidenca e harxhimit të materialeve (me dhënien nga rezerva)-----	151
Evidenca e harxhimit të materialeve (materiale të furniz. të harxhuara) -----	157
Shërbime me karakter të harxhimeve materiale -----	158
Rezervimet e kalkuluara të harxhimeve dhe rreziqeve -----	159
Evidenca e amortizimit-----	160
Harxhimet jo materiale-----	163
Rrogat e kompensimet -----	165
Renditja e harxhimeve-----	168
Tema 8: Evidenca e obligimeve dhe kapitalit (burimet e mjeteve) -----	180
Burimet e mjeteve -----	181
Kapitali si burim i mjeteve -----	181
Kapital i dominuar (i përhershëm)-----	183
Obligimet si burimet e mjeteve-----	186
Obligimet afatgjata -----	186

Obligimet rrjedhëse -----	188
Tema 9: Të hyra dhe të dala -----	193
Nocioni dhe grupimi i të hyrave -----	194
Nocioni dhe grupimi i të dalave -----	195
Përmbajtja dhe forma e bilancit të suksesit -----	197
Tema 10: Rezultati financiar -----	202
Rezultati financiar -----	203
Përcaktimi i të hyrave dhe të dalave -----	203
Përcaktimi kontabilist i rezultatit -----	204
Përcaktimi i fitimit neto (fitimi pas tatimit) -----	205
Shpërndarja e fitimit -----	206
Nocionet -----	209
Literatura -----	217

